

# HUMAN RIGHTS HUMAN

## RAPORTI I SHOQËRISË CIVILE PËR TË DREJTAT E NJERIUT

NË KOSOVË NË VITIN 2024

MAJ 2025

# PËRMBAJTJA

---

## 1. HYRJE

---

## 2. KORNIZA METODOLOGJIKE

---

## 3. KORNIZA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË

---

## 4. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

---

## 5. PJESA A: TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE

---

- 5.1 . E drejta për jetën
- 5.2 . Ndalimi i torturës dhe trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues
- 5.3 . E drejta për liri dhe siguri personale
- 5.4 . E drejta për proces të drejtë gjyqësor dhe mjete juridike efektive
- 5.5. Liria e shprehjes dhe e mendimit, e drejta për informim dhe e drejta për privatësi
- 5.6. Liria e tubimit paqësor
- 5.7. Liria e asociimit
- 5.8. Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

## 6. PJESA B: TË DREJTAT EKONOMIKE, SOCIALE DHE KULTURORE

---

- 6.1 Të drejtat e punës
- 6.2 E drejta për arsim
- 6.3. E drejta për kujdes shëndetësor
- 6.4. Të drejtat pronësore
- 6.5. Të drejtat kulturore

## 7. PJESA C: TË DREJTAT E PERSONAVE DHE GRUPEVE TË ÇAKTUARA

---

- 7.1. Të drejtat e grave dhe barazia gjinore
- 7.2. Të drejtat e fëmijëve
- 7.3. Të drejtat e të rinjve
- 7.4. Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara
- 7.5. Të drejtat e komuniteteve jo-shumicë
- 7.6. Të drejtat e personave LGBTIQ+
- 7.7. Personat në lëvizje

## 8. PJESA D: ÇËSHTJE TË NDËRLIDHURA/ÇËSHTJE SPECIFIKE LIDHUR ME TË DREJTAT E NJERIUT

---

- 8.1. Drejtësia tranzicionale dhe të drejtat e njeriut
- 8.2. Korrupsioni dhe të drejtat e njeriut
- 8.3. Mjedisi dhe të drejtat e njeriut
- 8.4. E drejta për barazi dhe mosdiskriminim

# LISTA E TERMEVE DHE SHKURTESAVE

|                             |                                                                                                        |
|-----------------------------|--------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>AGK</b>                  | Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës                                                                    |
| <b>AIP</b>                  | Agjencia për Informim dhe Privatësi e Kosovës                                                          |
| <b>AKKVP</b>                | Agjencia Kosovare për Krahësim dhe Verifikim të Pronës                                                 |
| <b>ANJF</b>                 | Agjencia për Ndihmë Juridike Falas                                                                     |
| <b>ASK</b>                  | Agjencia e Statistikave të Kosovës                                                                     |
| <b>Ashkali-K</b>            | Ashkali/ke i/e Kosovës                                                                                 |
| <b>BE</b>                   | Bashkimi Evropian                                                                                      |
| <b>CPT</b>                  | Komiteti Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimin ose Ndëshkimit<br>Çnjerëzor ose Poshtëruar |
| <b>DUDNJ</b>                | Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut                                                          |
| <b>Egjiptian-K</b>          | Egjiptian/e i/e Kosovës                                                                                |
| <b>GJEDNJ</b>               | Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut                                                             |
| <b>IAPK</b>                 | Institucioni i Avokatit të Popullit i Kosovës                                                          |
| <b>IPK</b>                  | Inspektorati i Policisë së Kosovës                                                                     |
| <b>KDF</b>                  | Konventa për të Drejtat e Fëmijës                                                                      |
| <b>KDPAK</b>                | Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara                                             |
| <b>KEDNJ</b>                | Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut                                                            |
| <b>KGJK</b>                 | Këshilli Gjyqësor i Kosovës                                                                            |
| <b>KiE</b>                  | Këshilli i Evropës                                                                                     |
| <b>KiK</b>                  | Kuvendi i Kosovës                                                                                      |
| <b>Komisioni i Venecias</b> | Komisioni Evropian për Demokraci përmes Ligjit                                                         |
| <b>KPK</b>                  | Këshilli Prokurorial i Kosovës                                                                         |
| <b>KPM</b>                  | Komisioni i Pavarur i Mediave                                                                          |
| <b>LGBTIQ+</b>              | lezbike, gej, biseksualë, transgjjinorë, interseksualë dhe queer                                       |
| <b>MASHTI</b>               | Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit                                            |
| <b>MD</b>                   | Ministria e Drejtësisë                                                                                 |
| <b>MFPT</b>                 | Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve                                                           |
| <b>MKRS</b>                 | Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve                                                              |
| <b>MSH</b>                  | Ministria e Shëndetësisë                                                                               |
| <b>OBSH</b>                 | Organizata Botërore e Shëndetësisë                                                                     |
| <b>OHCHR</b>                | Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut                          |
| <b>OJQ-të</b>               | Organizatë(a) joqeveritare                                                                             |
| <b>OKB</b>                  | Kombet e Bashkuara                                                                                     |
| <b>OSBE</b>                 | Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë                                                        |
| <b>OSHC-të</b>              | Organizata(t) e shoqërisë civile                                                                       |
| <b>PISA</b>                 | Programi për Vlerësim Ndërkombëtar të Nxënësve                                                         |

|                          |                                                                                           |
|--------------------------|-------------------------------------------------------------------------------------------|
| <b>PKBGj</b>             | Programi i Kosovës për Barazi Gjinore                                                     |
| <b>Plani i</b>           |                                                                                           |
| <b>Ahtisaarit (2007)</b> | Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës                            |
| <b>PNDKP</b>             | Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike                                     |
| <b>PNDESK</b>            | Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore                        |
| <b>PZhBV</b>             | Persona të zhvendosur brenda vendit                                                       |
| <b>QeK</b>               | Qeveria e Kosovës                                                                         |
| <b>Rom-K</b>             | Rom/e i/e Kosovës                                                                         |
| <b>RrDNj</b>             | Rrjeti për të Drejtat e Njeriut në Kosovë                                                 |
| <b>Serb-K</b>            | Serb/e i/e Kosovës                                                                        |
| <b>ShKK</b>              | Shërbimi Korrektues i Kosovës                                                             |
| <b>Shqiptar-K</b>        | Shqiptar/e i/e Kosovës                                                                    |
| <b>UNESCO</b>            | Organizata e Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë                          |
| <b>UNHCR</b>             | Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët                                 |
| <b>UNICEF</b>            | Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët                                                  |
| <b>ZQM</b>               | Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Mosdiskriminim |

## 1. HYRJE

**1.** Raporti i Shoqërisë Civile<sup>1</sup> për të Drejtat e Njeriut në Kosovë ofron një pasqyrë të përgjithshme të situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë në vitin 2024. Ai përfshin çështjet/zhvillimet kryesore, shkeljet e të drejtave të njeriut dhe sfidat ndaj realizimit efektiv të të drejtave të njeriut në praktikë. Raporti është hartuar bashkërisht nga organizatat e shoqërisë civile (OSHC) që punojnë në një numër të larmishëm fushash relevante për të drejtat e njeriut. Ky Raport synon të shërbejë si një mjet i pavarur për të vlerësuar situatën e përgjithshme të të drejtave të njeriut në Kosovë, duke plotësuar kështu një boshllëk ekzistues në raportimin e përbashkët për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në nivel lokal dhe ndërkombëtar, përveç rritjes së bashkëpunimit dhe koordinimit midis OSHC-ve.

**2.** Raporti është strukturuar në katër pjesë kryesore: **Pjesa A** i trajton të drejtat civile dhe politike, ku përfshihen e drejta për ndalimin e torturës dhe trajtimit ose ndëshkimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues; e drejta për liri dhe siguri personale, e drejta për proces të drejtë gjyqësor dhe qasje në drejtësi; liria e shprehjes, mendimit, informimit dhe e drejta për privatësi; liria e tubimit paqësor; liria e organizimit dhe liria e mendimit, e fesë dhe e ndërgjegjes. Në **Pjesën B** analizohen të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, siç është e drejta për arsim; e drejta për kujdes shëndetësor; të drejtat e punës, dhe të drejtat pronësore, dhe përfundon me një pasqyrë të të drejtave kulturore. **Pjesa C** trajton të drejtat e personave në situata të cenueshme, si të drejtat e fëmijëve, të rinjve, personave me aftësi të kufizuara, komuniteteve jo-shumicë, komuniteteve LGBTIQ+ dhe personave në lëvizje. Raporti përmbyllet me **Pjesën D**, ku shtjellohen një numër çështjesh të ndërlidhura dhe specifike për të drejtat e njeriut, siç janë drejtësia tranzicionale dhe të drejtat e njeriut, korrupsioni dhe të drejtat e njeriut, ndikimi i çështjeve mjedisore në të drejtat e njeriut, si dhe e drejta për barazi dhe mosdiskriminim.

## 2. KORNIZA METODOLOGJIKE

**3.** Raporti i përbashkët i OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut 2024 shërben si pasqyrë gjithëpërfshirëse e situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë në vitin 2024. Dokumenti trajton fushat kritike për kuptimin e zhvillimit të të drejtave të njeriut në Kosovë në kontekstin e zhvillimit të saj të vazhdueshëm si një shtet demokratik që ka në qendër vlerat universale të të drejtave dhe lirive të njeriut. Metodologjia bazohet në nevojën për një perspektivë me spektër të gjerë e cila e kombinon aspektin e politikave me praktikën dhe përvojat. Si i tillë, raporti i përbashkët i OSHC-ve dallon nga përmbledhjet e tjera për të drejtat e njeriut në Kosovë. Edhe pse raporti është gjithëpërfshirës, duhet pranuar se ka kufizime në atë që është mbuluar.

<sup>1</sup> Raporti i fundit i shoqërisë civile mbi gjendjen e të drejtave të njeriut në Kosovë për vitin 2023. Ky raport është dorëzuar me mbështetjen financiare të Komponentës për të Drejtat e Njeriut në kuadër të Administratës së Përkohshme të Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) dhe Zyrës së Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR).

**4.** Duke u bazuar në metodologjinë e zhvilluar nga Zyra e Komisionerit të Lartë të Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut (OHCHR), e cila ka të bëjë me zhvillimin e treguesve të të drejtave të njeriut, që nga viti 2022 në këtë raport është përdorur një metodologji e rishikuar që na mundëson të bëjmë krahasime kundrejt periudhave kohore. Në bazë të listave të treguesve të zhvilluar për çdo pjesë të të drejtave të njeriut, të dhënat e mbledhura pasqyrojnë jo vetëm një përpjekje cilësore për ta kuptuar kontekstin, por ato janë gjithashtu rezultat i një pune apo metodologjie sasore për matjen e situatës së të drejtave të njeriut.

**5.** Procesi i hartimit të raportit kishte për bazë parimin e pjesëmarrjes dhe pronësisë së plotë të OSHC-ve kryesore që punojnë në fushën e të drejtave të njeriut në nivel lokal dhe qendror. Mbledhja e të dhënave për përpilimin e raportit të përbashkët të OSHC-ve u krye përmes disa qasjeve. Së pari, raporti është rezultat i kontributeve përkatëse të 40 OSHC-ve që punojnë në çështje të caktuara të të drejtave të njeriut. Përveç kësaj, për herë të parë në procesin e hartimit të Raportit të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut, u zhvilluan intervista me OSHC-të përkatëse për të diskutuar çështje specifike të të drejtave të njeriut dhe për të verifikuar të dhëna të caktuara nga fushat e tyre përkatëse të ekspertizës. Kjo na mundësoi strukturimin e raportit në katër pjesët që i përmendëm më sipër, përkatësisht Pjesa A, B, C dhe D. Për fund, ky raport u mbështet edhe në një hulumtim të gjerë të dokumentacionit. Për secilën nga pjesët themelore, të dhënat u mbledhën nga një sërë burimesh të besueshme. Përveç kësaj, raporti kaloi në tre faza të njëpasnjëshme rishikimi gjatë procesit të hartimit. Me anë të tri takimeve konsultative të organizuara nga Rrjeti për të Drejtat e Njeriut<sup>2</sup> (RrDNj, nëntor 2024, shkurt 2025 dhe mars 2025), OSHC-të kontribuese patën mundësi t'i diskutonin gjetjet dhe të jepnin sugjerime të cilat më pas u përfshinë në raportin e përbashkët të OSHC-ve. Për më tepër, procedurat konsultative u mundësuan edhe me anë të korrespondencës me e-mail ndërmjet OJQ-së YIHR KS dhe hulumtuesve të kontraktuar.

**6.** 40 OJQ-të vijuese kontribuan në këtë raport: Activism Roots, Advancing Together (AT), Qendra për Trajnim dhe Burime për Avokim (ATRC), Qendra Avokuese për Kulturë Demokratike (ACDC), AKTIV, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK), Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës (HANDIKOS), Balkan Green Foundation (BGF), Rrjeti Ballkanik i Gazetarisë Hulumtuese në Kosovë (BIRN Kosova), Qendra për Veprime Afirmative Sociale (CASA), Qendra për Barazi dhe Liri (CEL), Qendra për Informim dhe Përmirësim Social (QIPS), Programi për të Drejtat Civile në Kosovë (CRP/K), Durmish Aslano, Pro Peace, Instituti GAP, Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë (FDHK), Instituti për Avokimin e Politikave Korrektuese (IAPK), Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Kosovo Young Lawyers (KYL), Kosovo Women for Women (KW4W), Rrjeti i Grave të Kosovës (RRrGK), Lëvizja FOL, Medica Gjakova, Qendra Burimore për Persona të Zhdukur (MPRC), Iniciativa e Re Sociale (NSI), OJQ Pishtaret, Rrjeti i Organizatave të Grave Rome, Ashkali dhe Egjiptase të Kosovës (RROGRAEK), Qendra për Informim, Kritikë dhe Aksion (QIKA), Save the Children Kosova/o, Syri i Vizionit, Terre des Hommes (TDH), The Ideas Partnership, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), TOKA, OJQ "Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptianëve (VoRAE), Vullnetaret e Qytetit (VEQ), Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (YIHR KS).

<sup>2</sup> Rrjeti për të Drejtat të Njeriut (HRN) (2024). RrDNj është rrjet i përbërë prej shtatë organizatash që punojnë së bashku në avancimin e mëtejshëm të të drejtave të njeriut për të gjithë në Kosovë. Anëtarë të RrDNj janë: Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut – Kosovë (YIHR KS), Shoqata e Paraplegjikëve dhe e Paralizës së Fëmijëve të Kosovës - HANDIKOS, Qendra për Barazi dhe Liri (CEL), Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD), Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ), Iniciativa e Re Sociale (IRS), Zëri i Romëve, Ashkalive dhe Egjiptasve (VoRAE). YIHR KS është themeluese dhe organ sekretarial i RrDNj-së.

### 3. KORNIZA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTAT E NJERIUT NË KOSOVË

**7.** Përkushtimi i Kosovës për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut është i ngulitur fort në Kushtetutën dhe legjislacionin e vendit, duke përdorur një qasje gjithëpërfshirëse tri-pjesëshe. Para së gjithash, Kushtetuta përfshin dispozita të shumta kushtuar mbrojtjes së lirive themelore dhe të drejtave të njeriut. Neni 3 i Kushtetutës shprehimisht i obligon autoritetet publike në Kosovë që të sigurojnë trajtim të barabartë para ligjit dhe respektim të palëkundur të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të njohura ndërkombëtarisht. Për më tepër, neni 7 i Kushtetutës vendos parimet themelore të rendit kushtetues të Kosovës, duke theksuar vlerat si barazia, respektimi i të drejtave dhe lirive të njeriut dhe mosdiskriminimit, duke e njohur specifikisht barazinë gjinore si parim themelor. Kapitulli II i Kushtetutës përcakton dispozita të përpikta që mbrojnë të drejtat civile dhe politike, duke përfshirë të drejtën për një proces të drejtë gjyqësor, të drejtën për privatësi, dhe lirinë e mendimit dhe të shprehjes, tubimit paqësor, asociimit, si dhe të lëvizjes. Ai gjithashtu parashikon mbrojtje për të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, duke përfshirë të drejtën për arsim dhe lirinë e profesionit. Në veçanti, neni 53 i Kushtetutës përcakton që çdo interpretim i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të garantuara me Kushtetutën e Kosovës duhet të jetë në harmoni me praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.

**8.** Së dyti, Kosova i ka përfshirë disa instrumente ndërkombëtare për të drejtat e njeriut në kornizën e saj ligjore vendore. Një përfshirje e tillë bazohet në nenin 22 të Kushtetutës, i cili përcakton se nëntë instrumente të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB) dhe të organizatave tjera rajonale për të drejtat e njeriut janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë, duke ofruar kështu një bazë ligjore shtesë për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të njeriut në Kosovë. Në shtator të vitit 2020, Kuvendi i Kosovës e ndryshoi nenin 22 duke e përfshirë edhe Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje (Konventa e Stambollit) në mesin e instrumenteve drejtpërdrejt të zbatueshme për të drejtat e njeriut, duke shënuar kështu një avancim të rëndësishëm për të drejtat e grave. Të gjitha këto instrumente për të drejtat e njeriut janë drejtpërdrejt të zbatueshme dhe kanë prioritet ndaj legjislacionit të Kosovës apo akteve të tjera të institucioneve publike në rast konflikti, konstatim ligjor ky i konfirmuar edhe nga praktika gjyqësore e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës.<sup>3</sup> Edhe pse Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore (KNDESK) nuk është ndër instrumentet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut që zbatohet drejtpërdrejt në Kosovë, Kuvendi i Kosovës e miratoi Agjendën 2030 dhe 17 Objektivat e saj për Zhvillim të Qëndrueshëm me një rezolutë unanime më 24 janar 2018, duke ofruar kështu një rrugë të rëndësishme për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave ekonomike, sociale dhe kulturore në Kosovë.

**9.** Vlen të përmendet se viti 2024 shënoi 76-vjetorin e Këshillit të Evropës (KiE). Në këtë vit të veçantë, Kosova arriti me sukses të marrë një rekomandim pozitiv për anëtarësim nga Asamble-

3 Gjykata Kushtetuese e Kosovës, rasti nr. [Kl207/19](#), paragrafët 105-111.



ja Parlamentare e Këshillit të Evropës (APKE).<sup>4</sup> Në opinionin e saj Nr. 302(2024) të 16 prillit 2024, APKE konfirmoi se “aspiratat e Kosovës për t’u anëtarësuar në Këshillin e Evropës duhet të marrin përgjigje pozitive” dhe se anëtarësimi në këtë organizatë do të çonte në forcimin e standardeve të të drejtave të njeriut duke siguruar më në fund qasje në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut për të gjithë ata që bien nën juridiksionin e Kosovës.<sup>5</sup> Edhe pse APKE-ja e pranoi progresin e arritur nga institucionet e Kosovës në fushën e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe sundimit të ligjit, kishte shumë fusha ku konsiderohej se nevojiteshin arritje dhe përpjekje të mëtejshme.<sup>6</sup> Pranimi i Kosovës në këtë organizatë tani pret fazën përfundimtare të votimit nga Komiteti i Ministrave.<sup>7</sup> Anëtarësimi në këtë organizatë do të ndihmojë në eliminimin e boshllëkut ekzistues të monitorimit me disa konventa të Këshillit të Evropës të cilat janë drejtpërdrejt të zbatueshme në Kosovë në përputhje me nenin 22 të Kushtetutës.

**10.** Së treti, Kapitulli III i Kushtetutës ofron garanci ekskluzive dhe mbrojtje të veçantë për komunitetet jo-shumicë në Kosovë. Këto garanci konsiderohen si “të drejta specifike” përveç të drejtave të tjera të parashikuara nga Kapitulli II i Kushtetutës, të cilat zbatohen ekskluzivisht për banorët që i përkasin të njëjtit grup kombëtar, etnik ose fetar historikisht të pranishëm në Kosovë.<sup>8</sup> Ndër klauzolat e tjera mbrojtëse standarde, ky Kapitull përfshin edhe disa dispozita shtesë që sigurojnë masa afirmative në mbrojtjen politiko-ekonomike dhe sociale të komuniteteve jo-shumicë në Kosovë.<sup>9</sup>

**11.** Kosova ka krijuar organe dhe mekanizma të dedikuar për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut, siç janë Institucioni i Avokatit të Popullit, Zyra për Qeverisje të Mirë, të Drejta të Njeriut, Mundësi të Barabarta dhe Kundër Diskriminimit (ZQM), Këshilli Presidencial për Demokraci, Grupi Koordinues Ndërmator për të Drejtat e Njeriut, Zyra e Komisionerit të Gjuhëve, Agjencia për Barazi Gjinore, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, Agjencia për Informim dhe Privatësi dhe Komiteti i Kuvendit për të Drejtat e Njeriut, si disa nga institucionet kryesore.

**12.** OSHC-të në Kosovë luajnë gjithashtu një rol shumë të rëndësishëm në monitorimin e zbatimit të kornizës së përgjithshme për të drejtat e njeriut dhe raportimin vjetor mbi arritjet, progresin, pengesat dhe dështimet. Raporti vjetor i publikuar bashkërisht nga OSHC-të në Kosovë që nga viti 2018 është një instrument kyç në përcjelljen dhe raportimin metodik të gjendjes së të drejtave të njeriut në Kosovë. Në këtë mënyrë, raporti i mban institucionet publike përgjegjëse për kushtet e të drejtave të njeriut në Kosovë dhe shqyrton në detaje sfidat sistematike me të cilat ballafaqohen grupet e marginalizuara në angazhimin e tyre me segmente të ndryshme të shoqërisë. Më konkretisht, OSHC-të sigurojnë llogaridhënie duke formuluar rekomandime që identifikojnë në mënyrë të qartë akterët përkatës. Pasi të publikohet raporti, RrDNj-ja jo vetëm që e shpërndan raportin, por gjithashtu i dërgon rekomandimet specifike institucioneve përkatëse përmes e-mailit dhe përmes kërkesave për dialog. Në këtë mënyrë, RrDNj-ja ia dorëzoi institucioneve përkatëse përmes email-it më shumë se 200 rekomandime të lëshuara në raportin e vitit 2023. Më pas, zbatimi i këtyre rekomandimeve u diskutua gjatë një takimi të Komitetit për Dialog ndërmjet OSHC-ve dhe institucioneve publike më 30 janar 2025. Ky takim shërbeu si dëshmi për besueshmërinë dhe ndikimin

4 Shih [Rekomandimi i APKE-së](#) që Kosova të bëhet anëtare e Këshillit të Evropës.

5 Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (2024), [Opinion nr. 302\(2024\)](#), 16 prill 2024.

6 Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës (2024), [Opinion nr. 302\(2024\)](#), 16 prill 2024, paragrafët 13-15.

7 Për më shumë detaje mbi hapat e anëtarësimit drejt Këshillit të Evropës, shih, Grupi për Hulumtimin e Politikave në Ballkan (2023), [Kosova dhe Këshilli i Evropës: Udhërrëfyti i anëtarësimit](#).

8 Neni 57 i Kushtetutës.

9 Shih për shembull, nenet 59, 60, 61 dhe 62 të Kushtetutës.



e shtuar të raportit të OSHC-ve si një burim kritik i gjendjes së të drejtave të njeriut në Kosovë. Dialogu jo vetëm që u përcoll me pjesëmarrjen e shumë institucioneve publike krahasuar me vitet e mëparshme, por shfaq edhe angazhimin e institucioneve në zbatimin e rekomandimeve. Në të vërtetë, gjatë këtij takimi u sqarua se një numër i konsiderueshëm rekomandimesh janë në proces të adresimit ose tashmë janë adresuar plotësisht. Ky është një zhvillim inkurajues që i motivon më tej OSHC-të në Kosovë që të vazhdojnë monitorimin e tyre dhe të propozojnë mënyra kreative për zgjidhjen e çështjeve të ndryshme të të drejtave të njeriut në Kosovë dhe kështu t'i ndihmojnë institucionet publike në përmbushjen e qëllimeve të tyre e nga të cilat do të përfitonte shoqëria në përgjithësi dhe grupet e marginalizuara në veçanti. Megjithatë, një numër institucionesh as nuk iu përgjigjën e-mailit dhe as nuk morën pjesë në takimin e OSHC-ve dhe institucioneve, gjë që vazhdon të jetë shpërfillje e përgjegjësisë të tyre.

## 4. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

**13.** Në vitin 2024, Kosova kaloi nëpër zhvillime të rëndësishme lidhur me të drejtat e njeriut, po megjithatë mbeten sfida të vazhdueshme në sigurimin e mbrojtjes dhe zbatimit të plotë të të drejtave civile, politike, ekonomike, sociale dhe kulturore. Ky raport i përpiluar nga OSHC-të, ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të të drejtave të njeriut në Kosovë, duke vlerësuar progresin, pengesat dhe rekomandimet për përmirësim.

**14.** Kosova vazhdoi të përballet me sfida në lidhje me të drejtat civile dhe politike, duke përfshirë të drejtën për jetë, trajtim njerëzor dhe ndalim të torturës. Edhe pse ekzistojnë kornizat legjislative, zbatimi i tyre mbetet i paqëndrueshëm, veçanërisht në lidhje me rastet e sjelljes së keqe të policisë dhe dhunës me bazë gjinore. Pavarësisht amandamenteve legjislative, ende përballemi me probleme të tilla si përdorimi i tepruar i forcës nga forcat e rendit, procedurat e stërzgjatura gjyqësore dhe sfidat në qasje në drejtësi. Femicidi mbetet një çështje shqetësuese, që u përcoll me një reagim të madh publik që i bënte thirrje autoriteteve të ndërmarrin veprime më vendimtare për të parandaluar dhunën me bazë gjinore.

**15.** Në sferën ekonomike, sociale dhe kulturore, raporti identifikon si progresin ashtu edhe pengesat. Investimet në kujdesin shëndetësor dhe arsim vazhduan, por problemet sistemike si mungesa e infrastrukturës mjekësore, shkeljet e të drejtave të punës dhe diskriminimi në qasjen në shërbime vazhduan. Për më tepër, zbatimi i ligjit të punës mbetet i dobët, duke ndikuar në të drejtat e punëtorëve dhe stabilitetin ekonomik.

**16.** Pavarësisht përpjekjeve për ta forcuar mbrojtjen ligjore, gratë, fëmijët, individët e komunitetit LGBTIQ+, komunitetet jo-shumicë, personat me aftësi të kufizuara dhe personat në lëvizje vazhdojnë të përballen me diskriminim dhe mbështetje të kufizuar institucionale. Raporti vë në pah sfidat në luftimin e dhunës në familje, adresimin e krimeve të urrejtjes dhe sigurimin e gjithëpërfshirjes sociale për grupet e marginalizuara. Megjithatë u bënë përmirësime legjislative, boshllëku në zbatim mbetet pengesë e rëndësishme për mbrojtje dhe barazi kuptimplotë.

**17.** Në adresimin e çështjeve të ndërlidhura të të drejtave të njeriut, drejtësia tranzicionale, korrupsioni dhe të drejtat mjedisore mbetën probleme kyçe në vitin 2024. Përparimi i Kosovës drejt integritetit në BE dhe anëtarësimit në Këshillin e Evropës ishte hap i rëndësishëm, megjithatë transparenca institucionale dhe llogaridhënia politike vazhdojnë të jenë fusha shqetësuese. Lufta kundër korrupsionit mbetet sfidë, me akuza për ndërhyrje politike në proceset gjyqësore që dëmtojnë besimin e publikut. Në fokus ishin edhe problemet mjedisore, veçanërisht në lidhje me ndotjen e ajrit dhe ujit, por zbatimi i ligjeve për mbrojtjen e mjedisit mbetet proces i mangët.

## 5. PJESA A: TË DREJTAT CIVILE DHE POLITIKE

### 5.1 E drejta për jetën

**18.** E drejta për jetën, e cila përkufizohet si e drejtë absolute, garantohet gjerësisht me ligje ndërkombëtare për të drejtat e njeriut. E drejta për jetën përcaktohet në nenin 3 të Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ), në Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (KNDCP) dhe në nenin 2 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ), duke përfshirë konventat e tjera ndërkombëtare. Në përputhje me përkufizimin e nenit 6 të KNDCP-së, e drejta për jetën është “e drejta e lindur e çdo personi për jetë” dhe e drejta për të mos u “privuar nga jeta në mënyrë arbitrare”.<sup>10</sup> Është e rëndësishme të theksohet se nuk lejohet shkelja e kësaj të drejte, as në kohën e krizave humanitare apo të luftës. Në vitin 2024, praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut vendosi për disa raste mbi të drejtën për jetë në lidhje me detyrimet pozitive të shtetit për të mbrojtur jetën e qytetarëve të vet.<sup>11</sup> Në nivel të Kushtetutës së Kosovës, e drejta për jetën e gjen bazën e saj ligjore në nenin 25 dhe nenin 22. Neni 25 në veçanti e ndalon dënimin me vdekje në Kosovë, çka është në përputhje me kërkesat e KEDNJ-së për ndalimin e vdekjes në të gjitha rrethanat. Detyrimi i shtetit në lidhje me të drejtën për jetën ka edhe dimensionin pozitiv, i cili kërkon nga shteti të ndërmarrë hapat e duhur për të mbrojtur jetën e atyre që janë në juridiksionin e tij.

**19.** Ashtu si në raportet e mëparshme të OSHC-ve, personat përgjegjës dhe autoritetet nuk kanë arritur t’i përgjigjen në mënyrë adekuate rasteve në rritje të femicidit në Kosovë, pavarësisht thirrjeve të vazhdueshme për veprime të shtuara në njohjen e problemit të dhunës dhe vrasjes me bazë gjinore.<sup>12</sup> Gjatë periudhës së fushatës “16 Ditë Aktivizëm Kundër Dhunës me Bazë Gjinore” në vitin 2024, u organizuan disa aktivitete nga institucionet publike (MD) dhe OSHC-të, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit mbi dhunën me bazë gjinore. Krahësuar me vitet e kaluara, Prokuroria veproi shpejt në përgatitjen e aktakuzave për tri raste të femicidit që ndodhën në prill dhe gusht 2024, me njëren prej rasteve që u mbyll pas pranimit të fajësisë nga Edmond Lajqi, ish-bashkëshorti i të

<sup>10</sup> Shih [OHCHR](#).

<sup>11</sup> Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (2024), [Udhëzues mbi Nenin 2 \(E Drejta për Jetën\) të KEDNJ-së](#); shih gjithashtu, Këshilli i Evropës (2024), [E drejta për jetën](#).

<sup>12</sup> Përkufizimi i *femicidit* marrë nga [UN Women](#), dhe mund të formulohet si: “vrasje e qëllimshme e lidhur me gjininë që mund të motivohet nga stereotipet gjinore, diskriminimi ndaj grave dhe vajzave, marrëdhëniet e pabarabarta të pushtetit ndërmjet grave dhe burrave ose normat e dëmshme shoqërore.”

ndjerës Gjyljeta Ukellaj.<sup>13</sup>Në një raport të kohëve të fundit (2023), Amnesty International thekson përpjekjet e dështuara të Qeverisë së Kosovës për t'i mbrojtur të mbijetuarit e dhunës në familje, duke kritikuar pengesat e shumta me të cilat përballen të mbijetuarit për të kërkuar mbrojtje dhe drejtësi. Pavarësisht rasteve në rritje të femicidit dhe kritikave pasuese publike, autoritetet kritikohen për fokusin e tyre të ngushtë në ndjekjen penale. Raporti gjithashtu kritikon fushatat e informimit publik që kryesisht i inkurajojnë të mbijetuarit t'i raportojnë rastet në polici, ndërkohë që nuk sfidojnë mjaftueshëm trajtimin mosrespektues nga zyrtarët e zbatimit të ligjit pas raportimit.<sup>14</sup>

**20.** Një ngjarje tragjike ndodhi në shkurt të vitit 2024 në Gjakovë, ku një vajzë e vogël 4-vjeçare humbi jetën në rrethana që sugjerojnë një mungesë të rëndë të kujdesit mjekësor dhe diskriminim të mundshëm. Ky incident jo vetëm që ka rezultuar në humbje të konsiderueshme personale për familjen, por ka ngritur edhe shqetësime rreth standardeve të praktikës mjekësore dhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve në shoqërinë e Kosovës. Disa OSHC, përkatësisht organizata pjesë të Rrjetit për të Drejtat e Njeriut, lëshuan një deklaratë publike për këtë humbje tragjike, duke u bërë thirrje autoriteteve lokale dhe qendrore të ndërmarrin veprime të menjëhershme për të hetuar thellësisht këtë rast. Është thelbësore që ky hetim të kryhet në mënyrë transparente, duke e mbajtur përgjegjëse për veprimet e veta çdo palë neglizhente. Për më tepër, ky incident duhet të shërbejë si katalizator për ndryshime sistemike brenda strukturave tona të kujdesit shëndetësor dhe social për të siguruar që çdo fëmijë të përmbushë të drejtën e vet për kujdes dhe mbrojtje.<sup>15</sup>

**21.** Për më tepër, OSHC-të janë të bindura në deklaratën e tyre se privatësia dhe dinjiteti i viktimës së familjes duhet të mbrohen. Sipas tyre, vajza e vogël u raportua të jetë anëtare e një komuniteti të marginalizuar etnik e cila pësoi lëndime si pasojë e një sulmi të dhunshëm dhe për këtë arsye kërkoi kujdes të menjëhershëm mjekësor. Megjithatë, akuzat sugjerojnë se trajtimi mjekësor që iu dha ishte jashtëzakonisht joadekuat, duke ngritur pyetje kritike në lidhje me shkallën në të cilën diskriminimi etnik mund të ketë kontribuar në pabarazitë në nivelin e kujdesit të ofruar. Incidente të tilla kontribuojnë në rënien e besimit të individëve me prejardhje të ndryshme etnike ndaj kujdesit shëndetësor të Kosovës dhe shkallës në të cilën ofrohet kujdes i përshtatshëm profesional për të gjithë qytetarët e Kosovës. Është e domosdoshme që për këtë humbje tragjike të kryhet një hetim i plotë dhe transparent mbi rrethanat që çuan në vdekjen e kësaj vajze të re, duke përfshirë edhe ekzaminimin e trajtimit shëndetësor që iu dha.<sup>16</sup>

**22.** Krahasuar me të gjitha raportet e mëparshme, jetëgjatësia në lindje nuk është përmirësuar dhe mbetet më e ulët në rajon, ndërsa incidenca e vdekshmërisë së foshnjave është më e larta. Për më tepër, barra financiare e drejtpërdrejtë mbi familjet mbetet e konsiderueshme, me shpenzime nga xhepi që vlerësohen të variojnë midis 30 dhe 40 përqind.<sup>17</sup>

13 Nacionale (2024), [2024: Edhe një vit i përgjakshëm me vrasje të grave](#).

14 Amnesty International (2023), [Kosovë: Autoritetet po i lënë në baltë viktimat e dhunës në familje](#)

15 Rrjeti për të Drejtat e Njeriut (2024), [Deklaratë Publike për Humbjen Tragjike të Jetës së një Fëmije në Gjakovë që Dyshohet se ka Rrjedhur si Rezultat i Neglizhencës Mjekësore](#).

16 Rrjeti për të Drejtat e Njeriut (2024), [Deklaratë Publike për Humbjen Tragjike të Jetës së një Fëmije në Gjakovë që Dyshohet se ka Rrjedhur si Rezultat i Neglizhencës Mjekësore](#).

17 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 69.

**23.** Në prill të vitit 2024, OJQ QIPS dhe 15 OJQ të tjera në Kosovë nisën petitionin për Projektligjin për Parandalimin e Vetëvrasjeve. Peticioni i kërkonte Kuvendit të hartonte një ligj që rregullon (i) shërbimet klinike për parandalimin e vetëvrasjeve, (ii) Integrimin e parandalimit të vetëvrasjeve në objektivat institucionale, (iii) mekanizmat për rritjen e profesionalizmit dhe vëmendjes mediatike në raportimin e rasteve të vetëvrasjeve; (iv) shërbimet dhe mbështetja sociale jo-klinike, (v) mekanizmat për zvogëlimin e qasjes në mjetet e vetëlëndimit, (vi) programet specifike për komunitetet jo-shumicë dhe (vii) mekanizmat për mbledhjen e të dhënave për vetëvrasjet.<sup>18</sup> Në shtator të vitit 2024, Kuvendit të Kosovës iu dorëzua peticioni me 13,361 nënshkrime. Ky peticion shënon fillimin e një procesi ligjor që synon krijimin e një kornize gjithëpërfshirëse të politikave për ta adresuar parandalimin e vetëvrasjeve për herë të parë në Kosovë.<sup>19</sup>

## 24. Rekomandimet

- Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve duhet të rrisë investimet publike në shërbimet shëndetësore duke mundësuar që Ministria e Shëndetësisë të bëjë reforma sistematike brenda sektorit të kujdesit shëndetësor;
- Ministria e Shëndetësisë duhet të krijojë një protokoll të fuqishëm reagimi ndaj emergjencave që siguron trajtim të barabartë pavarësisht nga etnia ose identiteti i individëve;
- Autoritetet e kujdesit shëndetësor në nivel lokal dhe agjencitë e tjera, përfshirë organet hetimore dhe mediat, duhet të zhvillojnë masa procedurale që respektojnë privatësinë dhe dinjitetin e viktimave dhe familjeve të tyre.

## 5.2 Ndalimi i torturës dhe trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues

**25.** Ndalimi i torturës dhe trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtërues njihet ndërkombëtarisht me Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut (DUDNJ, neni 5), Konventën Kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve të tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese (neni 1), Konventën Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike (neni 7) dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (neni 3). Në nivel lokal, Kushtetuta e Kosovës (Neni 27) ndalon torturën dhe çdo lloj trajtimi mizor, çnjerëzor ose degradues.

**26.** Në përputhje me nenin 5 të DUDNJ-së dhe nenin 27 të Kushtetutës së Kosovës, e drejta për trajtim njerëzor dhe ndalimi i torturës ka të bëjë, ndër të tjera, me integritetin fizik dhe mendor të personave të paraburgosur dhe të burgosur, kushtet e paraburgimit, përdorimi i forcës nga zyrtarët e zbatimit të ligjit ndaj civilëve dhe individëve jashtë paraburgimit dhe dhunës në komunitet dhe në familje. Sipas nenit 3 të KEDNJ-së, askush nuk duhet t'i nënshtrohet torturës, trajtimit dhe ndëshkimit çnjerëzor dhe poshtërues. Në vitin 2024, Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut vendosi për disa raste të rëndësishme mbi ndalimin e torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe poshtërues, me një fokus të veçantë në detyrimet pozitive të shtetit për të siguruar që kjo e drejtë të mos shkelet nga autoritetet shtetërore, duke përfshirë policinë, burgjet, gjykatat dhe zyrtarë të tjerë shtetërorë.<sup>20</sup>

18 QIPS (2024), [Komunikatë për media në Facebook lidhur me petitionin për Projektligjin për Parandalimin e Vetëvrasjeve](#)

19 QIPS (2024), [Komunikatë për media në Facebook në lidhje me dorëzimin e peticionit në KK](#).

20 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (2024), [Udhëzues mbi Nenin 3 \(Ndalimi i torturës\) të KEDNJ-së](#).

**27.** Teksa sistemi legjislativ në thelb mbronë kundër keqtrajtimit dhe torturës, nevojiten hapa të mëtejshëm për të siguruar që ato të zbatohen në mënyrë efektive në praktikë. Edhe pse legjislati i ri për ekzekutimin e sanksioneve penale është përgjithësisht në përputhje me standardet e BE-së, ekzistojnë dy akte ligjore zbatuese të cilat ende nuk janë miratuar në mënyrë që Ligji për Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale të jenë plotësisht funksionalë.<sup>21</sup> Sistemi i burgjeve në përgjithësi është në përputhje me Rregullat Minimale Standarde të OKB-së, por nevojiten përpjekje të mëtejshme për të siguruar që të drejtat e të burgosurve, veçanërisht grave, vajzave, anëtarëve të komunitetit jo-shumicë dhe të burgosurve me sëmundje mendore të respektohen.<sup>22</sup> Nuk u identifikuan raste të keqtrajtimit të të burgosurve.

**28.** Kur bëhet fjalë për policinë e Kosovës, Procedurat Standarde të Veprimit (PSV), përveç aspekteve të tjera të punës, përcaktojnë kodin e sjelljes për zyrtarët e policisë në rastet e hetimeve dhe marrjes në pyetje të individëve të arrestuar, sipas OJQ-së Instituti për Avokimin e Politikave Korrektuese (IAPK). E njëjta gjë vlen edhe për rastet e shkeljeve të të drejtave të njeriut nga zyrtarët e policisë. Shkeljet e vogla menaxhohen nga Njësia e Standardeve Profesionale, ndërsa shkeljet serioze adresohen në nivelin e Inspektoratit të Policisë së Kosovës (IPK). Për më tepër, Procedurat Standarde të Veprimit (PSV) të Qendrave të Paraburgimit i referohen procedurave që lidhen me mbajtjen e individëve të arrestuar në qelitë e paraburgimit deri në 48 orë, duke rregulluar kështu në mënyrë të veçantë mbrojtjet kundër keqtrajtimit. PSV të tilla janë rishikuar dhe miratuar në vitin 2019. Përveç kësaj, Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2019 mbi Shkeljet, Masat dhe Procedurat Disiplinore në Policinë e Kosovës përshkruan politikat mbi disiplinën, shkeljet dhe procedurat përkatëse. Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2019 përcakton zbatimin e parimeve ligjore, kërkesave institucionale dhe standardeve të të drejtave të njeriut, duke nxitur zbatimin e ligjit dhe përmirësimin e kushteve të punës.<sup>23</sup>

**29.** Teksa mbipopullimi në burgje raportohet si problem, IAP ka rekomanduar përmirësimin e kushteve në disa qendra korrektuese. Një numër në rritje i masave dhe dënimeve alternative të mbikëqyrura nga Shërbimi Sprovues i Kosovës u shënuar në vitin 2024.<sup>24</sup>

**30.** Inspektorati i Policisë së Kosovës rekomandoi pezullimin e dy zyrtarëve të policisë të akuzuar për rrahjen e një avokati serb të Kosovës, i cili u arrestua në veri të Mitrovicës.<sup>25</sup> Akuza të tjera për keqtrajtim u ngritën ndaj policisë së Kosovës nga protestuesit pas arrestimit të katër serbëve të Kosovës në shtator të vitit 2024.<sup>26</sup> Në vitin 2024, Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë pranoi 95 ankesa kundër policisë së Kosovës.<sup>27</sup>

**31.** Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) raportoi për një vizitë të veçantë të zhvilluar në Qendrën Korrektuese për të Mitur dhe Qendrën Korrektuese Edukative për të Mitur

21 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 32.

22 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 31-32.

23 IAPK (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

24 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024.

25 Balkan Insight (2024), [Policët e Kosovës të akuzuar për rrahjen e të ndaluarit duhet të pezullohen: Inspektorati](#).

26 Radio Evropa e Lirë (2024), [Protesta në veri të Mitrovicës](#).

27 IAP (2025), [Raporti Vjetor nr. 22](#), f. 19.



në Lipjan, me qëllim intervistimin e të miturve dhe monitorimin e respektimit të të drejtave të të miturve që mbahen në këto qendra korrektuese. Gjetjet kryesore të kësaj vizite të papritur përfshinin, ndër të tjera, probleme me: (i) temperaturat e larta në dhomat e të miturve gjatë verës që ndikojnë në shëndetin e tyre fizik dhe mendor, duke shkaktuar dehidratim dhe lodhje; (ii) ushqim me cilësi të dobët dhe të pamjaftueshëm për të miturit, gjë që ndikon në sistemin e tyre imunitar dhe rrit rrezikun e sëmundjeve; dhe (iii) mungesën e aktiviteteve që ndikon negativisht në zhvillimin e tyre, aftësitë e tyre të komunikimit dhe bashkëpunimit.<sup>28</sup> Për më tepër, raporti zbuloi gjithashtu se Kosovës i mungon një institucion i përshtatshëm ku të miturit e burgosur me probleme të shëndetit mendor mund të trajtohen në përputhje me rrethanat, një çështje që mund të përbëjë shkelje të të drejtave të tyre pasi i lë ata në një pozitë të pafavorshme në krahasim me të rriturit.<sup>29</sup> Rekomandimet e përcaktuara në Raportin e MKPT-së janë me rëndësi thelbësore për të siguruar që të drejtat e të miturve të burgosur të respektohen siç duhet.

**32.** Sipas OJQ-së Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), Kosova ka politika të qarta shëndetësore për qendrat e paraburgimit dhe burgjet, siç përcaktohen në Ligjin Nr. 08/L-132 Për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale. Këto politika sigurojnë që individët e dënuar të kenë qasje në të njëjtat standarde të kujdesit shëndetësor si komuniteti i përgjithshëm, pa pagesë, me Ministrinë e Shëndetësisë (MSH) që është përgjegjëse për ofrimin e shërbimeve të nevojshme mjekësore dhe kujdesit alternativ kur është e nevojshme. Për më tepër, Udhëzimi Administrativ Nr. 05/2014 për Funksionimin e Shërbimit Shëndetësor të Burgjeve përshtet organizimin dhe ofrimin e kujdesit shëndetësor për të burgosurit bazuar në Ligjin për Shëndetësi (neni 35, paragrafi 1, 2 dhe 3), Ligjin Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, Rregullat Evropiane të Burgjeve dhe rekomandimet e OBSH-së.<sup>30</sup> Edhe pse ekziston korniza ligjore, në praktikë nuk ofrohen shërbime adekuate. Ankesat e të burgosurve kanë të bëjnë kryesisht me qasjen dhe cilësinë e shërbimeve shëndetësore. Në vitin 2024, OJQ QKRMT mori 300 telefonata nga individë të burgosur, ku afërsisht gjysma e tyre lidheshin me çështje të kujdesit shëndetësor.<sup>31</sup>

**33.** OJQ QKRMT vuri në pah se në vitin 2024, Shërbimi Korrektues i Kosovës ndau 8 milionë euro për investime kapitale, një rritje e konsiderueshme nga buxheti prej 1 milion eurosh në vitin 2023. Fondet ishin të destinuara për tri projekte kryesore: (i) ndërtimin e një qendre të re korrektuese për gratë në Lipjan, (ii) ndërtimin e një qendre të re korrektuese në Prizren për të strehuar të paraburgosurit për rajonet e Prizrenit dhe Pejës, dhe (iii) rinovimin e Institutit të Psikiatrisë Forenzike. Megjithatë, OJQ QKRMT thekson se pavarësisht këtyre planeve, asnjë ndërtim nuk filloi në vitin 2024, dhe nuk ka siguri në lidhje me përdorimin e buxhetit në vitin e ardhshëm.<sup>32</sup>

**34.** Raporti i vizitës nga MKPT në Qendrën Korrektuese të Dubravës në korrik 2024 thekson se “kushtet e akomodimit në Qendrën Korrektuese të Dubravës janë në përgjithësi në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-132 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe standardet ndërkombëtare për të drejtat e të burgosurve.” Megjithatë, vihet re se kushtet e akomodimit në pavijonin që strehon të burgosurit e nënshtruar ndaj masave disiplinore të izolimit duhet të përmirësohen për shkak të depërtimit të lagështisë në objekt.<sup>33</sup>

28 MKPT (2024), [Raport mbi vizitën në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan](#).

29 MKPT (2024), [Raport mbi vizitën në Qendrën Korrektuese për të Mitur në Lipjan](#).

30 QKRMT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

31 QKRMT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

32 QKRMT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

33 QKRMT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

**35.** OJQ QKRMT deklaroi se në vitin 2023, u rekrutuan dhe filluan detyrat e tyre 45 zyrtarë/e korrektuese. Në vitin 2024, 70 zyrtarë/e korrektuese të tjera janë në proces të rekrutimit dhe aktualisht po ndjekin trajnimin në Akademinë për Siguri Publike. Me rritjen e numrit të stafit korrektues, Shërbimi Korrektues ka përmirësuar cilësinë e shërbimeve në institucionet korrektuese.<sup>34</sup>

**36.** Institucionet korrektuese në Kosovë kanë përmirësuar në mënyrë progresive respektimin e standardeve të të drejtave të njeriut brenda institucioneve korrektuese çdo vit. Për shkak të mungesës së monitorimit të vazhdueshëm, OJQ QKRMT mori vetëm dy ankesa në lidhje me përdorimin e forcës gjatë vizitës së saj në Gjilan në maj 2024. Shqetësime të ngjashme u ngritën edhe nga të miturit e mbajtur në Qendrën Korrektuese në Lipjan.<sup>35</sup>

**37.** OJQ QKRMT nuk kishte marrë njoftim paraprak nga administrata e burgut në lidhje me përdorimin e forcës në këto raste, edhe kur përdorimi i forcës ishte konsideruar i nevojshëm. Vetëm pas identifikimit dhe trajtimit të këtyre rasteve nga ekipi monitorues i OJQ QKRMT, administrata u përgjigj se në rastet e identifikuara, përdorimi i forcës ishte proporcional dhe i nevojshëm, duke u thirrur në dispozitat ligjore që lejojnë përdorimin e forcës proporcionale dhe të nevojshme.<sup>36</sup>

**38.** Gjatë vizitës së saj në Qendrën Korrektuese në Dubravë nga 23 deri në 25 prill 2024, MKPT zhvilloi intervista intenzive me të burgosurit, por nuk mori raportime për keqtrajtim fizik, përdorim të tepruar të forcës nga zyrtarët korrektues ose ndonjë sjellje tjetër nga autoritetet e burgut që mund të interpretohej si shkelje e dinjitetit të të burgosurve. MKPT vizitoi gjithashtu të burgosurit që i ishin nënshtruar izolimit disiplinor. I intervistoi dy të burgosur dhe nuk mori asnjë ankesë për keqtrajtim fizik, përdorim të tepruar të forcës ose shkelje të të drejtave të tjera që u takojnë, përveç aneksave për mungesën e ujit të nxehtë dhe pretendimit se masa e izolimit ishte vendosur padrejtësisht. Rregullorja e Brendshme për Trajtimin e Personave të Dënuar, neni 26 (Qëndrimi i të Burgosurve në Izolim), paragrafi 1, përcakton: «Një person i dënuar i nënshtruar masës disiplinore të izolimit, gjatë qëndrimit të tij në qeli, gëzon të drejtat minimale të parashikuara nga dispozitat ligjore në fuqi.»<sup>37</sup>

**39.** Sipas OJQ QKRMT, të drejtat e të burgosurve me çrregullime mendore në Kosovë mbeten kryesisht të pandryshuara në vitin 2024, por numri i individëve me çrregullime të tilla të përfshirë në krime është rritur. OJQ QKRMT thekson se, sipas Kodit Penal Nr. 06/L-074, individët me çrregullime mendore që kryejnë krime duhet të vendosen në institucione të specializuara shëndetësore, pasi veprimet e tyre burojnë nga gjendja e tyre e shëndetit mendor. Megjithatë, për shkak të mungesës së institucioneve të tilla, këta mbahen në qendra paraburgimi ose burgje të përgjithshme, të cilat QKRMT i konsideron si shkelje të rënda të të drejtave të njeriut. Këto institucione nuk kanë shërbime të vazhdueshme dhe të specializuara shëndetësore të përshtatura sipas nevojave të tyre. Në disa raste, mungesa e trajtimit të duhur çon në sjellje të dhunshme ose agresive ndaj stafit korrektues ose të burgosurve të tjerë. OJQ QKRMT thekson se ky problem lind sepse individët të tillë nuk duhet të vendosen në qendra paraburgimi, por në institucione të specializuara të pajisura për të ofruar kujdes të përshtatshëm për shëndetin mendor.<sup>38</sup>

34 QKRMT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

35 QKRMT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

36 QKRMT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

37 MKPT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

38 QKRMT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.



**40.** Pavarësisht numrit në rritje të të burgosurve me varësi nga droga lidhur me veprat e tyre penale, OJQ QKRMT vë në pah se ata mbahen së bashku me të burgosurit e tjerë. Shërbimit Korrektues të Kosovës i mungon një strategji e veçantë ose një program i specializuar rehabilitimi për t'i adresuar nevojat e tyre për trajtim.<sup>39</sup>

**41.** Sipas OJQ QKRMT, misioni dhe mandati i Pavijonit D në Qendrën Korrektuese në Dubravë ka evoluar që nga inaugurimi i tij në fillim të vitit 2023. Fillimisht i themeluar si një strukturë për individë me nevoja të veçanta, funksionalizimi i tij u vonua për disa muaj dhe kapaciteti i tij mbeti i kufizuar, duke akomoduar të burgosur nga kategori të ndryshme. Që nga viti 2024, Pavijoni D tani funksionon me një mandat të rishikuar, duke strehuar ekskluzivisht individë të dënuar për periudha specifike rehabilitimi. Fokusi i tij është zhvendosur drejt zhvillimit të aftësive dhe rehabilitimit, me një ekip multidisiplinar që ofron programe të strukturuar. Ky tranzicion shënon një ndryshim të rëndësishëm nga destinimi i tij fillestar, duke reflektuar përshtatjet e vazhdueshme në politikat korrektuese.<sup>40</sup>

**42.** Në vitin 2024, OJQ QKRMT vërejti përmirësim në kushtet e burgimit në institucionet korrektuese të Kosovës. Megjithatë, rastet e mbipopullimit të burgjeve vazhdojnë të jenë sfida, duke i detyruar disa të burgosur të flenë në dysheme. Gjatë një vizite në një qendër paraburgimi në Gjilan në maj 2024, QKRMT gjeti të burgosur që flinin në dyshekë në dysheme në vend të shtretërve. Përveç kësaj, QKRMT mori mbi 300 telefonata nga të burgosurit gjatë gjithë vitit 2024, duke ngritur shqetësime në lidhje me trajtimin e tyre, kushtet e gjumit dhe çështje të tjera që lidhen me burgimin.<sup>41</sup>

**43.** Nga viti 2006 deri në qershor 2024, QKRMT kishte qasje për t'i monitoruar institucionet korrektuese në Kosovë. Megjithatë, në qershor 2024, Ministria e Drejtësisë (Shërbimi Korrektues) propozoi një marrëveshje të re monitorimi, të cilën OJQ QKRMT e refuzoi, duke përmendur shkelje të misionit dhe mandatit të saj. Marrëveshja futi kufizime të reja, duke kërkuar që OJQ QKRMT të njoftojë autoritetet paraprakisht para se të kryejë vizita monitorimi, të marrë miratim paraprak nga të paraburgosurit dhe të kapërcejë pengesa shtesë burokratike për qasje në të dhënat zyrtare të të burgosurve. OJQ QKRMT paralajmëron se këto kufizime dëmtojnë rëndë monitorimin e pavarur të të drejtave të njeriut, pasi vetëm MKPT tani ka autoritetin për të kryer një mbikëqyrje të tillë, ndërsa OJQ-të janë përjashtuar nga ky proces. Si rezultat, që nga qershori i vitit 2024, OJQ QKRMT nuk ka mundur t'i monitorojë kushtet e të drejtave të njeriut në institucionet korrektuese të Kosovës për shkak të mungesës së një marrëveshjeje me Ministrinë e Drejtësisë. Ende nuk dihet nëse qeveria e ardhshme do t'ia rikthejë OJQ QKRMT-s qasjen në monitorim.<sup>42</sup>

**44.** Teksa numri i programeve të rehabilitimit për të burgosurit është rritur pak gjatë periudhës së raportimit, OJQ QKRMT thekson se Kosova ende nuk ka programe të individualizuara rehabilitimi të përshtatura për nevojat specifike të të burgosurve. Mungesa e programeve të tilla do të thotë që shumë të burgosur nuk marrin rehabilitim të mjaftueshëm, edhe pasi kanë kaluar një kohë të konsiderueshme në burg.<sup>43</sup>

39 QKRMT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

40 QKRMT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

41 QKRMT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

42 QKRMT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

43 QKRMT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

**45.** OJQ QKRMT vazhdon të ngrejë shqetësime për mungesën e një reagimi efektiv institucional ndaj rasteve të sulmit seksual në institucionet korrektuese. Në vitin 2023, OJQ QKRMT raportoi një rast sulmi seksual të kryer nga një i burgosur kundër një tjetri, duke u kërkuar autoriteteve të sigurojnë një hetim profesional dhe ofrimin e shërbimeve të nevojshme për viktimën. Megjithatë, Shërbimi Korrektues i Kosovës i hodhi poshtë akuzat pa kryer një hetim të plotë. Pas kësaj, OJQ QKRMT dorëzoi një kallëzim penal në Prokurorinë e Pejës në tetor të vitit 2023, por megjithatë nuk u ndërmor asnjë veprim gjatë gjithë vitit 2024, pavarësisht se OJQ QKRMT paraqiti pesë kërkesa zyrtare për përditësim të rastit. Ky mosveprim i vazhdueshëm vë në pah dështimet sistematike në adresimin e dhunës seksuale në institucionet e paraburgimit, duke i dekurajuar të paraburgosurit nga raportimi i rasteve të tilla për shkak të mungesës së mekanizmave efektivë të ankesave. QKRMT e konsideron këtë si një shkelje të rëndë të të drejtave të njeriut dhe vazhdon të avokojë për reforma strukturore për të siguruar llogaridhënien dhe mbrojtjen e të burgosurve të cënueshëm.<sup>44</sup>

**46.** Pavarësisht përpjekjeve të konsiderueshme të OJQ-ve për t'u ofruar institucioneve dhe stafit trajnim adekuat në përputhje me Protokollin mbi Sulmet Seksuale dhe Dhunën Seksuale në Kosovë, OJQ QKRMT thekson mungesën e angazhimit institucional për t'i zbatuar dispozitat kryesore të Protokollit në praktikë. Një mangësi e rëndësishme është mungesa e progresit në krijimin e Qendrës për Referimin e Rasteve të Sulmit Seksual, e cila ishte menduar të ndërtohej brenda Institutit të Mjekësisë Ligjore të Kosovës. Kjo strukturë e centralizuar është projektuar për të ofruar një mjedis të sigurt për intervistimin e viktimave të dhunës seksuale, duke parandaluar që ato të transferohen ndërmjet institucioneve për të dhënë dëshmi, siç edhe është praktika aktuale. Meqenëse Qendra nuk u ndërtua kurrë, ky aspekt thelbësor i Protokollit mbetet i pazbatuar, duke i lënë viktimat pa mbështetjen e specializuar të parashikuar në kornizë.<sup>45</sup>

**47.** OJQ QKRMT raporton se institucionet shtetërore po dështojnë në ofrimin e shërbimeve profesionale për t'i informuar viktimat e krimit në lidhje me procedurat ligjore. Për shkak të këtij boshllëku institucional, në vitin 2024, OJQ QKRMT ka ofruar mbështetje ligjore dhe psikologjike për 24 fëmijë që ishin viktimë të dhunës seksuale.<sup>46</sup>

**48.** Gjendja kritike e shëndetit mendor në Kosovë është rezultat i mungesës së ambienteve adekuate dhe masave të sigurisë në klinikat psikiatrike, siç edhe ilustron nga një zjarrvënie e shkaktuar nga pacientët në njësinë e Psikiatrisë në Prishtinë. Mungesa e aparateve për fikjen e zjarrit shfaq mungesën e rëndë të përgatitjes nga ana e institucioneve mjekësore. Për më tepër, vazhdimësia e metodave detyruese për t'i adresuar çrregullimet e shëndetit mendor bie ndesh me rekomandimet e OBSH-së dhe Këshillit të të Drejtave të Njeriut (KDNJ), duke shkaktuar dëme të konsiderueshme mendore dhe fizike tek individët. Mungesa e shërbimeve publike së bashku me mungesën e planeve për qendra të reja të shëndetit mendor e përkeqëson më tej krizën. Në vitin 2024, Ministria e Shëndetësisë e rinovoi klinikën psikiatrike për fëmijë. Gjersa rinovimi i këtyre objekteve paraqet një zhvillim pozitiv, OJQ QIPS thekson se kjo do t'i centralizojë më tej shërbimet

44 OJQ QKRMT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

45 OJQ QKRMT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

46 OJQ QKRMT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

psikiatrike për fëmijët në kryeqytet, duke paraqitur sfida të qasjes për familjet nga komuna të tjera. Sipas rekomandimeve të OBSH-së, trajtimi i fëmijëve për shëndetin mendor duhet të bëhet në afërsi të familjeve për të shmangur rrezikun e përkeqësimit të situatës që rrjedh nga ndarja nga kujdestarët.<sup>47</sup>

**49.** Vlen të përmendet se OJQ QIPS zbuloi izolimin njëmuor të një individi në një klinikë psikiatrike pa kontakt me asnjë person tjetër përveç mjekëve dhe stafit mjekësor. Si një rast ekstrem i trajtimit të pavullnetshëm, OJQ QIPS thekson se kjo është një dukuri e shpeshtë në kontekstin e Kosovës. Pranimi i përditshëm i pavullnetshëm në institucionet psikiatrike në Kosovë vazhdon të ndodhë në kundërshtim me traktatet dhe standardet ndërkombëtare.<sup>48</sup>

**50.** OJQ NSI thekson se më 14 prill 2024, njësitë speciale të Policisë së Kosovës ndaluan një serb të Kosovës (V.S.) në Zubin Potok, ku raportohet se individi iu nënshtrua forcës fizike.<sup>49</sup> Zyrtarët policorë kryen gjithashtu një kontroll të paautorizuar të telefonit të tij dhe e detyruan të thoshte fjalët "Republika e Kosovës".<sup>50</sup> Edhe pse Inspektorati i Policisë ka nisur një hetim për këtë rast, deri më sot nuk janë marrë masa disiplinore.

**51.** OJQ NSI deklaron se më 16 qershor 2024, dy të mitur serb u ndaluan nga Policia e Kosovës në Leposaviq për prishje të rendit publik sepse kishin kënduar këngë në një festë ditëlindjeje. Individët deklaruan se zyrtarët kishin përdorur gaz lotsjellës gjatë arrestimit dhe i kishin detyruar t'i këndonin këngët në stacionin e policisë.<sup>51</sup>

**52.** Gjithashtu, më 10 shtator, Policia e Kosovës arrestoi katër të rinj serb në veri të Mitrovicës pas një zënke me oficerë të veshur si civilë. U ngritën akuza në lidhje me përdorimin e tepruar të forcës, keqtrajtimin gjatë ndalimit dhe mohimin e kujdesit mjekësor. Individët u mbajtën në paraburgim në jug të Mitrovicës për 48 orë. Jashtë stacionit të policisë dhe gjykatës u mbajtën protesta paqësore me kërkesë lirim të tyre. Më 11 shtator, ata u vunë në arrest shtëpiak për 30 ditë. Pas një vizite tek të paraburgosurit, Zëvendësi i Avokatit të Popullit lëshoi një deklaratë që theksonte «elemente serioze që tregojnë shkelje të të drejtave të njeriut, përfshirë trajtimin çnjerëzor nga policia», dhe vuri në pah se të ndaluarit kishin lëndime të dukshme që nuk ishin raportuar në raportet e tyre mjekësore.<sup>52</sup> Pas një kohe, të rinjtë u liruan nga arresti shtëpiak.<sup>53</sup>

**53.** OJQ NSI thekson gjithashtu se më 26 tetor, një banor i Mitrovicës së Veriut, Miloš Subotić, raportoi se ishte ndaluar nga Policia e Kosovës pranë urës kryesore mbi lumin Ibër. Ai pretendonte se gjatë ndalimit të tij, i ishte nënshtruar keqtrajtimit fizik gjersa ishte i prangosur në një dhomë pa kamera, dhe se oficerët u përpoqën ta detyronin të bënte një test alkooli. Z. Subotić gjithashtu pretendoi se të drejtat e tij për qasje në përfaqësim ligjor ishin shkelur, së bashku me të drejtën e tij për informim në lidhje me arsyet e arrestimit të tij.<sup>54</sup>

47 QIPS (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024. Shih gjithashtu, Organizata Botërore e Shëndetësisë (2023), [Shëndeti Mendor, të Drejtat e Njeriut dhe Legjislacioni: Udhëzime dhe Praktika](#).

48 QIPS (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut 2024.

49 Këshilli i Sigurimit i OKB-së (2024), [Raporti për Kosovën 2024](#).

50 NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

51 NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

52 Këshilli i Sigurimit i OKB-së (2024), [Raporti për Kosovën 2024](#).

53 NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

54 NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024. Shih gjithashtu, Danas (2024), [Milosh Subotiq: Kosovo – Prebije Kosovska Policija](#).

**54.** Në ditën e sulmit në kanalin e ujit Ibër-Lepenc, Dušan Milanović, pronar i VIM Info dhe themelues i medias Kosova Online, u ndalua dhe u mbajt në paraburgim me dyshimin për kryerjen e veprës penale të “terrorizmit”, me qëllim që kthimi i tij të mos pengonte hetimet në vazhdim. Si përgjigje ndaj neglizhencës së perceptuar të EULEX-it dhe mungesës së veprimit në lidhje me këtë incident, një grup OJQ-sh nga pjesa veriore e Kosovës njoftuan pezullimin e bashkëpunimit të tyre me misionin.<sup>55</sup>

**55.** Më 6 nëntor, një individ me prejardhje etnike gorane, Shaqir Lutvija, u raportua se ishte subjekt i ngacmimit nga tre roje burgu shqiptarë në Podujevë në prani të familjes së tij. Pasi familja e tij ishte larguar rojet dyshohet se e sulmuan fizikisht, duke i dhënë disa goditje në kokë. Më pas, z. Lutvija informoi avokatin dhe familjen e tij për incidentin.<sup>56</sup>

**56.** Gjatë hetimit për sulmin në kanalin e ujit Ibër Lepenc, disa OJQ dhe individë ngritën shqetësime në lidhje me profesionalizmin i Policisë së Kosovës gjatë operacioneve të shumta. Në veçanti, disa OJQ nga pjesa e veriut të Kosovës kanë lëshuar një deklaratë ku theksojnë shkeljet serioze të të drejtave të njeriut, veçanërisht në lidhje me përdorimin e tepruar të forcës. Sipas nënkryetarit të Partisë Iniciativa e Romëve, Gzim Jahirović, ai dhe familja e tij iu nënshtruan keqtrajtimit fizik dhe trajtimit poshtërues gjatë një bastisjeje policore në shtëpinë e tij në Mikronaselj në Mitrovicën e Veriut, ndërsa gruaja e tij dyshohet se u përballë me sjellje të pahijshme nga zyrtarët policorë.<sup>57</sup>

**57.** Ende ka sfida në luftën kundër terrorizmit dhe radikalizimit në vitin 2024. Gjersa korniza ligjore ka nevojë për harmonizim të mëtejshëm për t’u konsideruar plotësisht në përputhje me standardet e BE-së dhe ato ndërkombëtare, Kosova po vazhdon të zbatojë marrëveshjen bilaterale me BE-në për luftën kundër terrorizmit. Aktualisht, 11 të burgosur në burgjet e Kosovës janë të dënuar për krime që lidhen me terrorizmin dhe nevojitet punë e vazhdueshme për zbatimin e masave parandaluese, rehabilituese dhe riintegruese. Përveç kësaj, Kosova duhet të qëndrojë vigjilente ndaj zhvillimeve dhe kërcënimeve të reja dhe t’i rishikojë programet dhe dokumentet strategjike ekzistuese në përputhje me rrethanat.<sup>58</sup>

**58.** Kuvendi i Kosovës ratifikoi marrëveshjen ndërkombëtare ligjore për transferimin e të burgosurve nga Danimarka në Kosovë.<sup>59</sup> Të burgosurit janë shtetas jo-danezë me urdhër dëbimi. Legjislacioni danez mbi ekzekutimin e sanksioneve penale do të zbatohet për rreth 300 të burgosur që pritet të vuajnë dënimin e tyre në Kosovë.

**59.** Rasti i zhdukjes së papritur të mostrave të Astrit Deharit nuk u zgjidh në vitin 2024 dhe vazhdon të ngrejë shqetësime në lidhje me procesin hetimor për vdekjen e Deharit. Në veçanti, Ministria e Drejtësisë ndërhyri në punën e prokurorisë duke komentuar se zhdukja e mostrave ishte një përpjekje e qëllimshme për ta penguar hetimin për vdekjen e Deharit dhe si pasojë pezulloi katër zyrtarë të Mjekësisë Ligjore, megjithëse autori i krimit ende nuk është identifikuar.<sup>60</sup>

55 NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

56 NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

57 NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

58 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 43.

59 Balkan Insight(2024) [Lajme: Kosova ratifikon marrëveshjen për strehim të 300 të burgosurve nga Danimarka](#).

60 Koha (2023), [Nesër protestë për Astrit Deharin](#).

## 60. Rekomandimet

- Inspektorati i Policisë së Kosovës (IPK) duhet t'i forcojë mekanizmat mbikëqyrës brenda Policisë së Kosovës duke siguruar kështu hetime të shpejta dhe transparente mbi përdorimin e forcës, duke rritur llogaridhënien publike dhe duke zbatuar masa disiplinore kundër zyrtarëve të shpallur fajtorë për sjellje të keqe;
- MD dhe SHKK duhet të rivendosin qasjen e monitorimit të pavarur në institucionet korrektuese duke eliminuar kushtet kufizuese që dëmtojnë transparencën dhe llogaridhënien në menaxhimin e burgjeve;
- MSH dhe SHKK duhet të krijojnë kushte të specializuara shëndetësore për të burgosurit me çrregullime të shëndetit mendor, në mënyrë që ata të marrin trajtimin e duhur në vend të strehimit të tyre aktual në qendrat e paraburgimit me të burgosurit e tjerë;
- Kuvendi i Kosovës duhet ta përshpejtojë miratimin dhe zbatimin e Projektligjit për Parandalimin e Vetëvrasjeve dhe Projektligjit për Shëndetin Mendor, duke u siguruar që ato të përfshijnë mekanizma konkrete për parandalim, ndërhyrje dhe mbështetje afatgjatë të shëndetit mendor;
- MD dhe SHKK duhet të zhvillojnë programe rehabilitimi të përshtatura për nevojat specifike të individëve, përfshirë të burgosurit e varur nga droga, me qëllim uljen e recidivizmit;
- Policia e Kosovës duhet të mbajë një qëndrim proaktiv në promovimin e sjelljes etike dhe profesionale kur angazhohet me qytetarët e komuniteteve jo-shumicë në mënyra që promovojnë paanshmërinë dhe respektin.
- IPK-ja duhet t'i forcojë mekanizmat mbikëqyrës duke rritur monitorimin sistematik të sjelljes së policisë dhe duke ndërmarrë hetime *ex officio* sa herë që informatat publike sugjerojnë raste të sjelljes së keqe ose shkelje të standardeve profesionale.

## 5.3 E drejta për liri dhe siguri personale

**61.** E drejta për liri dhe siguri personale njihet hapur në nivel ndërkombëtar me nenet 3, 4 dhe 9 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut (DUDNj), si dhe me nenin 5 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Në përkufizimin e saj, e drejta për liri dhe siguri janë të drejta të ndërthurura me njëra tjetrën, që do të thotë se siguria dhe liria nuk mund të trajtohen veçmas nga njëra-tjetra. Neni 29 i Kushtetutës së Kosovës parasheh se: "Askush nuk mund të privohet nga liria me përjashtim të rasteve të parapara me ligj dhe me vendim të gjykatës kompetente, si në vijim: pas shpalljes së dënimit me burgim për kryerjen e veprës penale; për dyshim të bazuar për kryerje të veprës penale, vetëm kur privimi nga liria me një bazë të arsyeshme konsiderohet i domosdoshëm për të parandaluar kryerjen e një vepre tjetër penale; për mbikëqyrjen e të miturit për qëllime edukimi ose për shoqërimin e tij/saj në një institucion kompetent, sipas një urdhri të ligjshëm; për mbikëqyrje shëndetësore të personit, i cili për shkak të sëmundjes paraqet rrezik për shoqërinë; për hyrje të paligjshme në Republikën e Kosovës ose pas urdhrit të ligjshëm për largim ose ekstradim." Kufizimet ligjore të lirisë së një personi janë të përcaktuara më tej në Kodin e Procedurës Penale të Kosovës (KPPK) dhe në Kodin e Drejtësisë për të Mitur (KDM).

**62.** Ligji Nr. 05/L-003 për Mbikëqyrjen Elektronike të Personave, lëvizja e të cilëve është e kufizuar me vendim gjykatë mund të fillojë të zbatohet së shpejti, nëntë vjet pas hyrjes së tij në fuqi në vitin



2015. Pas ndarjes së 600,000 eurove në fonde për zbatimin e sistemit elektronik të monitorimit që synon të rrisë mbrojtjen dhe sigurinë e të mbijetuarve/ave të dhunës, në korrik 2024, Ministria e Drejtësisë nënshkroi kontratën për blerjen e hallkave elektronike për të aktivizuar sistemin elektronik të monitorimit.<sup>61</sup> Në dhjetor 2024, u lansua projekti për përdorimin e hallkave elektronike.<sup>62</sup> Hallkat elektronike të monitorimit duhet të vendosen në mënyrë të sigurt në kyçin e dorës ose në kyçin e këmbës së individit të caktuar, duke përfshirë shkelësit, të dyshuarit ose shkelësit recidivistë. Në rast se individ i monitoruar i afrohet viktimës brenda një zone të kufizuar, autoritetet policore lokale dhe qendrore do të njoftohen menjëherë, duke shkaktuar aktivizimin e procedurave standarde të veprimit për të siguruar një ndërhyrje të shpejtë.<sup>63</sup> Mbetet për t'u përcaktuar nëse sistemi elektronik i monitorimit do të funksionojë në praktikë, e me këtë edhe aftësia e tij për të arritur objektivin e synuar të parandalimit të autorëve ose të dyshuarve nga kryerja e veprave penale që lidhen me dhunën në familje.

**63.** Pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme diplomatike, progresi në dialogun Kosovë-Serbi mbeti i kufizuar në vitin 2024. Marrëveshja e arritur midis dy palëve përfshinte fillimin e negociatave për vetëmenaxhim për komunitetin serb në Kosovë dhe miratimin e Deklaratës së Personave të Zhdukur. Megjithatë, përparimet konkrete në zbatim dhe zotimet e ndërsjella mbeten të pasigurta. Zbatimi i Marrëveshjes së Dialogut të Ohrit në Rrugën Drejt Normalizimit ka ngecur për shkak të mosmarrëveshjeve themelore mbi interpretimin e dispozitave kryesore dhe përshkallëzimit të tensioneve në veri të Kosovës. Mosmarrëveshjet në lidhje me renditjen e hapave të zbatimit, së bashku me paqëndrueshmërinë e vazhdueshme, kanë komplikuar më tej përpjekjet për t'i çuar përpara objektivat e marrëveshjes.<sup>64</sup> Pavarësisht përpjekjeve të BE-së, bllokimi i dialogut Kosovë-Serbi mbeti në fuqi gjatë gjithë vitit 2024.<sup>65</sup> Si pasojë, sanksionet e vendosura të BE-së vazhduan të ishin në fuqi gjatë gjithë vitit 2024,<sup>66</sup> dhe pavarësisht thirrjeve të bëra nga autoritetet e Kosovës për t'i hequr sanksionet,<sup>67</sup> BE-ja ende nuk është e prirur që ta rishqyrtojë vendimin e saj.

**64.** Tensionet në veri të Kosovës mbetën të larta gjatë gjithë vitit 2024. Raporti i Komisionit të BE-së thekson se si Kosova ashtu edhe Serbia luajtën një rol në përshkallëzimin e tensioneve. Kosova ndërmori veprime në kundërshtim me detyrimet e saj sipas dialogut, duke përfshirë operacionet policore kundër institucioneve paralele të mbështetura nga Serbia në veri, zbatimin e një ndalimi për transaksionet në monedha të tjera përveç euros dhe mbylljen e Bankës Postare Serbe dhe zyrave të Postës Serbe.<sup>68</sup> Nga ana tjetër, Komisioni i BE-së konfirmoi gjithashtu se procesi i normalizimit midis dy vendeve vazhdon të ndikohet negativisht nga hapat e pamjaftueshëm të Serbisë për të siguruar llogaridhënie për sulmin e dhunshëm në Banjskë të kryer nga sulmuesit e armatosur serb të Kosovës kundër policisë së Kosovës.<sup>69</sup>

61 Betimi për Drejtësi (2024), [Ministria e Drejtësisë njofton se është nënshkruar kontrata për blerjen e hallkave elektronike për monitorimin e dhunuesve](#).

62 Reporteri (2024), [Parandalimi i dhunës, prej sot vendosen hallkat elektronike te dhunuesit](#).

63 Reporteri (2024), [Parandalimi i dhunës, prej sot vendosen hallkat elektronike te dhunuesit](#).

64 Kosova Press (2024), [Bllokim në dialog, kërkohet më shumë qartësi nëse Serbia e ka tërhequr letrën nga Brukseli](#).

65 Prishtina Insight (2024), [I dërguari i BE-së në Prishtinë përpaket të thejë bllokimin e dialogut Kosovë-Serbi](#).

66 Grupi për Studime Ligjore dhe Politike (2024), [Njëvjetori i Masave të BE-së kundër Kosovës](#).

67 Prishtina Insight (2024), [Kosova bën thirrje për 'heqjen e menjëhershme' të sanksioneve](#).

68 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 60.

69 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 60.



**65.** OJQ AKTIV raportoi se zëvendëskryeministri Besnik Bislimi dhe zëvendësministri Arbër Vokrri bënë akuza kundër përfaqësuesve të OJQ-ve gjatë takimeve të BE-së, duke nxitur gjuhë urrejtjeje në internet. Këto veprime krijuan frikë tek punonjësit e OJQ-ve dhe dobësuan besimin në institucione, veçanërisht për serbët e Kosovës.<sup>70</sup>

**66.** Në fund të janarit dhe fillim të shkurtit 2024, Policia e Kosovës kreu operacione që kishin cak objektet e përdorura nga komunitetet jo-shumicë serbe në komunat Dragash, Pejë, Klinë dhe Istog, si dhe një qendër komunitare në Prishtinë. Policia e Kosovës raportoi konfiskimin e dokumenteve të ndryshme, mbylljen e ndërtesave dhe ndalimin e përkohshëm të stafit në katër komuna, duke ngritur dyshime se këto ambiente po përdoreshin për aktivitete të paligjshme.<sup>71</sup> Më 3 shkurt 2024, Policia e Kosovës ndaloi dy punonjës poste në Gorazhdec dhe e thirri për intervistim menaxherin e postës.<sup>72</sup>

**67.** Më 24 nëntor, Jovana Radosavljević, Drejtoreshë Ekzekutive e OJQ NSI, u ndalua në pikën e kontrollit në Bistricë me dyshimin se kishte kryer incizim të paautorizuar.<sup>73</sup> Në të njëjtën datë, 3 shtetas malazezë u arrestuan pranë Manastirit të Deçanit për shkak se kishin shfaqur sloganin «Kosova është Serbi» në targën e automjetit të tyre. Ata u ndaluan fillimisht për 48 orë, por vazhduan të mbeten në paraburgim gjatë vitit raportues 2024.<sup>74</sup>

**68.** Më 11 korrik 2024, punonjësit serbë të institucioneve të financuara nga Serbia në komunën e Shtërpcës në jug të Kosovës u thirrën për t'u paraqitur në Policinë e Kosovës për intervistim dhe u akuzuan për "sulm ndaj rendit kushtetues".<sup>75</sup>

**69.** Mes tensioneve të shtuara në veri të Kosovës dhe pranisë së shtuar të operacioneve nga Policia e Kosovës, EULEX vazhdoi të monitorojë rastet që përfshinin serbët e Kosovës që u arrestuan ose u morën në pyetje gjatë periudhës së raportimit (15 mars 2024 - 15 shtator 2024). Kjo përfshinte vlerësimin, aty ku ishte e nevojshme, të kushteve të paraburgimit të tyre. Në disa raste, Policia e Kosovës u dha njoftime verbale prokurorëve në momentin e fundit në lidhje me operacionet e planifikuara, duke shkelur dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, i cili u jep prokurorëve një rol më të rëndësishëm në mbikëqyrjen dhe autorizimin e hetimeve penale. Përveç kësaj, avokatët mbrojtës të serbve të Kosovës kanë raportuar vonesa në qasje me kohë në dosjet e rasteve që kanë të bëjnë me klientët e tyre, duke i ndërlikuar më tej procedurat ligjore.<sup>76</sup>

**70.** Një vit pas sulmit terrorist në fshatin Banjskë, Prokuroria Speciale në Kosovë ngriti aktakuzë kundër Milan Radoiqiq dhe 44 personave të tjerë të akuzuar për orkestrimin dhe ekzekutimin e sulmit terrorist që rezultoi në vdekjen e rreshterit të policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku, dhe plagosjen e oficerëve të tjerë të policisë së Kosovës.<sup>77</sup> Disa nga të akuzuarit janë në paraburgim, ndërsa shumë të tjerë po ikin nga drejtësia dhe do të gjykohen në mungesë në rast se nuk mund të arrestohen ose ekstradohen. 45 të akuzuarit u akuzuan për veprat penale të mëposhtme, përkatësisht kryerjen e një vepre terroriste; vepra të rënda penale kundër rendit kushtetues dhe sigurisë së Kosovës; lehtësimin dhe financimin e kryerjes së terrorizmit; dhe zhvatjen e parave.<sup>78</sup> Duke pasur

70 AKTIV (2025), Kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

71 Këshilli i Sigurimit i OKB-së (2025) [Raporti për Kosovën 2024](#).

72 NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

73 NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

74 NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

75 Këshilli i Sigurimit i OKB-së (2025) [Raporti për Kosovën 2024](#).

76 NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

77 Betimi për Drejtësi (2024), [Aktakuza e plotë në rastin e Banjskës](#).

78 Betimi për Drejtësi (2024), [Aktakuza e plotë në rastin e Banjskës](#).

parasysh kompleksitetin e rastit, dosjen e madhe të provave dhe hetimeve dhe numrin e lartë të akuzuarve, gjyqi pritet të zgjasë disa vite.

**71.** Përveç sulmit terrorist në Banjskë, një tjetër sulm i rëndë ndodhi në infrastrukturën e kanalit të ujit Ibër-Lepenc më 29 nëntor 2024.<sup>79</sup> Shpërthimi i fuqishëm çoi në ndërprerje serioze të furnizimit me ujë dhe dëmtoi infrastrukturën kritike në një kanal kyç që furnizon dy termocentrale kryesore në Kosovë që gjenerojnë pjesën më të madhe të energjisë elektrike në tërë Kosovën. Ky kanal është thelbësor për furnizimin me ujë të disa komunave dhe për ftohjen e termocentraleve kryesore me qymyr të Kosovës, Kosova A dhe Kosova B. Sulmi ndërpreu furnizimin me ujë dhe energji elektrike në shumë qytete.<sup>80</sup> Zyrtarët e Kosovës e kanë quajtur incidentin një akt terrorist të nxitur nga Serbia, ndërsa kjo e fundit i ka cilësuar akuzat e tilla si të pabaza.<sup>81</sup> Tetë arrestime u kryen pas bastisjeve në dhjetë lokacione në veri të Kosovës, ku u gjetën uniforma të shumta ushtarake dhe municione të rënda.<sup>82</sup> Sulmi është dënuar nga bashkësia ndërkombëtare, e cila bëri thirrje që autorët të nxirren para drejtësisë pas hetimeve të mëtejshme mbi këtë rast.<sup>83</sup> Bazuar në propozimin e prokurorëve publikë, Gjykata Themelore në Prishtinë ka vendosur që të dyshuarit kryesorë për sulmin, Jovan Vićentijević dhe Dragiša Vićentijević, duhet të mbahen në paraburgim për të paktën një muaj, në pritje të hetimeve të mëtejshme mbi rastin dhe përfshirjen e tyre.<sup>84</sup>

**72.** Lidhur me statusin e zbatimit të të gjitha marrëveshjeve të dialogut, shumë detyrime nga marrëveshjet e mëparshme mbeten të paplotësuara si nga Kosova ashtu edhe nga Serbia, duke përfshirë (i) kthimin e zyrtarëve serbë të Kosovës në institucionet e Kosovës; (ii) krijimin e Asociacionit të Komunave me shumicë serbe në përputhje me propozimin evropian që i është prezantuar palëve negociuese më 21 tetor 2023; (iii) hapjen e urës së Mitrovicës pas një koordinimi me partnerët e sigurisë; (iv) zbatimin e plotë të të gjitha marrëveshjeve teknike të dialogut; (v) zbatimin e plotë të marrëveshjeve për lirinë e lëvizjes; (vi) rifillimin e ndihmës së ndërsjellë ligjore e cila u ndalua nga Serbia; (vii) progresin në çështjen e Personave të Zhdukur.<sup>85</sup> Me fjalë të tjera, Kosova dhe Serbia duhet të demonstrojnë një angazhim më serioz dhe konstruktiv për të çuar përpara procesin e normalizimit dhe të përmbahen nga veprimet dhe retorika që minojnë stabilitetin dhe nuk promovojnë pajtimin.<sup>86</sup>

### 73. Rekomandimet

- Policia e Kosovës dhe Prokuroria Speciale duhet t'i intensifikojnë hetimet dhe përpjekjet për ndjekje penale në lidhje me sulmin në Banjskë dhe aktet e tjera terroriste, duke siguruar që të gjithë autorët të mbahen përgjegjës dhe që procedurat gjyqësore të zhvillohen në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe të procesit të rregullt ligjor;

79 YIHR KS (2025), [DEKLARATË / IZJAVA / STATEMENT](#).

80 Balkan Insight (2024), [Kosova kryen arrestime pas shpërthimit të kanalit që preku furnizimin me ujë](#).

81 Al Jazeera (2024), [Policia e Kosovës arreston tetë persona për shpërthimin në kanal, fajësohet Serbia](#).

82 Balkan Insight (2024), [Kosova vazhdon hetimin e 'sulmit terrorist' në kanal pas arrestimeve të fundjavës](#).

83 Radio Evropa e Lirë (2024), [Sulm, faj, akuza: Thirrje për hetime të pavarura në Ibër-Lepenc](#).

84 Betimi për Drejtësi (2024), [Ekskluzivno – Dosije Tuzilastva: Braca Vicentijevic osumnjiceni za izversenje teroristickog dela koriscenjem eksploziva u kanalu Ibar-Lepenac](#).

85 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 60-62.

86 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 62.

- IPK duhet të ofrojë mbikëqyrje dhe transparencë në lidhje me operacionet policore, veçanërisht në veri të Kosovës, duke siguruar respektimin e rreptë të procedurave ligjore nga policia e Kosovës që garantojnë qasje të papenguar në përfaqësim ligjor për të gjithë të arrestuarit;
- IPK-ja duhet të adresojë përdorimin e simboleve të paligjshme ose përçarëse etnike nga zyrtarët e policisë në zotimin e saj për të inkurajuar gjithëpërfshirjen dhe kohezionin social.

## 5.4 E drejta për proces të drejtë gjyqësor dhe mjete juridike efektive

**74.** E drejta për proces të drejtë gjyqësor dhe mjete juridike efektive njihet ndërkombëtarisht si e drejtë themelore e njeriut me nenin 10 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, i cili thotë se “secili ka të drejtë plotësisht të barabartë për gjykim të drejtë dhe publik [...]”<sup>87</sup> Neni 6 i KEDNJ-së përfshin gjithashtu të drejtën për një gjykim të drejtë dhe më tej përcakton se “secili ka të drejtë për një seancë të drejtë gjyqësore dhe publike brenda një afati të arsyeshëm [...]”<sup>88</sup>. Në kornizën legjislative të Kosovës, këto standarde ligjore ndërkombëtare janë të detyrueshme; ato parashikohen edhe në Kushtetutë me anë të nenit 22. Për më tepër, neni 30 parashikon të drejtat e të akuzuarve dhe në nenin 31 theksohen dispozitat për një gjykim të drejtë dhe të paanshëm. Neni 32 i Kushtetutës parasheh të drejtën e secilit për të përdorur mjete juridike “kundër vendimeve gjyqësore dhe administrative që cenojnë të drejtat ose interesat e tij/saj”<sup>89</sup>. Përveç Kushtetutës, ligjet dhe rregulloret e tjera të miratuara nga Qeveria e Kosovës rregullojnë të drejtën për gjykim të drejtë në procedurat gjyqësore në çështjet penale, civile dhe administrative. Këto përfshijnë Kodin Nr. 08/L-032 të Procedurës Penale (KPPK), Kodin Nr. 06/L-074 Penal (KPK), Ligjin Nr. 03/006 për Procedurën Kontestimore (LPK) dhe Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurat e Përgjithshme Administrative.

**75.** Gjatë vitit 2024, Gjykata Kushtetuese e Kosovës publikoi për herë të parë “Udhëzuesin Praktik mbi Kriteret e Pranueshmërisë”, i cili është hartuar për të informuar aplikantët, praktikuesit/ avokatët dhe komunitetin ligjor në lidhje me kriteret e pranueshmërisë për kërkesat individuale të paraqitura në Gjykatën Kushtetuese.<sup>90</sup> Ndër të tjera, ky Udhëzues do t’i ndihmojë palët të shfrytëzojnë siç duhet të drejtën e tyre për mjete juridike para Gjykatës Kushtetuese dhe të shmangin gabimet procedurale që do të çojnë në refuzimin e rasteve të tyre për shkak të arsyeve të pranueshmërisë. Përveç kësaj, Gjykata Kushtetuese ka publikuar gjithashtu tre buletine periodike për vitin 2025, ku pasqyrohet legjislacioni që lidhet, ndër të tjera, me të drejtën për proces të drejtë gjyqësor dhe mjete efektive juridike.<sup>91</sup>

**76.** Ligji Nr. 04/L-017 për Ndihmë Juridike Falas u ndryshua për t’u ofruar ndihmë juridike falas gazetarëve, fotoreporterëve, dhe individë të tjerë që përballen me padi për shpifje dhe SLAPP. Gjithashtu, Agjencia për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) u vendos në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë (MD), një veprim që u kritikua gjerësisht nga ekspertët ligjorë dhe shoqëria civile për politizim të mundshëm. Në qershor 2024, MD publikoi Koncept Dokumentin për Ndihmën Juridike Falas për

87 DUDNJ, Neni 10.

88 Këshilli i Evropës (2024), [E drejta për proces të drejtë gjyqësor](#) Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (2024), [Udhëzues mbi Nenin 13 \(E Drejta për Mjete Juridike Efektive\) të KEDNJ-së](#).

89 Kushtetuta e Kosovës (2008), nenet 30-31.

90 Gjykata Kushtetuese e Kosovës (2024), [Udhëzues Praktik mbi Kriteret e Pranueshmërisë](#).

91 Gjykata Kushtetuese e Kosovës (2024), [Buletinet periodike për vitin 2024](#).

konsultim publik. Një analizë e dhjetorit 2024 nga OJQ IKD zbuloi se (i) reforma strukturore është e panevojshme, por mekanizmat ekzistues duhet të forcohen; (ii) duhet të adresohet politizimi jokushtetues; dhe (iii) Koncept Dokumenti duhet të dallojë qartë ndihmën juridike falas nga këshilla juridike falas për të parandaluar ndërhyrjen e ANJF në procedurat penale.<sup>92</sup> Pavarësisht kritikave, Qeveria e Kosovës miratoi Koncept Dokumentin në shtator të vitit 2024.<sup>93</sup>

**77.** Mospërputhjet ndërmjet politikave dhe praktikës vazhdojnë të ekzistojnë ende në sistemin gjyqësor. Gjersa raporti i Komisionit të BE-së për vitin 2024 vuri në pah progresin në shkallën e zgjidhjes së rasteve, aftësia e gjyqësorit dhe prokurorisë për t'i menaxhuar rastet në kohën e duhur mbetet e kufizuar.<sup>94</sup> Gjykimet vazhduan të vonoheshin për shkak të shtyrjeve të shpeshta të seancave dëgjimore, të cilat shpesh vinin për shkak të menaxhimit joefikas të rasteve dhe arsyeve të pabaza. Edhe pse KGJK-ja dhe Gjykata Supreme prezantuan një mekanizëm për ta kufizuar ose minimizuar numrin e rigjyimeve, kjo praktikë jo vetëm që vazhdoi në vitin 2024, por numri i rigjyimeve u rrit në krahasim me vitet e mëparshme të raportimit.<sup>95</sup>

**78.** Në vitin 2024, propozimi për të zbatuar kontrollin e integriteti për zyrtarët e lartë gjyqësorë dhe prokurorialë mbeti i bllokuar në Kuvendin e Kosovës. Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në vitin 2023, kishte miratuar me shumicë votash një amendament kushtetues të propozuar i cili lejon kontrollë të përkohshme të integritetit për figurat kryesore të sistemit të drejtësisë, siç janë anëtarët e Këshillit Gjyqësor, Këshillit Prokurorial, kryetarët e gjykatave, kryeprokurorët dhe kandidatët për këto role, nga Autoriteti për Kontrollin e Integritetit.<sup>96</sup> Njëkohësisht, dy amendamente të tjera të propozuara që adresojnë kriteret për shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve për shkak të shkeljes së rëndë të detyrave, u konsideruan se nuk shkelin të drejtat themelore. Megjithatë, sipas OJQ IKD, gjatë vitit 2024 nuk është bërë asnjë përparim për të funksionalizuar vetingun në Kosovë në përputhje me amendamentet kushtetuese që u miratuan nga Gjykata Kushtetuese.<sup>97</sup>

**79.** Edhe nëse rekrutimi i vazhdueshëm i gjyqtarëve dhe prokurorëve të rinj mund të rrisë kompetencën e gjyqësorit dhe prokurorisë, si dhe nivelin e profesionalizmit, cilësia e vendimeve dhe aktakuzave mbetet e mangët. Themelimi i Gjykatës Komerciale ndihmoi në uljen e numrit të referimeve dhe kohës së zgjidhjes së rasteve, duke përfshirë cilësinë e rasteve të gjykuara. Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin e ri për Kontestet Administrative Nr. 08/L-182, i cili synon të përmirësojë kornizën e drejtësisë administrative dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve. Megjithatë, miratimi i shpejtë i Kodit Civil dhe Kodit të Procedurës Civile konsiderohet faktor thelbësor për të përmirësuar efikasitetin e drejtësisë civile në Kosovë.<sup>98</sup>

**80.** Në vitin 2024, KGJK miratoi Planin Strategjik të TI-së për vitet 2024-2029, që synon zbatimin e mjeteve digjitale të drejtësisë të hartuara nga Komisioni Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë

92 IKD (2024), [Eksperiment mbi Ndihmën Juridike Falas](#).

93 IKD (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-së për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

94 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën, f. 28-29.

95 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën, f. 28-29.

96 Betimi për Drejtësi (2023), [Gjykata Kushtetuese i hap rrugë Vetingut në sistemin e drejtësisë](#)

97 IKD (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

98 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 29.

(CEPEJ)<sup>99</sup> gjë që ndihmon në rritjen e efikasitetit të sistemit të drejtësisë.<sup>100</sup> Në vitin 2024, KPK-ja miratoi gjithashtu Strategjinë e saj të Komunikimit 2024-2029.<sup>101</sup> Megjithatë, zbatimi i planeve strategjike të KGJK-së dhe KPK-së duhet të përmirësohet më tej, veçanërisht duke krijuar mekanizma më të fortë të monitorimit.<sup>102</sup>

**81.** Zbatimi i kësaj Deklarate për Zotim të Përbashkët të bërë nga Ministria e Drejtësisë dhe krerët e institucioneve kryesore të sistemit të drejtësisë hasi në pengesa dhe vonesa serioze. Procesi i hartimit të ligjeve kryesore të reformës nuk siguroi konsultim kuptimplotë të akterëve përkatës kombëtarë dhe ndërkombëtarë dhe, pavarësisht këshillave serioze të BE-së, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk u konsultua me Komisionin e Venecias për pakon e reformës legislative.<sup>103</sup>

**82.** Viktimat e krimit nuk janë të informuara mjaftueshëm rreth procedurave ligjore dhe rrallë ndihmohen nga përfaqësuesit profesionistë. Sipas të dhënave të ofruara nga OJQ IKD, buxheti i ndarë për ndihmë juridike mbetet i pamjaftueshëm pavarësisht rritjes së parashikuar buxhetore krahasuar me vitet e kaluara (shih tabelën 1 më poshtë).<sup>104</sup>

**Tabela 1. Buxheti qeveritar i ndarë për ndihmë juridike**

|                                                          | 2024    | 2023    | 2022    | 2021    | 2020    |
|----------------------------------------------------------|---------|---------|---------|---------|---------|
| Buxheti total në EUR i ndarë nga QeK për ndihmë juridike | 537,831 | 444,170 | 443,995 | 439,298 | 422,699 |

**83.** Stërzgjatja e procedurave ligjore në Kosovë, veçanërisht e drejta për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, mbetet një sfidë e rëndësishme për gjykime të drejta dhe të paanshme. Kjo çështje gjithashtu dëmton qasjen efektive të qytetarëve në drejtësi. Ministria e Drejtësisë planifikoi të miratojë një ligj të ri për realizimin e së drejtës për proces të drejtë gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm deri më 28 qershor 2024, sipas Programit Legjislativ për vitin 2024.<sup>105</sup> Por ky ligj ende nuk është miratuar dhe mbetet për t'u parë nëse kohëzgjatja e procedurave do të konsiderohet përparësi nga QeK e ardhshme pas zgjedhjeve.

**84.** OJQ IKD vë në pah se projektligji për të drejtën për proces të drejtë gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm përcakton kufizime të rrepta për procesimin e rasteve me tri vjet në shkallën e parë dhe dy vjet në nivelin e apelit. Edhe pse objektivi i tij është legjitim, ligji dështon të marrë parasysh kompleksitetin e rasteve dhe faktorë të tjerë të përshkruar në praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së. Përveç kësaj, ligji nuk e adreson barrën e madhe të lëndëve të gjyqësorit, e cila është shkaku kryesor i vonesave, duke rrezikuar kështu mbingarkesën e mëtejshme të sistemit gjyqësor.<sup>106</sup>

99 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 26-29.

100 Për më shumë informata mbi mjetet e CEPEJ-it mbi cilësinë e drejtësisë, shihni raportet e CEPEJ-it. [në këtë link](#).

101 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 26.

102 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 26.

103 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 26.

104 IKD (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

105 Zyra e Kryeministrit, [Programi Legjislativ për vitin 2024](#).

106 IKD (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-së për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.



**85.** Lidhur me drejtësinë për të mitur, kjo fushë rregullohet nga Ligji Nr. 06/L-006 për Drejtësinë për të Mitur. Seancat gjyqësore në raste të tilla nuk janë publike, gjë që rezulton në mungesë të informacionit të mjaftueshëm në lidhje me rregullsinë e proceseve gjyqësore në këtë fushë. Lidhur me këtë çështje, Akademia e Drejtësisë organizon trajnime për gjyqtarë dhe prokurorë mbi drejtësinë për të mitur, me qëllim përmirësimin e kuptimit dhe trajtimit të rasteve që përfshijnë të mitur.<sup>107</sup>

**86.** Në Raportin e Monitorimit të Gjytimeve të vitit 2024 mbi rastet e dhunës në familje në Kosovë, OSBE-ja gjeti se gjykatat e rregullta në Kosovë vendosin masa tepër të buta për krimet e dhunës në familje, të tilla si gjoba, dënime me kusht ose masa të tjera alternative.<sup>108</sup> Dënimi mesatar për burgim efektiv ishte pak më shumë se pesë muaj, me një mesatare gjjobash prej 350 eurosh. Për më tepër, gjykatat dështuan t'i vlerësonin siç duhet rrethanat lehtësuese dhe rënduese, duke shkelur kështu standardet ndërkombëtare dhe duke u larguar nga korniza e udhëzimeve për dënime që përcaktohet nga Gjykata Supreme.<sup>109</sup> Përveç kësaj, Raporti ngriti një shqetësim tjetër serioz në lidhje me vonesat në procesimin e kërkesave për urdhra të mbrojtjes, të cilat "lanë gati një të katërtën e viktimave pa zgjidhje brenda afateve optimale, duke i ekspozuar kështu potencialisht viktimat ndaj dhunës së mëtejshme".<sup>110</sup>

**87.** OJQ IKD ka identifikuar raste ku akterët politikë kanë shkelur parimin e prezumimit të pafajësisë deri në dëshmimin e fajësisë përmes deklaratave publike. Sipas GJEDNJ-së, ky parim i kufizon autoritetet publike nga inkurajimi i publikut për të besuar se i akuzuari është fajtor ose për të paragjykuar vlerësimin e fakteve nga autoriteti gjyqësor.<sup>111</sup>

**88.** Pavarësia gjyqësore është një faktor thelbësor që ndikon në aspektet thelbësore të së drejtës për proces të drejtë gjyqësor dhe mjete juridike efektive. Sipas Kushtetutës dhe kornizës legjislative në Kosovë, gjyqësori është plotësisht i pavarur. Megjithatë, OJQ IKD vë në pah se kjo pavarësi është minuar nga tendencat për ndërhyrje politike, duke përfshirë kritikën publike nga akterët qeveritarë ndaj institucioneve të sistemit të drejtësisë. Kufizimet buxhetore në gjyqësor janë gjithashtu ndër pengesat me të cilat përballet sistemi nga ana e institucioneve të tjera. Financimi i shërbimeve ligjore nga ana e qeverisë është faktor thelbësor për të siguruar qasje në drejtësi për të gjithë qytetarët pavarësisht nga statusi i tyre socio-ekonomik. Ky financim është veçanërisht i rëndësishëm për individët me të ardhura të ulëta, komunitetet e marginalizuara dhe viktimat e diskriminimit sepse i fuqizon ata që t'i ushtrojnë të drejtat e tyre dhe të kërkojnë drejtësi.<sup>112</sup>

**89.** Sipas anketës së vitit 2024 të publikuar nga UNDP, vetëm 34.28 përqind e qytetarëve besojnë se gjyqësori është i pavarur.<sup>113</sup> Kjo përqindje, sipas OJQ IKD, pasqyron mungesën e besimit të publikut në pavarësinë e sistemit të drejtësisë. Pavarësisht masave të marra, sistemi i drejtësisë ende ka nevojë për ndërhyrje të mëtejshme për të siguruar efikasitetin e tij, për të përmirësuar mjetet

107 IKD (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-së për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

108 OSBE (2024) [Raporti i Monitorimit të Gjytimeve mbi Gjykimin e Rasteve të Dhunës në Familje në Kosovë](#)

109 OSBE (2024) [Raporti i Monitorimit të Gjytimeve mbi Gjykimin e Rasteve të Dhunës në Familje në Kosovë](#), f. 23.

110 OSBE (2024) [Raporti i Monitorimit të Gjytimeve mbi Gjykimin e Rasteve të Dhunës në Familje në Kosovë](#), f. 23.

111 IKD (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-së për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

112 IKD (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-së për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

113 UNDP (2024), [Përmbledhje e Opinioneve Publike](#).



efektive juridike dhe për të siguruar trajtimin profesional të rasteve në lëndët civile, penale, administrative dhe tregtare. Këto ndërhyrje përfshijnë veprime dhe aktivitete brenda kompetencave dhe përgjegjësi të Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit Prokurorial për të siguruar menaxhimin e rasteve, qasjen në drejtësi, promovimin e të drejtave të palëve në procedura, forcimin e llogaridhënies së gjyqtarëve dhe prokurorëve, barazinë gjinore në pozicionet udhëheqëse, etj. Ndërkohë, ndërhyrjet jashtë sistemit të drejtësisë përfshijnë reformat e vazhdueshme ku duhet të shprehet vullneti politik për t'i përmbushur detyrimet që rrjedhin nga Strategjia e Sundimit të Ligjit, miratimin e ligjeve që rrjedhin nga angazhimet e përbashkëta, digjitalizimin e shërbimeve gjyqësore dhe punën e gjykatave dhe prokurorive, ndalimin e sulmeve politike ndaj sistemit gjyqësor dhe prokurorial, gjyqtarëve dhe prokurorëve individualë, si dhe sigurimin e ndarjes së mjaftueshme buxhetore për funksionimin e sistemit të drejtësisë në Kosovë.

**90.** OJQ IKD thekson mungesën e vullnetit politik qoftë nga Qeveria e Kosovës apo nga Kuvendi i Kosovës për të ndërmarrë reforma në gjyqësor për të siguruar një sistem drejtësie të pavarur, të paanshëm dhe të drejtë. Ky dështim përfshin jo vetëm mosnjsjen e procesit të vetingut, por edhe dështimin për të miratuar projektligjet që rezultojnë nga procesi i angazhimeve të përbashkëta.<sup>114</sup>

**91.** Në vitin 2024, Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës (IAP) pranoi gjithsej 1,349 ankesa, nga të cilat 171 ankesa lidheshin me të drejtën për proces të drejtë gjyqësor dhe të paanshëm, 175 ankesa kishin të bëjnë me të drejtën për mjete efektive juridike dhe 47 raste lidheshin me ankesa në lidhje me të drejtën për barazi para ligjit.<sup>115</sup>

**92.** Efikasiteti i sistemit të drejtësisë ende duhet të përmirësohet, thekson OJQ IKD. Edhe pse ka përmirësim në shkallën e procesimit të lëndëve civile, aftësia e gjyqësorit dhe shërbimit prokurorial për t'i trajtuar lëndët me kohë mbetet e kufizuar, veçanërisht në lëndët e korrupsionit të nivelit të lartë. Gjykatat vazhdojnë të kenë vonesa për shkak të shtyrjeve të shpeshta, shpesh për arsye të pabaza dhe menaxhimit të dobët të lëndëve. Pavarësisht krijimit të një mekanizmi nga Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Gjykata Supreme për ta zvogëluar numrin e rigjytimeve, kjo praktikë ka vazhduar dhe numri i rigjytimeve është rritur. Kjo ka rritur më tej barrën e lëndëve dhe shpesh ka ndikuar në zgjatjen e paraburgimit.<sup>116</sup>

**93.** OJQ IKD vë në pah se shkelja e të drejtës së qytetarëve për proces të drejtë gjyqësor brenda një afati të arsyeshëm mbetet sistematike. Numri i rasteve të pazgjidhura është rritur vazhdimisht gjatë viteve, duke arritur në 125,805 raste të pazgjidhura në shtator 2024, krahasuar me 44,213 raste në vitin 2018. Kjo rritje e numrit të rasteve është ndikuar kryesisht nga dështimi i institucioneve publike për të përmbushur detyrimet e tyre, duke përfshirë rastet që lidhen me detyrimet e marrëveshjeve kolektive dhe rastet e pensioneve të dyfishta.<sup>117</sup>

**94.** Ndërkohë që Sistemi për Menaxhim Informativ të Lëndëve (SMIL) është funksional dhe disa shërbime gjyqësore janë digjitalizuar, sipas IKD-së nevojiten avancime të mëtejshme. Zgjerimi i përdorimit të teknologjisë, siç janë seancat dëgjimore virtuale, thirrjet me e-mail dhe komunikimi i automatizuar, do të rriste efikasitetin, qasjen dhe transparencën brenda gjyqësorit.<sup>118</sup>

114 IKD (2024), [Dështimi i Reformës në Drejtësi](#).

115 IKD (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-së për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024. Shih gjithashtu, OiK (2024), [Avokati i Popullit ia prezantoi mediave raportin e vitit 2024](#).

116 IKD (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-së për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

117 IKD (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-së për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

118 IKD (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-së për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

**95.** Standardet e arsytimit gjyqësor mbeten jokonsistente ku gjykatat nuk arrijnë të justifikojnë në mënyrë të mjaftueshme dënimet, duke përfshirë zbatimin e rrethanave lehtësuese dhe rënduese, sipas IKD-së. Përdorimi i shpeshtë i arsytimit të bazuar në shabllone dhe mosrespektimi i Udhëzimeve të Gjykatës Supreme mbi Politikën e Dënimeve dëmtojnë më tej vazhdimësinë e dënimeve dhe llogaridhënien gjyqësore.<sup>119</sup>

**96.** Numri i vendimeve të publikuara në gjuhën serbe mbetet shumë i ulët. Me mbështetjen e UNMIK-ut, IKD ndihmoi gjyqësorin në rritjen e numrit të vendimeve të publikuara në gjuhën serbe. Për më tepër, komentet mbi ligje specifike ofrohen vetëm në gjuhën shqipe dhe vazhdimisht mungon përkthimi në serbisht. Mungesa e vendimeve dhe komenteve në gjuhën serbe i privon qytetarët serbë dhe avokatët e tyre nga qasja e barabartë në informacione.<sup>120</sup>

## 97. Rekomandimet

- Të gjitha institucionet duhet ta mbështesin pavarësinë e gjyqësorit duke u përmbajtur nga deklaratat që dëmtojnë integritetin e sistemit të drejtësisë dhe duke siguruar ndarje të mjaftueshme buxhetore për funksionimin e tij efektiv;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës duhet ta adresojë çështjen e procedurave të stëzgjatura ligjore për t'i identifikuar dhe zvogëluar faktorët që kontribuojnë në vonesa, duke përfshirë keqadministrimin, performancën gjyqësore dhe menaxhimin joadekuat të rasteve, dhe të shqyrtojë shënjestrimin e mundshëm në baza etnike në lidhje me këto çështje, veçanërisht në lidhje me të paraburgosurit nga komunitetet jo-shumicë;
- Reforma e ndihmës juridike falas duhet të garantojë pavarësinë e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) nga Ministria e Drejtësisë. Forcimi i sistemit ekzistues të ndihmës juridike është thelbësor, ndërsa çdo model alternativ që mund të kompromentojë efikasitetin, qëndrueshmërinë ose pavarësinë funksionale të tij duhet të shmanget;
- QeK duhet t'i përmbushë detyrimet e veta ligjore ndaj qytetarëve, veçanërisht në lidhje me marrëveshjet kolektive dhe pensionet e dyfishta, për të parandaluar procedurat e panevojshme gjyqësore. Sigurimi i zbatimit të duhur të ligjeve ekzistuese do të zvogëlojë barrën gjyqësore dhe do të lehtësojë barrën financiare mbi buxhetin e shtetit.

## 5.5 Liria e shprehjes dhe e mendimit, e drejta për informim dhe e drejta për privatësi

**98.** Liria e shprehjes dhe e mendimit njihet si një e drejtë themelore e njeriut me nenin 19 të DUDNJ-së, i cili thotë se “secili ka të drejtën e lirisë së mendimit dhe të shprehjes [...] dhe me çfarëdo mjetesh”.<sup>121</sup> Kjo e drejtë universale përfshin të drejtën për të dhënë, marrë dhe përcjellë informacione. Këto dispozita bazë përcaktohen edhe me nenin 10 të KEDNJ-së, i cili për më tepër thekson se liria e shprehjes dhe e mendimit mund t'i nënshtrohet disa formaliteteve të përcaktuara

119 IKD (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

120 IKD (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

121 DUDNJ, [Neni 19](#).

me ligj për mbrojtjen e sigurisë, konfidencialitetit, paanshmërisë ose mbrojtjen e reputacionit ose të drejtave të të tjerëve.<sup>122</sup> Korniza legjislative e Kosovës mbron lirinë e shprehjes dhe të drejtën për informim në nenin 40 të Kushtetutës dhe në një numër ligjesh të tjera. Këto përfshijnë Ligjin Nr. 04/L-046 për Radion dhe Televizionin e Kosovës, Ligjin Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave, Ligjin Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve, Ligjin Nr. 04/L-137 për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë, Ligjin Nr. 03/L-118 për Tubimet Publike, Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve, Ligji Nr. 02/L-65 Civil kundër Shpifjes dhe Fyerjes, Ligji Nr. 02/L-31 për Lirinë Fetare në Kosovë, etj. Në përgjithësi, legjislacioni për lirinë e shprehjes dhe ligjet për mediat janë në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës dhe praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së.

**99.** Gjykata Kushtetuese e Kosovës ende nuk ka shpallur ndonjë aktgjykim që deklaron shkelje të lirisë së shprehjes të parashikuar nga neni 40 i Kushtetutës së Kosovës. Që nga gushti i vitit 2024, ekziston një lëndë e profilit të lartë në pritje për shqyrtim pranë Gjykatës Kushtetuese e ngritur nga deputetë të Kuvendit të Kosovës, e cila konteston kushtetutshmërinë e Ligjit të ri për Komisionin e Pavarur të Medias, ku argumentohet se ka ndodhur një shkelje e nenit 40. Mbetet të shihet nëse Gjykata Kushtetuese do të gjejë shkelje apo jo në këtë rast. Në anën tjetër, ekziston një rast ku janë analizuar çështjet që lidhen me nenin 40 të Kushtetutës dhe nenin 10 të KEDNJ-së, por në fund Gjykata Kushtetuese vendosi se nuk kishte ndodhur asnjë shkelje e kësaj të drejte.<sup>123</sup>

**100.** Pacenueshmëria e së drejtës për privatësi trajtohet ngjashëm në DUDNJ me anë të nenit 1, i cili thekson si në vijim: “Askush nuk duhet t’i nënshtrohet ndërhyrjeve arbitrare në privatësinë, familjen, shtëpinë ose korrespondencën e tij.”<sup>124</sup> KEDNJ nga ana tjetër e përfshin në mënyrë eksplicite të drejtën e privatësisë në kornizën e saj në nenin 8 në të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare.<sup>125</sup> Kushtetuta e Kosovës është veçanërisht shteruese kur bëhet fjalë për mbrojtjen e kësaj të drejte. Në të drejtën e privatësisë, siç renditet në nenin 36, mbrojtja e të dhënave personale (36.4) përfshihet krahas ruajtjes së fshehtësisë së korrespondencës (6.3) dhe paprekshmërisë së jetës private dhe familjare. Mbrojtja e të dhënave personale sigurohet ligjërisht përmes Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

**101.** Agjencia për Informim dhe Privatësi (AIP) është përgjegjëse për promovimin dhe mbrojtjen e të drejtës për qasje në informata dhe të drejtën e privatësisë në Kosovë. Roli i saj kryesor është të mbikëqyrë zbatimin e Ligjit Nr. 06/L-081 për Qasje në Dokumente Publike dhe Ligjit Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe të sigurojë që institucionet publike t’i zbatojnë këto ligje. AIP gjithashtu ofron udhëzime dhe këshilla për individët dhe organizatat për çështje që lidhen me qasjen në informata dhe mbrojtjen e të dhënave personale dhe ka kompetencë për të hetuar dhe vendosur sanksione në rastet e shkeljeve të këtyre ligjeve.<sup>126</sup> Në këtë drejtim, vlen të përmenden gjetjet e paraqitura në Raportin e AIP për muajt janar-nëntor 2024.<sup>127</sup> Gjatë kësaj periudhe, AIP pranoi gjithsej 810 ankesa nga OJQ-të, mediat, qytetarët dhe grupe të tjera interesi, nga të cilat 707 ankesa janë zgjidhur dhe 103 mbeten për t’u shqyrtuar.<sup>128</sup>

122 GJEDNJ, [Neni 10](#).

123 Shih për shembull [Vendimi KI27/20 i Gjykatës Kushtetuese](#) lidhur me një çështje zgjedhore ku u deklarua se nuk kishte ndodhur asnjë shkelje e Nenit 40 të Kushtetutës ose e Nenit 10 të KEDNJ-së.

124 DUDNJ, [Neni 12](#).

125 GJEDNJ, [Neni 8](#).

126 AIP (2024), shih [listën e botimeve dhe informacione të tjera](#) në faqen e tyre zyrtare të internetit.

127 AIP (2024), [Raporti Vjetor Janar-Nëntor 2024](#).

128 AIP (2024), [Raporti Vjetor Janar-Nëntor 2024](#).

**102.** Mediat në Kosovë konsiderohen pluraliste, por sektorit të medias ende i mungon transparenca dhe stabiliteti financiar, sipas raportit të Komisionit të BE-së. Të dhënat mbi tregun audiovizual mbeten të pamjaftueshme, duke përfshirë pronësinë dhe financimin e medias.<sup>129</sup> Sipas NSI, gazeta në gjuhën serbe nuk kishte në dispozicion për shitësit në Kosovë për shkak të kufizimeve të qershorit 2023 mbi importin e mallrave serbe, gjë që kishte ndikuar në të drejtat e serbëve të Kosovës për liri të shprehjes dhe informim.<sup>130</sup>

**103.** Gjatë periudhës së raportuar u vunë re disa ngjarje të cilat ndikuan te gazetarët serbë në kryerjen e punës së tyre profesionale të raportimit dhe mbulimit mediatik të ngjarjeve të caktuara. Për shembull, siç është raportuar nga mediat dhe është theksuar nga NSI, më 3 janar 2024, autoritetet e Kosovës e ndaluan gazetarin e Agjencisë Tanjug, Angjelko Utješanović, që të hynte në Kosovë për të mbuluar vizitën e Patriarkut Porfirije. Më 2 shkurt 2024, një ekip gazetarësh nga Radio Gorazdevac (Pejë), e vetmja media serbe në zonë, u ndalua nga Policia e Kosovës dhe automjeti i tyre u kontrollua, pavarësisht se i kishin ofruar kredencialet e vlefshme të gazetarëve. Këto ngjarje kanë minuar të drejtën e gazetarëve për të raportuar lirshëm dhe për të mbuluar çështje me interes publik, duke i përkeqësuar problemet dhe duke nxitur mosbesimin e vazhdueshëm nëse lihen pa u adresuar.

**104.** Sipas Raportit të Raportuesit Special mbi promovimin e të drejtës së lirisë së shprehjes, në Kosovë nevojitet mbështetje më e qëndrueshme për mediat e pavarura në gjuhën serbe.<sup>131</sup> Për më tepër, raporti ngret shqetësime praktike që lidhen me pandëshkueshmërinë për krimet kundër gazetarëve, pluralizmin e medias dhe përdorimin e gjuhëve të minoriteteve.<sup>132</sup> Si pasojë e tensioneve politike përgjatë vijave etnike, mjedisi në të cilin veprojnë mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe gazetarët është i polarizuar, "duke krijuar nevojën që autoritetet e Kosovës të hetojnë dhe të veprojnë menjëherë në të gjitha rastet e kërcënimeve, sulmeve dhe gjuhës së urrejtjes kundër gazetarëve dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut".<sup>133</sup>

**105.** Pozita e Kosovës në indeksin botëror të lirisë së shtypit është përkeqësuar në vitin 2024 krahasuar me vitet e mëparshme. Në vitin 2024, Kosova renditet e 75-ta krahasuar me vitin 2023 kur renditej e 56-ta.<sup>134</sup> Pavarësisht diversitetit të tregut mediatik, liria e mediave kërcënohet nga "rregullimi i politizuar, paditë strategjike, qasja e pamjaftueshme në informacione dhe një rritje e sulmeve fizike".<sup>135</sup>

**106.** Këshilli i Mediave të Shkruara të Kosovës (KMSHK) dhe Komisioni i Pavarur për Media (KPM) janë organet kryesore të përfshira në rregullimin e mediave në Kosovë. Ligji i shumëpritur për KPM-në u miratua në korrik të vitit 2024. Edhe pse kontribon në përmirësimin e rregullimit të mediave, ligji shkaktoi shqetësime në lidhje me lirinë e mediave, veçanërisht rregullimin e mediave

129 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 7.

130 NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

131 Kombet e Bashkuara, Asambleja e Përgjithshme, Këshilli i të Drejtave të Njeriut (2024), Vizitë në Serbi dhe Kosovë: [Raporti i Raportuesit Special mbi promovimin e të drejtës së lirisë së mendimit dhe shprehjes](#), Iren Khan.

132 Raportuesi Special i OKB-së (2024), [Raport mbi promovimin e të drejtës së lirisë së mendimit dhe shprehjes në Kosovë](#)

133 Raportuesi Special i OKB-së (2024), [Raport mbi promovimin e të drejtës së lirisë së mendimit dhe shprehjes në Kosovë](#)

134 Reporterët pa Kufij (2024) [Kosovë](#)

135 Reporterët pa Kufij (2024) [Kosovë](#)

online.<sup>136</sup> Kuvendi i Kosovës nuk arriti të pasqyrojë shumicën e rekomandimeve nga BE-ja, Këshilli i Evropës dhe partnerë të tjerë ndërkombëtarë<sup>137</sup> dhe derisa ky Ligj të jetë në përputhje me Direktivën e BE-së për Shërbimet e Mediave Audiovizuale, Kosova nuk mund të marrë pjesë në degën MEDIA të programit Creative Europe.<sup>138</sup> Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës dorëzoi komente në Gjykatën Kushtetuese<sup>139</sup> pas kontestimit të kushtetutshmërisë së këtij ligji nga disa deputetë të Kuvendit të Kosovës.<sup>140</sup> Lënda është në pritje të shqyrtimit në Gjykatën Kushtetuese që nga gushti i vitit 2024.

**107.** Dezinformimi mbetet një sfidë e rëndësishme në Kosovë dhe karakterizohet nga mungesa e vizionit të qartë për ta luftuar këtë fenomen. Sipas një Raporti të vitit 2024 të publikuar nga National Democratic Institute (NDI), mediat tradicionale dhe platformat online si TikTok, X, Facebook dhe Telegram janë përdorur si armë për të përhapur narrativa të rreme, për t'i frikësuar individët dhe për ta manipuluar opinionin publik.<sup>141</sup> Për shembull, nga 4,859 artikuj dhe postime të monitoruara, 996 prej tyre rezultuan se përmbanin çrregullime informative dhe këto artikuj/postime kishin ndërveprim dhe klikime më të larta, duke treguar kështu potencialin për ndikim të lartë që mund të kenë çrregullimet informative. Raporti gjithashtu thekson kërcënimin në rritje që paraqet përmbajtja e gjeneruar nga inteligjenca artificiale dhe deepfakes në përhapjen e dezinformimit dhe rolin e bot-ëve në përhapjen e agjendave politike dhe shtrembërimin e perceptimit publik mbi çështje të caktuara me interes. Përballimi i sfidave me të cilat përballlet Kosova në këtë drejtim kërkon vigjilencë të shtuar, edukim kritik mediatik dhe përgjigje të fuqishme për të mbrojtur perceptimin mediatik dhe për të mbështetur integritetin e informacionit.<sup>142</sup> Nga pikëpamja ekonomike, për mediat dhe veprimtarinë e tyre në Kosovë, qëndrueshmëria financiare varet kryesisht nga reklamat dhe donatorët financiarë, shpesh nga parti të ndryshme politike.<sup>143</sup> Veçanërisht në mesin e transmetuesve privatë, kjo situatë ka krijuar një paradoks ku qëndrueshmëria e mediave varet nga financimi i jashtëm, por ruajtja e integritetit të medias, me objektivitetin dhe paanshmërinë si dimensione thelbësore, kërkon pavarësi të plotë.

**108.** Katër organizata të shoqërisë civile, përkatësisht FOL, YIHR KS, INPO, dhe KDI i kanë bërë thirrje Ministrisë së Financave dhe Agjencisë për Informim dhe Privatësi që t'i zbulojnë të dhënat mbi Fondin e Sigurisë, duke argumentuar se klasifikimi i tij si konfidencial nuk është më i vlefshëm. Këto orgnizatapretendojnë se shuma e mbledhur nga fondi vullnetar duhet të jetë publike, dhe pretendimet se zbulimi i tij mund të rrezikojë interesat e sigurisë së Kosovës janë të pabaza. Këto organizata theksojnë mungesën e transparencës, duke vënë në dukje se gjersa buxheti shtetëror për Forcën e Sigurisë së Kosovës është i detajuar publikisht, Fondi Vullnetar i Sigurisë mbetet konfidencial. Më tutje argumentojnë se ky klasifikim bie ndesh me standardet ligjore dhe ndërkombëtare të transparencës, duke reflektuar mungesën e transparencës së qeverisë. Ato i kërkojnë Agjencisë për Informim dhe Privatësi që të mbështesë të drejtën e qytetarëve për qasje në këto të dhëna dhe kështu të tregojë pavarësinë e saj institucionale.<sup>144</sup>

136 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024.

137 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024.

138 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024.

139 AGK(2024), [AGK dorëzon në Gjykatën Kushtetuese Komente për Ligjin për Komisionin e Pavarur për Media](#).

140 Radio Evropa e Lirë (2024), [PDK dërgon në Kushtetuese ligjet për KPM-në dhe statutin për UP-në](#).

141 NDI (2024), [Raporti mbi Çrregullimet e Informacionit në Kosovë 2023](#).

142 NDI (2024), [Raporti mbi Çrregullimet e Informacionit në Kosovë 2023](#).

143 NDI (2022), [Integriteti i informacionit në Kosovë. Vlerësimi i ekonomisë politike të dezinformimit](#).

144 YIHR KS (2025), Kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024



**109.** Në vitin 2024, rritja e armiqësisë ndaj aktivistëve dhe organizatave që punojnë në çështjet e të drejtave të njeriut rezultoi në turrjen e hapësirës civile. Disa aktivistë u vunë në shënjestër me kërcënime dhe gjuhë urrejtjeje, duke përfshirë përpjekje për t'i diskredituar dhe frikësuar ata. Disa politikanë madje nxitën fushata linçimi kundër aktivistëve duke shtuar frikën dhe hakmarrjen ndaj tyre. Organizatat anëtare të Rrjetit për të Drejtat e Njeriut (RrDNj) kanë dënuar gjuhën e përdorur nga Ministri i Financave, Hekuran Murati, i cili në një seancë parlamentare në maj 2024 deklaroi se raporti i Departamentit të Shtetit të SHBA-së ra "viktimë e dezinformimit mediatik, i cili është ende pjesë e gardës së vjetër dhe madje edhe e disa organizatave të shoqërisë civile që maskohen si të tilla".<sup>145</sup>

**110.** Në një incident të raportuar nga OJQ AKTIV, Đorđe Bojović, konsulent i Viola Von Cramon, u përball me sulme në internet duke e akuzuar atë si agjent të Beogradit dhe Rusisë dhe për mohimin e dhunës në Kosovë në vitin 1999. Këto akuza buronin nga një video e vitit 2015, e cila ishte edituar për të shtrembëruar deklaratat e Bojović-it. YIHR KS e mbrojti atë dhe theksoi rëndësinë e hapësirave të sigurta për të diskutuar çështje të ndjeshme. Këto sulme, sipas AKTIV, kontribuojnë në krijimin e një atmosfere ku njerëzit kanë frikë t'i shprehin mendimet e tyre, duke kufizuar lirinë e fjalës.<sup>146</sup>

**111.** Në tri vitet e fundit, sipas OJQ AKTIV, në rrjete sociale është shfaqur një trend shqetësues, veçanërisht në TikTok, ku anëtarët e Policisë së Kosovës promovojnë etno-nacionalizmin shqiptar. Këto akte bien ndesh me Kushtetutën e Kosovës, e cila promovon neutralitetin dhe përfshirjen qytetare. Në fillim të nëntorit 2024, një kërkim kumulativ i hashtageve që lidhen me Policinë e Kosovës zbuloi mbi 14,000 postime. Për shembull, vetëm hashtagu #njesiaspecialekosoves kishte mbi 4,000 postime, duke gjeneruar më shumë se 270 milionë shikime. Postimet problematike shpesh shoqërohen me muzikë etno-nacionaliste, e cila e portretizon aparatin e sigurisë si promovues të qëllimeve nacionaliste shqiptare në vend që të zbatojë vizionin qytetar të Kosovës. Mbi 140 fotografi u ofruan si prova, ku shihen më shumë se 300 zyrtarë policor duke përdorur emblema, simbole, flamuj ose gjeste etnike që identifikojnë përkatësinë e tyre etnike. Këto akte vënë në pah pikëpamjet e tyre nacionaliste dhe, në disa raste, glorifikojnë "drejtësinë" jashtëgjyqësore. Pavarësisht natyrës së përhapur të këtij trendi në Kosovë, ka pasur pak njohje publike të efekteve të tij të dëmshme dhe nuk janë shqiptuar sanksione apo dënime. Institucionet përgjegjëse për adresimin e çështjeve të tilla, si Inspektorati i Policisë së Kosovës dhe misionet ndërkombëtare si EULEX-i nuk kanë arritur të reagojnë gjatë tre viteve të fundit, gjersa ky trend është rritur.<sup>147</sup>

**112.** Pas pezullimit të certifikatës së biznesit të mediumit Klan Kosova në vitin 2023,<sup>148</sup> beteja ligjore vazhdoi në vitin 2024. Në mars të vitit 2024, Gjykata Komerciale miratoi padinë që Klan Kosova ngriti kundër Agjencisë së Regjistrimit të Bizneseve (ARBK), duke konfirmuar kështu licencën e biznesit të këtij mediumi për të vepruar lirshëm.<sup>149</sup> Fillimisht, kur u dha vendimi për mbylljen e mediumit, Asociacioni i Gazetarëve të Kosovës (AGK) me gazetarë, fotoreporterë, kameramanë

145 YIHR KS (2025), [RrDNj dënon sulmin e Ministrit Hekuran Murati ndaj mediave dhe OSHC-ve.](#)

146 AKTIV (2025), Kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

147 AKTIV (2025), Kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

148 Prishtina Insight (2023), [Pezullimi i certifikatës së mediumit nxit protesta në Kosovë.](#)

149 Klan Kosova (2024) [Klan Kosova fiton padinë ndaj ARBK-së.](#)



dhe aktivistë u mbledhën para qeverisë për të kundërshtuar pezullimin e licencës si një formë të censurës mediatike dhe një kërcënim për lirinë e fjalës.

**113.** Transmetuesi publik i Kosovës, RTK, u përballë me mungesë stabiliteti gjatë vitit 2024 përcjellur me një numër dorëheqjesh nga radhët e menaxhmentit të lartë dhe anëtarëve të bordit.<sup>150</sup> Sipas Raportit të BE-së për Kosovën, ekzistojnë shqetësime serioze në lidhje me pavarësinë dhe llogaridhënien redaktoriale, të cilat duhet të adresohen shpejt. Konkursi për zgjedhjen e Drejtorit të ri të Përgjithshëm të RTK-së është anuluar në tetor 2024 dhe që atëherë transmetuesi publik po funksionon me një ushtrues detyre të Drejtorit.<sup>151</sup>

**114.** Ligji Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve është një tjetër mjet juridik me anë të cilit mund të imponohet liria e shprehjes dhe e mendimit, si dhe e drejta për informim. Gjatë periudhës së raportimit, ka pasur shkelje të vazhdueshme të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve, veçanërisht në lidhje me gjuhën serbe si gjuhë zyrtare në të gjithë Kosovën, gjë që ka pasur një ndikim negativ në të drejtën e qasjes në informata. Gjykatat hasin vështirësi në përmbushjen e kërkesës së Ligjit për Gjuhët për të publikuar vendimet gjyqësore në të dy gjuhët zyrtare për shkak të mungesës së përkthyesve serb. Disponueshmëria dhe cilësia e përkthimit në procedurat gjyqësore mbetet një sfidë tjetër. Mediat në gjuhën serbe vazhdojnë të përballen me sfida në qasjen në informacione, sepse institucionet publike nuk i përmbushin kërkesat e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve.<sup>152</sup>

**115.** Ligji Nr. 06/L-081 për Qasjen në Dokumente Publike dhe Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve janë miratuar, por ende nuk janë zbatuar në një nivel të kënaqshëm. Në vitin 2024, OJQ FOL publikoi një raport të titulluar: “Gjetjet e anketës mbi kuptimin dhe perceptimin e sinjalizuesve nga punonjësit e sektorit privat”, i cili zbuloi se 75 përqind e bizneseve të anketuara nuk kanë krijuar akte të brendshme për të rregulluar procedurën e sinjalizuesve siç parashikohet nga Ligji për Mbrojtjen e Sinjalizuesve.<sup>153</sup> Raporti zbulon gjithashtu se (i) shumica e bizneseve treguan vështirësi në kuptimin e procedurave të sinjalizimit; (ii) shumë e konsiderojnë mekanizmin e sinjalizimit si jo “shumë të rëndësishëm”; dhe se (iii) vetëm një pjesë e vogël e bizneseve të anketuara i ishin nënshtruar inspektimeve nga Inspektorati i Punës në lidhje me emërimin e zyrtarëve të sinjalizimit - një fakt që nxjerr në pah mungesën e mbikëqyrjes nga Inspektorati i Punës.<sup>154</sup>

**116.** Një raport i publikuar së fundmi nga OJQ FOL në dhjetor të vitit 2024 identifikon disa çështje kyçe në lidhje me përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Ligji Nr. 06/L-082 për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Këto përfshijnë dështimin e një numri të konsiderueshëm institucionesh publike për të emëruar zyrtarë përgjegjës për mbrojtjen e të dhënave personale, mungesën e politikave të privatësisë, mungesën e trajnimit të zyrtarëve, një numër të ulët institucionesh që kanë zhvilluar protokolle për menaxhimin e të dhënave të ndjeshme dhe mungesën e rregulloreve mbi masat e sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale, ndër të tjera. Të dhënat e mbledhura nga institucionet publike tregojnë se edhe pse disa kanë bërë progres në këtë fushë, ende mbetet një boshllëk i konsiderueshëm në zbatimin e standardeve të kërkuara ligjore.<sup>155</sup>

150 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën, f. 7.

151 Koha (2024), [RTK-ja emëron ushtruesin e detyrës së drejtorit të përgjithshëm](#).

152 NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

153 FOL (2024), [Raport: Gjetjet e anketës mbi kuptimin dhe perceptimin e sinjalizimit nga punonjësit e sektorit privat](#).

154 FOL (2024), [Raport: Gjetjet e anketës mbi kuptimin dhe perceptimin e sinjalizimit nga punonjësit e sektorit privat](#).

155 FOL (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

### 117. Rekomandimet

- Agjencia për Informim dhe Privatësi duhet të vazhdojë mbikëqyrjen e saj mbi qasjen në dokumente publike dhe mbrojtjen e të dhënave personale duke siguruar pajtueshmëri ndërmjet institucioneve publike dhe duke zbatuar sanksione për çdo shkelje;
- Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të forcojë mbrojtjen për gazetarët dhe punonjësit e mediave duke siguruar hetime me kohë për kërcënimet dhe sulmet, duke përmirësuar transparencën në pronësinë e mediave dhe duke adresuar sfidat e qëndrueshmërisë financiare në këtë sektor;
- Këshilli Gjyqësor dhe ai Prokurorial duhet të përmirësojnë pajtueshmërinë me Ligjin Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve duke adresuar mungesën e përkthyesve të gjuhës serbe në gjykata dhe duke siguruar publikimin me kohë të vendimeve gjyqësore në të dy gjuhët zyrtare.

## 5.6. Liria e tubimit paqësor

**118.** Liria e tubimit paqësor si një e drejtë themelore e njeriut parashihet në nivel ndërkombëtar me nenin 20 të DUDNj-së që përcakton qartë se: “secili e ka të drejtën e lirisë së tubimit dhe organizimit paqësor” (shih gjithashtu pjesën 5.7 të këtij raporti, për lirinë e asociimit). Neni 11 i KEDNj-së ngjashëm e formulon lirinë e asociimit si vlerë thelbësore. Në Kushtetutën e Kosovës, një formulim sinonim është miratuar në nenin 43 si liria e tubimit dhe jo e mbledhjes. Kushtetuta thotë se “Secili person gëzon të drejtën për të organizuar tubime, protesta dhe demonstrata, si dhe të drejtën për të marrë pjesë në to”.<sup>156</sup> Ligjet e tjera që formojnë sfondin legjislativ të kësaj të drejte në Kosovë janë Ligji Nr. 03/L-166 për Tubimet Publike, Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë dhe Kodi Penal Nr. 06/L-074.

**119.** Gjatë një vizite të Kryeministrit Albin Kurti në veri të Kosovës në shtator 2024, dy politikanë serbë të Kosovës (Aleksandar Arsenijević dhe Ivan Orlović) u arrestuan pas protestës së tyre kundër vendimit të Qeverisë për të ndërtuar një nënstacion të ri policor në Leshkë. Politikanët serbë të Kosovës u arrestuan nga Policia e Kosovës me pretekstin se prishën rendin dhe qetësinë publike duke i fishkëllyer kryeministrit dhe shoqëruesve të tij gjatë vizitës së tyre në veri të Kosovës. Rrjeti për të Drejtat e Njeriut (RrDNj) shprehi shqetësime serioze në lidhje me ndalim e tyre të jashtëligjshëm pas protestës së tyre paqësore, duke i bërë thirrje Qeverisë së Kosovës dhe Policisë së Kosovës që t’i respektojnë të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe të fillojnë procedurat kundër atyre që janë të përfshirë në ndalimin e këtyre individëve.<sup>157</sup> Ata u liruan brenda pak orësh.

**120.** Sipas OJQ NSI, e drejta për protestë paqësore ishte ndër të drejtat më të kërcënuara për komunitetin serb në Kosovë gjatë vitit 2024. Politikiani Aleksandar Arsenijević u arrestua shtatë herë për pjesëmarrje në demonstrata paqësore, duke përfshirë katër raste ku vepra penale për të cilën arrestohej ishte thjesht “fryrja e një bilbili”. Këto veprime u kritikuan gjerësisht nga disa OJQ dhe

156 Kushtetuta e Kosovës (2008), Neni 43.

157 YIHR KS(2025), [Rrjeti i të Drejtave të Njeriut dënon fuqishëm arrestimin e qytetarëve serbë të Kosovës në veri të Mitrovicës](#).

akterë politikë, të cilët i dënuan ato si një shtypje të hapur të së drejtës për protestë paqësore. Në një rast veçanërisht shqetësues, Arsenijević u akuzua për ngacmim ndaj Visar Sylës, shefit të stafit të Kryetarit të Komunës së Mitrovicës së Veriut, Erden Atiq, për përdorimin e një bilbili si formë proteste. Aktivistë të tjerë nga partia politike e Arsenijević-it u përballën gjithashtu me arrestime të shumta. Demonstratat paqësore dhe përpjekjet e aktivistëve u monitoruan shpesh nga një prani e madhe policore, ku disa ngjarje u mbikëqyrën edhe nga njësitë speciale të policisë. Vendosja e kontingjenteve të mëdha të zyrtarëve të njësisë speciale, si me uniformë ashtu edhe me rroba civile, së bashku me veprimet kundër aktivistëve, dukeshin të dizajnuara për të shtypur mospajtimin publik dhe për të dekurajuar protesta të mëtejshme.<sup>158</sup>

**121.** Më 8 mars 2024, u organizua një protestë ku u avokua për drejtësi, barazi dhe siguri për gratë, me thirrje për të ndëshkuar autorët e dhunës në familje me dënime që do të dekurajonin përsëritjen e krimeve të tilla në Kosovë.<sup>159</sup> Aktivistët, të cilët kërkonin ndryshime për gratë dhe vajzat në Kosovë, u pritën me forcë të tepruar nga policia e Kosovës ndërsa përpiqeshin të hynin në oborrin e hapur të Qeverisë së Kosovës. Aktivistët mbetën të përkushtuar për të vazhduar luftën për të drejtat e tyre, duke kërkuar llogari për veprimet e policisë dhe duke riafirmuar se “rrugët janë tonat, jo të qeverisë”.<sup>160</sup>

**122.** Më 9 gusht 2024, përpara stacionit të policisë në Graçanicë u organizua një protestë kundër femicidit dhe dhunës ndaj grave. Protesta u organizua nga OJQ Pravo na pravo, e cila deklaroi se femicidi duhet të dënohet me burgim të përjetshëm dhe se dhuna në familje nuk është çështje private, por një çështje për të cilën Qeveria dhe shoqëria duhet të bëjnë më shumë.<sup>161</sup> Protesta u organizua pas vrasjes së një gruaje në Graçanicë, e cila vdiq si pasojë e lëndimeve që pësoi nga sulmi fizik nga bashkëshorti i saj.<sup>162</sup>

**123.** Në shkurt të vitit 2024, mijëra serbë të Kosovës u mbledhën në veri të Mitrovicës për të protestuar kundër vendimit të Qeverisë për ta bërë euron monedhën e vetme ligjore në Kosovë.<sup>163</sup> Në gusht të vitit 2024, serbët e Kosovës nga veriu i Kosovës protestuan kundër hapjes së urës kryesore në Mitrovicën e Veriut, pas zbulimit të planeve të Qeverisë për ta hapur urën për trafik - një vendim i Qeverisë së Kosovës i kundërshtuar fuqishëm nga NATO dhe vendet e Kuintit.<sup>164</sup> Në shtator të vitit 2024, dhjetëra serbë të Kosovës protestuan kundër mbylljes së pesë institucioneve paralele të drejtuara nga Serbia në veri të Kosovës.<sup>165</sup> Nuk u raportuan incidente gjatë protestës në të cilën morën pjesë rreth 80 qytetarë.

**124.** E drejta e lirisë së shprehjes për fëmijët njihet dhe mbrohet sipas Nenit 13 të Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve (UNCRC). Ky nen përcakton disa parime kryesore në lidhje me të drejtat e fëmijëve për të shprehur lirshëm pikëpamjet e tyre dhe për të pasur qasje në informata. Neni 13 thotë se “fëmija ka të drejtën e lirisë së shprehjes”. Kjo përfshin aftësinë për të kërkuar, marrë dhe përhapur informacion dhe ide të të gjitha llojeve, pavarësisht nga mediumi i përdorur (formë e folur, e shkruar apo artistike). E drejta për të pasur qasje në informata është

158 NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

159 Radio Evropa e Lirë (2024), [Thirrje për drejtësi, barazi dhe siguri për gratë](#).

160 YIHR KS (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

161 Radio Evropa e Lirë (2024), <https://www.evropaelire.org/a/gracanice-proteste-dhuna-ndaj-grave-vrasjet-/33072504.html>.

162 Kallxo (2024), [Vdekja e gruas në Graçanicë, rasti kualifikohet nga dhuna në familje në vrasje të rëndë](#).

163 Reuters (2024), [Serbët në Kosovë protestojnë kundër ndalimit të dinarit serb](#).

164 Radio Evropa e Lirë (2024), [Serbët e Kosovës protestojnë në veri të Mitrovicës kundër hapjes së urës kryesore](#).

165 Balkan Insight (2024), [Serbët e Kosovës protestojnë kundër mbylljes së 'Institucioneve Paralele' të udhëhequra nga Serbia](#).

gjithashtu pjesë integrale e lirisë së shprehjes. Neni 13 përcakton që fëmijët duhet të kenë qasje në një sërë burimesh dhe materialesh që promovojnë kuptimin e tyre të çështjeve sociale, politike dhe kulturore, duke i mundësuar kështu ata të jenë të informuar.<sup>166</sup>

**125.** Në lidhje me kornizën ligjore ekzistuese, OJQ Save the Children Kosova/o vë në pah se Ligji Nr. 08/L-166 për Tubimet Publike mund të vendosë kërkesa procedurale që e ndërlikojnë aftësinë e fëmijëve dhe të rinjve për të organizuar ose marrë pjesë në tubime publike. Për shembull, përcaktimet për njoftim paraprak të autoriteteve mund të ndikojnë në mënyrë disproporcionale te pjesëmarrësit më të rinj, të cilëve mund t'u mungojnë burimet ose njohuritë për të kaluar nëpër proceset burokratike. Kjo bie ndesh drejtpërdrejt me Nenin 12 të KDF-së së OKB-së, i cili thotë se fëmijët kanë të drejtë të shprehin lirshëm pikëpamjet e tyre në të gjitha çështjet që i prekin ata dhe pikëpamjeve të tyre duhet t'u ipet pesha e duhur. Fokusi kryesor i ligjit në ruajtjen e rendit publik pa dashje i jep përparësi interesave të shtetit mbi të drejtat pjesëmarrëse të fëmijëve. Ndërsa është thelbësore të sigurohet siguria gjatë tubimeve publike, theksi i tepërt në kufizime minon frymën e angazhimit demokratik. Neni 29 i KDF-së së OKB-së thekson rëndësinë e arsimit për zhvillimin e fëmijës, duke përfshirë respektin për të drejtat e të tjerëve dhe të mësuarit rreth angazhimit dhe pjesëmarrjes qytetare.<sup>167</sup>

**126.** Në qershor të vitit 2024, u mbajt Parada e Krenarisë e komunitetit LGBTIQ+ në Prishtinë. Sipas OJQ CEL, Java e Krenarisë dhe Parada e Krenarisë e vitit 2024 mund të konsiderohet si një ngjarje që u zhvillua pa probleme dhe pa ndonjë incident apo pengesë të madhe. Parada e Krenarisë e vitit 2024 u mbështet nga disa individë dhe organizata me ndikim në Kosovë, përfshirë politikanë të nivelit të lartë. Pjesëmarrësit ishin të lirë të shpreheshin dhe të shijonin ngjarjen.<sup>168</sup>

## 127. Rekomandimet

- Qeveria e Republikës së Kosovës dhe Policia e Kosovës duhet të sigurojnë që e drejta për tubime paqësore të respektohet dhe që arrestimet ose ndalimet të mos përdoren si mjet për të shtypur mospajtimet, veçanërisht në zonat politikisht të ndjeshme;
- Kuvendi i Kosovës duhet të rishikojë dhe ndryshojë Ligjin për Tubimet Publike për të eliminuar pengesat procedurale të panevojshme për fëmijët dhe të rinjtë, duke siguruar të drejtën e tyre për tubim paqësor në përputhje me Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve;
- Ministria e Drejtësisë duhet të forcojë mbrojtjen ligjore për lirinë e shprehjes, veçanërisht për aktivistët, komunitetet jo-shumicë dhe gazetarët, duke siguruar që ata të mund të veprojnë pa frikën e ngacmimit ose ndërhyrjes së shtetit;
- IPK-ja dhe IAP-ja duhet të monitorojnë sjelljen e policisë gjatë protestave publike, duke siguruar që veprimet e zbatimit të ligjit të jenë në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut dhe që çdo shkelje të hetohet.

166 Save the Children Kosova/o (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

167 Save the Children Kosova/o (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

168 CEL Kosova (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

## 5.7. Liria e asociimit

**128.** Liria e asociimit është një dimension thelbësor i kornizës së të drejtave të njeriut dhe njihet krahas lirisë së tubimit në nenin 20 të DUDNJ. Një dispozitë shtesë është formuluar në nenin 20.1, si e drejta e secilit për të mos qenë i detyruar të bëjë pjesë në një shoqatë.<sup>169</sup> Liria e asociimit dhe e tubimeve garantohet gjithashtu nga Neni 11 i KEDNJ-së dhe GJEDNJ-ja ka ndërtuar një praktikë gjyqësore shumë të larmishme në lidhje me formën dhe llojin e tubimit/asociimit, detyrimet pozitive të shtetit në sigurimin e kësaj të drejte, kufizimet në ushtrimin e kësaj të drejte, etj.<sup>170</sup> Komisioni i Venecias ka qenë gjithashtu aktiv në ofrimin e udhëzimeve mbi lirinë e asociimit.<sup>171</sup> Liria e asociimit garantohet gjithashtu përmes Kushtetutës së Kosovës dhe përfshin të drejtën për të “themeluar një organizatë pa pasur nevojë për leje” (neni 44.1) dhe të drejtën për të themeluar sindikata (neni 44.2). Përveç këtyre instrumenteve ndërkombëtare dhe kushtetuese, një sërë ligjesh dhe rregulloresh të tjera vendore e plotësojnë kornizën legjislative të zbatueshme për këtë të drejtë.

**129.** Ligji Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare më tej rregullon të drejtën kushtetuese për asociim pa marrë leje. I njohur si Ligji për OJQ-të, legjislacioni për OJQ-të ofron një mjedis të përmirësuar ligjor duke hequr kufizimet për shtetasit e huaj dhe duke përfshirë forma të reja ligjore me periudha të shkurtuara për regjistrim.<sup>172</sup>

**130.** Në vitin 2024, disa dispozita specifike të ligjit bazë për lirinë e asociimit u ndryshuan përmes Ligjit Nr. 08/L-244 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare.<sup>173</sup> Amendamenti më i rëndësishëm ka të bëjë me të drejtën e ankimit kundër çdo vendimi përfundimtar që merret në bazë të këtij Ligji, i cili do të shqyrtohet nga një Komision Ankesash që do të krijohet nga Ministria e Administratës Publike. Sipas kornizës ligjore, Komisioni i Ankesave do të ketë tre anëtarë dhe njëri prej tyre duhet të jetë gjithmonë përfaqësues nga sektori i OJQ-ve. Akti nënligjor i titulluar: “Rregullorja (MPB) Nr. 01/2024 për Themelimin, Përbërjen, Mandatin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit të Ankesave për Organizatat Joqeveritare” u miratua në shtator 2024 nga Ministria e Punëve të Brendshme.<sup>174</sup> Prandaj, raporti i Komisionit të BE-së ka konfirmuar se legjislacioni mbi lirinë e asociimit përmbush standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, por paralajmëroi se Komisioni i ri i Ankesave duhet të jetë i pavarur nga pushteti ekzekutiv.<sup>175</sup>

**131.** Për më tepër, Ligji Nr. 04/L-011 për Organizimin e Sindikatave në Kosovë dhe Ligji Nr. 03/L-212 për Punën rregullojnë të drejtën e secilit për të formuar sindikata në kontekstin e sektorëve publikë dhe privatë të punësimit. Ligji për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare zbatohet për të gjitha llojet e OJQ-ve, duke përfshirë organizatat bazë. Udhëzimi Administrativ Nr. 12/2022 për Regjistrimin, Funksionimin dhe Çregjistrimin e Organizatave Joqeveritare përcakton gjithashtu procedurat për regjistrimin, funksionimin dhe çregjistrimin e instituteve si një formë e re e orga-

169 DUDNJ, [Neni 20](#).

170 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (2024), [Udhëzues mbi Nenin 11 \(Liria e tubimit dhe e asociimit\) të KEDNJ-së](#).

171 Komisioni i Venecias, [Udhëzime të Përbashkëta mbi Lirinë e Asociimit](#).

172 Qendra Evropiane për Legjislacionin Jo-Fitimprurës (2019), [Kosova miraton një ligj të ri progresiv mbi OJQ-të](#).

173 [Ligji Nr. 08/L-244 për ndryshimin e Ligjit Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare](#).

174 Ministria e Punëve të Brendshme (2024), [Rregullorja nr. 01/2024 për Themelimin, Përbërjen, Mandatin, Detyrat dhe Përgjegjësitë e Komisionit të Ankesave për Organizatat Joqeveritare](#) i cili u miratua bazuar në Nenin 8.3 të [Ligjit Nr. 08/L-244 për ndryshimin e Ligjit Nr. 06/L-043 për Lirinë e Asociimit në Organizatat Joqeveritare](#).

175 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 34.



nizimit të OJQ-ve të njohura nga Ligji për OJQ-të.<sup>176</sup> Regjistri publik i OJQ-ve duhet të përditësohet dhe duhet të sigurohet që sistemi elektronik i organizatave joqeveritare të Kosovës të jetë plotësisht i besueshëm.

**132.** Qershori i vitit 2024 shënoi njëvjetorin e masave të BE-së kundër Kosovës, një përgjigje e BE-së ndaj vendimit të njëanshëm të Qeverisë së Kosovës për të dërguar në zyret e tyre publike kryetarët e komunave që u zgjodhën me një pjesëmarrje të papërfillshme të elektoratit në komunat veriore. Ky vendim erdhi pa mbështetjen e BE-së.<sup>177</sup> Si pasojë, projekte me vlerë rreth 300 milionë euro u pezulluan, duke ndikuar ndjeshëm tek OSHC-të në Kosovë dhe në potencialin për zhvillim ekonomik dhe social. Pavarësisht faktit se Përfaqësuesi i Lartë i BE-së ka rekomanduar heqjen e sanksioneve kundër Kosovës dhe se disa OSHC i kanë konsideruar masat kufizuese të BE-së si “kundërproduktive”, “të çekuilibruara” dhe “një goditje për vendin”, BE-ja nuk i ka hequr sanksionet kundër Kosovës. Sipas raporteve të fundit, BE-ja synon t’i heqë sanksionet në mënyrë të pjesshme dhe graduale dhe jo të gjitha menjëherë.<sup>178</sup>

**133.** Në vitin 2024, Qeveria e Kosovës (QeK) nuk arriti të miratonte Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile (2024-2029), pavarësisht përpjekjeve të vazhdueshme nga Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM) dhe Platforma CiviKos për të finalizuar zhvillimin e saj. Kjo vonesë, së bashku me mosaktivitetin e Këshillit për Bashkëpunim të Qeverisë me Shoqërinë Civile gjatë gjithë vitit ngritë shqetësime në lidhje me angazhimin e QeK për të nxitur një bashkëpunim kuptimplotë me organizatat e shoqërisë civile në Kosovë. Mungesa e një strategjie të përditësuar thekson më tej ngecjen në bashkëpunimin institucional, duke kufizuar efektivitetin e pjesëmarrjes së shoqërisë civile në proceset e hartimit të politikave.<sup>179</sup>

**134.** Sipas Freedom House, korniza legjislative në Kosovë u mundëson OJQ-ve të funksionojnë lirshëm dhe shumë prej tyre angazhohen në kritika ndaj autoriteteve dhe kanë qenë në gjendje të angazhohen në punë avokuese pa ndërhyrje. Megjithatë, në raste të caktuara OJQ-të hasin në presion për t’i kufizuar kritikën ndaj qeverisë.<sup>180</sup>

**135.** Analiza e Hapësirës Qytetare e kryer nga OJQ Save the Children Kosova/o në konsultim me grupe të udhëhequra nga fëmijët identifikoi disa kufizime në lirinë e asociimit për fëmijët. Një nga kritikën kryesore është se ligji në përgjithësi kufizon aftësinë e individëve nën 18 vjeç për të formuar ose udhëhequr organizata joqeveritare në mënyrë të pavarur. Kjo krijon pengesa për angazhimin e të rinjve në shoqërinë civile, duke i penguar ata të ushtrojnë plotësisht të drejtën e tyre për asociim. Ndërsa të miturit mund t’u bashkohen organizatave, mungesa e autonomisë së tyre ligjore kufizon aftësinë e tyre për të ndikuar ndjeshëm në proceset e vendimmarrjes.<sup>181</sup>

176 Zyra për Qeverisje të Mirë (2022), [Draft udhezim nr. xx/2021](#).

177 GLPS (2024), Njëvjetori i Masave të BE-së kundër Kosovës.

178 Radio Evropa e Lirë (2024), [BE-ja pritët t’i heqë pjesërisht dhe gradualisht masat ndaj Kosovës](#).

179 Platforma CiviKos (2024), [Grupi punues për hartimin e Strategjisë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile 2024-2029 mbajti një tjetër punëtori](#).

180 Freedom House (2024), [Kosovë](#).

181 Save the Children Kosova/o (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.



**136.** Sipas OJQ Save the Children Kosova/o, korniza ligjore ekzistuese mund të mos sigurojë në mënyrë të mjaftueshme që zërat e fëmijëve dhe të rinjve të dëgjohen në shoqatat ku ata anëtarësohen. Ky nën-përfaqësim mund të çojë në mungesë të avokimit për çështjet që prekin posaçërisht të rinjtë, siç janë arsimi, shëndetësia dhe pjesëmarrja në aktivitete qytetare. Si pasojë, interesat dhe të drejtat e të miturve mund të anashkalohen në agjendat më të gjera organizative. Gjersa shoqatat formale rregullohen me ligj, grupet joformale të të rinjve, të cilat mund të jenë thelbësore për angazhimin e komunitetit dhe aktivizmin shoqëror, mund të mos njihen ose të mos mbështeten në mënyrë të mjaftueshme. Kjo mund të pengojë aftësinë e të rinjve për t'u mobilizuar për kauza të rëndësishme për ta, duke kufizuar aftësinë e tyre për t'u organizuar dhe për të avokuar kolektivisht. Ligjet dhe rregulloret ekzistuese mund të përfitojnë nga dispozita më të qarta që njohin dhe mbështesin të drejtat e fëmijëve dhe të rinjve për të formuar shoqatat e tyre. Kornizat gjithëpërfshirëse duhet të adresojnë në mënyrë të qartë të drejtat e të rinjve për t'u organizuar, për të marrë pjesë dhe për të udhëhequr brenda shoqërisë civile, në përputhje me konventat ndërkombëtare si Konventa për të Drejtat e Fëmijëve, e cila thekson rëndësinë e pjesëmarrjes së fëmijëve në çështjet që kanë të bëjnë me ta.<sup>182</sup>

### 137. Rekomandimet

- Ministria e Punëve të Brendshme duhet të sigurojë pavarësinë e plotë të Komisionit të Ankesave për Organizatat Joqeveritare, duke parandaluar ndërhyrjen e ekzekutivit në veprimtarinë e tij;
- Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të miratojë Strategjinë Qeveritare për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile (2024-2029) pa vonesa të mëtejshme dhe të riaktivizojë Këshillin për Bashkëpunim me Shoqërinë Civile për të forcuar dialogun institucional me OJQ-të;
- Ministria e Punëve të Brendshme duhet të përditësojë rregullisht Regjistrin Publik të OJQ-ve dhe të përmirësojë sistemin elektronik të Kosovës për regjistrimin e OJQ-ve për të rritur transparencën, qasjen dhe besueshmërinë.

## 5.8. Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe e fesë

**138.** Liria e besimit, e ndërgjegjes dhe fesë ka të bëjë me të drejtën e individëve për të manifestuar, adhuruar dhe praktikuar besimet e tyre vetëm ose në një komunitet me të tjerët. Njohja e saj si një e drejtë universale e njeriut është e përcaktuar në nenin 18 të DUDNJ-së dhe në mënyrë ekuivalente

shprehet edhe në nenin 9 të KEDNJ-së. Në këtë Konventë, kufizimet në manifestimet e besimit ose fesë mund të përcaktohen me ligj vetëm në rrethana kur ato cenojnë interesat dhe vlerat e një shoqërie demokratike dhe janë të domosdoshme në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit publik ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve. GJEDNJ-ja ka interpretuar Nenin 9 të KEDNJ-së në një numër rastesh të rëndësishme, ku ka përcaktuar parimet kryesore që lidhen me detyrimet negative dhe pozitive të shtetit në sigurimin e mbrojtjes së kësaj të drejte.<sup>183</sup>

<sup>182</sup> Save the Children Kosova/o (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

<sup>183</sup> Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (2024), [Udhëzues mbi Nenin 9 \(Liria e mendimit, e ndërgjegjes dhe e fesë\) të KEDNJ-së](#).

**139.** Në kuadër të Kushtetutës së Kosovës, kjo e drejtë është formuluar në kuptimin e lirisë së besimit, ndërgjegjes dhe fesë në nenin 38. Për më tepër, Kushtetuta e Kosovës (Të Drejtat e Komuniteteve) parasheh në nenin 59, paragrafi 1, se: “pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë, individualisht ose në komunitet, të shprehin, mbajnë dhe zhvillojnë kulturën e tyre dhe të ruajnë elementet thelbësore të identitetit të tyre, përkatësisht fenë, gjuhën, traditat dhe kulturën e tyre”. E drejta për të besuar dhe manifestuar fenë e dikujt shkon paralelisht në Kushtetutë me të drejtën për të ndryshuar fenë (neni 3) ose për të mos qenë i detyruar për t’u bashkuar me një komunitet fetar ose për të bërë të njohur përkatësitë fetare. Megjithatë, duhet theksuar se Kosova është shtet laik dhe është neutral në çështjet e besimeve fetare siç parashihet me nenin 8 të Kushtetutës. Kjo u vërtetua në rastin e Arjeta Halimit, për të cilin Gjykata Kushtetuese deklaroi, ndër të tjera, se autoritetet publike janë të detyruara të respektojnë nenin 8 të Kushtetutës për të ruajtur neutralitetin e shtetit për çështjet fetare.<sup>184</sup>

**140.** Miratimi i Projektligjit për Lirinë Fetare ka mbetur pezull prej vitesh. Ai nuk është përfshirë në Agjendën Legjislative të Qeverisë së Republikës së Kosovës për vitin 2024<sup>185</sup> pavarësisht se u miratua nga Qeveria e Kosovës një vit më parë. Projektligji fillestar për Lirinë Fetare u miratua për herë të parë në vitin 2006 dhe më pas në vitin 2023 dhe në të dyja rastet me qëllim përditësimin e kornizës ligjore për liritë fetare dhe rritjen e përputhshmërisë me të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara nga Kushtetuta.<sup>186</sup> Pritej që ndryshimet në statusin ligjor të bashkësisë fetare do të përfshijnë të drejtën e pronësisë ligjore të pronës, të drejtën e marrjes me qira të pronës, të drejtën e mbajtjes së një llogarie zyrtare bankare, të punësimit të punëtorëve dhe të themelimit të institucioneve me karakter humanitar dhe arsimor. Ndryshimet pritej gjithashtu të përfshinin formimin e një komisioni për t’u marrë me çështjet praktike dhe për të përcaktuar kriteret për regjistrimin e bashkësive të reja fetare në Kosovë.

**141.** Kosova ka 43 zona në mbrojtje të veçantë, të cilat janë krijuar me Ligjin Nr. 03/L-039 për Zonat e Veçanta të Mbrojtura, me qëllim të ruajtjes së lokacioneve me rëndësi fetare dhe kulturore. Këtyre zonave u ofrohet mbrojtje ligjore nga çdo aktivitet që potencialisht mund të shkaktojë dëm ose shqetësim në mjedisin historik, kulturor ose natyror. Një njësi e specializuar policore, e përbërë nga individë me prejardhje të ndryshme etnike, ofron vëzhgim 24 orë në ditë për të garantuar sigurinë e këtyre zonave. Edhe pse nuk kanë ndodhur incidente të rënda në këto vende vitet e fundit, gjatë periudhës së raportimit kanë ndodhur akte të përdhosjes kundër Kishës Ortodokse Serbe dhe përpjekje për të përvetësuar dhe minuar identitetin e zonave fetare.<sup>187</sup>

**142.** Më 13 mars 2024, Kryeministri Albin Kurti i kërkoi Agjencisë Kadastrale të Kosovës që të zbatojë plotësisht Vendimin e Gjykatës Kushtetuese të vitit 2016 për Manastirin e Deçanit. Të nesërmen, vendimi u zbatua nga Agjencia Kadastrale e Kosovës dhe Ministrja e Punëve të Jashtme të Kosovës i dërgoi një shkresë Këshillit të Evropës duke i informuar ata për përfundimin e kësaj çështjeje të

184 Rasti Nr. [KI 36/11](#) Rishikimi kushtetues i mosekzekutimit të pretenduar të vendimit të Gjykatës së Qarkut në Gjiilan CN.nr.24/09 i 17 nëntorit 2009 dhe shkelje e pretenduar e të drejtave të njeriut të aplikantit.

185 Qeveria e Kosovës, [Agjenda Legjislative për vitin 2024](#).

186 Nacionale (2023), [Qeveria miraton projektligjin për Lirinë Fetare](#), AA (2023), [Qeveria e Kosoves miraton projektligjin per lirine fetare](#).

187 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 33.

rëndësishme,<sup>188</sup> e cila u vendos si parakusht për të vazhduar procesin e pranimit brenda organizatës. Në një deklaratë të përbashkët, shtetet e Kuintit mirëpritën dhe përgëzuan veprimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës duke theksuar se “zbatimi i sundimit të ligjit dhe respektimi i pavarësisë gjyqësore janë detyrime për të gjitha qeveritë e zgjedhura në mënyrë demokratike dhe parakushte të nevojshme për integrimin e Kosovës në institucionet evropiane dhe euroatlantike”.<sup>189</sup> Vendimi i Qeverisë së Kosovës për të zbatuar Vendimin për Manastirin e Deçanit ishte vendimtar në marrjen e një rekomandimi pozitiv nga Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, e cila e quajti aktin e zbatimit “një progres të madh”.<sup>190</sup> Për më tepër, zbatimi i Aktgjykimit për Manastirin e Deçanit u konsiderua si një shenjë konkrete e angazhimit të Kosovës për të vepruar në përputhje të plotë me sundimin e ligjit, pavarësisht nga aspektet politike.<sup>191</sup>

**143.** Në janar të vitit 2024, Instituti Arkeologjik i Kosovës ngriti një rrethojë rreth zonës së veçantë të mbrojtur të manastirit Hvosno në Istog. Kisha Ortodokse Serbe ngriti ankesa në lidhje me mungesën e komunikimit të Prishtinës në lidhje me rrethojën dhe punimet e restaurimit. Në tabelën e vendosur me atë rast, teksti ishte shkruar ekskluzivisht në gjuhën shqipe, duke deklaruar se “është një bazilikë, jo manastir i Kishës Ortodokse Serbe». Në fillim të marsit, rrethoja e ngritur u dëmtua.<sup>192</sup>

**144.** Më 13 maj 2024, autoritetet e Kosovës penguan Patriarkun Porfirije dhe shtatë hierarkët e tjerë të Kishës Ortodokse Serbe të hynin në Kosovë për të marrë pjesë në Asamblenë e Shenjtë të Ipeshkvijve të Kishës Ortodokse Serbe në Patriarkanën e Pejës në komunën e Pejës. Kuinti dhe Bashkimi Evropian e cilësuan vendimin në kundërshtim me Planin e Ahtisaarit. Më 26 qershor, z. Petković iu mohua leja për të udhëtuar në Kosovë për festën kombëtare serbe të Vidovdanit.<sup>193</sup> Sipas OJQ AKTIV, ky vendim shkeli marrëveshjet ekzistuese, Planin e Ahtisaarit dhe Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, konkretisht në lidhje me të drejtat fetare.<sup>194</sup>

**145.** Sipas komenteve të dorëzuara nga OJQ NSI, pati disa incidente që prekën komunitetet ortodokse dhe katolike serbe në zonat e komunitetit jo-shumicë. Këto përfshijnë thyerje ose përpjekje për thyerje në kishat ortodokse serbe në Shillovë, Krushevë e Madhe, në Talinoc të Muhaxherëve dhe në qytetin e Lipjanit. Rastet tjera që përfshijnë objektet fetare të komuniteteve jo-shumicë përfshijnë hedhjen e paligjshme të mbeturinave në varrezat ortodokse serbe në qytetin e Klinës dhe në zonën e veçantë të mbrojtur të manastirit të Binaçit në Buzovik në mars; vizatimi i grafitëve brenda Kishës Ortodokse Serbe të Atit të Shenjtë në Nakëll; dhe dëmtime të një kryqi në një varrezë ortodokse serbe në Rahovec në maj.<sup>195</sup> Gjithashtu, OJQ AKTIV raportoi se një kishë ishte grabitur nga individë të njohur për vendasit, ku ishin ndërmarrë veprime të kufizuara nga autoritetet pavarësisht incidenteve të përsëritura. Sipas OJQ AKTIV, kjo ngritë shqetësime në lidhje me neglizhencën institucionale, duke kontribuar në frikën e dëmtimit të mëtejshëm të pronës dhe përkallëzimin e tensioneve midis komunitetit serb dhe atij shqiptar.<sup>196</sup>

188 Balkan Insight (2024), [Kosova do të zbatojë vendimin e gjykatës që i jep tokën e kontestuar manastirit serb](#).

189 [Deklarata e Quint-it](#) mbi Zbatimin e Regjistrimit të Tokës së Manastirit të Deçanit, 14 mars 2024.

190 [Rekomandimi i PACE-së mbi kërkesën e Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës](#) (2024).

191 [Rekomandimi i PACE-së mbi kërkesën e Kosovës për anëtarësim në Këshillin e Evropës](#) (2024). Për më shumë informacione mbi rëndësinë e Aktgjykimit të Deçanit në rrugën e Kosovës drejt Këshillit të Evropës, shih edhe Iniciativën Evropiane për Stabilitet (2024), [Manastiri, gjykatat e Kosovës dhe rruga drejt Këshillit të Evropës](#).

192 NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

193 NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

194 AKTIV (2025), Kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

195 NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

196 AKTIV (2025), Kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

**146.** Për më tepër, NSI tregon për incidente të shumta që prekin zonat veçanta të mbrojtura, duke përfshirë prerjen e paligjshme të pyjeve nga tre të dyshuar shqiptarë të Kosovës të identifikuar nga policia në pyllin në pronësi të Manastirit Ortodoks Serb të Draganacit në prill 2024. Po atë muaj, autoritetet ndaluan një burrë shqiptar të kultivonte fushat në pronësi të Patriarkatit të Pejës pa autorizim në fshatin Budisalc. NSI gjithashtu vë në pah se në gusht 2024, një rrugë e financuar nga institucionet e Kosovës ishte ndërtuar brenda perimetrit prej 50 metrash të Manastirit Dolac. Ndërtimi nuk ishte miratuar paraprakisht nga Kisha Ortodokse Serbe, siç kërkohet nga Ligji për Zonat e Veçanta të Mbrojtura. Në takimin e parë që nga nëntori i vitit 2020, Këshilli i Zbatimit dhe Monitorimit mbajti një takim të jashtëzakonshëm më 4 shtator, ku Kisha Ortodokse Serbe ra dakord për vazhdimin e punimeve rrugore.<sup>197</sup>

**147.** Më 3 korrik 2024, Manastiri Ortodoks Serb i Deçanit pranoi një draft të planit të zhvillimit komunal nga komuna që e klasifikonte manastirin dhe pjesë të konsiderueshme të zonës së veçantë të mbrojtur si një “zonë urbane” dhe parashikonte disa projekte infrastrukturore në zonë. Manastiri i kërkoi autoritetit komunal t’i përmbahej kornizës ligjore dhe bëri thirrje për konsultime për të eksploruar strategji alternative të zhvillimit, por deri më tani nuk është zhvilluar asnjë konsultim.<sup>198</sup>

#### 148. Rekomandimet

- Qeveria e Republikës së Kosovës duhet t’i japë përparësi miratimit të Projektligjit për Lirinë Fetare për të siguruar qartësi ligjore në lidhje me të drejtat dhe përgjegjësitë e bashkësive fetare, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe detyrimet kushtetuese;
- Policia e Kosovës dhe gjyqësori duhet t’i forcojnë masat mbrojtëse për zonat fetare dhe të ndërmarrin veprime të shpejta ligjore kundër akteve të përdhosjes, vandalizmit dhe dhunës me motive fetare për të mbështetur sundimin e ligjit dhe për të nxitur harmoninë ndëretnike dhe ndërfetare;
- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit duhet të sigurojë përputhshmëri të plotë me Ligjin për Zonat e Veçanta të Mbrojtura duke u angazhuar në konsultime gjithëpërfshirëse me komunitetet fetare përpara se të miratojë projektet e zhvillimit që mund të ndikojnë në zonat e trashëgimisë fetare dhe kulturore;
- Agjencia Kadastrale e Kosovës duhet të mbajë procedura transparente dhe ligjërish të duhura në lidhje me të drejtat pronësore të bashkësive fetare, duke siguruar që të gjitha vendimet përkatëse gjyqësore dhe dispozitat ligjore të zbatohen plotësisht.

<sup>197</sup> NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

<sup>198</sup> NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

## 6. PJESA B: TË DREJTAT EKONOMIKE, SOCIALE DHE KULTURORE

### 6.1 Të drejtat e punës

**149.** Të drejtat e punës e kanë bazën e tyre ligjore universale dhe ndërkombëtare në nenin 23 të DUDNJ-së, kurse KEDNJ-ja ndalon çdo formë të punës së detyruar me nenin 4 të saj kur thotë se: “askujt nuk duhet t’i kërkohet të kryejë punë të detyruar ose të detyrueshme”.<sup>199</sup> Në nivel lokal, të drejtat e punës mbrohen me Kushtetutën e Kosovës. Kushtetuta garanton të drejtën për të punuar dhe për të zgjedhur lirishëm profesionin, siç përcaktohet në nenin 49.2 se: “Secili person është i lirë të zgjedhë profesionin dhe vendin e punës”. Liria e asociimit, liria e formimit të sindikatave dhe ndalimi i punës së detyruar mbrohet edhe me Kushtetutë. Dispozitat e tjera përfshijnë sigurimet bazike sociale lidhur me papunësinë në nenin 51, si dhe përfaqësimin e drejtë të komuniteteve dhe anëtarëve në punësimin publik në nenin 61.<sup>200</sup> Baza legjislative është formuar edhe me Ligjin Nr. 03/L-212 për Punën, Ligjin Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe Ligjin Nr. 04/L-011 për Organizimin Sindikal, i cili rregullon dhe përcakton të drejtat dhe liritë e punëtorëve për të krijuar sindikata në sektorin publik dhe privat.

**150.** Pavarësisht se ekzistojnë disa ligje të punës, zbatimi i këtyre ligjeve mbetet i dobët. Mungesa e zbatimit çon në shkelje të të drejtave të punës, përfshirë pagat e ulëta, oraret të gjata pune dhe kushte të pasigurta pune. Një përqindje e konsiderueshme e fuqisë punëtore në Kosovë është e punësuar në sektorin joformal. Ky lloj punësimi shpesh shoqërohet me paga të ulëta, mungesë sigurie në punë dhe qasje të kufizuar në mbrojtje sociale dhe shëndetësore. Një numër i konsiderueshëm punëtorësh nuk mbulohen nga skemat e mbrojtjes sociale, siç janë pensionet, sigurimi shëndetësor dhe skemat sociale për papunësinë. Kjo mungesë e mbrojtjes sociale i bën punëtorët më të ekspozuar ndaj krizave ekonomike dhe varfërisë. Në veçanti, ekonomia joformale është e dëmshme për gratë, ku puna e papaguar, angazhimi në bizneset familjare dhe puna e tyre në bujqësi mbeten pak të trajtuara nga korniza ligjore dhe rregulloret për paga të dinjitetshme.<sup>201</sup>

**151.** Ndonëse parashikohej në programin legjislativ të Qeverisë së Kosovës për vitin 2023, projektligji për ndryshimin e Ligjit ekzistues Nr. 03/L-212 të Punës nuk ishte pjesë e programit legjislativ për vitin 2024.<sup>202</sup> Forumi Ekonomik i Grave protestoi para Qeverisë së Kosovës, duke kërkuar rifutjen e Ligjit të Punës në agjendën legjislative, pasi u hoq nga qeveria. Pavarësisht se ka dërguar dy thirrje urgjente për veprim që nga 15 shkurti 2024, qeveria nuk ka ndërmarrë asnjë hap për të adresuar çështjen.<sup>203</sup> Sipas OJQ KDI (2024), dështimi i vazhdueshëm i qeverisë aktuale dhe i të gjitha administratave të kaluara për të ndryshuar Ligjin e Punës të vitit 2012 ka ndikuar negativisht në të drejtat e njeriut dhe ato të punëtorëve, përveç krijimit të një klime pasigurie dhe stagnimi në tregun e punës në Kosovë.<sup>204</sup> Ekziston një nevojë urgjente që Qeveria e Republikës së Kosovës të përfshijë Ligjin e Punës në agjendën e ardhshme legjislative për vitin 2025. Para dhe gjatë procesit

199 GJEDNJ, [Neni 4](#).

200 Kushtetuta e Kosovës (2008).

201 Rrjeti i Grave të Kosovës (2024), [Në Hije: Një Analizë Gjinore e Punës Joformale në Kosovë](#).

202 Qeveria e Kosovës, [Programi Legjislativ 2024](#).

203 Telegrafi (2024), [Protestohet para Qeverisë kundër heqjes së Ligjit për Punën nga Kalendari Legjislativ](#).

204 KDI (2024), [Ligji i Ri i Punës në mes të nevojave dhe kërkesave për ndryshim](#).



të hartimit të ligjit, ekziston gjithashtu nevoja urgjente për të filluar një proces të gjerë dhe kuptimplotë konsultimi me të gjithë akterët dhe grupet e interesit, si një mjet për hartimin e një ligji të ri që është në përputhje me standardet evropiane dhe që adreson nevojat e punëtorëve dhe tregut të punës në Kosovë.

**152.** Në vitin 2024, Qeveria e Republikës së Kosovës miratoi Strategjinë e re të Punësimit 2024-2028.<sup>205</sup> Është e rëndësishme të theksohet se Strategjisë i mungon një pasqyrë themelore, d.m.th. objektivat nuk përfshihen në dokument dhe as nuk përmban një hyrje apo përfundim. Një Plan Veprimi për Punësimin për vitet 2024-2025 thuhet se gjendet në fund të dokumentit si pjesë e Shtojcës 1 të Strategjisë, por nuk është publikuar si i tillë dhe nuk shfaqet në dokumentin e cituar. Strategjia vlerëson se burimet financiare për zbatimin e kësaj Strategjie arrijnë në 90,234,248 EUR, por nuk shpjegon më tej se si dhe ku do të investohen shuma të tilla.

**153.** Inspektorati i Punës i Kosovës është organi qendror monitorues që mbikëqyr zbatimin e ligjeve të punës në praktikë. Kjo përfshin menaxhimin e marrëdhënieve të përgjithshme të punës, si dhe dispozitat shëndetësore në punë. Ky i fundit është në përputhje me Ligjin Nr. 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Aktivitetet e Inspektoratit të Punës janë gjithashtu të përshtatura në kontekstin e një grupi specifik ligjesh dhe rregulloresh të tjera. Këto përfshijnë Ligjin Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit, i cili është ndryshuar në vitin 2022<sup>206</sup>, Ligjin Nr. 04/L-219 për të Huajt, Ligjin Nr. 03/L-019 për Aftësimin Profesional, Rehabilitimin dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Ligjin Nr. 02/L-81 për Nxitjen dhe Mbrojtjen e të Ushqyerit me Qumësht Gjiri. Qeveria e Republikës së Kosovës nuk arriti të përfundojë një projektligj të ri për Inspektoratin e Punës brenda afatit të qershorit 2024, siç parashikohet nga programi legjislativ për vitin 2024.<sup>207</sup>

**154.** Qeveria e Republikës së Kosovës dha njoftim për rritje të pagave në sektorin publik në vitin 2024, pak para zgjedhjeve të shkurtit 2025. Rritja e pagave është planifikuar të hyjë në fuqi në dy faza - janar dhe korrik 2025. Kjo masë vjen pas rregullimit të mëparshëm të pagave, duke përfshirë ligjin e pagave të vitit 2023, i cili strukturoi pagat e sektorit publik bazuar në koeficientë që variojnë nga 1 në 20. Teksa qeveria e justifikon këtë rritje si një mjet për të rritur stabilitetin ekonomik, sindikatat, veçanërisht në sektorin e arsimit, e kanë kritikuar atë si të pamjaftueshme, duke kërkuar një rritje më të konsiderueshme prej 30 përqind. Ngjashëm, udhëheqësit e opozitës e kanë hedhur poshtë masën si të pamjaftueshme. Koha e këtyre rregullimeve të pagave, së bashku me vendimet e mëparshme për të rritur pagën minimale dhe pensionet, ka ngritur shqetësime në lidhje me përdorimin e fondeve publike për përfitime zgjedhore në vend të reformës së qëndrueshme të sektorit publik.<sup>208</sup>

**155.** Të dhënat më të fundit mbi papunësinë sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK) për kategoritë e moshës 15-64 vjeç janë 10.7 përqind. Statistikat e tjera të rëndësishme të tregut të punës që rrjedhin nga rezultatet e fundit të pyetësorit të fuqisë punëtore janë si më poshtë: (i) 42.3 përqind është shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore për kategoritë e moshës 15-64 vjeç;

205 Qeveria e Kosovës (2024), [Strategjia e Punësimit 2024-2028](#).

206 Gazeta Zyrtare (2022), [Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-156 për duhanin](#).

207 Qeveria e Kosovës (2024), [Programi Legjislativ 2024](#).

208 Prishtina Insight (2024), [Qeveria e Kosovës njofton për rritje të pagave përpara zgjedhjeve të vitit 2025](#).



(ii) 57.7 përqind është shkalla e popullsisë ekonomisht joaktive; (iii) 22.6 përqind është shkalla e fuqisë punëtore të të rinjve (15-24 vjeç); 37.8 përqind është raporti i punësimit ndaj popullsisë (15-64 vjeç); 18.3 përqind është raporti i punësimit të të rinjve ndaj popullsisë (15-24 vjeç); ndërsa 19 përqind është shkalla e papunësisë së të rinjve.<sup>209</sup>

**156.** Vazhdojnë të ekzistojnë shqetësime të konsiderueshme në lidhje me masat joadekuatë të sigurisë në vendin e punës në sektorin privat, ku sektori i ndërtimit është fusha me shkallën më të lartë të lëndimeve dhe vdekshmërisë.<sup>210</sup> Sindikatat kanë bërë thirrje për veprime më urgjente dhe shtim të inspektimeve për të adresuar vazhdimësinë e problemit. Ekspertët e sigurisë kanë ngritur shqetësim se nuk është bërë asnjë përparim në vitet e fundit pavarësisht numrit të lartë të aksidenteve dhe i bëjnë thirrje Inspektoratit të Punës që të kryejë monitorim më të rreptë në të gjithë Kosovën.<sup>211</sup> Gjersa sipas Inspektoratit të Punës gjatë vitit 2024 (janar deri në nëntor) kanë ndodhur 8 vdekje në vendin e punës, Sindikata e Sektorit Privat pohon se 23 persona kanë humbur jetën në vendin e tyre të punës gjatë vitit 2024.<sup>212</sup> Kjo mospërputhje ngritë shqetësime në lidhje me raportimin e qartë dhe koordinimin ndër-institucional në monitorimin e sigurisë në punë.

**157.** Të rinjtë në Kosovë shprehin shqetësim të madh në lidhje me mungesën e mundësive të punësimit brenda tregut të punës në Kosovë. Në të vërtetë, shqetësimet në lidhje me papunësinë janë më të përhapura në mesin e moshave 15 deri në 29 vjeç.<sup>213</sup>

**158.** Ekspertët kanë paralajmëruar se kushtet e këqija të punësimit, përcjellë me liberalizimin e vizave për Kosovën në janar 2024, mund të shkaktojnë emigrim masiv. Në veçanti, Aleanca Kosovare e Bizneseve i kërkoi Qeverisë së Kosovës të subvencionojë sektorin privat për të parandaluar largimin e punëtorëve. Sipas Eurostat, liberalizimi i vizave ka rezultuar në 1960 aplikime për azil në 27 shtetet e BE-së në katër muajt e parë të vitit 2024, që paraqet një rritje prej 68 përqind krahasuar me të njëjtën periudhë në vitin 2023.<sup>214</sup>

**159.** Eksodi është veçanërisht shqetësues në sektorin e shëndetësisë. Në vitin 2024, 109 mjekë nxorën certifikatat e tyre përkatëse të etikës, një dokument që nevojitet për të aplikuar për punësim jashtë vendit. Si krahasim, në vitin 2023 u kërkuan 167 certifikata.<sup>215</sup> Si rezultat i eksodit, periudhat e pritjes janë rritur për shërbime të caktuara dhe aparaturat moderne mjekësore nuk mund të përdoren për shkak të mungesës së stafit mjekësor profesional.<sup>216</sup>

**160.** Ligji Nr. 03/L-019 për Aftësimin Profesional, Rehabilitimin dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara vazhdon të shpërfilllet në praktikë. Edhe pse ligji i detyron kompanitë si nga sektori publik ashtu edhe nga ai privat të rezervojnë çdo vend të 50-të për një person me aftësi të kufizuara, punëdhënësit shpërfillin kualifikimet profesionale të individëve me aftësi të kufizuara.<sup>217</sup> Si pasojë, Inspektorati i Punës ka rritur gjokat në sektorin privat dhe ka rritur kapacitetet

209 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2025), [Të dhënat më të fundit mbi tregun e punës](#).

210 Dukagjini (2024), [Siguria e punëtorëve në punë, ligji e garanton por s'gjen zbatim](#).

211 Dukagjini (2024), [Siguria e punëtorëve në punë, ligji e garanton por s'gjen zbatim](#).

212 Albinfo.ch (2024), [Kosovë: Siguria në punë, sfida për punëtorët kosovarë](#).

213 Friedrich Ebert Stiftung (2024), [Të pavarur, por të shqetësuar: zërat e të rinjve në Evropën Juglindore](#).

214 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën, f. 45-46.

215 Radio Evropa e Lirë (2024), [Edhe një vit me mbi 100 mjekë të ikur nga Kosova](#), Bold News (2024), [Edhe një vit me mbi 100 mjekë të ikur nga Kosova](#).

216 Radio Evropa e Lirë (2024), [Edhe një vit me mbi 100 mjekë të ikur nga Kosova](#).

217 Handikos (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

e veta monitoruese. Për më tepër, OJQ Handikos deklaroi se edhe nëse e drejta për punësim do të respektohej, individët me aftësi të kufizuara privohen nga kushte të përshtatshme pune, duke përfshirë qasjen në ndërmarrjet përkatëse, transportin dhe kushte të tjera fizike. Përveç kësaj, OJQ Down Syndrome Kosova thekson se kjo situatë nuk ndodhë vetëm në sektorin privat, por edhe në institucionet publike, të cilat në vend se të luajnë një rol shembullor për fuqinë punëtore, dështojnë në zbatimin e ligjit.<sup>218</sup>

**161.** Gratë dhe vajzat në Kosovë përballen me sfida të konsiderueshme në fuqinë punëtore, me shkallë papunësie që janë më të lartat dhe dukshëm më të larta se ato të burrave.<sup>219</sup> Nga një perspektivë statistikore, vetëm 20.9 përqind e grave (15-64 vjeç) janë të punësuar krahasuar me 54.8 përqind të burrave në të njëjtën kategori moshe. Anasjelltas, 17.2 përqind e grave (15-64 vjeç) janë të papuna krahasuar me 7.9 përqind të burrave në të njëjtën kategori moshe. Ngjashëm, një përqindje e lartë e grave (74.8 përqind) konsiderohen si joaktive (15-64 vjeç) krahasuar me 40.5 përqind të burrave joaktive në të njëjtën kategori moshe. Tek të rinjtë, 33.6 përqind e grave (15-24 vjeç) nuk janë të punësuar ose të angazhuara në arsim ose trajnim, krahasuar me 31.7 përqind të burrave në të njëjtën kategori moshe.<sup>220</sup>

## 162. Rekomandimet

- Qeveria e Republikës së Kosovës duhet t'i japë përparësi ndryshimit të Ligjit të Punës duke e rivendosur atë në agjendën legjislative të vitit 2025 dhe duke siguruar konsultime të gjera me akterët për ta harmonizuar atë me standardet evropiane dhe nevojat e tregut të punës;
- Ministria e Financave duhet ta përmirësojë transparencën dhe llogaridhënien në politikat e punësimit duke përcaktuar qartë ndarjen buxhetore dhe objektivat e Strategjisë së Punësimit 2024-2028, duke siguruar zbatimin efektiv të saj;
- Inspektorati i Punës duhet të intensifikojë monitorimin dhe zbatimin e ligjeve të punës, veçanërisht në sektorët me rrezik të lartë, siç është ndërtimi, për të përmirësuar sigurinë në vendin e punës dhe për të zvogëluar vdekjet në vendin e punës.

## 6.2 E drejta për arsim

**163.** Sfondi ndërkombëtar në të cilin e drejta për arsim kuptohet më së miri në kontekstin e zhvillimit të Kosovës si shoqëri demokratike është neni 26 i DUDNJ dhe neni 2 i KEDNJ. Konkretisht, paragrafi 26.1 i DUDNJ-së thekson se "secili ka të drejtën e arsimit" dhe vë në pah se arsimi duhet të jetë falas dhe të jetë i qasshëm për të gjithë të paktën në nivelin fillor dhe të mesëm. Nga ana tjetër, neni 2 i Protokollit Nr. 2 të KEDNJ-së thotë se "askujt nuk duhet t'i mohohet e drejta për arsim" dhe se shtetet duhet të respektojnë "të drejtën e prindërve për të siguruar që arsimi dhe mësimdhënia të jenë në përputhje me bindjet e tyre fetare dhe filozofike".

218 Syri TV (2024), [Ligji për Punësimin e Personave me të Kufizuara, nuk respektohet nga sektori privat](#).

219 UN Women (2024), [Profili Gjinnor i Vendlut në Kosovë](#)

220 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2024), [Rezultatet e Anketës së Fuqisë Punëtore](#)

**164.** Në kornizën legjislativë të Kosovës, e drejta për arsim është e mbrojtur me Kushtetutë. Neni 47 siguron të drejtën për arsim fillor falas dhe mundësi të barabarta për arsim për të gjithë individët në përputhje me nevojat dhe aftësitë e tyre specifike. Në nenin 59 të të drejtave të komuniteteve dhe anëtarëve të tyre, Kushtetuta garanton të drejtën e komuniteteve jo-shumicë për të vijuar arsimin në gjuhën e tyre amtare, me kusht që gjuha të jetë zyrtarisht në përdorim në Kosovë. Kjo është përsëritur në Ligjin Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës. Ligji mbron gjuhën e folur nga komunitetet jo-shumicë si gjuhë e mësimin në arsimin fillor dhe të mesëm. Korniza legjislativë e mjedisit arsimor të Kosovës është kompletuar me Ligjin Nr. 03/L-068 për Arsim në Komunat e Republikës së Kosovës. Ky ligj rregullon organizimin e institucioneve publike në shkollat fillore dhe të mesme. Konteksti parësor legjislativ për arsimin në nivelin terciar është Ligji Nr. 04/L-037 për Arsimin e Lartë.

**165.** Zbatimi i Ligjit Nr. 08/L-153 për Edukimin në Fëmijëri të Hershme filloi me pilotimin e kurrikulave të reja për vitin akademik 2023/2024.<sup>221</sup> Vlen të përmendet se ky Ligj rregullon ofrimin e standardeve të arsimit cilësor dhe e bën arsimin parashkollor të detyrueshëm që nga viti 2024. Sipas Ministrisë së Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit (MASHTI), ligji “hedh themelet për rritjen dhe zhvillimin e të rinjve”. Deri më tani, UNICEF në Kosovë raporton se qasja në arsimin parashkollor në Kosovë është shumë më poshtë standardit evropian prej 96 përqind dhe më e ulët se mesataret rajonale.

**166.** Strategjia për Arsim 2022–2026 përqendrohet në përmirësimin e qasjes, cilësisë dhe barazisë në sistemin arsimor të Kosovës. Kjo përfshin obligimin që arsimi të jetë i detyrueshëm për të gjithë fëmijët deri në një moshë të caktuar dhe ruajtjen e qasjes falas në arsim. Strategjia thekson uljen e pabarazive në arsim, veçanërisht në zonat rurale dhe të marginalizuara dhe adresimin e pengesave me të cilat përballen grupet e cenuara, siç janë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ata nga minoritetet etnike. Megjithatë, pavarësisht dy viteve të mbetura deri në përfundimin e zbatimit të strategjisë, nuk është arritur progres i rëndësishëm, sipas OJQ Save the Children Kosova/o. Problemi i vazhdueshëm i cilësisë së arsimit mbetet veçanërisht shqetësues, siç pasqyrohet në rezultatet e PISA-s. Ndër sfidat e vazhdueshme është edhe përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe fëmijëve nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, të cilët vazhdojnë të përballen me qasje joadekuate në arsim cilësor.<sup>222</sup>

**167.** Arsimi është një shtyllë kyçe e Planit Kombëtar të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara; megjithatë, zbatimi i tij has në sfida të konsiderueshme. OJQ Save the Children Kosova/o thekson mungesën e mekanizmave efektivë të ekzekutimit dhe financimin e pamjaftueshëm. Shërbimet e rehabilitimit, thelbësore për arsimin gjithëpërfshirës, ofrohen ekskluzivisht nga një sektor privat i palicencuar, duke kufizuar qasjen për fëmijët nga familjet e pasura. Mungesa e këtyre shërbimeve ndikon negativisht në rezultatet e të nxëniet për fëmijët me aftësi të kufizuara. Përveç kësaj, ekziston një mungesë kritike e mësimdhënësve të specializuar mbështetës. Gjersa Ministria e Arsimit ka punësuar afërsisht 400 asistentë, ky numër mbetet i pamjaftueshëm duke pasur parasysh kërkesën e lartë.<sup>223</sup>

221 Komisioni i BE-së (2024), Raporti mbi Kosovën, f. 16.

222 Save the Children Kosova/o (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

223 Save the Children Kosova/o (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

**168.** Një çështje veçanërisht shqetësuese e vënë re nga OJQ Save the Children Kosova/o është numri i papërcaktuar i fëmijëve me aftësi të kufizuara që mbeten jashtë sistemit arsimor. Për fëmijët romë, ashkali dhe egjiptianë, shkalla e braktisjes së shkollës mbetet problematike, veçanërisht në arsimin e mesëm. Bursat e ofruara nga Qeveria e Kosovës në arsimin e mesëm të lartë ndikuan pozitivisht në vazhdimin e shkollimit të tyre. Shkalla e braktisjes së shkollës mbetet e lartë në arsimin e mesëm. Kjo përkeqësohet edhe nga përfshirja e hershme e fëmijëve në fuqi punëtore, por edhe nga martesat e hershme dhe rrethanat e varfërisë së vazhdueshme që pengojnë realizimin e plotë të objektivave të arsimit gjithëpërfshirës.<sup>224</sup>

**169.** Sfidat që kanë të bëjnë me mospërputhjet midis kërkesave të tregut të punës në Kosovë dhe ofertës arsimore trajtohen pjesërisht në Strategjinë e Arsimit (2022-2026). Nismat kryesore përfshijnë përditësimin e kurrikulave, zgjerimin e platformave digjitale, forcimin e trajnimit të mësimeve dhe nxitjen e partneriteteve publiko-private për të kapërcyer mungesën në shkathtësi. Megjithatë, në praktikë, ka ende sfida në lidhje me cilësinë, pasi ende ekziston një mospërputhje midis kërkesave të tregut të punës dhe kualifikimeve të të diplomuarve, si dhe boshllëqe në kompetencat e vetë të diplomuarve.<sup>225</sup>

**170.** Bazuar në të dhënat zyrtare të raportuara nga OJQ Save the Children Kosova/o, raporti nxënës-mësimdhënës në arsimin fillor është një mësimdhënës për çdo 20 nxënës; në arsimin e mesëm, kjo arrin në një mësimdhënës për çdo 15 nxënës. Zhvendosjet e popullsisë urbane-rurale kanë rezultuar në shkolla urbane të mbipopulluara dhe në zvogëlim të burimeve dhe ambienteve shkollore. Anasjelltas, shkollat rurale përballen me rënie të regjistrimeve, duke çuar në konsolidime të klasave dhe mbyllje graduale. Këto lëvizje demografike duhet të merren më seriozisht pasi ato vazhdimisht ndikojnë në rritjen e pabarazive arsimore ndërmjet nxënësve të zonave urbane dhe atyre rurale. Adresimi i këtij çekuilibri është thelbësor për të siguruar qasje të barabartë në arsim cilësor. Numri i fëmijëve që nuk vijojnë shkollën mbetet i panjohur, ku kjo prek veçanërisht fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ata nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, siç u përmend më sipër.<sup>226</sup>

**171.** Pabarazitë gjinore në arsim mbeten shqetësuese, veçanërisht në zonat rurale ku rolet tradicionale gjinore shpesh kufizojnë qasjen e vajzave në arsim. Pritshmëritë kulturore, martesat e hershme dhe presionet ekonomike mund t'i detyrojnë vajzat të largohen nga shkolla para kohe. Këto pengesa krijojnë një cikël mundësish të kufizuara për gratë dhe vajzat, duke minuar potencialin e tyre për të kontribuar plotësisht në shoqëri.

**172.** Ndërkohë që qasja në arsim është përmirësuar, sigurimi i cilësisë mbetet një problem urgjent. Shkollave shpesh u mungojnë burimet e mjaftueshme, duke përfshirë materialet moderne mësimore dhe edukatorët e trajnuar, veçanërisht në zonat rurale dhe të pashërbyera. Kjo ndikon në mënyrë disproporcionale tek fëmijët e marginalizuar, të cilët mund të përballen me pengesa shtesë në të nxënë.<sup>227</sup>

224 Save the Children Kosova/o (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

225 Save the Children Kosova/o (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

226 Save the Children Kosova/o (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

227 Save the Children Kosova/o (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

**173.** Krijimi i mjedisve të sigurta dhe mbrojtëse për fëmijët brenda shkollave është thelbësor. Megjithatë, rastet e ngacmimit dhe dhunës në shkolla nuk janë të rralla. Mekanizmat për raportimin dhe adresimin e incidenteve të tilla mbeten të dobëta, duke lënë shumë fëmijë të cenueshëm dhe të pambrojtur.<sup>228</sup>

**174.** Në mars të vitit 2024, Qeveria e Republikës së Kosovës publikoi një raport mbi rishikimin e teksteve shkollore pas një procesi të plotë rishikimi që filloi në prill të vitit 2023.<sup>229</sup> Fokusi i rishikimit ishte në lëndët e gjuhës shqipe dhe matematikës, si lëndët më kritike që kërkojnë përmirësim në tekstet shkollore.<sup>230</sup>

**175.** Në nëntor të vitit 2024, filloi një debat publik përçarës në lidhje me edukatën seksuale në shkolla, pas një akuze nga deputeti Eman Rrahmani, se MASHTI dyshohet se ka miratuar doracakë të edukatës seksuale që bien ndesh me vlera të caktuara familjare, duke kërkuar që fëmijët “të prekin njëri-tjetrin në pjesë të ndryshme të trupit”, duke përfshirë pjesët intime gjatë seancave të edukimit seksual në shkolla.<sup>231</sup> Pretendimet e bëra nga anëtarë i Kuvendit të Kosovës ishin të pasakta, pasi ushtrimi praktik të cilit ai iu referua nuk kishte të bënte fare me edukatën seksuale, por me një ushtrim që përfshinte individë me dëmtime në shikim.<sup>232</sup> Pavarësisht këtij keqinterpretimi, debati vazhdoi për ditë të tëra, ku partitë politike dhe OSHC-të mbajtën qëndrime të ndryshme brenda diskutimit. Disa komuna gjithashtu nxorën vendime për ndalim të doracakëve në shkollat e tyre përkatëse.<sup>233</sup> Për më tepër, MASHTI pranoi se kishte përmbytje të gabuar në doracakë duke deklaruar se ato duheshin rishikuar dhe korrigjuar.<sup>234</sup> Si rezultat i debatit, Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve (KOMF) theksoi rëndësinë jetike të edukatës seksuale për fëmijët dhe vuri në dukje se materialet edukative dhe tekstet shkollore duhet të jenë të përshtatshme për moshën.<sup>235</sup>

**176.** Në dhjetor 2024, YIHR KS publikoi një raport mbi përhapjen e diskriminimit përmes përdorimit të gjuhës në tekstet shkollore.<sup>236</sup> Raporti ofron një shqyrtim të gjerë të manifestimit të formave të ndryshme të diskriminimit eksplicit dhe implicit përmes gjuhës dhe imazheve të përdorura në tekstet shkollore të një sërë lëndësh në arsimin e mesëm të lartë në Kosovë, duke zbuluar nevojën që materialet edukative të rishikohen për të pasqyruar një botëkuptim gjithëpërfshirës me kuptimet bashkëkohore të gjinisë, seksualitetit, racës, moshës dhe etnisë.<sup>237</sup>

**177.** Pavarësisht rritjes së vazhdueshme të buxhetit të MASHT-it për vitin 2024, pabarazitë në ekzekutimin e buxhetit ishin të dukshme gjatë gjithë vitit. Më e rëndësishmja, për digjitalizimin e shkollave u parashikua një planifikim buxhetor prej 18 milionë eurosh, të cilat mbetën tërësisht të pashpenzuara. Ky mosveprim është veçanërisht shqetësues pasi shkollat publike në Kosovë kanë mesatarisht vetëm një kompjuter për 35 nxënës, me vetëm 15 përqind të institucioneve parauniversitare që kanë qasje në internet. Si pasojë, MASHTI u kritikua për dështim në shfrytëzimin e buxhetit të vet për të siguruar pajisje digjitale të cilat ishin shumë të nevojshme për institucionet arsimore.<sup>238</sup>

228 Save the Children Kosova/o (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

229 Kallxo (2024), [Nagavci ia prezanton Kurtit raportin mbi 600-faqësh pas rishikimit të teksteve shkollore](#).

230 Telegrafi (2024), [Rishikimi i teksteve shkollore, dorëzohet raporti për tekstin e gjuhës shqipe dhe matematikës së klasave 1-9](#).

231 Nacionale (2024), [Doracaku i edukatës seksuale](#).

232 Radio Evropa e Lirë (2024), [Debati për edukatën seksuale: çka është e vërtetë e çka jo?](#)

233 Gazeta Express (2024), [Pas Prishtinës, edhe Skenderaji ndalon përdorimin e doracakëve të edukimit seksual](#).

234 Nacionale (2024), [Doracaku i edukatës seksuale](#).

235 Kallxo.com (2024), [KOMF flet për rëndësinë e edukimit seksual të fëmijëve në shkolla](#).

236 YIHR KS (2024), [Gjuha Diskriminuese në Tekstet Shkollore: Një analizë e teksteve shkollore të arsimit të mesëm të lartë në Kosovë](#).

237 YIHR KS (2024), [Gjuha Diskriminuese në Tekstet Shkollore: Një analizë e teksteve shkollore të arsimit të mesëm të lartë në Kosovë](#).

238 Koha.net (2024), [Ministria e Arsimit s'e shfrytëzon buxhetin për digjitalizimin e shkollave](#)



**178.** Vlen të theksohet pjesëmarrja e Kosovës në programin Erasmus+ 2021-2027, sepse kjo ka lehtësuar lëvizjen për studentët dhe stafin brenda shteteve anëtare të BE-së dhe shkëmbimin e praktikave të mira në shkencë dhe teknologji. Në periudhën 2014-2024, mbi 10 mijë studentë kosovarë kanë përfituar nga projektet Erasmus+ në arsimin e lartë.<sup>239</sup> Të dhënat e fundit tregojnë se pjesëmarrja e Kosovës në Erasmus+ është përmirësuar në vitin 2024, duke konfirmuar trendin pozitiv të vitit të kaluar.<sup>240</sup>

**179.** Edhe pse mbi gjysma e nxënësve të shkollave të mesme të larta në Kosovë janë të regjistruar në arsim dhe aftësim profesional (AAP), ende ka sfida në këtë sektor. Në vitet 2023-2024, AAP-ja u zgjerua me tetë profile shtesë, duke e çuar numrin total të profileve të arsimit të dyfishtë në 12. Ky zgjerim synon të përmirësojë punësimin si të vajzave ashtu edhe të djemve. Kryeministri nisi një fushatë ndërgjegjësimi për të mbështetur zbatimin e AAP-së së dyfishtë në Kosovë, ndërsa koncepti për një ligj të ri për AAP-në mbetet të finalizohet. Forcimi i përputhshmërisë midis arsimit dhe nevojave të tregut të punës kërkon bashkëpunim me bizneset dhe rishikimin e kornizës ligjore për arsimin dhe aftësimin profesional.<sup>241</sup>

**180.** Përmirësimi i qasjes në arsim për nxënësit me aftësi të kufizuara mbetet prioritet kyç. Në Opinionin e vitit 2024 mbi anëtarësimin e Kosovës, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës vuri në pah nevojën e autoriteteve të Kosovës për të siguruar qasje efektive në arsim fillor dhe të mesëm me cilësi të lartë dhe në tekste shkollore për të gjithë fëmijët, veçanërisht për ata me aftësi të kufizuara, ata nga komunitetet jo-shumicë dhe me prejardhje të cënueshme.<sup>242</sup> Sipas Komisionit të BE-së, miratimi i një Ligji specifik mbi të drejtat, vlerësimin, trajtimin dhe njohjen e statusit të shërbimeve dhe përfitimeve për personat me aftësi të kufizuara është akt tejet i vonuar.<sup>243</sup>

**181.** Rasti i raportuar gjerësisht i abuzimit të rëndë ndaj një vajze 3-vjeçare me autizëm nga logopedi i saj shkaktoi një reagim të fortë nga Asociacioni Nacional i Autizmit në Kosovë (ANAK). Kjo pasoi me një vendim gjykatë të vitit 2024 që e liroi nga akuzat logopedin Iljasa Fazliu, vendim ky që shkaktoi zemërim publik dhe thirrje të reja për mbrojtje më të madhe të fëmijëve të cënueshëm.<sup>244</sup> Sipas ANAK-ut, vendimi për ta liruar logopedin nga akuzat ishte i palogjikshëm duke pasur parasysh gjuhën stigmatizuese dhe ofenduese që u përdor ndaj vajzës.<sup>245</sup> Si pasojë, Prokuroria Publike në Gjilan paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit më 21 nëntor 2024.<sup>246</sup> Mbetet për t'u përcaktuar nëse Gjykata e Apelit do ta kthejë rastin për rigjykim në Gjykatën Themelore apo do ta ushtrojë autoritetin e saj për të nxjerrë vetë një vendim përfundimtar për këtë rast të abuzimit dhe keqtrajtimit të fëmijëve.

**182.** Mes çështjeve të pazgjidhura pronësore që përfshinin ish-ndërmarrjet shoqërore në Kosovë, Agjencia e Privatizimit e Kosovës shiti objektet ku ndodhej Biblioteka Universitare e Universitetit të Prishtinës me selinë e saj të përkohshme në Mitrovicën e Veriut.<sup>247</sup>

239 Telegrafi (2024), [Mbi 10 mijë studentë nga Kosova kanë përfituar nga projektet Erasmus+](#).

240 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024.

241 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 76.

242 Asambleja Parlamentare e Këshillit të Evropës, [Opinion nr. 302\(2024\)](#) i 16 prillit 2024.

243 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024.

244 Bota Sot (2024), [Logopedi s'u dënua për keqtrajtimin e 3-vjeçares me autizëm, reagon ANAK](#).

245 Bota Sot (2024), [Logopedi s'u dënua për keqtrajtimin e 3-vjeçares me autizëm, reagon ANAK](#).

246 Nacionale (2024), Pas raportimit në Nacionale dhe protestës, Prokuroria ankohet për vendimin e Gjykatës që liroi Iljasa Fazliun.

247 NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.



**183.** Kërkesa e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të Kosovës (KQZ) për t'i përdorur shkollat e drejtura nga autoritetet serbe si qendra votimi për votimet për shkarkim të kryetarëve të komunave u refuzua nga shkollat përkatëse. Më 4 korrik 2024, zyra e prokurorit në Mitrovicë nisi procedurat kundër 14 drejtorëve serb të shkollave me dyshimin se e kanë penguar procesin zgjedhor. Drejtoret u morën në pyetje, por nuk u ngritën aktakuza.<sup>248</sup>

**184.** Situata e ndarjes etnike (segregacioni) në shkolla ndikon në përhapjen e përçarjeve etnike dhe pengon zhvillimin e një shoqërie multietnike dhe shumëkulturore. Ndarja etnike e komuniteteve rome dhe ashkali vazhdoi të ndodhë edhe në vitin 2024, përfshirë edhe në kurrikulën e sponsorizuar nga qeveria e Serbisë në veri të Mitrovicës. Shkollat mbeten të ndara sipas vijave etnike, shkalla e braktisjes së shkollës është më e lartë te nxënësit e këtyre komuniteteve sesa për nxënësit me prejardhje të tjera etnike, dhe një ndjenjë e përgjithshme diskriminimi mbetet si tipar i përhapur i peizazhit arsimor të Kosovës.<sup>249</sup>

**185.** Në vitin 2023, Fakulteti Juridik i Universitetit të Prishtinës shënoi një moment të rëndësishëm duke lansuar Programin e tij të parë Master në të Drejtat e Njeriut, të Drejtën Penale Ndërkombëtare dhe Drejtësinë Tranzicionale. Në veçanti, kjo iniciativë progresive ka marrë mbështetje nga UNMIK/OHCHR përmes OJQ Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë (YIHR KS). UNMIK përmes YIHR KS po e mbështet në mënyrë aktive programin pasi ai shquhet si i pari i këtij lloji në Kosovë, duke mirëpritur studentë ndërkombëtarë me orar të rregullt dhe duke krijuar klinikën ligjore. Një Memorandum Mirëkuptimi (MM) është nënshkruar me Fakultetin Juridik për të përmirësuar koordinimin dhe zbatimin praktik të kësaj iniciative të rëndësishme arsimore.<sup>250</sup> Pas suksesit në vitin e parë, programi vazhdoi edhe për vitin e tij të dytë.

## 186. Rekomandimet

- Qeveria e Kosovës dhe MASHTI duhet të sigurojnë zbatimin e plotë të politikave të arsimit gjithëpërfshirës duke ndarë fonde të mjaftueshme për shërbime mbështetëse, mësimdhënës të specializuar dhe teknologji ndihmëse për të rritur qasjen për fëmijët me aftësi të kufizuara dhe ata nga komunitetet e marginalizuara;
- MASHTI duhet t'i rishikojë dhe përditësojë kurrikulat dhe tekstet shkollore për të eliminuar gjuhën diskriminuese, për të siguruar gjithëpërfshirjen dhe për të ofruar përfaqësime historike dhe kulturore të sakta, të larmishme dhe të paanshme në materialet edukative;
- Qeveria e Republikës së Kosovës dhe MASHTI duhet ta përmirësojnë arsimin dhe aftësimin profesional (AAP) duke finalizuar ligjin e ri për Arsimin dhe Aftësimin Profesional, duke zgjeruar programet duale të arsimit dhe duke harmonizuar kurrikulën me kërkesat e tregut të punës përmes partneriteteve më të forta me bizneset dhe akterët e industrisë.

248 Kombet e Bashkuara, Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm mbi Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, S/2024/741 (Nju Jork; Kombet e Bashkuara, 2024), qasur më 12 janar 2025, <https://documents.un.org/doc/undoc/gen/n24/281/08/pdf/n2428108.pdf>.

249 Radio Kosova e Lirë (2023), [Edukimi, armë kundër diskriminimit](#).

250 YIHR KS(2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

### 6.3. E drejta për kujdes shëndetësor

**187.** Baza ndërkombëtare e të drejtave të njeriut mbi të cilën mund ta vlerësojmë të drejtën për kujdes shëndetësor në kontekstin e Kosovës është DUDNJ. Në nenin 5 të DUDNJ-së fokusi i drejtohet të drejtës së të gjithë individëve për “një standard jetese të përshtatshëm për shëndetin dhe mirëqenien e tyre dhe të familjes, duke përfshirë ushqimin, veshmbathjen, banimin [...]”.<sup>251</sup> Edhe pse KEDNJ-ja nuk e thekson në mënyrë eksplicite të drejtën për kujdes shëndetësor, një gamë e gjerë çështjesh që kanë të bëjnë me shëndetin janë trajtuar nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Praktika gjyqësore e Gjykatës kërkon që shtetet të mbrojnë mirëqenien mendore dhe fizike të njerëzve në rrethana të ndryshme, duke përfshirë qasjen në kujdes shëndetësor, të drejtën e fjalës në trajtimin që marrin dhe të drejtën për drejtësi kur bëhen gabime mjekësore.<sup>252</sup>

**188.** Korniza legjislative e Kosovës për të drejtën për kujdes shëndetësor përfshin ligje dhe dispozita të shumta. Një pasqyrë e përgjithshme është renditur me nenin 51 të Kushtetutës së Kosovës për Mbrojtjen Shëndetësore dhe Sociale. Konkretisht, paragrafi 1 përcakton se kujdesi shëndetësor dhe sigurimet shoqërore rregullohen me ligj, pasuar në paragrafin 2 nga sigurimet sociale themelore që kanë të bëjnë me papunësinë, sëmundjet, paaftësinë dhe pleqërinë, siç rregullohet edhe me ligj. Në maj të vitit 2022 është miratuar Ligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-249 për Sigurimin Shëndetësor.<sup>253</sup> Ky ligj përbën një hap të rëndësishëm në nivel të Qeverisë së Kosovës drejt rregullimit të sigurimit shëndetësor publik për qytetarët e Kosovës. Korniza legjislative plotësohet më tej me ligjet e mëposhtme: Ligji Nr. 04/L-125 për Shëndetësi, Ligji Nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike, Ligji Nr. 02/L-76 për Shëndetin Riprodhues, Ligji Nr. 06/L-042 për Gjakun dhe Përbërës të Gjakut dhe Ligji Nr. 02/L-200 për Parandalimin dhe Luftimin e Sëmundjeve Ngjitëse.

**189.** Realiteti i sistemit të shëndetësisë të Kosovës është në kontrast të thellë me kornizën legjislative të vendit. Progresi drejt përmirësimit të shëndetësisë kërkon një ristrukturim të konsiderueshëm të sistemit, të cilin Qeveria e Kosovës ende nuk e ka bërë me anë të një skeme funksionale të shëndetësisë. Si pasojë e kushteve të këqija infrastrukturore për mjekët dhe punëtorët e shëndetësisë dhe pagave të ulëta në përgjithësi në sektorin publik, migrimi drejt vendeve më të pasura është bërë i zakonshëm. Kjo është problematike pasi rezulton në një ikje të konsiderueshme të trurit në të gjithë vendin.

**190.** Duke nënvizuar cilësinë e përgjithshme nën standarde të sektorit të shëndetësisë, shpenzimet për shëndetësi në Kosovë shënojnë shkallën e dytë më të ulët në rajon dhe me vetëm 3 përqind të BPV-së totale janë tri herë më të ulëta se mesatarja e BE-së prej përafërsisht 11 përqind. Përkundër kësaj, viti 2024 vendosi një rekord për buxhetin e sektorit të shëndetësisë i cili arriti në 345 milionë euro (rritje prej 14.2 përqind) krahasuar me 300 milionë në vitin 2023.<sup>254</sup> Cilësia e kujdesit shëndetësor mbetet shqetësim, me projektligje për shëndetësinë dhe sigurimin shëndetësor që presin zbatim të suksesshëm dhe/ose ndryshime për vite me radhë. Strategjia e re e Sektorit të

251 DUDNJ, [Neni 5](#).

252 Këshilli i Evropës (2024), [Të drejtat e njeriut dhe shëndeti](#).

253 [Ligji Nr. 08/L-042 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-084 për sigurimin shëndetësor](#).

254 Klan Kosova (2024), [Vitia: Buxheti i vitit 2024, më i lartë që i dedikohet shëndetësisë](#).

Shëndetësisë 2025-2030 u miratua në nëntor 2024, me “qëllim për t’u ofruar politikëbërësve shëndetësorë, institucioneve shëndetësore dhe të gjithë pjesëmarrësve të tjerë në sektor mundësinë për të (...) pasur një ndikim në shëndetin dhe mirëqenien e popullatës”.<sup>255</sup> Pavarësisht një buxheti rekord të lartë për sektorin e shëndetësisë në vitin 2024, llogaridhënia institucionale mbetet e ulët dhe nuk ka tregues të bazuar në performancë.<sup>256</sup>

**191.** Pavarësisht një rritjeje të konsiderueshme prej rreth 14.2 përqind në buxhetin për vitin 2024 krahasuar me vitin e kaluar, ende nuk bëhen blerje strategjike në sektorin e shëndetit publik, duke rezultuar në joefikasitete të mëdha dhe rezultate të dobëta shëndetësore, me jetëgjatësinë në lindje që është më e ulët në rajon, ndërsa shkalla e vdekshmërisë së foshnjave është më e larta.<sup>257</sup> Buxheti i ndarë për shëndetin mendor ishte 4,077,437 EUR në vitin 2024, ndërsa për vitin 2025 është planifikuar të jetë 4,236,172 EUR, një rritje e lehtë që do të shkojë kryesisht në paga dhe nuk ka gjasa të krijojë një ndryshim të konsiderueshëm në shërbimet e shëndetit mendor, sipas OJQ QIPS. Shpenzimet për shëndetin mendor variojnë rreth 1 deri në 2 përqind të shpenzimeve vjetore, duke rezultuar në renditjen e ulët të shëndetit mendor në prioritetet e Qeverisë së Kosovës.<sup>258</sup> Për më tepër, raporti i Komisionit të BE-së thekson se pabarazitë në shëndetësi mbeten shqetësim serioz, që rrjedh nga mungesa e një marrëveshjeje të përshtatshme financiare që do të siguronte mbulim të përgjithshëm shëndetësor dhe do të ndalonte pagesat e larta të vazhdueshme nga xhepi, të cilat vlerësohen të variojnë midis 30-40 përqind.<sup>259</sup>

**192.** Ekziston gjithashtu një skepticizëm i përhapur ndaj sistemit publik të kujdesit shëndetësor, që rrjedh nga favorizimi, duke lënë kështu një pjesë të konsiderueshme të popullsisë pa qasje në kujdes shëndetësor cilësor për shkak të mungesës së lidhjeve. Si pasojë, shumë individë përdorin fonde personale për shërbime private të kujdesit shëndetësor. Situata në vitin 2024 u përkeqësua në këtë drejtim duke pasur parasysh se çmimet në klinikat private janë rritur ndjeshëm, duke i bërë shërbimet e kujdesit shëndetësor edhe më vështirë të qasshme për ata që kanë nevojë.<sup>260</sup>

**193.** Kosova mbetet i vetmi vend në rajon, qytetarët e të cilit nuk kanë qasje në sigurimin shëndetësor publik. Projektligji për Sigurimet Shëndetësore vazhdoi të ishte në agjendën legjislative për vitin 2024, por ende nuk është miratuar, pavarësisht premtimeve të përsëritura nga qeveri të ndryshme në 10 vitet e fundit. Kosovo 2.0 ka shqyrtuar versionin aktual të projektligjit të miratuar nga Qeveria e Kosovës dhe ka analizuar implikimet kryesore të tij.<sup>261</sup> Kritikët kanë theksuar se implikimet buxhetore të nevojshme që programi i sigurimeve në nivel shtetëror të funksionojë janë të larta dhe konsiderojnë se pikërisht këto implikime janë përdorur për të “justifikuar” vonesën në zbatimin e sigurimit shëndetësor. Sipas njohësve të skemave publike të sigurimeve, do të duhen mbi pesë vjet për të zbatuar plotësisht sistemin e sigurimeve shëndetësore në Kosovë, ku procesi legjislativ për të miratuar një ligj të tillë do të marrë kohë të konsiderueshme.<sup>262</sup>

**194.** Përveç mungesës së një sistemi institucional të sigurimit shëndetësor, mungesa e një Sistemi Informativ Shëndetësor (SISH) pengon më tej progresin. Funkcionalizimi i SISH mund të lehtësojë

255 [Strategjia e Sektorit të Shëndetësisë 2025-2030](#), publikuar në nëntor 2024.

256 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 69.

257 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 69.

258 QIPS (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

259 Komisioni i BE-së (2024), Raporti mbi Kosovën 2024, f. 69.

260 QIPS (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

261 Kosova 2.0. (2024), [Sigurimi Shëndetësor: Çfarë, Pse dhe Kur?](#)

262 Kosova 2.0. (2024), [Sigurimi Shëndetësor: Çfarë, Pse dhe Kur?](#)

**240.** Planet e veprimit dhe politikat kryesore në nivel kombëtar janë të përfshira në Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (2022-2026)<sup>327</sup> e cila përqendrohet në parandalimin, mbrojtjen, mbështetjen dhe politikat e integruara, si dhe në Programin e Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024 (PKBGJ), i cili përfundoi në vitin 2024.<sup>328</sup> Detyrimi për të zhvilluar PKBGJ-në si një platformë referimi për zhvillimin e veprimeve dhe strategjive institucionale drejt zbatimit të kornizës ligjore u specifikua në nenin 11 të Ligjit Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore. Objektivi kryesor i PKBGJ-së ishte “të avancoje parimet e barazisë gjinore dhe të arrinte një shoqëri paqësore, të begatë dhe me harmoni për gratë dhe burrat në Kosovë”. Në tetor 2024, Agjencia për Barazi Gjinore publikoi Raportin e saj përfundimtar mbi vlerësimin e Programit për Barazi Gjinore për vitet 2020-2024, ku ndër arritjet tjera u përmend ulja e shkallës së papunësisë tek gratë gjatë kësaj periudhe.<sup>329</sup> Agjencia për Barazi Gjinore/Zyra e Kryeministrit po punon për hartimin e Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2025-2035, ky Program është një dokument strategjik dhe kyç që synon t’i adresojë sfidat dhe të promovojë progresin drejt barazisë gjinore në vend.<sup>330</sup>

**241.** Ndonëse ende të nënpërfaqësuar, gratë po luajnë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në vendimmarrje në Kosovë. Institucioni i Avokatit të Popullit të Kosovës (IAP) ka dorëzuar në Gjykatën Kushtetuese Ligjin e ri Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme me qëllim sqarimin e mospërputhjes midis kuotës gjinore prej të paktën 30 përqind për Kuvendin dhe rregullit të përfaqësimit të barabartë prej 50 përqind që kërkohet nga Ligji për Barazinë Gjinore. Më 27 dhjetor 2024, Gjykata Kushtetuese vendosi për këtë rast duke vendosur se Neni 28 (Kuotat Gjinore) i Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme nuk është në kundërshtim me Nenin 45 (Liria e Zgjedhjeve dhe Pjesëmarrja) të Kushtetutës.<sup>331</sup> Gjykata Kushtetuese sqaroi se Kushtetuta nuk e pengon vendosjen e masave afirmative të nevojshme për avancimin e të drejtave të individëve ose grupeve të nën-përfaqësuar që janë në pozitë të pabarabartë, duke mundësuar, ndër të tjera, futjen e kuotave ligjore për pjesëmarrje dhe përfaqësim të barabartë të gjinive në jetën politike derisa të arrihet barazia e kërkuar. Megjithatë, Kushtetuta nuk përcakton përqindjen e saktë të kuotës ligjore, duke ia deleguar kështu këtë çështje Kuvendit të Kosovës për vendimmarrje bazuar në zgjedhjet e tij politike, ndërkohë që mbetet nën detyrimin për t’i respektuar standardet që rrjedhin nga instrumentet ndërkombëtare në fuqi.<sup>332</sup>

**242.** Në vitin 2024, OJQ Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) publikoi një analizë tematike rreth kuotave gjinore duke rekomanduar një modalitet të “kuotave zinxhir” si pjesë të trajektoreve politike të Kosovës drejt barazisë gjinore.<sup>333</sup> Vlen të përmendet se një sistem zinxhir i kuotave synon përfaqësim gjinor prej 50-50 përqind, por zbatimi i tij faktik varet nga faktorët zgjedhorë dhe socialë, siç ilustron nga shumë vende që e praktikojnë sistemin në BE. Sipas praktikës gjy-

327 Qeveria e Republikës së Kosovës (2022-2026), [Strategjia Kombëtare për Mbrojtje nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave \(2022-2026\)](#).

328 QKSGJ (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

329 Agjencia për Barazi Gjinore (2024), [Prezantohet Raporti përfundimtar i Programit të Kosovës për Barazi Gjinore 2020-2024](#).

330 QKSGJ (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

331 Gjykata Kushtetuese e Kosovës (2024), [rasti nr. KO15/24, Institucioni i Avokatit të Popullit – Vlerësimi i kushtetutshmërisë së nenit 28 të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës](#).

332 Gjykata Kushtetuese e Kosovës (2024), [përmbledhje e rastit nr. KO15/24](#).

333 Qendra e Studimeve Gjinore e Kosovës (2024), [Kuotat gjinore dhe debati për to](#).



qësore të Gjykatës Kushtetuese mbi kuotat, Kushtetuta lejon kuotat si masa afirmative drejt barazisë gjinore, por Gjykata Kushtetuese nuk mund ta detyrojë Kuvendin e Kosovës (KK) të prezantojë një kuotë prej 50 përqind ose ndonjë formë të një sistemi zinxhir në zgjedhjet e përgjithshme, pasi kjo nuk është detyrim kushtetues, por një zgjedhje politike e Qeverisë së Kosovës (QK) dhe KK-së.

**243.** Diskrepancat midis politikës dhe praktikës janë përkthyer gjithashtu në nën-përfaqësim të grave në agjendat e paqes dhe sigurisë. Sipas rezolutës 1325 të OKB-së, proceset e sigurisë dhe ndërtimit të paqes në Kosovë kërkojnë përfshirjen e grave në ekipet negociuese gjatë dialogut midis Kosovës dhe Serbisë.

**244.** Gjuha seksiste dhe komentet përçmuese drejtuar politikanëve gra vazhduan njëjtë edhe në vitin 2024, duke ilustruar mjedisin armiqësor që pengon aspiratat e grave për të marrë pjesë në peizazhin publik politik. OJQ Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) publikoi një raport në vitin 2024 rreth gjuhës seksiste, raciste, mizogjene dhe homofobike të përdorur nga përfaqësuesit në Kuvendin e Kosovës. Raporti gjeti përdorim të shpeshtë të gjuhës joparlamentare dhe fyese, me diskutime që përfshinin sulme personale dhe deklarata përçmuese, të cilat minonin dinjitetin e Kuvendit të Kosovës.<sup>334</sup>

**245.** Pavarësisht angazhimeve formale për barazi gjinore, Instituti GAP tregon se Kosova vazhdon të përballë me boshllëqe të konsiderueshme në përdorimin e të dhënave të ndara sipas gjinisë për hartimin efektiv të politikave. Edhe pse janë duke u bërë disa përpjekje, kufizimet institucionale duke përfshirë ndërgjegjësimin e ulët, kapacitetin e kufizuar dhe mungesën e një kulture sensitive ndaj gjinisë vazhdojnë ta pengojnë progresin. Statistikat gjinore të përditësuara dhe të përpiluara sistematikisht mbeten të pakta në numër, veçanërisht për qëllime të buxhetimit dhe vlerësimit të ndikimit. Për më tepër, Kosova ende nuk ka zhvilluar një Indeks të Barazisë Gjinore, dhe gjersa Agjencia e Statistikave të Kosovës publikon të dhëna të ndara sipas gjinisë, ato rrallë ndahen më tej sipas etnisë, gjeografisë ose variablave të tjera kryesore.<sup>335</sup>

**246.** Instituti GAP gjithashtu përmend barrierat financiare si sfidën kryesore për gratë dhe bizneset në pronësi të komuniteteve jo-shumicë. Stereotipet gjinore vazhdojnë, veçanërisht në sektorët që tradicionalisht konsiderohen të grave si ushqimi dhe shitja me pakicë, ku normat patriarkale dhe ndërhyrja familjare pengojnë rritjen. Megjithatë, etnia ka pak ndikim në suksesin e biznesit. Në disa raste, gratë ndiejnë nevojën për t'i përfshirë partnerët burra për të shmangur ngacmimin ose shkarkimin nga puna. Gjersa disa biznese raportojnë se marrin mbështetje shtetërore, veçanërisht ato në pronësi të komuniteteve jo-shumicë nuk kanë përfutur kurrë nga ndihma qeveritare.<sup>336</sup>

**247.** Megjithatë, OJQ QKSGJ vë në pah se pavarësisht penalizimit të ngacmimit seksual në vendin e punës në legjislacionin e Kosovës, dukuria e ngacmimit seksual në sektorin privat nuk është trajtuar mjaftueshëm. Ngacmimi seksual në vendin e punës shpesh kryhet nga individë në pozita të larta të cilët shfrytëzojnë autoritetin e tyre për të ndikuar në vendimet kyçe të karrierës së punon-

334 IKD (2024), [Kuvendi i dështimeve: Raport i monitorimit të punës së Kuvendit të Kosovës për vitin 2023](#)

335 GAP (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

336 GAP (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.



jëseve dhe ushtrojnë kontroll dhe pushtet mbi viktimën. Anasjelltas, viktimat në Kosovë shpesh gjenden në pozita të cënueshme pa autoritet vendimmarrës dhe siguri pune. Sipas QKSGJ, 64 përqind e grave të punësuar në sektorin privat besojnë se ngacmimi seksual është një fenomen i përhapur me vetëm 10 përqind që raportojnë të kenë përjetuar ngacmim seksual.<sup>337</sup>

**248.** Në nëntor të vitit 2024, OJQ GLPS publikoi një raport që zbuloi se në rastet e dhunës në familje dhe dhunës me bazë gjinore, gratë përbënin 79 përqind të viktimave të raportuara. Përveç kësaj, 71.9 përqind e viktimave nuk kishin përfaqësim ligjor gjatë procedurave gjyqësore, duke zbuluar kështu boshllëqe të konsiderueshme në qasjen në drejtësi për të mbijetuarat.<sup>338</sup> Bazuar në këtë studim, gjykatat i kanë shpallur të akuzuarit fajtorë në 98.2 përqind të rasteve; megjithatë, nuk janë përdorur politika të përshtatshme penale për shkak se mbizotërojnë dënimet alternative, ndërkohë që në 50 përqind të vendimeve nuk përmendet nëse autorët e krimit kanë qenë recidivistë apo jo.<sup>339</sup>

**249.** Për më tepër, OJQ QKSGJ thekson gjithashtu se, duke pasur parasysh një vlerësim të kryer nga Këshilli i Evropës,<sup>340</sup> Kosova ka përparuar në adresimin e dhunës ndaj grave, duke harmonizuar kornizat e saj ligjore dhe të politikave me Konventën e Stambollit përmes iniciativave që përfshijnë Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (2022-2026). Megjithatë, ende ka sfida, duke përfshirë këtu mungesën e trajnimeve për profesionistët, vlerësimet e pabarabarta të rrezikut, mbështetjen e pamjaftueshme të specialistëve për viktimat e dhunës seksuale dhe martesës së detyruar, dhe fokusin e pamjaftueshëm në ndikimin afatgjatë ekonomik dhe psikologjik të dhunës ndaj grave.<sup>341</sup>

**250.** Lidhur me politikat dhe kornizën ligjore për eliminim të praktikave të dëmshme tradicionale të gjymtimit të grave, martesave të hershme ose të detyruara dhe vrasjeve për nder, OJQ QKSGJ thekson se neni 180 i Kodit Penal penalizon gjymtimin gjenital të grave, dhe neni 239 penalizon martesën e detyruar. Kodi Penal i Kosovës ka përfshirë në thelb Konventën e Stambollit. Penalizimi i vrasjeve për nder gjen bazën tek neni 173 i Kodit Penal. Kosova ka hartuar një kornizë gjithëpërfshirëse ligjore dhe të politikave për të trajtuar dhunën ndaj grave dhe dhunën në familje, Strategjinë Kombëtare për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje dhe Dhuna ndaj Grave (2022-2026). Janë marrë gjithashtu masa për të emëruar njësi të specializuara të zbatimit të ligjit, prokurorë ose gjyqtarë civilë që merren me rastet e dhunës në familje.<sup>342</sup>

**251.** Përveç kësaj, Protokolli Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale u përqendrua në standardizimin e "veprimeve të nevojshme për një reagim të vazhdueshëm, gjithëpërfshirës dhe të përgjegjshëm, për identifikimin, mbrojtjen, trajtimin, dokumentimin, referimin, fuqizimin e qëndrueshëm dhe riintegrimin e viktimave/të mbijetuarve të dhunës seksuale, përmes ndërhyrjeve të menjëhershme dhe profesionale të institucioneve përgjegjëse".<sup>343</sup>

337 QKSGJ (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

338 GLPS (2024), [Trajtimi institucional i rasteve të dhunës në familje në vitin 2024](#).

339 QKSGJ (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

340 Këshilli i Evropës, [Vlerësimi i përputhshmërisë së ligjeve, politikave dhe masave të tjera të Kosovës me standardet e Konventës së Stambollit](#).

341 QKSGJ (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

342 QKSGJ (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

343 [Protokolli Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale](#)

**252.** Më 29 gusht 2024, OJQ Rrjeti i Grave të Kosovës (RRGK) i dërgoi një letër të hapur Ministres së Drejtësisë duke kërkuar të sigurohet që buxheti i ardhshëm i shtetit të jetë një buxhet i përgjegjshëm ndaj gjinisë, i fokusuar drejt adresimit të nevojave të barazisë gjinore. Në këtë drejtim, OJQ RRGK rekomandoi posaçërisht që të sigurohet financim i mjaftueshëm për zbatimin e Protokollit Shtetëror për Trajtimin e Rasteve të Dhunës Seksuale.<sup>344</sup> Në vitin 2024, Ministria e Drejtësisë njoftoi krijimin e një qendre referimi të dedikuar për trajtimin e rasteve të dhunës seksuale brenda Institutit të Mjekësisë Ligjore. Qendra, e para e këtij lloji në rajon, synon të ofrojë shërbime gjithëpërfshirëse, duke përfshirë mbledhjen e provave, ekzaminimin dhe mbështetjen psikologjike për të mbijetuarat.<sup>345</sup>

**253.** Sipas Raportit të fundit të Policisë së Kosovës të publikuar për vitin 2024, ka pasur një rritje të rasteve të raportuara të dhunës në familje gjatë vitit 2024 në krahasim me vitin 2023, me 2,959 raste të dhunës në familje të raportuara në vitin 2024, krahasuar me 2,251 raste në vitin 2023.<sup>346</sup> OJQ QKSGJ vuri në dukje se gjatë vitit 2024, Kosova mund të ketë një rritje të shkallës së raportimit të rasteve të dhunës ndaj grave, përfshirë dhunën në familje, dhunën seksuale dhe dhunën me bazë gjinore. Kosova ka një rritje prej 6 përqind në rastet e raportuara krahasuar me vitin 2023. Ndërsa autoritetet përpiqen të merren me numrin në rritje të raportimeve të dhunës në familje, në dhjetor 2024, Policia e Kosovës nisi një skemë të re për të gjurmuar kryesit e dhunës në familje me anë të hallkave elektronike.<sup>347</sup>

**Tabela 2. Rastet e dhunës në familje ndërmjet viteve 2019 dhe 2024<sup>348</sup>**

| Viti                                | 2019  | 2020  | 2021  | 2022  | 2023  | 2024  |
|-------------------------------------|-------|-------|-------|-------|-------|-------|
| Rastet e dhunës në familje në numër | 1,915 | 2,069 | 2,200 | 2,273 | 2,638 | 2,959 |

**254.** Kosova ka tetë strehimore të licencuara të dedikuara për mbështetjen e viktimave të dhunës në familje, ku ofrohen shërbime thelbësore si akomodim, mbështetje psikologjike dhe ndihmë juridike. Mesatarisht, strehimoret mund të akomodojnë 15 persona (përfshirë fëmijë), por shumica ofrojnë edhe shtretër shtesë për situata emergjente. Kohëzgjatja maksimale e qëndrimit në to është gjashtë muaj; megjithatë, nëse nuk janë të sigurta dhe viktima nuk ka vend tjetër për të shkuar, ato mund të transferohen në një strehimore tjetër ose të qëndrojnë në të njëjtën strehimore përtej periudhës gjashtëmujore bazuar në një marrëveshje paraprake me Ministrinë e Punëve të Brendshme.<sup>349</sup>

344 RrGK (2024), [Drejt një Buxheti të Kosovës për vitin 2025 sensitiv ndaj çështjeve gjinore](#)

345 Telegrafi (2024), [Për herë të parë në Kosovë dhe rajon do të hapet një qendër referimi për rastet e dhunës seksuale në IML](#)

346 Ministria e Drejtësisë (MD 2024), [databaza për evidentimin e rasteve të dhunës në familje](#).

347 QKSGJ (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

348 Ministria e Drejtësisë (MD 2024), [databaza për evidentimin e rasteve të dhunës në familje](#).

349 QKSGJ (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

**255.** Edhe pse trendet tregojnë se dhuna në familje është në rritje, numri i përgjithshëm i incidenteve ka të ngjarë të mos raportohet sa duhet. Në një kontekst të normave patriarkale, gratë përjetojnë frikë të përhapur nga partnerët dhe familjet e tyre për të raportuar autorin në polici. Faktorë të tjerë janë mungesa e trashëgimisë dhe pasiguria financiare.

**256.** Gjatë katër periudhave të fundit të raportimit (2021-2024), femicidi është bërë një problem thellësisht i rrënjosur në shoqërinë e Kosovës, duke reflektuar vazhdimësinë e trendeve alarman-te shoqërore. Në vitin 2024 u shënuan 3 raste të femicidit. Të dhënat zbulojnë një trend shumë shqetësues me të paktën 58 gra të vrara në Kosovë që nga viti 2010, kryesisht nga autorë burra, përfshirë bashkëshortët, baballarët dhe djemtë.<sup>350</sup> Brenda pesë ditësh në prill të vitit 2024, dy gra të reja shqiptare (Erona Cakolli dhe Gjyljeta Ukellaj) u vranë nga ish-bashkëshortët e tyre në rre-thana rënduese, gjë që rezultoi në protesta publike. Presidentja e Kosovës e shpalli 17 prillin 2024 si ditë zie, «në kujtim të të gjitha grave dhe vajzave të vrara në Kosovë si rezultat i dhunës me bazë gjinore».<sup>351</sup> RrDNj lëshoi gjithashtu një deklaratë ku shprehte keqardhje të thellë për vras-jen e grave të reja dhe u bëri thirrje institucioneve përgjegjëse të reagojnë menjëherë dhe me profesionalizëm në trajtimin e rasteve të femicidit. Femicidi duhet të trajtohet si një emergjencë kombëtare nga institucionet e Kosovës nëse dëshirojmë që t'i japim fund ciklit të dhunës me bazë gjinore.<sup>352</sup>

**257.** Si përgjigje ndaj këtyre dy rasteve tragjike të vrasjes së grave, Prokuroria veproi menjëherë duke ngritur aktakuza kundër të akuzuarve. Njëri nga të akuzuarit, Edmond Lajqi, ish-bashkëshorti i Gjyljeta Ukellajt, u dënua me burgim të përjetshëm pasi pranoi akuzat për vrasje. Në gusht 2024, një vrasje e tretë tragjike ndodhi në Graçanicë, ku një grua serbe vdiq në spital dy ditë pasi pësoi lëndime të rënda të shkaktuara nga bashkëshorti i saj.<sup>353</sup>

**258.** Tre rastet e vrasjeve të grave që ndodhën në vitin 2024 shkaktuan zemërim publik dhe protes-ta, gjersa hodhën dritë mbi dështimin e Policisë së Kosovës dhe institucioneve të tjera përgjegjëse për të mbrojtur viktimat e dhunës në familje. Protestat u udhëhoqën nga organizatat e të drejtave të grave, OJQ të ndryshme, aktivist/e dhe të mbijetuara të dhunës, të cilat kërkuan që Qeveria të ndër marrë veprime për të adresuar çështjen e sigurisë për të gjitha gratë në Kosovë dhe dhunën me bazë gjinore në rajon.<sup>354</sup> Këto protesta i bënë jehonë thirrjes së përsëritur për një qëndrim më proaktiv nga institucionet publike në mbrojtjen e grave të rrezikuara nga autorët e dhunës me bazë gjinore. Gjyqtarët dhe prokurorët ende nuk janë të profesionalizuar mjaftueshëm për t'i menaxhuar rastet në mënyrë adekuate, duke dështuar shpesh në zbatimin e saktë të kornizës leg-jislative. Sulmet verbale dhe gjuha diskriminuese ndaj grave në pozita publike, siç janë deputetet e Kuvendit, mbeten tejet të përhapura në vitin 2024.<sup>355</sup> Në qershor të vitit 2024, Ministria e Drejtësisë e Kosovës nisi hartimin e Ligjit të parë kundër femicidit. Iniciativa synon të përcaktojë qartë femi-cidin në terma legjislativë dhe të prezantojë masa më të rrepta për parandalimin, ndjekjen penale dhe mbrojtjen e viktimave.<sup>356</sup>

350 Gazeta INFOKUS (2024), [Familja vendi më i rrezikshëm për gratë: 58 gra u vranë për 14 vite në Kosovë, 3 prej tyre vetëm në vitin 2024](#).

351 Presidentja e Kosovës (2024), [Presidentja Osmani e shpallë të mërkurën ditë zie shtetërore](#).

352 HRN (2024), [Një tjetër rast vrasjeje të grave në Kosovë!](#)

353 Nacionale (2024), 2024: [Edhe një vit i përgjakshëm me vrasje të grave](#); Albanian Post (2024), [Vrasja e gruas në Graçanicë, protestohet kundër dhunës e femicidit](#).

354 Sinjali (2024), <https://sinjali.com/protestohet-ne-gracanice-kunder-femicidit-dhe-dhunes-ndaj-grave/>.

355 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 36.

356 Kallxo.com (2024), [Ministria e Drejtësisë inicion hartimin e Projektligjit kundër femicidit](#).

**259.** Pas denoncimeve të 27 studentëve të Fakultetit të Mjekësisë për ngacmim seksual nga Profesori Xhevat Krasniqi, OJQ YIHR KS dhe 41 OSHC-të tjera i dërguan një letër të hapur Rektorit (në atë kohë në detyrë) të Universitetit të Prishtinës, z. Qerim Qerimi. Përmes një letre të tillë, OSHC-të kërkuan veprime të menjëhershme nga Rektori për t'i adresuar këto denoncime serioze duke pezulluar menjëherë Profesorin në fjalë, derisa të arrihet një epilog për rastin. OSHC-të theksuan se duhet të ketë tolerancë zero për rastet e ngacmimit seksual në institucionet arsimore. Kushdo që hesht përballë veprimeve të tilla të neveritshme në fakt po bashkëpunon me autorin e krimit dhe po i amnistion krimet seksuale brenda Universitetit të Prishtinës.<sup>357</sup>

**260.** Në vitin 2024, SIT - Qendra për Këshillim, Shërbime Sociale dhe Hulumtime kreu një studim me titull "Dhuna me Bazë Gjinore (DHBGJ) nga perspektiva e gjeneratës Z", duke u përqendruar në qëndrimet e të rinjve në Kosovë. Studimi zbuloi se një pjesë e konsiderueshme e të rinjve/rejave nuk arritën t'i identifikonin sjelljet kontrolluese ndaj partnereve gra si forma të dhunës. Për më tepër, hulumtimi identifikoi një bindje mbizotëruese në mesin e këtyre burrave se rrethana të caktuara mund të justifikonin ose arsyetonin dhunën me bazë gjinore. Alarmuese është se shumë nga të anketuarit e gjeneratës Z në mostrën e anketës ranë dakord me pohimin se "burrat kanë të drejtë t'i disiplinonin gratë për sjellje 'të pahijshme' "(38 përqind).<sup>358</sup>

**261.** OJQ QKSGJ vë në pah se qasja në kontraceptivë emergjent, abort të sigurt dhe profilaksë të IST-ve në Kosovë mbetet e paqartë. Bazuar në raportin e OJQ-së RrGK, kontracepsioni emergjent përmendet si tekniki në dispozicion, por qasja pengohet nga ndërgjegjësimi i kufizuar publik dhe furnizimi jokonsistent në farmaci dhe institucione shëndetësore.<sup>359</sup>

## 262. Rekomandimet

- Inspektorati i Punës duhet t'i përshtatë rregulloret në vendin e punës për ta adresuar ngacmimin seksual, veçanërisht në sektorin privat, ku kjo dukuri mbetet e nënraportuar;
- Kuvendi i Kosovës duhet ta penalizojë femicidin si një vepër penale të veçantë dhe të rëndë, me udhëzime të detyrueshme minimale për dënimin dhe ndëshkime të ashpërsuara;
- Kuvendi i Kosovës duhet të krijojë një Kod të Etikës Parlamentare obligativ dhe me dispozita specifike që ndalojnë gjuhën seksiste, raciste dhe mizogjene, i cili do të zbatohet nga një mekanizëm i pavarur disiplinor me kompetenca sanksionuese.

## 7.2 Të drejtat e fëmijëve

**263.** Konventa e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve (KDF), e cila i përcakton fëmijët si persona nën moshën 18 vjeçare, është drejtpërdrejt e zbatueshme në Kosovë sipas nenit 22 të Kushtetutës dhe ka përparësi ndaj ligjeve vendore dhe akteve të Qeverisë. Megjithatë, kjo Konventë mbetet e

357 YIHR KS (2024), [Letër e hapur Rektorit të Universitetit të Prishtinës z. Qerim Qerimi](#).

358 QKSGJ (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024. Shih gjithashtu, SIT (2024), [Dhuna me Bazë Gjinore \(DHBGJ\) nga Perspektiva e Gjeneratës Z](#).

359 QKSGJ (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

pazbatuar mjaftueshëm nga gjyqtarët dhe prokurorët, siç parashikohet në nenin 22 të Kushtetutës së Kosovës.<sup>360</sup> Mbrojtja e të drejtave të fëmijëve si një shtyllë themelore e zhvillimit demokratik të Kosovës është përcaktuar në Nenin 50 të Kushtetutës. Kushtetuta e vë theksin në mirëqenien, barazinë dhe mbrojtjen e fëmijëve nga keqtrajtimi, dhuna dhe çdo formë shfrytëzimi. Në përputhje me standardet ndërkombëtare, legjislacioni primar është plotësuar së fundmi nga Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijëve. Ky ligj i mbron fëmijët nga format e ndryshme të abuzimit fizik, mendor dhe emocional; neglizhencës; dhe shfrytëzimit në të gjitha sferat shoqërore, duke filluar nga institucionet e përkujdesjes te institucionet publike e deri te mjedisi shtëpiak.

**264.** Korniza ligjore e Kosovës për të drejtat e fëmijës është kryesisht në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe standardet ndërkombëtare, por zbatimi mbetet i kufizuar. Nga gjithsej 17 Udhëzime Administrative të parashikuara sipas Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve, të gjitha janë miratuar tashmë, megjithëse me një vonesë të konsiderueshme dhe shqetësuese.<sup>361</sup> Sipas OJQ Terre des Hommes Kosovo, përveç avancimit të kornizës legjislative në vitin 2024, nuk mund të thuhet se ka pasur ndonjë përmirësim të konsiderueshëm në zbatimin e një kornize të tillë. Edhe pse ka pasur një përpjekje për ta përmirësuar zbatimin në disa fusha dhe vëmendje pak më të shtuar nga institucionet publike, në nivel ndikimi - nuk ka ndryshime pozitive që vlen të theksohen.<sup>362</sup>

**265.** Mekanizmat institucionalë që garantojnë zbatimin e legjislacionit dhe që përfshijnë mekanizmat e pjesëmarrjes së fëmijëve përcaktohen nga Ligji Nr. 06/L-084 për Mbrojtjen e Fëmijëve.<sup>363</sup> Ato përfshijnë Komitetin Ndërmintor për të Drejtat e Fëmijëve, i cili vepron brenda Zyrës së Kryeministrit përmes Zyrës për Qeverisje të Mirë, dhe mekanizma të tjerë në nivel qendror dhe lokal.<sup>364</sup> Strategjia për të Drejtat e Fëmijëve dhe Plani i Veprimit (2019-2023)<sup>365</sup> nuk është më në fuqi dhe gjatë periudhës raportuese nuk është miratuar asnjë Strategji specifike për të Drejtat e Fëmijëve. Megjithatë, në vitin 2024, MKRS publikoi Strategjinë e saj Shtetërore për Rininë (2024-2032)<sup>366</sup> e cila i referohet çështjeve që lidhen me të drejtat e fëmijëve, megjithëse shumë më pak sesa do të bënte një Strategji specifike për të Drejtat e Fëmijëve. Gjetjet kryesore të Strategjisë Shtetërore për Rininë (2024-2032) në lidhje me të drejtat e fëmijëve janë si më poshtë: (i) 88 përqind e fëmijëve me aftësi të kufizuara nuk vijnë shkollën; (ii) shkalla e vijimit të mësimave në shkollën fillore në mesin e komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian është 84 përqind krahasuar me 100 përqind të popullsisë së përgjithshme, ndërsa në shkollën e mesme është 63 përqind, dhe 31 përqind në arsimin e lartë.<sup>367</sup> Kjo mungesë e objektivave dhe planeve strategjike për t'i përmirësuar të drejtat e fëmijëve në Kosovë nënkupton se ekziston nevoja për miratimin e një Strategjie specifike për të Drejtat e Fëmijëve.

**266.** Në vitin 2024, në Ministrinë e Drejtësisë u krijua Divizioni për Mbrojtjen e Fëmijëve. Rekomandohet që ky divizion të funksionalizohet plotësisht dhe të pajiset me staf të kualifikuar për të kryer në mënyrë efektive përgjegjësitë e veta.<sup>368</sup>

360 UNHCR (1989), [Konventa për të Drejtat e Fëmijës](#).

361 Terre des Hommes Kosova (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

362 Terre des Hommes Kosova (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

363 Save the Children Kosova/o (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

364 Terre des Hommes Kosova (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

365 Uebfaqja e ZQM-së (2025), [strategjia për të drejtat e fëmijëve 2019-2023](#)

366 MKRS (2024), [Strategjia Shtetërore për Rininë 2024-2032](#).

367 MKRS (2024), [Strategjia Shtetërore për Rininë 2024-2032](#).

368 Terre des Hommes Kosova (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.



**267.** Zbatimi i plotë i Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve mbetet pezull, parandalimi vazhdon të mos jetë një element kyç i shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve, dhe iniciativa të tilla si linja falas e ndihmës për fëmijë dhe shtëpitë për mbrojtjen e fëmijëve, ashtu siç parashikohen nga Ligji, ende nuk janë krijuar. E njëjta gjë vlen edhe për Ligjin Nr. 08/L-255 për Shërbimet Sociale dhe Familjare, sipas Save the Children Kosova/o. Analiza e fundit e Situatës së të Drejtave të Fëmijëve nga Save the Children Kosova/o, vë në pah pengesa themelore, duke përfshirë mungesën e masave parandaluese dhe afatgjata të shërbimeve të integritetit, sistemin e fragmentuar të ofrimit të shërbimeve, norma të ulëta raportimi për fëmijët që përfshijnë dhunë, kapacitete të kufizuara njerëzore dhe infrastrukture dhe shqetësime lidhur me qëndrueshmërinë financiare të shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve.

**268.** Raporti i fundit i KOMF-it, i publikuar në tetor të vitit 2024, zbulon të dhënat e mëposhtme: (i) 30 përqind e popullsisë në Kosovë janë fëmijë; (ii) shuma e ndihmës sociale varion nga 70 deri në 250 euro në muaj; (iii) 36,633 fëmijë janë përfitues të ndihmës sociale; (iv) 46,000 fëmijë përfituan nga shtesa prej 20 euro në muaj dhe rreth 344,000 fëmijë përfituan nga shtesa prej 10 euro në muaj; (v) numri mesatar i rasteve për një zyrtar të shërbimeve sociale ishte rreth 250 raste në vit; (vi) e vetmja strehimore për fëmijë në nivel kombëtar u mbyll për shkak të mungesës së fondeve; (vii) 634 fëmijë janë pa kujdes prindëror; (viii) 564 raste incidentesh në shkolla dhe përreth tyre; (ix) vetëm 45 raste dhune në shkolla të raportuara nga shkollat në SMIA; (x) 335 fëmijë viktimë të dhunës në familje morën shërbime nga strehimoret; (xi) 194 raste të të miturve në konflikt me ligjin nën moshën 14 vjeç; (xii) 1,867 kallëzime penale për autorë të mitur të veprave penale; (xiii) 124 raste të vdekjes së të porsalindurve; (xiv) një psikolog ose pedagog shkollor punon me rreth 1,400 fëmijë, ndërsa vetëm 7 psikiatër për fëmijë janë në institucione publike; (xv) vetëm 54 institucione parashkollë/kopshte në sektorin publik, me 10 komuna që nuk kanë asnjë institucion publik parashkollor.<sup>369</sup>

**269.** Viti 2024 ka qenë një vit krize financiare që ka prekur organizatat e licencuara që kontribuojnë në të drejtat e fëmijëve dhe që ofrojnë shërbime sociale, sipas OJQ Terre des Hommes. Kjo për shkak se shumë donacione, veçanërisht programet e BE-së që kanë mbështetur ofrimin e shërbimeve sociale, kanë mbaruar. Ministritë dhe akterët e tjerë nuk kanë pasur kapacitetet e nevojshme financiare për ta mbuluar boshllëkun e lënë nga mungesa e fondeve. Si rezultat, shumë organizata janë detyruar t'i zvogëlojnë shërbimet e tyre ose t'i ndalojnë ato krejtësisht, duke rezultuar në mbylljen e dy organizatave (njëra prej tyre e specializuar në strehimin e fëmijëve pa kujdes prindëror dhe viktimitave të ndryshme të dhunës). Komunitatet kanë ofruar pak ose aspak mbështetje, ndërsa një fond i ndarë qeveritar prej 1.5 milion ka qenë i pamjaftueshëm për t'i mbuluar nevojat.<sup>370</sup>

**270.** Sipas anketës me titull "Young Voices 2024", gjersa një shumicë e konsiderueshme e fëmijëve (94 përqind) janë të vetëdijshëm për të drejtat e fëmijëve, dhe 68 përqind kanë njohuri për Konventën e OKB-së për të Drejtat e Fëmijëve, pjesëmarrja aktuale në qeverisje dhe konsultime publike mbetet alarmante. Vetëm 9 përqind e fëmijëve raportuan se kanë marrë pjesë në ndonjë konsultim publik të organizuar nga komunitet ose Qeveria në dy vitet e fundit. Kjo tregon për një

369 KOMF (2024), [Raport: Cili është rezultati i përgjithshëm i Kosovës për kujdesin ndaj fëmijëve?](#)

370 Terre des Hommes Kosova (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

boshllëk të konsiderueshëm midis ndërgjegjësimit për të drejtat dhe angazhimit aktiv në vendimmarrje. Pavarësisht kësaj, ekziston një dëshirë e fortë në mesin e fëmijëve për përfshirje më të madhe. Një shifër mbresëlënëse prej 83 përqind shprehën dëshirën për më shumë ndikim, pushtet dhe mundësi për të shprehur mendimet e tyre mbi çështjet që i prekin ata/ato dhe bashkëmoshatarët e tyre. Përveç kësaj, 64 përqind e fëmijëve treguan interes për të marrë pjesë në konsultime publike, duke sugjeruar një gatishmëri për t'u angazhuar nëse u jepet mundësia.<sup>371</sup>

**271.** Diskutimi me fëmijë nga Grupi "Respect Our Rights" (ROR), Grupi Hëna dhe Um za Decu, të cilët u konsultuan gjatë zhvillimit të anketës "Young Voices 2024", nxori në pah mangësi kritike në konsultimet publike. Shumë fëmijë i kritikuan këto forume si joadekuate për fëmijët ose aspak tërheqëse. Ata vunë re se struktura e këtyre konsultimeve shpesh nuk arrin t'i përshtatet orareve shkollore dhe mund të jetë tepër formale, duke e bërë të vështirë që fëmijët t'i kuptojnë diskutimet. Një vajzë 17-vjeçare u shpreh: "Edhe nëse marrim pjesë, shprehja e mendimit tonë nuk ka ndikim tek vendimmarrësit", duke theksuar shkëputjen midis pjesëmarrjes së fëmijëve dhe ndikimit aktual në politika. Ndërkohë që nuk ka dallime të konsiderueshme gjinore në shkallët e pjesëmarrjes, fëmijët e moshës më të rritur kanë tendencë të jenë më të përfshirë. Pavarësisht këtyre pengesave, 64 përqind e fëmijëve shprehën dëshirën për të marrë pjesë në konsultime të tilla, me 70 përqind të vajzave dhe 55 përqind të djemve që treguan interes për pjesëmarrje.<sup>372</sup>

**272.** Kosova ka një kornizë ligjore për ta adresuar delikuecën e të miturve, e cila siguron mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve në konflikt me ligjin dhe promovon rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri. Sipas Kodit 06/L-006 për Drejtësinë për të Mitur, fëmijët që kryejnë vepra penale i nënshtrohen procedurave dhe sanksioneve që dallojnë nga ato për të rriturit.

**273.** Fëmijët vazhdojnë të jenë subjekt i dhunës, neglizhencës, abuzimit, shfrytëzimit dhe trafikimit, thekson OJQ Terre de Hommes. Dhuna dhe ndëshkimi trupor vazhdojnë të jenë masa disiplinore të pranueshme nga shoqëria në Kosovë, me programe ose shërbime të kufizuara për të mbështetur prindërimin pozitiv dhe mirëqenien e fëmijëve. Identifikimi dhe raportimi i fëmijëve në situata të dhunshme mbetet një sfidë e madhe, madje edhe brenda institucioneve, pavarësisht detyrimeve ligjore. Sistemi i fragmentuar i mbrojtjes së fëmijëve çon në shërbime të izoluar dhe të pakoordinuara që nuk kanë një qasje shumëdisiplinore për të adresuar në mënyrë efektive dhunën. Vazhdon të ketë sfida në qasjen në shërbime, veçanërisht për fëmijët me aftësi të kufizuara, për shkak të burimeve të kufizuara njerëzore, mungesës së shërbimeve të specializuara dhe ofrimit të shërbimeve të fragmentuara, gjë që shpesh çon në ri-viktimizim. Sistemi aktual i mbrojtjes sociale në Kosovë, edhe pse ofron ndihmë financiare, nuk i plotëson mjaftueshëm nevojat e larmishme të familjeve dhe fëmijëve në nevojë. Shumë familje dhe fëmijë përjashtohen për shkak të kriterëve diskriminues dhe për më tepër, skema e ndihmës sociale funksionon pothuajse në mënyrë të pavarur nga shërbimet sociale, duke kufizuar ndikimin e saj të përgjithshëm.<sup>373</sup>

**274.** Save the Children Kosova/o thekson se epoka digjitale sjell rreziqe që duhet të menaxhohen me kujdes, siç janë ekspozimi ndaj përmbytjes së papërshtatshme, bullizmi kibernetik dhe shkeljet e privatësisë. Lidhur me rreziqet që lidhen me dëmet digjitale, mungojnë mekanizmat ekzistues të raportimit, siç janë linjat telefonike dhe mjetet e tjera të raportimit që shërbejnë si

371 Save the Children Kosova/o (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

372 Save the Children Kosova/o (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

373 Save the Children Kosova/o (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

pikë kontakti për fëmijët dhe viktimat e tjera të mundshme që duan të adresojnë abuzimin seksual ose shfrytëzimin, me një fokus të veçantë në përmbajtjen online të abuzimit me fëmijët. Raporti Young Voices 2024 tregon se 78 përqind e fëmijëve raportojnë se ngacmimi është shumë ose mesatarisht i pranishëm në shkollën e tyre. Fëmijët identifikojnë më tej TikTok (78 përqind), Snapchat (57 përqind), hapësirat shkollore dhe publike (52 përqind), Instagramin (45 përqind) dhe Facebook-un (28 përqind) si hapësira ku ngacmimi ndodh shpesh ose gjithmonë.<sup>374</sup>

**275.** Në korrik të vitit 2024, Qeveria e Republikës së Kosovës prezantoi skemën e re për shtesat për fëmijë, përmes së cilës nënat me një ose dy fëmijë do të marrin 20 euro në muaj për secilin fëmijë, ndërsa nënat me tre ose më shumë fëmijë do të marrin 30 euro në muaj për secilin fëmijë.<sup>375</sup> Në dhjetor 2024, Qeveria e Kosovës ndau fonde për shtesa të njëhershme në vlerë prej 100 eurosh për fëmijët dhe pensionistët.<sup>376</sup> Megjithatë, sipas një analize të Radios Evropa e Lirë të kryer në vitin 2024 në lidhje me shtesat për fëmijë, disa komunitete (si për shembull komunitetet rome, egjiptian dhe ashkali) kanë më shumë vështirësi në marrjen e këtyre shtesave për shkak të disa faktorëve, përkatësisht mosregjistrimit në regjistrat civilë të institucioneve të Kosovës, pamundësisë për të shkruar dhe lexuar dhe vështirësisë për të përdorur teknologjinë për aplikimet online.<sup>377</sup> Megjithatë, sipas Institutit për Zhvillimin e Politikave Sociale, ekziston nevoja për të krijuar një zyrë ose për të emëruar një zyrtar që mund t'i ndihmojë me procedurat e aplikimit komunitetet dhe personat që jetojnë në zona rurale.<sup>378</sup>

**276.** Efektiviteti i shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve është veçanërisht sfidues për grupet e margjinalizuara, duke përfshirë fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, dhe fëmijët me aftësi të kufizuara. Këto komunitete përjetojnë diskriminim në shumë nivele, gjë që përkeqëson cënueshmërinë dhe kufizon qasjen në shërbimet e mbrojtjes. Joefikasiteti sistematik brenda sistemit të drejtësisë për të mitur, veçanërisht në zbatimin e masave të diversitetit, nxjerr në pah më tej fushat që kanë nevojë për përmirësim për të siguruar që fëmijët e margjinalizuar të marrin mbrojtje dhe mbështetje të mjaftueshme.<sup>379</sup>

**277.** Sistemi i shërbimeve sociale në Kosovë vazhdon të jetë i mbingarkuar, i financuar dobët dhe i paaftë për t'u përballur me kërkesat në rritje të njerëzve në nevojë dhe grupeve të cënueshme. Miratimi i Ligjit të ri Nr. 08/L-255 për Shërbimet Sociale dhe Familjare duhet të konsiderohet si një zhvillim pozitiv pasi garanton ofrimin e shërbimeve me cilësi më të lartë, sipas OJQ Terre Des Hommes. Çështja më kritike mbetet zbatimi i ligjit në lidhje me punën që bëhet nga Qendra për Punë Sociale. Ky është institucioni kryesor me një mandat të qartë për mbrojtjen e fëmijëve. Megjithatë, këto qendra vuajnë nga mungesa e burimeve njerëzore dhe financiare, dhe kanë nevojë për ndërtim kapacitësh dhe profilizim më të mirë të punonjësve socialë. Kjo sepse, për shembull, një punonjës social merret me trajtimin e të gjitha kategorive, qofshin fëmijë, të rritur, të moshuar dhe nuk është i specializuar për kategori specifike që kanë edhe nevoja specifike. OJQ Terre des

374 Save the Children Kosova/o (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

375 Kallxo (2024), [Rriten shtesat për fëmijë, Kurti prezanton skemën e re të pagesave](#).

376 Monitor (2024), [Qeveria e Kosovës ndan nga 100 euro shtesa për pensionistë e fëmijë](#).

377 Radio Evropa e Lirë (2024), [Shtesat për fëmijë: Kush fiton e kush humb?](#)

378 Radio Evropa e Lirë (2024), [Shtesat për fëmijë: Kush fiton e kush humb?](#)

379 Save the Children Kosova/o (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

Hommes përsërit rekomandimin e saj që çdo qendër pune sociale duhet të caktojë një person të veçantë që merret vetëm me çështjet e fëmijëve. Cilësia e ofrimit të shërbimeve do të jetë më e mirë nëse këta persona profilizohen për të punuar me kategori specifike dhe jo me të gjitha kategoritë njëkohësisht.<sup>380</sup>

**278.** Shfrytëzimi i fëmijëve përmes punës së fëmijëve dhe lëmshës vazhdon të ndodhë edhe në vitin 2024. Sipas raportit të Komisionit të BE-së, rreth 9 përqind e fëmijëve janë të përfshirë në punë, nga të cilët 5.6 përqind në kushte të rrezikshme, një problem që është kryesisht i përhapur në mesin e komuniteteve romë dhe ashkali.<sup>381</sup> Kosova vazhdon të përballet me mungesë të shërbimeve të specializuara komunale për të mbrojtur fëmijët e përfshirë në punë. Shumica e fëmijëve të angazhuar në punë të rrezikshme nuk janë të integruar në sistemin e mbrojtjes dhe nuk marrin asnjë shërbim. Varfëria pretendohet të jetë arsyeja kryesore pse këta fëmijë detyrohen të kërkojnë lëmshë në rrugët e Kosovës. Një problem i ngjashëm prek edhe fëmijët viktimë të trafikimit të qenieve njerëzore, me sfida të mëdha në identifikimin e tyre dhe mungesë të programeve afatgjata të riintegrit.<sup>382</sup>

**279.** Fëmijët me aftësi të kufizuara përballen me sfida të mëtejshme, shpesh detyrohen të udhëtojnë në qytete më të mëdha për shërbime thelbësore për shkak të mungesës së burimeve lokale. Ngjashëm, Ligji Nr. 03//L-022 për Mbështetjen Materiale për Familjet e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara njeh të drejtën për kompensim material vetëm për fëmijët me aftësi të kufizuara të përhershme fizike, mendore dhe shqisore, të cilët janë plotësisht të paaftë të kryejnë aktivitetet e jetës së përditshme pa marrë kujdes nga një person tjetër, duke përjashtuar kështu shumicën e fëmijëve me aftësi të kufizuara.

**280.** Disa shërbime, të tilla si kujdesi familjar për fëmijët pa kujdes prindëror, nuk janë në dispozicion në të gjitha komunat, pavarësisht detyrimeve ligjore që secila prej tyre të krijojë tri familje kujdestare. Shumë komuna nuk e kanë përmbushur këtë kërkesë dhe mungojnë familje kujdestare të specializuara që mund t'i adresojnë nevojat specifike (siç janë ato për fëmijët me aftësi të kufizuara), duke çuar në boshllëqe të konsiderueshme në qasjen dhe cilësinë e shërbimeve.<sup>383</sup>

**281.** Fëmijët nga komunitetet jo-shumicë janë fëmijët në pozicionin më të cenueshëm në aspektin social, ekonomik dhe kulturor. Pabarazitë në lidhje me qasjen në kujdesin shëndetësor themelor, arsim dhe kulturë mbeten ende të përhapura, pjesërisht për shkak se komunitetet romë dhe ashkali diskriminohen vazhdimisht. Institucionet publike nuk kanë bërë mjaftueshëm përtej dispozitave legjislative drejt veprimeve sociale dhe programeve të gjithëpërfshirjes.<sup>384</sup> Pavarësisht disa përmirësimeve në periudhën raportuese, fëmijët nga grupet e cenueshme dhe komunitetet jo-shumicë vazhdojnë të jenë të marginalizuar kur bëhet fjalë për mundësitë e arsimit, në veçanti, fëmijët nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian. Disa qendra arsimore janë mbyllur për shkak të varësisë së tyre të madhe nga mbështetja financiare e jashtme dhe MASHTI duhet të sigurojë që këto qendra të vazhdojnë të funksionojnë dhe të jenë të pajisura me burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare.<sup>385</sup>

380 Terre des Hommes Kosova (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

381 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 73.

382 Save the Children Kosova/o (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

383 Save the Children Kosova/o (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

384 Kosova 2.0, [Ndihmë e vogël për të varfrit](#).

385 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 74.

**282.** Fenomeni i martesave të hershme vazhdon të jetë i përhapur dhe ndikon në jetën dhe arsimimin e fëmijëve në Kosovë, veçanërisht në mesin e komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptian.<sup>386</sup> Sipas Raportit të BE-së për Kosovën, Qeveria e Republikës së Kosovës tregoi përkushtim duke krijuar një grup ndërinstitucional pune për parandalimin e martesave të hershme të komunitet rom, ashkali dhe egjiptian.<sup>387</sup>

**283.** Në tetor 2024, zyra e UNICEF-it në Kosovë publikoi një raport ekskluziv rreth efekteve të krizës klimatike në të drejtat e fëmijëve në Kosovë.<sup>388</sup> Analiza zbulon një gamë komplekse dhe alarmante rreziqesh që lidhen me klimën dhe mjedisin, të cilat kërcënojnë sigurinë, shëndetin dhe mirëqenien e përgjithshme të fëmijëve. Të gjitha rajonet e Kosovës shënuan rezultate “të larta” ose “jashtëzakonisht të larta” në aspektin e ekspozimit të përgjithshëm ndaj rreziqeve mjedisore, duke i bërë fëmijët e Kosovës “ndër më të ekspozuarit ndaj rreziqeve klimatike në Evropë”, një çështje që rrjedh nga nivelet e larta të cenueshmërisë si rezultat i varfërisë. Shkakët kryesore të vdekjes tek fëmijët mbeten të lidhura ngushtë me ndryshimet klimatike dhe mjedisin, me infeksionet e traktit të poshtëm respirator që përkeqësohen nga temperaturat ekstreme, ndotja e ajrit dhe mungesa e qasjes në ujë të pijshëm. Këto sfida theksojnë nevojën urgjente për veprime të koordinuara për t’i mbrojtur burimet kombëtare të Kosovës dhe për të siguruar një të ardhme të qëndrueshme për qytetarët më të rinj të vendit.<sup>389</sup>

## 284. Rekomandime

- QeK duhet t’i japë përparësi të drejtave të fëmijëve si prioritet politik, duke siguruar që politikat, buxhetet dhe strategjitë në të gjithë sektorët të integrojnë një qasje me fokus të fëmija;
- Duhet bërë përpjekje më të mëdha për të rritur pjesëmarrjen e fëmijëve në vendimmarrje si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë lokal. Kjo përfshin krijimin e mundësive të sigurta, kuptimplota dhe të strukturuara për fëmijët dhe grupet e udhëhequra nga fëmijët për të shprehur pikëpamjet e tyre, duke siguruar që ata të konsultohen përmes mekanizmave adekuat për fëmijët dhe duke garantuar që mendimet e tyre vërtet të merren parasysh në proceset e politikbërjes dhe vendimmarrjes;
- Ministria e Drejtësisë duhet t’i rrisë alokimet buxhetore për shërbimet sociale dhe familjare në nivel qendror dhe lokal, duke përfshirë programet e mbrojtjes së fëmijëve, për të siguruar ofrimin e shërbimeve të qëndrueshme dhe me cilësi të lartë;
- Ministria e Drejtësisë duhet të forcojë zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen e Fëmijëve duke krijuar Shtëpitë për Mbrojtjen e Fëmijëve;
- ZQM-ja duhet të sigurojë funksionimin e duhur të një linje telefonike falas për fëmijët, duke siguruar raportim dhe reagim efektiv ndaj dhunës, abuzimit, neglizhencës dhe trafikimit;

386 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 36.

387 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 38.

388 UNICEF-i në Kosovë (2024), [Një Analizë e Peizazhit Klimatik për Fëmijë](#).

389 UNICEF-i në Kosovë (2024), [Një Analizë e Peizazhit Klimatik për Fëmijë](#).



- Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të hartojë një Strategji gjithëpërfshirëse për Fuqizimin e Familjes për t'i adresuar sfidat ekonomike dhe sociale, duke siguruar qasje të barabartë në shërbimet mbështetëse dhe duke rritur mirëqenien e familjes;
- Kuvendi i Kosovës duhet ta miratojë Ligjin për Skemën e Ndhmës Sociale pa vonesa të mëtejshme.

### 7.3 Të drejtat e të rinjve

**285.** Kushtetuta e Kosovës nuk i përmend të rinjtë dhe të drejtat e tyre në tekst specifikisht. Ajo vetëm përcakton të drejtën për të votuar si në zgjedhjet lokale ashtu edhe në ato të përgjithshme nga mosha 18 vjeç. Ligji i ri Nr. 08/L-264 për Rininë hyri në fuqi në gusht të vitit 2024, me qëllim rregullimin e fushës së të rinjve në nivel ndërinstitucional dhe ndërsektorial, duke i vendosur të rinjtë në qendër të prioritetëve shtetërorë.<sup>390</sup> Me këtë ligj krijohet "Komisioni Shtetëror për Rininë", si mekanizëm i lartë koordinues ndërinstitucional për zbatimin e politikave rinore. Komisioni në fjalë krijohet me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe drejtohet nga Kryeministri, ndërsa përfaqësuesi i "Këshillit Qendror Rinor" merr pjesë në mbledhjet e Komisionit dhe ka një rol këshillues, avokues dhe monitorues. Komisioni do të mbajë mbledhje dy herë në vit dhe, ndër të tjera, do të përcaktojë prioritetet rinore aty ku nevojiten masa; do të propozojë krijimin e grupeve të ndryshme ndërsektoriale të punës të nevojshme për t'u marrë me çështje specifike rinore; do të koordinojë institucionet dhe mekanizmat që kanë ndikim në sektorin e rinisë dhe do të raportojë mbi zbatimin e politikave rinore, duke përfshirë Strategjinë Shtetërore për Rininë dhe miratimin e planit vjetor të Strategjisë.

**286.** Sipas Strategjisë së re për Rininë që mbulon periudhën 2024-2032, Qeveria e Republikës së Kosovës do të angazhohet më tej për fuqizimin e nevojave të individëve të Kosovës, duke siguruar realizimin e nevojave, të drejtave dhe potencialit të tyre njerëzor. Strategjia synon integrimin e të rinjve në shoqëri dhe fuqizimin e tyre si kontribues në një shoqëri gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.<sup>391</sup> Strategjia është në fuqi, por nuk ka përditësime zyrtare nga MKRS-ja në lidhje me zbatimin e saj praktik ose plane specifike veprimi të miratuara me qëllim të zbatimit të saj.

**287.** Ligji i ri për Rininë i vitit 2024 parasheh një Këshill Qendror Rinor si një grup këshillues, avokues dhe monitorues për çështjet rinore, i cili shërben si një platformë për bashkëpunim midis Qeverisë së Republikës së Kosovës, këshillave lokale, organizatave rinore dhe grupeve joformale rinore. Mbetet për t'u parë nëse korniza e re legislative, e shoqëruar nga një Strategji e re për Rininë, do të jetë në gjendje të rrisë mbrojtjen dhe zhvillimin e të drejtave të të rinjve.

**288.** Kosova është bërë zyrtarisht anëtare e Shoqatës Evropiane të Kartës Rinore (EYCA), organizatë ndërkombëtare me seli në Bruksel që lëshon Kartën Evropiane Rinore në mbi 30 vende evropiane.<sup>392</sup> Iniciativa përputhet me rritjen e mobilitetit së të rinjve në Evropë, e mbështetur nga masa të tilla si Young Cells Scheme, bursat e Ministrisë së Arsimit dhe grantet e mobilitetit të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, duke ofruar mundësi të shumta për përvoja arsimore, konkur-

<sup>390</sup> Kuvendi i Kosovës (2024), Ligji Nr. 08/L-264 për Rininë.

<sup>391</sup> MKRS (2023), [Strategjia shtetërore për rininë \(2024-2033\)](#).

<sup>392</sup> MKRS (2024), [Tashmë zyrtare: Kosova anëtare në EYCA - European Youth Card Association](#).

ruese dhe profesionale për të rinjtë në Kosovë. Të pajisur me kartën rinore, të rinjtë e Kosovës do të gëzojnë mundësi dhe përfitime të barabarta së bashku me bashkëmoshatarët e tyre evropianë. Në nëntor të vitit 2024, u publikua një thirrje për aplikime për Raundin XV të Young Cells Scheme.<sup>393</sup>

**289.** Papunësia tek të rinjtë mbetet një problem me pasoja të konsiderueshme në shkallë të gjerë për zhvillimin socio-ekonomik të rajonit me një shkallë punësimi prej vetëm 20.4 përqind.<sup>394</sup>

**290.** Pas miratimit të Planit të Zbatimit të Garancive Rinore, Kosova nisi një pilotim të Skemës së Garancive Rinore në dy komuna në janar 2024. Sipas raportit të Komisionit të BE-së për Kosovën, Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të përgatitet për një zbatim të plotë të Skemës së Garancive Rinore bazuar në mësimet e nxjerra gjatë fazës pilotuese dhe të vazhdojë ta forcojë qeverisjen e Arsimit dhe Aftësisimit Profesional (AAP-së) dhe cilësinë e AAP-së për profesionet që kërkohen për Garancinë Rinore.<sup>395</sup>

**291.** Në përputhje me Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike në të cilën Qeveria e Republikës së Kosovës u garantoj të rinjve «punën e parë, të subvencionuar nga shteti në nivelin e pagës minimale»,<sup>396</sup> Qeveria e Republikës së Kosovës lansoi platformën “Superpuna”, një iniciativë kyçe që synon adresimin e papunësisë së të rinjve dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik. Platforma, e menaxhuar nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (MFPT), jep një subvencion prej 264 eurosh përveç pagës minimale për gjashtë muajt e parë të punësimit. Platforma “Superpuna” vazhdoi të funksionojë në vitin 2024 dhe është zgjeruar në grupmoshën 18-29 vjeç krahasuar me fazën fillestare që ofrohej vetëm për të rinjtë e moshës 18-25 vjeç.<sup>397</sup> Megjithatë, pavarësisht historive të shumta pozitive të të rinjve që janë angazhuar në tregun e punës, Kallxo.com publikoi një numër dëshmish anonime të të rinjve që janë ankuar për platformën “Superpuna”, duke pretenduar se nuk po i marrin pagat e tyre nga MFPT (me një të anketuar që deklaroi se nuk e kishte marrë pagën e tij edhe pas 5 muajsh nga përfundimi i punës së tij).<sup>398</sup>

**292.** Në vitin 2024, OJQ Qendra Kosovare për Studime Gjinore (QKSGJ) publikoi një analizë të titulluar “Përmirësimi i Efektivitetit të Platformës Superpuna për t’i Adresuar Nevojat e Grave Rome, Ashkallike dhe Egjiptiane”, duke theksuar domosdoshmërinë e rishikimit të kriterëve të përshtatshmërisë, zgjerimit të shtrirjes së aktiviteteve dhe integritetit të një qasjeje ndërsektori-ale. Studimi theksoi se këto masa janë thelbësore që Superpuna të evoluojë në një program më gjithëpërfshirës dhe me ndikim, duke kontribuar ndjeshëm në fuqizimin e komuniteteve të marginalizuara në Kosovë.<sup>399</sup>

**293.** Kosova ka një përqindje të lartë (39.8 përqind) të rinisë që nuk është e angazhuar në asnjë program arsimor. Kjo vjen si pasojë e një angazhimi të ulët në arsimin e lartë si rezultat i faktorëve

393 Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë (2024), [Thirrje për Aplikime – Raundi XV i Young Cells Scheme](#).

394 ASK (2024), [Tregu i punës](#).

395 Komisioni i BE-së (2024), Raporti mbi Kosovën 2024, f. 16.

396 Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve (2021), [Pakoja e Rimëkëmbjes Ekonomike](#).

397 Radio Evropa e Lirë (2024), [Qeveria e Kosovës zgjeron skemën Superpuna](#).

398 Kallxo (2024), [Ankesa për platformën “Superpuna”, nuk po ju dalin pagat](#).

399 Qendra Kosovare për Studime Gjinore (2024), [Rritja e efektivitetit të platformës Superpuna për t’i adresuar nevojat e grave rome, ashkallike dhe egjiptiane](#).

socialë, duke përfshirë vështirësitë ekonomike, shkallët e larta të papunësisë dhe financimin e kufizuar publik për arsimin. Në veçanti, shkalla më e ulët e angazhimit të Kosovës në arsimin e lartë lidhet edhe me situatën e saj unike politike dhe ekonomike. Vetëm 26.7 përqind e të rinjve në Kosovë punojnë në profesionin e tyre, ndërsa një shifër marramendëse prej 81.7 përqind e të rinjve të mbiarsimuar në Kosovë punojnë jashtë profesionit të tyre.

**294.** Profili i të rinjve që synojnë të emigrojnë ka ndryshuar me kalimin e viteve: Në vitin 2018, kjo përfshinte individë me kushte më të dobëta socio-ekonomike, ndërsa në vitin 2024 statusi socio-ekonomik nuk luan një rol të rëndësishëm. Në Kosovë, dëshira për t'u larguar nga vendi është e lidhur pozitivisht me rreziqet (në tregun e punës dhe strehimin). Megjithatë, studimi i FES vuri në dukje gjithashtu se të rinjtë (përfshirë ata nga Kosova) po kalojnë një kohë më të gjatë jashtë vendit për qëllime të tjera përveç emigrimit.<sup>400</sup>

**295.** Sipas një raporti të publikuar nga OJQ YIHR KS në tetor 2024, të rinjtë në Kosovë demonstrojnë një vetëdije të fortë dhe konsensus mbi domosdoshmërinë e ndjekjes penale të krimeve të luftës, pavarësisht nga identiteti etnik i viktimave ose i autorëve të krimeve. Studimi zbuloi se shumica e të anketuarve/ave (65.5 përqind) posedojnë një nivel të caktuar njohurish rreth krimeve të luftës. Konkretisht, 18.3 përqind raportuan se kishin shumë njohuri, ndërsa 54.1 përqind treguan se kishin njohuri të mjaftueshme. Kjo vetëdije ndikohet ndjeshëm nga bisedat me anëtarët e familjes, veçanërisht prindërit, të cilët shërbejnë si burime kryesore informacioni rreth luftës.<sup>401</sup> Ekziston një konsensus i fortë midis të rinjve se krimet e luftës duhet të ndiqen penalisht, pavarësisht nga prejardhja etnike e viktimave ose autorëve të krimeve. Kjo pasqyron një qëndrim të unifikuar midis grupeve të ndryshme etnike, duke theksuar rëndësinë e drejtësisë pas konfliktit.<sup>402</sup>

**296.** Për më tepër, raporti i OJQ YIHR KS konfirmon se memoria kolektive e ngjarjeve që lidhen me luftën ka një ndikim të thellë në qëndrimet e të rinjve kosovarë në lidhje me pikëpamjet e tyre mbi pajtimin ndëretnik dhe ndërveprimin ndëretnik.<sup>403</sup> Anketa nxjerr në pah dallime të dukshme në qëndrimet midis të rinjve shqiptarë dhe serbë në lidhje me luftën, ndjekjen penale të krimeve të luftës dhe rolin e të rinjve në përpjekjet e pajtimit. Pavarësisht dallimeve të perceptuara, ekziston një pajtim i përgjithshëm mbi nevojën për veprime të drejtësisë tranzicionale për t'i përmirësuar marrëdhëniet ndëretnike.<sup>404</sup> Shumë të anketuar/a shprehën pakënaqësi me mënyrën se si shkollat i trajtojnë ngjarjet e luftës, duke treguar një nevojë urgjente për përmirësimin e arsimit mbi këtë temë. Ky boshllëk në arsim mund të pengojë zhvillimin e një të riu/reje të informuar mirë, të aftë për t'u angazhuar në dialog konstruktiv rreth së kaluarës.<sup>405</sup>

## 297. Rekomandimet

- Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) duhet të sigurojë zbatimin e plotë të Ligjit për Rininë dhe Strategjisë Shtetërore për Rininë (2024-2032) duke zhvilluar plane të qarta veprimi, duke vendosur objektiva të matchëm dhe duke krijuar mekanizma të fuqishëm monitorimi për të ndjekur progresin dhe ndikimin;

400 Friedrich-Ebert-Stiftung (2024), [Studimi i të Rinjve në Evropën Juglindore 2024](#).

401 YIHR KS (2024) [Qëndrimet e të rinjve ndaj luftës dhe krimeve të luftës në Kosovë](#), f. 6.

402 YIHR KS (2024) [Qëndrimet e të rinjve ndaj luftës dhe krimeve të luftës në Kosovë](#), f. 31-37.

403 YIHR KS (2024) [Qëndrimet e të rinjve ndaj luftës dhe krimeve të luftës në Kosovë](#), f. 37.

404 YIHR KS (2024) [Qëndrimet e të rinjve ndaj luftës dhe krimeve të luftës në Kosovë](#), f. 11 dhe 37.

405 YIHR KS (2024) [Qëndrimet e të rinjve ndaj luftës dhe krimeve të luftës në Kosovë](#), f. 31-37.

- Ministria e Financave duhet t'i rishikojë kriteret e pranueshmërisë së platformës Superpuna për t'i akomoduar më mirë gratë rome, ashkallike dhe egjiptiane;
- MASHTI duhet t'i forcojë programet e arsimit dhe trajnimit profesional dhe të zgjerojë ndihmën financiare për arsimin e lartë për ta adresuar përqindjen e lartë të të rinjve që nuk janë të angazhuar në arsim ose punësim;
- MKRS-ja duhet t'i integrojë dialogun ndërtnik, bashkëjetesën multikulturore dhe programet e pajtimit në kurrikulat shkollore dhe aktivitetet jashtëshkollore për të nxitur kohezionin shoqëror afatgjatë dhe ndërtimin e paqes.

#### 7.4. Të drejtat e personave me aftësi të kufizuara

**298.** Korniza legjislativë që lidhet me të drejtat e njeriut të personave me aftësi të kufizuara në Kosovë përbëhet nga garancitë kushtetuese së bashku me ligje dhe rregullore të shumta në të cilat bëhet referencë specifike për këtë segment të popullsisë. Një pjesë e kornizës legjislativë përmes së cilës mbrohen të drejtat e personave me aftësi të kufizuara është Ligji Nr. 2003/23 për Pensionet e Personave me Aftësi të Kufizuara dhe Ligji Nr. 03/L-022 për Mbështetjen Materiale për Familjet e Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara të Përhershme. Dy ligje të tjera që mbështesin personat me aftësi të kufizuara janë Ligji Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik dhe Ligji Nr. 04/L-092 për Personat e Verbër. Një pjesë e kornizës ligjore të Kosovës pasqyron Konventën e Kombeve të Bashkuara për Personat me Aftësi të Kufizuara (CRPD), por ajo ende nuk është përfshirë në Kushtetutë si një instrument ndërkombëtar i zbatueshëm drejtpërdrejt për të drejtat e njeriut sipas nenit 22. Kosova gjithashtu ka miratuar një vizion gjithëpërfshirës të përqendruar në promovimin e të drejtave dhe kushteve dhe lehtësirave të këtij komuniteti në Strategjinë për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (2013-2023). Edhe pse Zyra për Qeverisje të Mirë ka planifikuar të zhvillojë një strategji të re e cila do të fillojë brenda vitit 2024, një strategji e tillë nuk është miratuar gjatë 2024.

**299.** Legjislacioni i Kosovës bazohet në mënyrë të nënkuptuar në instrumentet evropiane dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, por i mungon një harmonizim i formuluar siç duhet dhe i qartë. Në Nenin 22 të Kushtetutës, një numër instrumentesh kyçe të të drejtave të njeriut shërbejnë si bazë për ligjet dhe rregulloret lokale, por Konventa e Kombeve të Bashkuara për Personat me Aftësi të Kufizuara (CRPD) nuk përfshihet në mesin e tyre. Sipas OJQ HANDIKOS, përfshirja e CRPD-së është thelbësore nëse qëllimi është të arrihen parakushtet themelore që personat me aftësi të kufizuara të jetojnë një jetë normale dhe dinjitoze.<sup>406</sup>

**300.** Lidhur me këtë, Gjykata Kushtetuese e Kosovës nxori një vendim (Rasti KO 207/22) mbi përputhshmërinë e amendamentit kushtetues të propozuar për të shtuar CRPD-në në listën e marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërdrejt në Kosovë. Gjykata e shpalli kërkesën të pranueshme dhe vendosi unanimisht se amendamenti i propozuar, pra përfshirja e CRPD-së në nenin 22 të Kushtetutës, nuk i cenon të drejtat dhe liritë themelore të

garantuara nga Kapitulli II dhe III i Kushtetutës. Vendimi vuri në pah parimet e Konventës së OKB-së, duke theksuar të drejtat që lidhen me dinjitetin, autonominë, mosdiskriminimin, pjesëmarrjen e plotë dhe detyrimet pozitive për zbatim.<sup>407</sup> Në tetor të vitit 2023, Kuvendi i Kosovës u përpoq ta ndryshonte Kushtetutën për ta përfshirë CRPD-në në nenin 22, por për shkak të arsyeve politike, ndryshimi nuk mundi të bëhej sepse deputetët e Kuvendit të Kosovës nga komuniteti serb nuk ishin të pranishëm për të dhënë votën e tyre.<sup>408</sup> Në vitin 2024, nuk u bënë përpjekje për ta ndryshuar Kushtetutën dhe për ta shtuar CRPD-në, pavarësisht miratimit të dhënë nga Gjykata Kushtetuese që nga gushti i vitit 2023.

**301.** OJQ HANDIKOS thekson se Kushtetuta e Kosovës nuk ka ndonjë përcaktim të veçantë për personat me aftësi të kufizuara. Nga ana tjetër, një numër i konsiderueshëm ligjesh mbrojnë dhe promovojnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, duke përfshirë qasjen e barabartë në kujdesin shëndetësor, mjedisin fizik dhe shoqëror gjithëpërfshirës dhe sensitiv ndaj aftësisë së kufizuar, qasjen në arsim cilësor dhe mundësi të barabarta në punësim. Megjithatë, sipas OJQ HANDIKOS, këto ligje përmbajnë terminologji që është në kundërshtim me Kushtetutën.<sup>409</sup>

**302.** Pikërisht në kontekstin e ankesave për infrastrukturën dhe ankesave të tjera që rrjedhin nga të gjitha format e diskriminimit ndaj personave me aftësi të kufizuara, që nga viti 2018 janë ngritur pesë padi kundër institucioneve të ndryshme.<sup>410</sup> Deri më tani, vetëm dy padi kanë përfunduar në shkallën e parë në favor të paditësve dhe tani janë në Gjykatën e Apelit. Katër rastet e tjera nuk janë shqyrtuar ende nga gjykatat themelore. Shumë persona me aftësi të kufizuara kanë paraqitur ankesa kundër komisioneve të vlerësimit përgjegjëse për përcaktimin e të drejtës për pensione për persona me aftësi të kufizuara. Këto komisione janë kritikuar për mungesë profesionalizmi dhe njohuri të pamjaftueshme të legjislacionit përkatës, duke nxjerrë shpesh vendime që bien ndesh me dispozitat ligjore dhe nuk arrijnë të mbështesin të drejtat e garantuara me ligj. Pas shumë ankesave të paraqitura nga OJQ HANDIKOS, Qeveria e Republikës së Kosovës ka krijuar një komision të ri në fund të vitit 2024.<sup>411</sup>

**303.** Pavarësisht rëndësisë së tyre thelbësore, sistemi i kujdesit shëndetësor dhe shërbimet sociale në nivel institucional nuk i adresojnë në mënyrë të mjaftueshme nevojat themelore të individëve me aftësi të kufizuara. Paradoksi shtrihet përtej trajtimit të pabarabartë dhe diskriminues që ata marrin nga personeli i kujdesit shëndetësor. Përveç kësaj, mungojnë mekanizmat që sigurojnë shërbime të menjëhershme shëndetësore për personat me aftësi të kufizuara. Si pasojë, OJQ HANDIKOS thekson se personat me aftësi të kufizuara janë të detyruar të kërkojnë ndihmë nga qendrat private mjekësore apo edhe jashtë vendit, duke u përballur me shpenzime të konsiderueshme financiare. Lidhur me këtë, një person me aftësi të kufizuara ngriti një padi për mbrojtje nga diskriminimi në vitin 2018 kundër Qendrës Klinike Universitare të Kosovës, por çështja nuk mori epilog deri në vitin 2023. Në vitin 2023, paditësi ndërroi jetë. Gjykatat nuk ishin në gjendje të mbanin një seancë dëgjimore ose të jepnin një përfundim të përshtatshëm për rastin. Për më tepër, çdo ditë raportohen vështirësi në blerjen e ilaçeve nga personat me aftësi të kufizuara në mungesë të sigurimit shëndetësor dhe për shkak të pensioneve të ulëta.<sup>412</sup>

407 Gjykata Kushtetuese (2023), [Njoftim mbi vendimin në Rastin KO 207/22](#).

408 HANDIKOS (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

409 HANDIKOS (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

410 HANDIKOS(2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

411 HANDIKOS(2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

412 HANDIKOS(2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.



**304.** Ekzistojnë pengesa të konsiderueshme për sa i përket lëvizjes dhe barriera fizike për personat me aftësi të kufizuara, të cilët kanë nevojë për produkte ndihmëse si karroca, paterica, asistencë përmes kafshëve, asistencë njerëzore, etj. Megjithatë, sipas OJQ HANDIKOS, Qeveria e Republikës së Kosovës nuk i mbulon ose nuk ofron produkte për lehtësimin e lëvizjes. Përkundrazi, të gjitha këto produkte ofrohen falas nga shoqatat, pavarësisht rregulloreve që kërkojnë që Qeveria e Kosovës t'i ofrojë këto pajisje.

**305.** Gjatë periudhës së raportimit, HANDIKOS ngriti shqetësime se institucionet publike marrin vendime të shpejta për çështjet që prekin personat me aftësi të kufizuara pa kryer analiza para-prake thelbësore. Skenarë të tillë shpesh kanë rënë në kundërshtim legjislationin primar dhe sekondar, duke krijuar kështu shkelje të të drejtave për personat e prekur. Për më tepër, në rastet e konsultimeve publike, si dhe në rastet kur janë bërë kufizime mbi disa të drejta të personave me aftësi të kufizuara, OJQ-të kanë ngritur shqetësimet e tyre përmes reagimeve dhe takimeve me institucionet. Megjithatë, këto shqetësime nuk janë marrë në konsideratë nga Qeveria e Kosovës. Strategjia dhe Plani i Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara ende nuk është finalizuar, edhe pse ka kaluar më shumë se një vit që kur kjo strategji do të duhej të hynte në fuqi.<sup>413</sup>

**306.** Në vitin 2024, OJQ HANDIKOS dhe OJQ Save the Children Kosova/o publikuan një dokument të titulluar: "Analizë mbi Perspektivën e Aftësisë së Kufizuar dhe Perspektivën Gjinore në Kosovë".<sup>414</sup> Ndër gjetjet kryesore të kësaj analize janë si më poshtë: (i) Ligji për Barazinë Gjinore nuk parasheh masa specifike për të siguruar mundësi të barabarta në punësim dhe trajnim për individët me aftësi të kufizuara; (ii) gratë me aftësi të kufizuara përballen me dyfish më shumë pengesa në diskriminim; (iii) politikat dhe programet për ta promovuar pavarësinë ekonomike në mesin e grave paraplegjike dhe tetraplegjike janë të pakta dhe të pamjaftueshme; (iv) legjislationi në Kosovë nuk rregullon në mënyrë të detajuar qasjen e barabartë në kujdesin shëndetësor për gratë dhe vajzat me aftësi të kufizuara; (v) politikat për mbrojtjen nga diskriminimi shpesh nuk përfshijnë masa të detajuara për t'i mbrojtur në mënyrë efektive nga dhuna dhe diskriminimi gratë me aftësi të kufizuara; (vi) Strategjia Kombëtare kundër Dhunës në Familje dhe Dhunës ndaj Grave 2022-2026 nuk përfshin trajnime për profesionistët shëndetësorë dhe ata nga sektori i drejtësisë dhe shërbimeve sociale se si të trajtohen nevojat specifike të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara; (vii) ka mungesë përfshirjeje të grave dhe vajzave me aftësi të kufizuara në proceset e hartimit dhe zbatimit të politikave dhe strategjive për mbrojtje nga dhuna, duke i anashkaluar kështu pikëpamjet e tyre.<sup>415</sup>

**307.** Ekzistojnë disa raste ku qytetarët me aftësi të kufizuara pretendojnë se janë diskriminuar në punësim. Disa prej tyre, si Metie Kastrati, kanë vendosur ta padisin Qeverinë e Kosovës për mosfrimin e punësimit pavarësisht se kanë kaluar të gjitha procedurat e konkursit. Rasti i saj është ende në pritje të shqyrtimit në gjykatat e rregullta në vitin 2024.<sup>416</sup> Ligji për Aftësimin Profesional, Rehabilitimin dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara ka përcaktuar se cilët punëdhënës duhet të punësojnë persona me aftësi të kufizuara, siç janë institucionet e administratës publike,

413 HANDIKOS (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

414 HANDIKOS dhe Save the Children (2024), [Analizë mbi perspektivën e aftësisë së kufizuar dhe perspektivës gjinore në Kosovë](#).

415 HANDIKOS dhe Save the Children (2024), [Analizë mbi perspektivën e aftësisë së kufizuar dhe perspektivës gjinore në Kosovë](#)

416 Tëvë1 (2024), [Sfidat e personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë e Shqipëri](#).

punëdhënësit nga sektori privat dhe sektori i OJQ-ve (në rrethana specifike). Megjithatë, ka raporte të gjera dhe të besueshme që pohojnë se ky Ligj nuk zbatohet në praktikë, madje as nga institucionet publike.<sup>417</sup> Në praktikë, OJQ HANDIKOS vë në pah se vetëm një numër i vogël vendesh të lira pune i janë ofruar shprehimisht kësaj kategorie punonjësish për të aplikuar. Në realitet, individët me aftësi të kufizuara shpesh e gjejnë veten në disavantazh në krahasim me kolegët e tyre, pasi aftësia e kufizuar tenton të ndikojë negativisht në mundësitë e tyre të punësimit.<sup>418</sup>

**308.** Miratimi nga Qeveria e Kosovës i projektligjit për Vlerësimin, Trajtimin dhe Statusin e Personave me Aftësi të Kufizuara, dhe Shërbimet dhe Përfitimet për ta konsiderohet si i "vonuar".<sup>419</sup> Një rregullore e re e miratuar në korrik 2024 pritet ta përmirësojë llogaridhënien e Komisionit për Vlerësimin dhe Njohjen e Statusit dhe të Drejtave të Personave Paraplegjikë dhe Tetraplegjikë, si dhe të eliminojë rivlerësimin e panevojshëm të aftësisë së kufizuar.<sup>420</sup> Mbetet për t'u parë nëse në praktikë personat që kanë nevojë për kujdestarë personalë dhe socialë do të jenë në gjendje ta realizojnë të drejtën e tyre. Në gusht 2024, Qendra për Raste Gjyqësore Strategjike në Kosovë paraqiti një kërkesë urgjente pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë në lidhje me çështjen e tyre të pazgjidhur mbi të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të paraqitur kundër Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve në vitin 2023. Sipas Qendrës për Raste Gjyqësore Strategjike, e cila është pjesë e OJQ Grupi për Studime Juridike dhe Politike (GLPS), Gjykata Themelore në Prishtinë nuk ka ndërmarrë asnjë hap procedural që prej më shumë se një viti nga momenti kur është paraqitur kërkesa.<sup>421</sup> Rasti është i natyrës urgjente pasi lidhet me mohimin e të drejtës së një qytetari për kompensim mujor dhe kujdes personal në përputhje me të drejtën e garantuar me Ligjin Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik.

**309.** Vlen të rikujtojmë se në vitin 2022, Komisioni për Shëndetësi kreu një rivlerësim të të drejtës për kompensim financiar dhe shërbime sociale, siç përcaktohet në Ligjin Nr. 05/L-067 për Statusin dhe të Drejtat e Personave Paraplegjik dhe Tetraplegjik. Ky proces çoi në përjashtimin e një numri të konsiderueshëm individësh që më parë u ishte njohur statusi me të drejtë sipas këtij ligji. Përafërsisht 30,000 individë iu nënshtruan një rivlerësimi të gjendjes së tyre gjatë vitit, duke ndjekur procedurat e përcaktuara nga rregulloret e Komisionit të Shëndetësisë. Si rezultat, Avokati i Popullit, në një raport të dhjetorit 2023, ngriti shqetësime në lidhje me mungesën e bazës ligjore për rivlerësime të tilla dhe i inkurajoi institucionet ta përmirësojnë Rregulloren Nr. 07/2017. OJQ HANDIKOS pohon se të drejtat e individëve me aftësi të kufizuara nuk duhet t'i nënshtrohen rivlerësimeve, pasi kushtet e tyre nuk përmirësohen. Si rrjedhim i këtyre shkeljeve, HANDIKOS i dërgoi disa raste Departamentit Administrativ të Gjykatës Themelore në Prishtinë, ku ato aktualisht janë ende nën vlerësim. Pasoja kritike e kësaj situatë është marginalizimi i shtuar socio-ekonomik i individëve të prekur, të cilët tani janë të privuar nga kompensimi financiar thelbësor për shpenzimet e tyre themelore të jetesës dhe nevojat mjekësore. E drejta e individëve për të mos iu nënshtruar rivlerësimeve të pajustificuara duhet të mbrohet për të parandaluar dëme të mëtejshme dhe për të siguruar qasjen e tyre në mbështetje thelbësore.<sup>422</sup>

417 Tëvë1 (2024), [Sfidat e personave me Aftësi të Kufizuara në Kosovë e Shqipëri](#); shih gjithashtu, Forumi Kosovar i Aftësisë së Kufizuar, [Niveli i Zbatimit të Strategjisë Nacionale për Personat me Aftësi të Kufizuar](#).

418 HANDIKOS (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

419 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 37.

420 Gazeta Zyrtare (2024), [Rregullorja \(QRK\) nr. 23/2024 mbi Procedurat dhe Kriteret për vlerësimin dhe njohjen e statusit dhe të drejtave të personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë](#).

421 Qendra për Raste Gjyqësore Strategjike në Kosovë (2024), [Mohimi i të drejtës së personave paraplegjik dhe tetraplegjik për kompensim dhe kujdestarë personal](#).

422 HANDIKOS (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

### 310. Rekomandimet

- Qeveria e Kosovës duhet të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përfshirë Konventën e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (CRPD) në Nenin 22 të Kushtetutës, duke siguruar që ajo të bëhet një instrument drejtpërdrejt i zbatueshëm i të drejtave të njeriut në Kosovë;
- Ministria e Financave duhet të sigurojë që komisionet për vlerësimin e të drejtës për pensione të personave me aftësi të kufizuara të përbëhen nga profesionistë të kualifikuar me njohuri solide të legjislacionit përkatës;
- Ministria e Shëndetësisë duhet të garantojë që personat me aftësi të kufizuara të kenë qasje në shërbime shëndetësore cilësore dhe me kosto të përballueshme, duke përfshirë medikamentet e nevojshme, pajisjet ndihmëse dhe shërbimet e rehabilitimit;
- MASHTI duhet ta përmirësojë arsimin gjithëpërfshirës duke siguruar që shkollat të jenë fizikisht të qasshme, duke ofruar trajnime të specializuara për edukatorët mbi metodat e mësimdhënies që janë sensitive ndaj aftësisë së kufizuar.

## 7.5. Të drejtat e komuniteteve jo-shumicë

**311.** Kosova ka institucione të themeluara në nivel qendror dhe komunal, si dhe një kornizë adekuate legjislative, për të garantuar të drejtat e komuniteteve jo-shumicë. Kushtetuta e Kosovës deklaron në nenin 3.1 (Barazia para ligjit) se Kosova “është një shoqëri multietnike e përbërë nga shqiptarët dhe komunitetet e tjera”.<sup>423</sup> Komunitetet jo-shumicë të Kosovës përfshijnë komunitetet Serb, Turk, Rom, Ashkali, Egjiptianë, Boshnjakë dhe Goranë<sup>424</sup> dhe komunitete të tjera. Në Tabelën 5 më poshtë, ilustron përqindja demografike e komuniteteve përkatëse sipas regjistrimit të fundit të popullsisë në vitin 2024.<sup>425</sup> Megjithatë, duhet theksuar se jo të gjithë serbët e Kosovës morën pjesë në regjistrimin e vitit 2024.<sup>426</sup> Sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, ata kanë arritur të regjistrojnë rreth 35-36 mijë serbë të Kosovës që jetojnë kryesisht në jug të Kosovës, duke marrë parasysh se shumica dërrmuese e serbëve që jetojnë në veri të Kosovës nuk kanë marrë pjesë në regjistrim pavarësisht vullnetit të ekipeve të regjistrimit për kryer këtë detyrë me sukses.<sup>427</sup> OSBE-ja dhe mediat serbe kanë shprehur shqetësime se burimet për procesin e regjistrimit të popullsisë ishin të kufizuara, informacioni përkatës nuk ishte i përkthyer gjithmonë në serbisht dhe se përkthimi në serbisht (kur ishte në dispozicion) nuk ishte gjithmonë i saktë.<sup>428</sup>

**312.** Përveç Kushtetutës, të drejtat e komuniteteve jo-shumicë garantohen në Ligjin Nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë. Në këtë ligj, “diversiteti kombëtar, etnik dhe fetar” i Kosovës përkufizohet si “një burim force dhe

423 Kushtetuta e Kosovës (2008).

424 Kushtetuta e Kosovës (2008), Kapitulli III.

425 Agjencia e Statistikave të Kosovës (2024), [Regjistrimi i popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Kosovë 2024](#).

426 Radio Evropa e Lirë (2024), [Lista Serbe: Serbët nuk do të marrin pjesë në regjistrimin e popullsisë së Kosovës](#).

427 Lajmet e Kosovës (2024), [Kastrati nga ASK paralajmëron gjoka ndaj atyre që refuzuan të marrin pjesë në regjistrim të popullsisë](#).

428 Balkan Insight (2024), [Kosovës i bëhet thirrje t'i adresojë shqetësimet rreth regjistrimit të popullsisë pas bojkotit serb](#).

pasurie për zhvillimin e mëtejshëm të një shoqërie demokratike”.<sup>429</sup> Bazuar në këtë kuptim, ligji parasheh masa të veçanta që mund të sigurojnë zbatimin e statusit të barabartë dhe integrimin e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në shoqërinë kosovare. Për më tepër, në Ligjin Nr. 02/L-37 për Përdorimin e Gjuhëve (Ligji i Gjuhëve) shqipja dhe serbishtja kanë statusin e gjuhëve zyrtare.

**313.** Në nivel komune, gjuha e çdo komuniteti jo-shumicë do të ketë statusin e një gjuhe në përdorim zyrtar nëse një komunë banohet nga një komunitet, gjuha amtare e të cilit nuk është gjuhë zyrtare dhe që përbën të paktën 3 përqind të totalit të popullsisë së komunës përkatëse.<sup>430</sup> Përdorimi zyrtar i gjuhës turke dhe rome në Komunën e Prizrenit është një rast ilustrues i këtij ligji në praktikë. E njëjta gjë vlen edhe për gjuhën rome në Graçanicë.

**314.** Probleme me zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve janë identifikuar edhe nga Zyra e Komisionerit të Gjuhëve, në një Raport të vitit 2024 të titulluar: “Zbatimi i Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në Komuna dhe Gjykata Themelore”. Raporti gjeti, ndër të tjera, se: (i) niveli i zbatimit të këtij Ligji në komuna është përkeqësuar që nga viti 2019, ndërsa për gjykatat janë zbuluar vetëm lëshime të vogla; (ii) ka shumë pak përkthyes brenda institucioneve dhe kapacitetet janë në rënie, me shumicën e shërbimeve të përkthimit që kontraktohen nga jashtë; (iii) ka mungesë të buxhetit të veçantë, mungesë të stafit dhe personave të kualifikuar për të kryer shërbime përkthimi, veçanërisht në komuna.<sup>431</sup>

**Tabela 3. Popullsia sipas prejardhjes etnike duke përfshiruar ‘të tjerët’ dhe ‘preferoj të mos përgjigjem’<sup>432</sup>**

| Shqiptarë të Kosovës       | Serbë të Kosovës       | Turq të Kosovës   | Boshnjakë të Kosovës   | Romë të Kosovës       | Ashkali të Kosovës     | Egjiptianë të Kosovës  | Goranë të Kosovës     | Të tjerë              | Gjithsej         |
|----------------------------|------------------------|-------------------|------------------------|-----------------------|------------------------|------------------------|-----------------------|-----------------------|------------------|
| 1,454,963<br>91.76 përqind | 36,625<br>2.31 përqind | 19,419<br>përqind | 26,841<br>1.69 përqind | 8,730<br>0.55 përqind | 16,207<br>1.02 përqind | 10,581<br>0.67 përqind | 9,140<br>0.58 përqind | 2,051<br>0.13 përqind | <b>1,585,566</b> |

**315.** OJQ AKTIV vë në pah se çështja e të drejtave gjuhësore u bë e diskutueshme në veri të Kosovës pas zëvendësimit të tabelave rrugore në gjuhë serbe me tabela rrugore dygjuhëshe (shqip-serbisht), të cilat më pas u vandalizuan. Zëvendësimi i këtyre tabelave, së bashku me një deklaratë nga Ministri i Infrastrukturës që justifikonte heqjen e alfabetit cirilik në përputhje me ligjin e Kosovës, shkaktoi debat të gjerë. Largimi i këtyre tabelave, në kontrast me mungesën e veprimeve të ndërmarra kur emrat serb u dëmtuan më parë, nxiti shumë njerëz në veri të Kosovës të pyesin nëse të drejtat gjuhësore zbatohen vërtet në mënyrë të barabartë apo manipulohen për përfitime politike.

**316.** Fushata e ministrave Elbert Krasniqi dhe Xhelal Sveçla për t’i hequr simbolet serbe, siç janë billbordet në Zveçan dhe në veri të qytetit të Mitrovicës, kontribuoi në përshkallëzimin e tensioneve. Gjersa flamuri serb në majë të Kalasë së Zveçanit mbeti i paprekur, kjo fushatë shkaktoi një cikël heqjeje dhe rivendosjeje të flamurit, duke çuar në një konfrontim në mars të vitit 2024. Një person

429 Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës [Ligji nr. 03/L-047](#).  
430 Ligji për Përdorimin e Gjuhëve [Ligji nr. 02/L-037](#).  
431 Zyra e Komisionerit të Gjuhëve (2024), [Raport mbi Zbatimin e Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve në komuna dhe gjykata themelore](#).  
432 Ngjashëm me regjistrimin e vitit 2011, shumica e serbëve të Kosovës bojkotuan regjistrimin e vitit 2024 në Kosovë. Si rezultat, ende nuk ka të dhëna zyrtare se sa serbë etnikë banojnë në Kosovë (veçanërisht në veri të Kosovës).

që po hiqte flamurin u ndoq nga një grup dhe, megjithëse nuk ndodhi konflikt i drejtpërdrejtë, shtiza e flamurit u dëmtua. Ky incident është bërë një temë e nxehtë, duke treguar se si veprimet e nivelit të lartë mund të ndikojnë në konfliktet lokale dhe të përshkallëzojnë tensionet, duke rrezikuar potencialisht marrëdhëniet dhe sigurinë e komunitetit.<sup>433</sup>

**317.** Në përgjithësi, OJQ Aktiv nuk vërejti përmirësime të rëndësishme në të drejtat e njeriut krahasuar me periudhat e mëparshme. Gjuha e urrejtjes kundër komuniteteve jo-shumicë mbetet e përhapur, me reagime të dobëta institucionale dhe retorikë nxitëse nga zyrtarët e Kosovës që nxisin tensione, veçanërisht në veri të Kosovës. Prania e njësive speciale të policisë në pikat e improvizuara të kontrollit vazhdon të kontribojë në një atmosferë pasigurie. Për shembull, një shofer raportoi se pati një konfrontim të tensionuar me policinë speciale, ku të drejtat e tij gjuhësore nuk u respektuan, pavarësisht garancive kushtetuese për gjuhët serbe dhe shqipe. Kjo nxjerr në pah shkeljet e mundshme të të drejtave të njeriut gjatë aksioneve të policisë.<sup>434</sup> Më 14 maj 2024, një konferencë në veri të Mitrovicës, e thirrur nga Ministri i Punëve të Brendshme, u mbajt pa përkthim në serbisht, duke shkelur të drejtat gjuhësore të garantuara nga Kushtetuta e Kosovës. Vetëm pasi gazetarët i bënë presion Ministrit, ai u përgjigj në serbisht.<sup>435</sup>

**318.** Mekanizmat institucionalë që mbrojnë të drejtat e komuniteteve jo-shumicë në Kosovë bëjnë pjesërisht pjesë në kuadër të Këshillit Konsultativ të Komuniteteve të Zyrës së Presidentit të Kosovës, Zyrave Komunale për Komunitete dhe Kthim, por edhe të Avokatit të Popullit dhe Ministrisë për Komunitete dhe Kthim. Këshilli Konsultativ i Komuniteteve shërben si urë lidhëse midis institucioneve publike të Kosovës dhe komuniteteve. Roli i tij qendror është të artikulojë pikëpamjet e komuniteteve mbi legjislacionin, politikat dhe programet relevante për komunitetet jo-shumicë, të garantojë funksionimin efikas të organizatave përfaqësuese të komuniteteve dhe t'u ofrojë komuniteteve mundësinë për të marrë pjesë në nisma ligjore dhe politike. Përveç Këshillit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka miratuar gjithashtu Strategjinë për Përfshirjen e Komuniteteve Rom dhe Ashkali në Shoqërinë e Kosovës 2022-2026 dhe Strategjinë dhe Planin e Veprimit për 2022-2024.<sup>436</sup>

**319.** Në vitin 2024, Qeveria e Kosovës publikoi raportin e saj mbi zbatimin e Strategjisë së lartpërmendur për komunitetet rom dhe ashkali.<sup>437</sup> Gjetjet dhe përfundimet kryesore të Raportit janë se: (i) ka pasur përparim në integrimin dhe avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Kosovë, në përputhje me Deklaratën e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor mbi Integrimin e Romëve në Procesin e Zgjerimit të BE-së (Deklarata e Poznanit); (ii) miratimi i kuotave të punësimit me Ligjin Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publikë do të sigurojë që anëtarët e këtyre komuniteteve të kenë kuota të garantuara të punësimit; (iii) MASHTI ka bërë "përpjekje maksimale" për të integruar komunitetet rom dhe ashkali, për të siguruar që ata të kenë qasje në arsim, arsim alternativ dhe për të minimizuar braktisjen e shkollës; (iv) platforma kombëtare për mbrojtjen nga diskriminimi

433 AKTIV (2025), Kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

434 AKTIV (2025), Kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

435 AKTIV (2025), Kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

436 Qeveria e Kosovës (2022), [Strategjia për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 dhe Planin e Veprimit 2022-2024](#).

437 Qeveria e Kosovës (2024), [Raport – Zbatimi i Strategjisë për avancimin e komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 si dhe Planin e Veprimit 2022-2024](#).



i këtyre komuniteteve ka qenë një sukses me më shumë se 10 raste diskriminimi që janë duke u hetuar.<sup>438</sup> Megjithatë, Raporti përqendrohet kryesisht në arritjet që Qeveria e Kosovës i konsideron të kenë kontribuar në avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali, por nuk ofron ndonjë kritikë ose informacion në lidhje me objektivat që nuk mund të arrihen dhe arsyet e një dështimi të tillë. Raporti duhet të kishte qenë më i balancuar/transparent dhe të kishte elaboruar më hapur fushat ku Strategjia nuk dha efektet e dëshiruara ose të planifikuara.

**320.** Pas Deklaratës së Poznanit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka krijuar një Grup Teknik për Mbrojtjen nga Diskriminimi të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian. Grupi Teknik është përgjegjës për adresimin e çështjeve që lidhen me diskriminimin ndaj këtyre komuniteteve në Kosovë, identifikimin e rasteve të diskriminimit dhe bashkëpunimin me autoritetet përkatëse për t'i adresuar këto çështje. Përveç kësaj, grupi është përgjegjës për rritjen e ndërgjegjësimit rreth diskriminimit ndaj këtyre komuniteteve dhe promovimin e të drejtave dhe mundësive të barabarta. Gjatë viteve 2021, 2022 dhe 2023, Grupi Teknik mbajti 8 takime ku u ftuan të merrnin pjesë edhe anëtarë të shoqërisë civile. Megjithatë, në vitin 2024 nuk u mbajt asnjë takim.

**321.** Platforma Kombëtare kundër Diskriminimit për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian,<sup>439</sup> ka pranuar 11,023 vizitorë, 673 përdorues aktivë dhe 73 raste të raportuara deri në vitin 2024, duke treguar nevojën për mekanizma të vazhdueshëm dhe të qasshëm për të raportuar dhe luftuar antigjipsizmin.<sup>440</sup> Sipas rezultateve të regjistrimit të fundit të popullsisë për vitin 2024 në Kosovë, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian përbëjnë 2.24 përqind të popullsisë së përgjithshme, që përkthehet në 35,518 individë, ku komuniteti rom përfaqësohet me 0,55 përqind të popullsisë ose 8,730 individë, komuniteti ashkali me 1,02 përqind të popullsisë ose 16,207 individë, dhe komuniteti egjiptian me 0,67 përqind të popullsisë ose 10,581 individë.<sup>441</sup> Është shqetësuese që Platforma Kombëtare nuk ofron një mekanizëm raportimi për komunitetet e tjera jo-shumicë përvec romëve, ashkalinjve dhe egjiptianëve, dhe as nuk sqaron se si duhet të trajtohen rastet kur diskriminuesi i dyshuar është vetë një institucion shtetëror - një boshllëk që dëmton ndjeshëm si qasjen në drejtësi ashtu edhe llogaridhënien institucionale.<sup>442</sup>

**322.** Në nëntor të vitit 2024, në Ferizaj u krye një sulm i dhunshëm ku katër individë të komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian u plagosën rëndë me thikë. Në mesin e viktimave janë dy vajza të mitura, gjë që e bën këtë incident edhe më shqetësues dhe alarmues për sigurinë e komuniteteve të cenueshme në Kosovë. Sipas informacioneve fillestare, ekziston dyshimi i bazuar se ky sulm është i motivuar nga urrejtja, anti-gjipsizmi dhe paragjykimet etnike. Prokuroria tashmë ka kërkuar caktimin e masave të paraburgimit kundër të dyshuarit i cili dyshohet se ka kryer vrasje të rëndë në tentativë.<sup>443</sup>

**323.** Sipas OJQ VoRAE, ky incident serioz dhe kërcënues për jetën shfaq nevojën për një reagim të menjëhershëm nga institucionet shtetërore dhe shoqëria civile për ta garantuar sigurinë e komuniteteve të prekura dhe për t'i adresuar motivet që qëndrojnë pas këtij akti. Autoritetet

438 Qeveria e Kosovës (2024), [Raport – Zbatimi i Strategjisë për avancimin e të gjithë komuniteteve Rom dhe Ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026 si dhe Planit të Veprimit 2022-2024](#).

439 ZQM (2024), [Platforma për mbrojtje nga diskriminimi për komunitetet Rom, Ashkali dhe Egjiptian](#).

440 VoRAE (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

441 VoRAE (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

442 YIHR KS (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

443 VoRAE (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

duhet të kryejnë një hetim të plotë, duke siguruar që të gjitha rrethanat e sulmit të sqarohen dhe personat përgjegjës të sillen para drejtësisë. Për më tepër, duhet të merren masa konkrete për ta luftuar diskriminimin dhe paragjykimet ndaj komuniteteve rom, ashkali dhe egjiptian, përmes edukimit, ndërgjegjësimit dhe garantimit të mbrojtjes institucionale. Sulmi i fundit ndaj këtyre qytetarëve është një sinjal i rrezikshëm për shtetin e Kosovës dhe shoqërinë e tij. Nevojitet një qasje e palëkundur dhe gjithëpërfshirëse për të parandaluar incidente të tilla në të ardhmen dhe për të ndërtuar një shoqëri ku të gjithë qytetarët, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike, të ndihen të sigurt dhe të barabartë.<sup>444</sup>

**324.** Një studim i vitit 2024 i kryer nga Klinika Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut (IHRC) në Shkollën Juridike të Harvardit dokumentoi ndikimet e vazhdueshme të helmimit nga plumbi në mesin e të mbijetuarve rom, ashkali dhe egjiptian që jetuan në kampet e zhvendosjes të drejtuara nga OKB-ja në Kosovë ndërmjet viteve 1999 dhe 2013. Përmes intervistave me 70 ish-banorë të kampeve, IHRC zbuloi se të mbijetuarit vazhdojnë të vuajnë nga efekte dobësuese fizike dhe kognitive shëndetësore, shumë prej të cilave madje janë përhapur edhe tek fëmijët e tyre. Studimi nxjerr në pah pakënaqësinë e thellë me Fondin e Mirëbesimit të OKB-së të krijuar në vitin 2017, i cili u krijua pa konsultim me të mbijetuarit dhe nuk ka arritur të ofrojë kompensim të drejtpërdrejtë. Të mbijetuarit shprehën vazhdimisht një preferencë të fortë për dëmshpërblime financiare individuale, të cilat i asocojnë me dinjitetin, drejtësinë dhe fleksibilitetin për të përmbushur nevojat urgjente mjekësore dhe të jetesës. Studimi i konsideroi projektet në nivel komuniteti si të pamjaftueshme dhe të shkëputura nga dëmet specifike të pësura. Gjetjet e IHRC theksojnë nevojën për një përgjigje të bazuar në të drejta dhe të përqendruar te të mbijetuarit, e cila ka në qendër angazhimin e drejtpërdrejtë dhe që bazohet në realitetet e përjetuara të komuniteteve.<sup>445</sup>

**325.** Një aspekt kyç brenda vlerësimit të situatës së të drejtave të njeriut në Kosovë për vitin 2024 është ai i sigurisë, që ndikon ndjeshëm në kuptimin tonë të tensioneve në komunitet. Perceptimi në mesin e shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës është thellësisht i formësuar nga peizazhi më i gjerë politik i rajonit. Situata e sigurisë në veri të Kosovës mbeti e tensionuar gjatë gjithë vitit 2024, dhe u shënuar nga incidente të shumta.<sup>446</sup> Në veçanti, tensionet në veri të Kosovës u përshkallëzuan me mbylljen e pesë institucioneve paralele serbe në veri të Kosovës, një veprim i Qeverisë së Kosovës i cili u kritikua ashpër nga Shtetet e Bashkuara dhe shtetet e tjera perëndimore.<sup>447</sup>

**326.** OJQ AKTIV vërejti sfida të shumta gjatë vitit 2024 për sa i përket respektimit të të drejtave civile, duke përfshirë të drejtën për siguri, lirinë e lëvizjes, protestën paqësore dhe liri të tjera sociale. Këto shkelje shpesh justifikohen me pretekstin e “sundimit të ligjit”, antiterrorizmit dhe narrativave të ngjashme. Megjithatë, veprime të tilla kanë kontribuar në rritjen e pakënaqësisë në mesin e popullsisë ndaj institucioneve të Kosovës, duke destabilizuar më tej paqen e brishtë në veri të Kosovës.<sup>448</sup>

444 VoRAE (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

445 Klinika Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut (IHRC) e Shkollës Juridike të Harvardit 2024, Ndikimet e Vazhdueshme të Helmimit nga Plumbi dhe Perspektivat mbi Dëmshpërblimet në Kosovë.

446 Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara (2024), [Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm](#).

447 Euronews (2024), [Kosova mbyll pesë institucione serbe në veri të vendit, duke nxitur tensionet](#).

448 AKTIV (2025), Kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

**327.** Pas dorëheqjes masive të zyrtarëve serbë të Kosovës në veri të Kosovës, popullsia serbe bojkotoi zgjedhjet e prillit 2023 me një pjesëmarrje historikisht të ulët prej 3.47 përqind<sup>449</sup> gjë që rezultoi në zgjedhjen e kryetarëve të komunave me prejardhje shqiptare në të gjitha komunat veriore. Pas thirrjeve të vazhdueshme se kryetarët e zgjedhur nuk kanë legjitimitet dhe se duhet të japin dorëheqje, autoritetet e Kosovës morën vendimin për të mbajtur referendum për shkarkimin e kryetarëve të komunave. Referendumi u mbajt në katër komuna në veri të Kosovës më 21 prill 2024, por vetëm 253 nga 46,556 votues të regjistruar dolën në votime.<sup>450</sup> Pas dështimit të referendumi për shkak të një bojkoti të gjerë, kryetarët shqiptarë të komunave vazhduan të shërbenin në katër komunat veriore të Kosovës deri në mbajtjen e zgjedhjeve të ardhshme lokale.<sup>451</sup> Komisioni i BE-së deklaroi se referendumi i 21 prillit 2024 “mund të kishte hapur një rrugë për kthimin e serbëve të Kosovës në institucionet e Kosovës”, por bojkoti i votimit për shkarkimin e kryetarëve nga elektorati serb i Kosovës do të thotë që kryetarët aktualë të komunave do të mbeten në detyrë. Për më tepër, u tha gjithashtu se bojkoti i zgjedhjeve lokale shkeli detyrimet e Serbisë nga Dialogu dhe përbënte një hap prapa në përmbytjen e marrëveshjeve të Dialogut nga ana e Serbisë.<sup>452</sup> OJQ AKTIV shprehi shqetësime serioze në lidhje me administrimin e zgjedhjeve të ardhshme parlamentare të shkurtit 2025, duke i karakterizuar ato si ndër më të dobëtat deri më sot. Organizata vuri në dukje mangësitë sistematike që i vënë në disavantazh veçanërisht serbët e Kosovës dhe personat e zhvendosur brenda vendit (PZHBV). Këto përfshijnë qasje të pamjaftueshme në informata në gjuhën serbe, pasiguri procedurale rreth procesit të votimit jashtë Kosovës dhe një mungesë të përgjithshme transparence në menaxhimin e përgjithshëm të zgjedhjeve.<sup>453</sup>

**328.** Sipas OJQ NSI, në përpjekje për të ndryshuar në mënyrë të njëanshme situatën në zonat me shumicë serbe, duke anashkaluar Dialogun dhe formimin e Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe, institucionet e Kosovës kanë krijuar sfida të shumta për jetën e përditshme të anëtarëve të komunitetit serb të Kosovës. Për shembull, Banka Qendrore e Kosovës miratoi një rregullore mbi pagesat në para të gatshme me qëllim për ta mbrojtur integritetin e sistemit financiar në Kosovë dhe për të luftuar pastrimin e parave dhe financimin e aktiviteteve terroriste. Rregullorja përcaktonte që nga 1 shkurti 2024, e vetmja monedhë e lejuar për transaksione në para të gatshme në Kosovë do të ishte Euro, duke ndërprerë kështu praktikën e zakonshme të përdorimit të dinarit serb si valutë kryesore për para të gatshme dhe transaksione tregtare në zonat me shumicë serbe, që kishte qenë në fuqi që nga viti 1999. Para datës së zbatimit, autoritetet e Kosovës ofruan shpjegime të kufizuara publike për përmbytjen dhe efektin e rregullores. Zbatimi i rregullores ndërpreu pagesat për individët e punësuar nga institucionet e financuara nga Serbia dhe për pensionistët e sistemit paralel serb të sigurimeve shoqërore në Kosovë. Kjo gjithashtu preku bizneset e vogla dhe të mesme, si dhe shërbimet shëndetësore, ato të kujdesit për fëmijët dhe të arsimit.<sup>454</sup> Përgjigja e Serbisë, duke ngritur banka të përkohshme mobile, dështoi t'i adresonte nevojat e atyre që jetonin në jug të lumit Ibër, të cilët ishin të detyruar të udhëtonin distanca të gjata për qasje në pagesa. Linja telefonike e OJQ Aktiv shfaqti zhgënjimin e përhapur të qytetarëve serb për çështjet e pazgjdhura, dhe pretendimet e kryeministrit Albin Kurti se kafenetë në veri pranonin euro ishin kryesisht të pavërteta, gjë që thelloi mosbesimin në institucionet e Kosovës.<sup>455</sup>

449 HRN (2024), Raporti i Përbashkët i OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2023.

450 Euronews (2024), [Komunitet me shumicë serbe bojkotojnë votimin për shkarkimin e kryetarëve shqiptarë të komunave](#).

451 Zëri i Amerikës VOA (2024), [Dështon referendum për largimin e kryetarëve shqiptarë të komunave në veri të Kosovës](#).

452 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 60.

453 AKTIV (2025), Kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

454 NSI dhe AKTIV (2025), Kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

455 AKTIV (2025), Kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

**378.** Sipas OJQ YIHR KS, regjistrimi civil në Kosovë përfaqëson një sfidë të rëndësishme që prek kryesisht komunitetet jo-shumicë në Kosovë dhe ato në pozitë të cenueshme. Korniza legjislative mbi regjistrimin civil interpretohet në mënyrë jokonsistente midis komunave/zyrave të ndryshme të regjistrimit civil, duke çuar në mospërputhje në praktikë dhe duke ndikuar në të drejtat dhe interesat e komunitetit serb të Kosovës në lidhje me fitimin e shtetësisë. Për më tepër, komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian janë në një disavantazh të madh pasi u mungon njohuria mbi procedurat e regjistrimit civil dhe procedurat për të filluar ankesa kur të drejtat e tyre shkelen nga autoritetet lokale ose qendrore.<sup>515</sup>

**379.** Në vitin 2024, OJQ CRP/K ndihmoi 117 persona me regjistrimin e vonuar të lindjeve dhe marrjen e shtetësisë dhe identifikoi mbi 100 individë të paregjistruar që kishin nevojë për ndihmë juridike. Kjo mbështetje ka qenë thelbësore në adresimin e sfidave komplekse të pa-shtetësisë, duke ndikuar në demografi të ndryshme, duke përfshirë gratë, burrat, fëmijët dhe grupet e marginalizuara si të moshuarit. Përtej ndihmës së drejtpërdrejtë juridike, OJQ CRP/K ka zbatuar gjithashtu nisma për ndërtimin e kapaciteteve, të tilla si diskutime, seanca trajnimi dhe takime informuese, duke forcuar njohuritë e akterëve për parandalimin e pa-shtetësisë dhe kornizën ligjore që rregullon regjistrimin e gjendjes civile.<sup>516</sup>

**380.** Procesi i ripërtëritjes së lejeve të qëndrimit të përkohshëm për personat pa shtetësi mbetet problematik, kryesisht për shkak të barrierave administrative dhe mungesës së një mekanizmi të qartë institucional për verifikimin dhe riafirmimin e statusit pa-shtetësi. Aktualisht, për çdo vazhdim të lejeqëndrimit nevojitet një vendim zyrtar administrativ që rikonfirmon statusin e pandryshuar pa-shtetësi të një individi. Kjo kërkesë shton kompleksitetin e procedurave, duke shkaktuar vonesa të konsiderueshme në vazhdimin e lejeve të qëndrimit dhe si pasojë pengon qasjen e shpejtë në dokumente dhe shërbime thelbësore të identifikimit për individët pa shtetësi.<sup>517</sup>

**381.** Strehimi me qira është një nga skemat për ofrimin e ndihmës për strehim sipas Rregullores Nr. 01/2018 për Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhjet e Qëndrueshme.<sup>518</sup> Qiraja ofro-

514 CRP/K (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

515 YIHR KS (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

516 CRP/K (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

517 CRP/K (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

518 Rregullorja nr. 01/2018 mbi Kthimin e Personave të Zhvendosur dhe Zgjidhjet e Qëndrueshme, Neni 15, në dispozicion në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=15942>.

het si masë e përkohshme akomodimi për të kthyerit derisa të gjendet një zgjidhje e qëndrueshme për strehimin. Qiraja për të kthyerit e kategorive serioze (të rëndë)<sup>519</sup> ofrohet për një periudhë midis 3 dhe 12 muajsh, në varësi të kapaciteteve financiare të Ministrisë për Komunitete dhe Kthim.<sup>520</sup>

**382.** Situata e familjeve të kthyerë në nevojë, veçanërisht nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, mbetet e rëndë pasi ato vazhdojnë të jetojnë në banesa me qira me pak ose aspak ndihmë nga autoritetet përkatëse, pavarësisht dispozitave në kornizën legjislative të hartuara për t'i mbështetur ato. Kushtet e tyre të brishta të jetesës përkeqësohen më tej nga kostot e larta të qirasë dhe mungesa e zgjidhjeve të qëndrueshme të strehimit, të cilat nuk janë materializuar pavarësisht se janë vlerësuar dhe miratuar më parë për ndihmë strehimi. Kanë kaluar vite dhe këto familje ende nuk kanë një rrugë të qartë drejt strehimit të përhershëm. Për më tepër, një problem i rëndësishëm është fakti se të kthyerit që jetojnë në prona me qira private nuk kanë marrëveshje formale qiraje, gjë që i lë ata pa mbrojtje ligjore. Kjo mungesë e dokumentacionit zyrtar ka një ndikim serioz në aftësinë e tyre për qasje në programe thelbësore të ndihmës sociale, si dhe forma të tjera të mbrojtjes ligjore dhe sociale. Mungesa e strehimit të sigurt dhe pasiguria në lidhje me statusin e tyre të banimit i lë këto familje të ekspozuara ndaj vështirësive ekonomike. Pa zgjidhje formale strehimi, e drejta e tyre për të siguruar strehim dhe mbrojtje sociale - e garantuar sipas Kushtetutës së Kosovës dhe ligjit ndërkombëtar për të drejtat e njeriut - mbetet e paplotësuar.<sup>521</sup>

**383.** Mosregjistrimi i njësive të banimit në të dhënat kadastrale komunale, të ndërtuara përmes programeve të ndihmës për strehim në vitet e mëparshme, mbetet një problem i vazhdueshëm. Këto njësi banimi, megjithëse të ndërtuara në pronën në pronësi të të kthyerve, janë ligjërisht jo-ekzistente pasi familjet nuk u këshilluan për një hap shtesë që duhej të ndiqnin për të legalizuar plotësisht njësitë e tyre të banimit të ndërtuara rishtazi (tani jo-formale). Kjo situatë i lë familjet e kthyerë të cënueshme ndaj mungesës së mbrojtjes ligjore. Kjo çështje vazhdon të pengojë familjet për të ushtruar plotësisht të drejtat e tyre pronësore dhe rrezikon sigurinë dhe qasjen e tyre në të drejta të tjera. Sfidat kryesore që kontribuojnë në këtë situatë përfshijnë procedurat komplekse ligjore, kufizimet financiare, kapacitetin e kufizuar njerëzor dhe teknik në nivel komunal dhe mungesën e dokumentacionit dhe informacionit të kërkuar. Këta faktorë vazhdojnë të krijojnë pengesa të konsiderueshme, duke penguar përmbushjen e detyrimeve ligjore në lidhje me regjistrimin kadastral. Si rezultat, të drejtat pronësore të familjeve të kthyerë nuk mbrohen mjaftueshëm, duke penguar aftësinë e tyre për të integruar plotësisht në shoqëri dhe duke minuar suksesin e synuar të programeve të ndihmës për strehim.<sup>522</sup>

**384.** Sipas një Raporti të Sekretarit të Përgjithshëm për vitin 2024 drejtuar Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, UNHCR-ja regjistroi 13 kthime vullnetare nga anëtarët e komuniteteve jo-shumicë që ishin zhvendosur jashtë dhe brenda Kosovës, midis tyre 9 burra, 4 gra nga këta/këto 7 serbë, 5 romë dhe 1 ashkali.<sup>523</sup> Numri i përgjithshëm i personave të zhvendosur nga komunitetet jo-shumicë që kanë gjetur zgjidhje të qëndrueshme në Kosovë që nga viti 2000 është tani 29,418 persona (midis tyre 14,435 gra, 14,983 burra, 12,831 serbë, 7,780 egjiptianë dhe ashkali,

519 Po aty, neni 10, paragrafi 2, parashikon kategoritë e cënueshmërisë së familjeve të kthyerë bazuar në vlerësimin i cili mund të jetë, siç tregohet në nënparagrafin 2.1, serioz/i rëndë, 2.2 i moderuar dhe 2.3 cënueshmëri e ulët.

520 Po aty, Neni 15, paragrafi 2.2.5.

521 AT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut 2024.

522 AT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut 2024.

523 Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara (2024), [Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm](#).

4,095 romë, 1,879 boshnjakë, 1,464 goranë, 1,325 shqiptarë, 21 malazezë, 18 turq dhe 4 kroatë). Që nga viti 2024, brenda Kosovës kanë mbetur 15,586 persona të zhvendosur.<sup>524</sup>

**385.** Një familje rome e kthyer në komunën e Gjilanit është privuar nga realizimi i plotë i të drejtave të tyre pronësore. Komuna refuzoi lëshimin e lejes së ndërtimit për ndërtimin e shtëpisë përmes një programi ndihme për strehim, duke cituar Planin e Zhvillimit Urbanistik të vitit 2013. Sipas raportimeve, ky plan parashikon ndërtimin e cerdhes publike në atë zonë. Megjithatë, më 09.08.2021, Drejtoria Komunale për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit lëshoi një vendim për leje ndërtimi, duke lejuar ndërtimin pavarësisht nga plani ekzistues urban komunal, por ajo leje nuk u përdor për shkak të mungesës së fondeve në atë kohë nga Ministria për Komunitete dhe Kthim. Që nga miratimi i planit urbanistik komunal deri më sot, nuk është hartuar ose buxhetuar asnjë projekt për ndërtimin e cerdhes. Pronarë të tjerë të pronave në zonën e caktuar për cerdhen vazhdojnë t'i ushtrojnë të drejtat e tyre të plota pronësore pa kufizime. Nenet 2.1.9, 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi theksojnë detyrimin për të siguruar trajtim të barabartë dhe për të parandaluar praktikat diskriminuese në çështjet e të drejtave pronësore. Përveç vendosjes së pengesës administrative, komuna nuk ka filluar një proces shpronësimi dhe nuk ka ofruar një zgjidhje alternative. Në vitin 2024, pas një kohe të gjatë pritjeje, familja më në fund u përzgjedh për të përfituar nga programet e strehimit për të kthyerit, të cilat iu refuzuan me refuzimin komunal për të lëshuar një leje ndërtimi. Me këtë vendim, komuna nuk shkeli vetëm të drejtat e pronës, por edhe të drejtën për një jetë të dinjitetshme, siç garantohet nga Kushtetuta e Kosovës. Familja rome e kthyer ka paraqitur një ankesë kundër vendimit komunal në Ministrinë e Planifikimit Hapësinor, Mjedisit dhe Infrastrukturës, por nuk është marrë asnjë vendim brenda afatit të kërkuar të përcaktuar nga neni 135 i Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.<sup>525</sup>

**386.** Situata në lidhje me procesin e regjistrimit për të drejtat e përdorimit të pronës në vendbanimin "Fidanishte" në Mitrovicën e Jugut mbetet e njëjtë. Gjithsej 288 shtëpi janë ndërtuar në lagjen "Fidanishte" për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, të financuara nga donatorë të ndryshëm ndërkombëtarë. Megjithatë, nuk janë ndërmarrë masa proaktive nga Kryetari i Komunës ose Departamenti i Gjeodezisë, Kadastrit dhe Pronës për të regjistruar pronat e 74 familjeve egjiptiane në regjistrat kadastral, gjë që është e nevojshme për t'ua njohur ligjërisht të drejtat e tyre pronësore. Si rezultat, familjet e prekura ndihen të pasigurta, pasi u mungon dokumentacioni i duhur për të garantuar të drejtën e tyre për përdorim të sigurt dhe të papenguar të pronave të tyre. Një situatë e ngjashme vlen edhe për katër familje të kthyera egjiptiane në Gjakovë, të cilat janë përfituese të një programi strehimi të donatorëve në tokë të ndarë nga komuna. Procesi i regjistrimit për të drejtat e tyre të përdorimit të pronës ka ngecur që nga viti 2015, duke i lënë përfituesit në një gjendje pasigurie në lidhje me të drejtat e tyre pronësore. Vonesat dhe mosveprimi në regjistrimin e të drejtave të pronësisë për këto grupe të cënueshme mund të shihen si një dështim i autoriteteve për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut.<sup>526</sup>

524 Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara (2024), [Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, Raporti i Sekretarit të Përgjithshëm](#).

525 AT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2024.

526 AT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2024.

**387.** Ministria e Infrastrukturës aktualisht po kryen një projekt të zgjerimit të rrugës, përkatësisht zgjerimin e autostradës Pejë-Prishtinë, gjë që po ndikon në pronat e të kthyerve serbë të Kosovës në fshatin Gremnik në Klinë. Gjatë procesit të shpronësimit, të kthyerve serbë iu dha një vendim përfundimtar në gjuhën shqipe, duke shpërfillur të drejtën e tyre për përdorimin e gjuhës. Kjo përbën një shkelje të qartë të nenit 5 të Kushtetutës së Kosovës, i cili garanton të drejtat e të gjitha komuniteteve, përfshirë të drejtën për të përdorur gjuhën e tyre amtare. Për më tepër, vetë procesi i shpronësimit u krye në një mënyrë jo-transparente. Të kthyerit e prekur nuk u informuan siç duhet për vendimin e shpronësimit dhe, më e rëndësishmja, nuk u njoftuan as nuk u ftuan në asnjë seancë publike ku u diskutua shpronësimi. Kjo mungesë komunikimi përbën shkelje të së drejtës së individit për t'u informuar dhe për të marrë pjesë në proceset publike që ndikojnë në pronën e tyre.<sup>527</sup>

**388.** Situata në lidhje me qasjen në ndihmë juridike për individët në rrezik për të mbetur pa shtetësi mbetet kryesisht e njëjtë që nga viti 2023. Këta individë vazhdojnë të varen kryesisht nga ndihma juridike e ofruar nga OJQ-të, pasi kriteret e pranueshmërisë së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas (ANJF) përjashtojnë personat e rritur të paregjistruar që nuk kanë dokument identiteti. Për më tepër, për shkak të mungesës së stafit, ANJF nuk është në gjendje t'i adresojë të gjitha nevojat për ndihmë juridike në këtë fushë. Kjo e fundit, brenda kornizës së marrëveshjes së saj me organizatat që ofrojnë ndihmë juridike falas, bazohet kryesisht në mbështetjen e tyre në fushat që përputhen me ekspertizën e tyre. Për të rritur kapacitetet e stafit të ANJF-së në regjistrimin e gjendjes civile dhe procedurat përkatëse, UNHCR dhe OJQ CRP/K po punojnë ngushtë me ANJF-në përmes seancave të trajnimit dhe bashkëpunimit të vazhdueshëm. Këto përpjekje synojnë t'i forcojnë përgjigjet institucionale dhe të përmirësojnë qasjen në ndihmë juridike për personat që janë në rrezik pashtetësie. Duke pasur parasysh këtë kontekst, OJQ CRP/K, me mbështetjen e UNHCR-së, ka qenë instrumentale në ofrimin e ndihmës juridike falas dhe përfaqësimit gjyqësor për individët e paregjistruar, duke siguruar që të drejtat e tyre të njihen në procedurat administrative dhe gjyqësore.<sup>528</sup>

### 389. Rekomandimet

- Agjencia e Regjistrimit Civil duhet të ndërmarrë hapa konkretë për të krijuar një mekanizëm funksional për identifikimin, parandalimin dhe zvogëlimin e numrit të individëve të paregjistruar, me fokus të veçantë në komunitetet e marginalizuara, në përputhje me Strategjinë për Avancimin e të Drejtave të Komuniteteve Rome dhe Ashkali;
- Kuvendi i Kosovës duhet t'i japë përparësi miratimit të projektligjit për Gjendjen Civile, Ligjit për Shtetësinë dhe Ligjit për të Huajt, pasi këto janë thelbësore për forcimin e mbrojtjeve ligjore për personat në rrezik pashtetësie;
- Duhet të krijohet një mekanizëm verifikimi për të thjeshtuar dhe përsheptuar procesin e vazhdimin të lejeve të qëndrimit për individët e njohur si pa shtetësi. Kjo do të zvogëlonte vonesat administrative dhe do të përmirësonte qasjen e shpejtë në dokumentacion dhe shërbime;
- Projektligji i ardhshëm për Ndihmën Juridike Falas duhet të përfshijë në mënyrë të qartë personat e rritur në rrezik pashtetësie si përfitues të përshtatshëm. Përveç kësaj, qeveria duhet të rrisë mbështetjen financiare për ANJF dhe OJQ-të e specializuara për të sigurimin e ofrit të shërbimeve përkatëse të ndihmës juridike që synojnë eliminimin e pashtetësisë.

527 AT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2024.  
528 CRPK (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

## 8. Pjesa D: ÇËSHTJE TË NDËRLIDHURA/ ÇËSHTJE SPECIFIKE LIDHUR ME TË DREJTAT E NJERIUT

### 8.1. Drejtësia tranzicionale dhe të drejtat e njeriut

**390.** Përkufizimi i drejtësisë tranzicionale në këtë dokument rrjedh nga OHCHR, e cila e përcakton atë në lidhje me të drejtat e njeriut si: “një qëllim për të siguruar njohjen e viktimave, për të rritur besimin e individëve në institucionet shtetërore, për të përforcuar respektin për të drejtat e njeriut dhe për të promovuar sundimin e ligji si një hap drejt pajtimit dhe parandalimit të shkeljeve të reja”.<sup>529</sup> Një qasje gjithëpërfshirëse ndaj drejtësisë tranzicionale mund të lehtësoj proceset e pajtimit dhe të kontribuoj në transformimin e shoqërisë së Kosovës në një shtet më gjithëpërfshirës e të përbashkët për të gjitha komunitetet etnike.

**391.** Korniza legjislative që adreson drejtësinë tranzicionale në kontekstin e konfliktit të Kosovës përfshin Ligjin Nr. 05/L-060 për Mjekësinë Ligjore, në fuqi që nga prilli i vitit 2016, i cili themelon Institutin e Mjekësisë Ligjore me detyrën e gjetjes, zhvarrosjes dhe përcaktimit të fatit të personave të zhdukur. Së dyti, Ligji Nr. 04/L-172 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile të Luftës dhe Familjeve të Tyre adreson dhunën seksuale të lidhur me konfliktin. Megjithatë, ky ligj paraqet sfida, pasi kufizon njohjen vetëm në incidentet menjëherë pas luftës 1998-1999. Së treti, Ligji Nr. 08/L-177 për Institutin e Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë, i miratuar në vitin 2023, themeloi Institutin e Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë me qëllim kryerjen e hulumtimeve dhe dokumentimit të krimeve të kryera në Kosovë nga 1 janari 1998 deri më 20 qershor 1999.

**392.** Pas vitesh të tëra iniciativash të mangëta dhe planesh të papërfunduara për të miratuar një Strategji për Drejtësinë Tranzicionale, Qeveria e Republikës së Kosovës më në fund ka miratuar një Strategji 10-vjeçare për Drejtësinë Tranzicionale 2024-2034 dhe një Plan Veprimi integral për vitet 2024-2026, të bashkëngjitur si shtojcë të dokumentit kryesor.<sup>530</sup> Strategjia e përshkruan veten “jo vetëm si një udhërrëfyes për t’i shëruar plagët e së kaluarës, por edhe si një vizion për një të ardhme kohezive dhe gjithëpërfshirëse”. Ajo thekson një qasje me viktimat në qendër, duke synuar të adresojë trashëgiminë e shkeljeve masive të të drejtave të njeriut përmes masave të tilla si gjetja e së vërtetës, drejtësia, reparacionet dhe reformat institucionale. Edhe pse Strategjia për Drejtësi Tranzicionale i referohet parimit të gjithëpërfshirjes që në hyrje të saj, përmbajtja e saj nuk e pasqyron këtë angazhim. Megjithatë, fushëveprimi kohor i strategjisë është i kufizuar në periudhën 1989-2000, duke përjashtuar përvojat dhe pikëpamjet e tjera relevante.<sup>531</sup> OJQ NSI shpreh

529 OCHR (2022), [drejtësia tranzicionale dhe të drejtat e njeriut](#).

530 Qeveria e Kosovës (2024), [Strategjia e Republikës së Kosovës për Drejtësinë Tranzicionale 2024-2034](#).

531 QKRMT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.



shqetësimin se strategjisë së drejtësisë tranzicionale i mungon gjithëpërfshirja dhe drejtësia, pasi ajo përjashton kryesisht përvojat e komuniteteve jo-shumicë dhe i anashkalon krimet e pasluftës. Pavarësisht përpjekjeve formale për konsultim, kontributi domethënës nga këto komunitete u injorua.<sup>532</sup>

**393.** Sipas OJQ BIRN, miratimi i Strategjisë së re në të njëjtën kohë ngjalli shpresa dhe dyshime, pas miratimit të saj 25 vite pas përfundimit të luftës. Që ajo të funksionojë në praktikë dhe të jetë në gjendje ta adresojë trashëgiminë e konfliktit, Strategjia “duhet të jetë e besueshme si nga komuniti Shqiptar dhe ai Serb”, mendojnë ekspertët e drejtësisë tranzicionale.<sup>533</sup> Sipas OJQ NSI, disa anëtarë të shoqërisë civile shprehën kritika dhe disa të tjerë u tërhoqën nga konsultimet për shkak të asaj që e konsideruan si një proces jo-gjithëpërfshirës, të karakterizuar nga një qasje «etnocentrike» ndaj drejtësisë tranzicionale në vend të një qasjeje me viktimat në qendër. Përfaqësuesit e bashkësisë ndërkombëtare shprehën shqetësime të ngjashme.<sup>534</sup>

**394.** Instituti për Krimet e Kryera gjatë Luftës në Kosovë, i funksionalizuar për ta dokumentuar dhe ruajtur kujtesën kolektive, erdhi si iniciativë e Ministrisë së Drejtësisë. Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin Nr. 08/L-177 për Institutin e Krimeve të Kryera gjatë Luftës në Kosovë në vitin 2023, si një iniciativë që synon t'i dokumentojë krimet e kryera gjatë luftës në Kosovë midis periudhës 1 janar 1998 deri më 20 qershor 1999 dhe gjithashtu mund të zbatohet për krimet e ndodhura pas periudhës së luftës, që lidhen me luftën, jo më vonë se 31 dhjetor 2000. Instituti do të funksionojë si një Agjenci brenda Zyrës së Kryeministrit dhe do të ketë një numër kompetencash të rëndësishme që lidhen me kërkimin, mbledhjen e të dhënave, publikimin e kujtimeve të të mbijetuarve, menaxhimin e bazave të të dhënave të krimeve të luftës, përgatitjen e të dhënave statistikore, etj. Më 17 shkurt 2024, Instituti mori dokumentet e para që lidhen me dëshmitë e krimeve të zhdukjes me forcë, të cilat u dorëzuan nga Kryetari i Shoqatës së Familjeve të Personave të Zhdukur në Kosovë.<sup>535</sup>

**395.** Ligji Nr. 04/L-023 për Personat e Zhdukur, i cili mbron të drejtat e të zhdukurve dhe familjeve të tyre, veçanërisht atyre që u zhdukën si rezultat i konfliktit të viteve 1998-1999 në Kosovë, hasi në pakënaqësi, duke nxitur kështu nevojën për ndryshime (shih edhe raportet e mëparshme të viteve 2021, 2022 dhe 2023). Sipas Strategjisë për Drejtësinë Tranzicionale 2024-2034, përkatësisht objektivit specifik 2, të titulluar «Intensifikimi i procesit të zbardhjes së fatit dhe vendndodhjes së personave të zhdukur», ndryshimi dhe plotësimi i Ligjit Nr. 04/L-023 për Personat e Zhdukur është planifikuar si një nga masat/veprimet për të arritur këtë objektiv specifik.<sup>536</sup> Megjithatë, sipas Planit të Veprimit 2024-2026 të bashkëngjitur dokumentit kryesor të Strategjisë si pjesë integrale e saj, afati i fundit për të ndryshuar Ligjin për Personat e Zhdukur ishte viti 2024. Strategjia dhe Plani i saj i Veprimit u miratuan më 13 qershor 2024,<sup>537</sup> dhe një nga masat/veprimet kryesore për të arritur një nga objektivat e Strategjisë është tashmë me vonesë duke pasur parasysh dështimin e Qeverisë së Kosovës për ta ndryshuar Ligjin për Personat e Zhdukur brenda afatit që vetë e kanë përcaktuar. Kjo gjetje e veçantë ngre shqetësime nëse Plani i Veprimit është menduar me kujdes dhe nëse Qeveria e Kosovës do të arrijë të zbatojë në mënyrë efektive të gjitha masat e shpallura në këtë Strategji ambicioze, por të shumëpritur.

532 NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

533 Balkan Insight, Drejtësia Tranzicionale në Ballkan (2024), [Kosova në vitin 2024: Strategjia e re e drejtësisë ngjall shpresë – por edhe dyshime](#).

534 NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

535 Zyra e Kryeministrit (2024), [Instituti për Krimet e kryera gjatë luftës pranoi dosjet e para për krimet e luftës](#).

536 Qeveria e Kosovës (2024), [Strategjia e Republikës së Kosovës për Drejtësinë Tranzicionale 2024-2034](#), f. 26.

537 Betimi për Drejtësi (2024), [Qeveria miraton Strategjinë për Drejtësi Tranzicionale 2024-2024](#).

**396.** Ligji Nr. 04/L-054 për Statusin dhe të Drejtat e Dëshmorëve, Invalidëve, Veteranëve, Pjesëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Viktimave të Dhunës Seksuale të Luftës, Viktimave Civile dhe Familjeve të tyre, i miratuar në vitin 2011 dhe i ndryshuar në vitin 2023, përcakton statusin dhe mbështetjen financiare përmes pensioneve dhe përfitimeve të veçanta për kategoritë e luftës.<sup>538</sup> Problemi me zbatimin e kësaj kornize legjislative në praktikë del në pah kur një përfitues mbush moshën 65 vjeç dhe ka të drejtë për pension si kontribut për vitet e tij të shërbimit. Një anëtar i familjes, përfitues në këtë situatë, është i detyruar të vendosë nëse dëshiron të vazhdojë të marrë pensionin familjar si një formë kompensimi për humbjen e anëtarit të familjes së tij apo pensionin si kontribut për vitet e tij të shërbimit, pasi nuk ka të drejtë të marrë të dy pensionet nga i njëjti fond. Anëtarët e familjeve të personave të zhdukur e konsiderojnë këtë rregullore diskriminuese, pasi të ardhurat janë të një natyre të ndryshme dhe nuk duhet të ndërhyjnë me njëra-tjetrën. Ka raste të kësaj natyre të paraqitura në gjykatat lokale, të cilat po ndihmohen nga OJQ IKD, e cila gjithashtu po ndihmon në procesin e negociatave me Qeverinë e Kosovës për të gjetur një zgjidhje të përshtatshme për këtë çështje komplekse.<sup>539</sup>

**397.** Gjatë vitit 2024, OJQ QKRMT pranoi katër vendime pozitive, me anë të të cilave Gjykata Themelore në Prishtinë njohu të drejtat e viktimave për t'i marrë të dyja pensionet. Në këto raste, Gjykata Themelore në Prishtinë i referohet praktikës gjyqësore së GJEDNJ-së, e cila në fakt konfirmon se pensionet që rrjedhin nga kontributet e mëparshme konsiderohen si pronë e dikujt, e cila nuk mund të mohohet nga askush dhe se pensioni që rrjedh nga statusi i viktimës shërben për të njohur kontributin, humbjen dhe sakrificën e pësuar gjatë luftës. Këto katër raste tani janë në pritje në Gjykatën e Apelit, duke marrë parasysh se autoritetet shtetërore në Kosovë kanë paraqitur ankesë kundër këtyre vendimeve. Megjithatë, OJQ QKRMT është e bindur se këto vendime do të konfirmohen nga të tri instancat në Kosovë, në përputhje me një precedent të mëparshëm gjyqësor i cili tashmë ka konfirmuar të drejtën e viktimave për pension të dyfishtë. Falë suksesit të këtyre rasteve, gjykatat e Kosovës tani janë vërshuar me mijëra raste që kërkojnë konfirmimin për marrjen e pensioneve të dyfishta.<sup>540</sup>

**398.** Gjatë dy viteve të fundit, janë ngritur dhjetë padi në lidhje me dhunën seksuale, katër prej të cilave vetëm në vitin 2024. Të gjitha rastet u përgatitën dhe u mbështetën nga QKRMT-ja, duke ofruar si ndihmë psikologjike për të mbijetuarit ashtu edhe përfaqësim ligjor përmes angazhimit të avokatëve mbrojtës.<sup>541</sup>

**399.** Deri në fund të vitit 2024, numri i aplikimeve për statusin e viktimës për dhunë seksuale gjatë luftës ka arritur në 2,204 aplikime - nga të cilat 1,726 janë miratuar nga Komisioni përgjegjës, ndërsa 344 janë refuzuar. OJQ QKRMT vë në pah se numri prej 344 refuzimesh është shumë shqetësues dhe pasqyron një qasje josensitive të Komisionit përgjegjës të Qeverisë së Kosovës ndaj viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës. Arsyeimi i përgjithshëm i Komisionit se këto viktimat nuk i kanë bindur për ngjarjet e luftës që lidhen me dhunën seksuale nuk është mënyra e duhur për të trajtu-

538 MPRC (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

539 MPRC (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

540 QKRMT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

541 QKRMT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

ar historinë personale të viktimave që kanë vuajtur gjatë luftës.<sup>542</sup> Për më tepër, QKRMT ka dokumentuar 1,400 raste të dhunës seksuale të kryera gjatë luftës në Kosovë. Pas një avokimi të qëndrueshëm dhe të suksesshëm, Ligji për Sigurimin Shëndetësor tani garanton sigurim shëndetësor falas dhe të pakushtëzuar për të mbijetuarit e dhunës seksuale gjatë luftës.<sup>543</sup>

**400.** Më 12 shtator 2024, Medica Gjakova, në partneritet me Medica Mondiale në Këln, lansoi studimin “Nuk jam fajtor për atë që më ka ndodhur”, i zhvilluar me 200 të mbijetuar të Dhunës Seksuale gjatë Konfliktit përmes një qasjeje me të mbijetuarit në qendër. Hulumtimi nxjerr në pah sfidat e vazhdueshme psikologjike, sociale dhe ekonomike me të cilat përballen të mbijetuarit e dhunimit gjatë luftës në Kosovë, ndërkohë që ofron prova që shërbejnë si bazë për politikat e informuara nga trauma, për të sfiduar stigmën shoqërore dhe për të avokuar për mbështetje institucionale afatgjatë.<sup>544</sup>

**401.** IAP publikoi një Raport Ex-Officio në vitin 2024 mbi “respektimin e të drejtave të njeriut gjatë zhvillimit të procesit të njohjes dhe verifikimit të statusit të viktimës së dhunës seksuale gjatë luftës çlirimtare në Kosovë dhe pengesat e realizimit të beneficioneve të përcaktuara me ligj”.<sup>545</sup> Një nga gjetjet kryesore të Raportit është se ka boshllëqe të konsiderueshme ligjore në legjislacionin dytësor në lidhje me afatet kohore dhe dispozitat që lidhen me mjetet juridike në procedurën administrative. Si rezultat, IAP ka sugjeruar ndryshimin e Rregullores Nr. 22/2015 si një mjet për të siguruar respektimin e të drejtave të personave të prekur dhe për të garantuar ushtrimin efektiv të mjeteve juridike. Për më tepër, IAP shprehu gjithashtu shqetësime në lidhje me procesin e intervistimit të viktimave të dhunës seksuale, pasi mënyra e përdorur rrezikon të shkelë konfidencialitetin e procedurës duke mos ruajtur mjaftueshëm identitetin e tyre. Së fundmi, IAP u bëri thirrje institucioneve përgjegjëse të sigurojnë ruajtjen e dinjitetit të aplikantëve duke i trajtuar ata me respekt dhe duke shmangur ritraumatizimin gjatë procesit të intervistimit.<sup>546</sup> QKRMT-ja gjithashtu ka raportuar vazhdimisht për këtë çështje, duke përfshirë kontributin e saj në raportin e Avokatit të Popullit në lidhje me qasjen e Komisionit ndaj viktimave.<sup>547</sup>

**402.** Përmes avokimit nga organizatat e shoqërisë civile dhe familjet e viktimave dhe personave të zhdukur në Kosovë është kërkuar vazhdimisht dhe me këmbëngulje një zgjatje e afatit të regjistrimit për të mbijetuarit përtej afatit aktual kohor.<sup>548</sup> Edhe pse Qeveria e Kosovës ka rënë dakord ta shtyjë afatin për viktimat e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë për të aplikuar për njohjen e statusit të viktimës, OJQ QKRMT ka mbështetur vazhdimisht idenë se nuk duhet të ketë një afat të tillë dhe se duhet të jetë në diskrecionin e viktimave të vendosin se kur dëshirojnë të aplikojnë për një status të tillë.<sup>549</sup>

**403.** Fati i pazgjidhur i personave të zhdukur vazhdon të mbetet një çështje kyçe që duhet zgjidhur. Gjatë periudhës qershor 2023 dhe qershor 2024, institucionet e Kosovës zgjidhën 10 raste, ndërsa fati i 1,612 personave të zhdukur ende nuk është përcaktuar. Zbatimi i Deklaratës për Personat e Zhdukur të miratuar në takimin e nivelit të lartë të dialogut të lehtësuar nga BE-ja më 2 maj

542 QKRMT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

543 QKRMT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

544 Medica Kosova (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

545 IAP (2024), [Raporti i Avokatit të Popullit sipas detyrës zyrtare nr. 436/2023](#).

546 IAP (2024), [Raporti i Avokatit të Popullit sipas detyrës zyrtare nr. 436/2023](#).

547 QKRMT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

548 Balkan Insight (2024), [Verifikim faktesh nga BIRN: A ia vleu pritja për strategjinë e parë për drejtësi tranzicionale të Kosovës?](#)

549 QKRMT (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

2023, pas marrëveshjes së vitit 2023 për normalizimin e marrëdhënieve, nuk ka filluar ende duke pasur parasysh se Kosova dhe Serbia janë ende duke negociuar termat e referencës për Komisionin e Përbashkët i cili, ndër të tjera, parashikohet të mbështesë përpjekjet për zgjidhjen e fatit të 1,612 personave të mbetur që u zhdukën në vitet 1998-99.<sup>550</sup> Trajtimi i çështjes së personave të zhdukur si çështje urgjente është thelbësor për t'u dhënë përgjigje familjeve që presin për gati 25 vjet, duke theksuar domosdoshmërinë humanitare mbi qëllimet politike.<sup>551</sup> Megjithatë, pavarësisht këtyre premtimeve të ripërtërira, politizimi i çështjes mbetet pengesa kryesore për përparimin real në zbulimin e rasteve të personave të zhdukur.<sup>552</sup>

**404.** Lidhur me përbërjen e Komisionit të Qeverisë së Kosovës për Personat e Zhdukur, një organ qeveritar i cili kryeson, mbikëqyr, harmonizon dhe koordinon aktivitetet me institucionet vendore dhe ndërkombëtare në lidhje me sqarimin e fatit të personave të zhdukur, OJQ MPRC shprehu shqetësime serioze se ky organ i rëndësishëm është i mangët që nga marsi i vitit 2020, duke marrë parasysh se nuk është emëruar asnjë anëtar nga komunitetet jo-shumicë. Është absolutisht e nevojshme që Komisioni të kompletohet sa më shpejt që është e mundur dhe të vazhdojë punën e vet për sqarimin e fatit të personave të zhdukur pavarësisht nga prejardhja e tyre etnike, feja apo statusi.<sup>553</sup>

**405.** Në korrik 2024, Kosova ishte organizatore e Forumit të XVI-të për Drejtësinë Tranzicionale në Shtetet Post-Jugosllave, të organizuar nga OJQ Fondi për të Drejtën Humanitare dhe Fondi për të Drejtën Humanitare në Kosovë. Forumi ofroi një platformë për t'i diskutuar sfidat dhe strategjitë që lidhen me drejtësinë tranzicionale në rajon.<sup>554</sup>

**406.** Pavarësisht themelimit të Komisionit Ministror për Memorialin për Fëmijët e Vrarë gjatë Luftës së Kosovës 1998-1999, dhe nënshkrimit të Memorandumit të Mirëkuptimit midis MKRS-së dhe Universitetit të Prishtinës për konsultim dhe hartimin e një dokumenti narrativ mbi përkuajtimin e fëmijëve të vrarë dhe të zhdukur gjatë luftës, Memoriali nuk u themelua gjatë vitit 2024. Megjithatë, nuk është hequr dorë nga planet për themelimin e tij duke pasë parasysh se Qeveria e Kosovës i referohet "Memorialit për fëmijët e vrarë dhe të zhdukur gjatë luftës" në Strategjinë e saj më të re për Drejtësinë Tranzicionale 2024-2034, e cila, sipas Planit të Veprimit 2024-2026, do të përfundojë midis viteve 2025-2026.<sup>555</sup>

**407.** Një analizë e publikuar nga OJQ YIHR KS në tetor të vitit 2024 me titull: "Qëndrimet e të rinjve ndaj luftës dhe krimeve të luftës në Kosovë", konfirmoi supozimin se kujtimet e ngjarjeve të luftës kanë një ndikim të rëndësishëm në qëndrimet e të rinjve kosovarë, edhe pse 84 përqind e të anketuarve nuk kanë ndonjë përvojë personale të luftës. Ky hulumtim, i mbështetur nga anketa të kryera me të rinj, zbuloi: (i) se bisedat me anëtarët e familjes dhe ata që kanë përjetuar luftën janë burimet më me ndikim të informacionit rreth ngjarjeve të luftës, të kombinuara me burimet

550 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 58.

551 Balkan Insight (2024), [Kosova dhe Serbia duhet ta mbajnë premtimin e tyre për personat e zhdukur](#).

552 Shihni gjithashtu raportet e viteve 2023, 2022 dhe 2021 për komente të ngjashme nga OSHC-të përkatëse.

553 MPRC (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

554 FDH Kosovë (2024), [Forumi XVI për Drejtësinë Tranzicionale në Shtetet Post-Jugosllave](#).

555 Qeveria e Kosovës (2024), [Strategjia e Republikës së Kosovës për Drejtësinë Tranzicionale 2024-2034](#), faqja 61.

tradicionale të mediave masive; (ii) ekzistencën e dallimeve të konsiderueshme në përgjigjet midis të anketuarve shqiptarë dhe serbë kur bëhet fjalë për njohuritë e tyre mbi luftën, njohuritë për krimet e luftës dhe mendimet e tyre mbi marrëveshjet e paqes dhe marrëdhëniet ndëretnike; (iii) ekzistencën e një korrelacioni midis adresimit të së kaluarës së dhunshme dhe ndjekjes penale të krimeve të luftës me ndërtimin e besimit, pajtimin dhe përmirësimin e marrëdhënieve ndëretnike; (iv) të anketuarit nuk ishin të kënaqur me mënyrën se si shkollat kontribonin në njohuritë e tyre rreth luftës; (v) të anketuarit janë më të prirur të informohen për krimet e luftës të kryera kundër grupeve të tyre etnike krahasuar me ato kundër popullsisë civile të një etnie tjetër; etj.<sup>556</sup>

**408.** Më 18 dhjetor 2024, me vendim të QeK u themelua zyrtarisht “Muzeu i Gjenocidit dhe Përpjekjes për Liri” (Eng: “the Museum of Genocide and Freedom Endeavour”).<sup>557</sup> Kjo pasoi shumë përpjekje të mëparshme të qeverive të mëparshme për të themeluar një qendër të tillë përkujtimore.<sup>558</sup> Ky muze specifik do të përbëjë një njësi të veçantë të Muzeut të Kosovës dhe do t’i dokumentojë krimet e kryera kundër popullsisë së Kosovës dhe të tjerëve gjatë luftës së fundit. Objektivat kryesore janë institucionalizimi i kujtesës kolektive të Kosovës, përkujtimi i krimeve gjenocidale të kryera nga ish-Jugosllavia dhe Serbia.<sup>559</sup> Megjithatë, vlen të përmendet se iniciativa nuk pasqyrohet në Ligjin Nr. 08/L-066 për Buxhetin që u miratua së fundmi.<sup>560</sup>

**409.** Në nëntor të vitit 2024, Fondacioni Jahjaga hapi muzeun e parë të të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë, duke përkujtuar rreth 20,000 viktima të dhunës seksuale. Kultura e përgjithshme e heshtjes rreth çështjes së përdhunimit gjatë luftës mund të ndryshohet ngadalë duke pasur qasje në muze që u japin zë viktimave dhe sigurohen që krimi i përdhunimit dhe dhunës seksuale të mos harrohet nga shoqëria.<sup>561</sup>

**410.** Më 26 dhjetor 2024, Departamenti Special i Gjykatës Themelore në Prishtinë shpalli vendimin e parë ndonjëherë në mungesë kundër Čedomir Aksić, i cili u dënua me 15 vjet burgim për kryerjen e krimeve të luftës kundër civilëve shqiptarë të Kosovës. Sipas OJQ FDHK, ky vendim është një precedent i ri që shënon një ngjarje të rëndësishme në sistemin gjyqësor të Kosovës; megjithatë, ka shqetësime në lidhje me gjykimin në mungesë dhe faktin se ai mund të “ndikojë negativisht në standardet e drejtësisë dhe transparencën në procedurat gjyqësore”.<sup>562</sup> Gjatë vitit 2024, u shpallën katër vendime të tjera fajësie për rastet e krimeve të luftës të kryera nga Muhamet Alidemaj (15 vjet burgim), Dusko Arsić (13 vjet burgim), Ekrem Bajorvić (12 vjet burgim) dhe Časlav Jolić (8 vjet burgim). Tre individë (Zlatan Arsić, Sylejman Selimi dhe Jahir Demaku) të akuzuar për krime lufte u liruan nga akuzat; disa raste të tjera të krimeve të luftës që janë në vazhdim e sipër po gjykohen para gjykatave të Kosovës dhe pritet të përfundojnë në vitet në vijim; ndërsa disa akuza të reja në mungesë u ngritën nga Prokuroria Speciale e Kosovës. Numri i prokurorëve të caktuar në departamentin e krimeve të luftës të ZPS-së u rrit, por vështirësitë për të procesuar numrin e konsiderueshëm të rasteve të prapambetura ende vazhdojnë. Strategjia e re për krimet e luftës është në pritje të miratimit. OJQ FDHK vazhdon të avokojë që Kosova dhe Serbia të angazhohen në një bashkëpunim kuptimplotë ligjor si pjesë e procesit të dialogut dhe t’u mundësojë të dy shteteve, përmes një marrëveshjeje, të bashkëpunojnë dhe të sjellin para drejtësisë të gjithë ata

556 YIHR (2024), [Qëndrimet e të rinjve ndaj luftës dhe krimeve të luftës në Kosovë](#).

557 MKRS (2024), [Themelohet Muzeu i Gjenocidit dhe Përpjekjes për Liri](#).

558 Koha (2024), [Muzeu i Gjenocidit “i themeluar” ndër vite, tash me letra](#).

559 Radio Evropa e Lirë (2024), [Kosova bëhet me Muze të Gjenocidit dhe Përpjekje për Liri](#).

560 Koha (2024), [Muzeu i Gjenocidit “i themeluar” ndër vite, tash me letra](#).

561 Drejtësia Tranzicionale në Ballkan (2024), [Kosova Ndërmerr Hapa të Kujdesshëm Drejt Përkujtimit të Përdhunimeve të Luftës](#).

562 FDHK (2024), [Vendimi i parë në mungesë për krime lufte në praktikën gjyqësore në Kosovë: Një precedent i ri dhe sfidat për drejtësinë](#).



që kanë kryer krime lufte. Një bashkëpunim i tillë shihet si i domosdoshëm për të garantuar procedurën të drejtë dhe të barabartë për të akuzuarit dhe për të siguruar drejtësi për viktimat e luftës.<sup>563</sup>

**411.** Debati mbi transparencën dhe integritetin e Dhomave të Specializuara të Kosovës u zhvillua gjatë gjithë vitit 2024, me ekspertë dhe raportime të medias që pretendonin se mbajtja e shumicës dërrmuese të seancave me dyer të mbyllura shkon kundër parimit të publicitetit dhe transparencës.<sup>564</sup> Sipas ekspertëve ligjorë që kanë folur për BIRN, rreth 60 përqind e dëshmitarëve kanë dëshmuar në seanca të mbyllura për publikun dhe mungesa e vëzhguesve të pavarur në seancat gjyqësore pengon raportimin mbi punën e gjykatës, duke ndikuar kështu në mosbesimin e publikut ndaj Dhomave të Specializuara të Kosovës.<sup>565</sup> Lidhur me temën e transparencës dhe integritetit, OJQ FDHK publikoi një broshurë me titull: “Sa janë transparente Dhomat e Specializuara të Kosovës?”, ku vuri në dukje gjetjet e saj kryesore në lidhje me sfidat e transparencës me të cilat përballlet ky institucion, përkatësisht faktin se: (i) një pjesë e konsiderueshme e seancave gjyqësore janë të mbyllura për publikun, duke çuar në pikëpyetje serioze në lidhje me transparencën e gjykatës; (ii) seancat e mbyllura për publikun dhe qasja e medias në proceset gjyqësore e bënë të vështirë mbikëqyrjen publike mbi vendimet gjyqësore; (iii) publikut po i mohohet e drejta për të dëgjuar deklaratat e dëshmitarëve duke redaktuar të gjithë dëshminë në disa raste dhe jo vetëm informacionin që ndikon në zbulimin e identitetit të dëshmitarëve të mbrojtur.<sup>566</sup>

**412.** Në Kosovë është krijuar një fond për të ofruar ndihmë juridike për individët e akuzuar në Dhomat e Specializuara të Kosovës, dhe ndihmë financiare për familjet e tyre.<sup>567</sup> Në anën tjetër, viktimat e njohura të krimeve të luftës dhe krimeve kundër njerëzimit nuk kanë marrë mbështetje financiare përkatëse. Korrigjimi i kësaj pabarazie në trajtim është thelbësor sipas Komisionit të BE-së dhe një numri të OSHC-ve.<sup>568</sup> Në vitin 2024, Trupi Gjyqësor i Dhomave të Specializuara të Kosovës e shpalli Pjetër Shalën fajtor për krime lufte të ndalimit arbitrar, torturës dhe vrasjes dhe e dënoi atë me 18 vjet burgim<sup>569</sup> ndërsa dënimi për Salih Mustafën u ul nga 22 vjet në 15 vjet burgim nëpërmjet Panelit të Gjykatës së Apelit të Dhomave të Specializuara të Kosovës.<sup>570</sup> Më 6 dhjetor 2024, Zyra e Prokurorit të Specializuar ngriti aktakuzën e dytë kundër Hashim Thaçit në lidhje me veprat e tij të dyshuara penale për pengim të drejtësisë dhe arrestoi Bashkim Smakajn, Isni Kilajn dhe Fadil Fazliun për tentativë pengimi të personave zyrtarë në kryerjen e detyrave zyrtare dhe për shpërfillje të gjykatës. Përveç kësaj, po atë ditë, ish-zëvendëskryeministri dhe Ministri i Drejtësisë, Hajredin Kuçi, u thirr të paraqitej para Dhomave të Specializuara për t’iu përgjigjur dy akuzave të tij për shpërfillje të gjykatës.<sup>571</sup> Të gjitha palët janë deklaruar të pafajshme për këto akuza dhe mbetet të shihet se si do të shkojë procesi i ardhshëm gjyqësor.

563 HLCK (2024), [Vendimi i parë në mungesë për krime lufte në praktikën gjyqësore në Kosovë: Një precedent i ri dhe sfidat për drejtësinë](#).

564 Media DTV (2024), [Qerkini: Specialja e vetmja që mban shumicën e seancave të mbyllura](#); Gazeta Blic (2024), [Nait Hasani: Transparenca e 'Gjykatës Speciale' është zero](#).

565 Balkan Insight, Drejtësia Tranzicionale në Ballkan (2024), [Seancat e mbyllura në Gjykatën e Hagës për Krime të Luftës "Rritin mosbesimin" në Kosovë](#).

566 HLCK (2024), [Sa janë transparente Dhomat e Specializuara të Kosovës?](#)

567 Komisioni i BE-së (2023), Raporti për Kosovën 2023, f. 23.

568 YIHR KS (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut 2024.

569 Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (2024) [Pjetër Shala](#). Për më shumë në lidhje me këtë, shih edhe Radio Evropa e Lirë (2024), [Pjetër Shala dënohet 18 vjet burgim për krime lufte](#);

570 Gazeta Demos (2024), [I zbritet denimi Salih Mustafës, nga 22 në 15 vjet burgim](#).

571 Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar (2024), [ZPS akuzon Thaçin për pengim; arreston Smakaj, Kilaj dhe Fazliu në Kosovë; dhe thërret Kuçin](#).

**413.** Pavarësisht këtyre përparimeve, Kosova vazhdon të përballlet me sfida në zbatimin e plotë të masave të drejtësisë tranzicionale. Nevoja për baza të dhënash gjithëpërfshirëse mbi viktimat e luftës, praktika të standardizuara të publikimit dhe transparencë të shtuar në proceset gjyqësore mbetet kritike. Raportet kanë theksuar domosdoshmërinë për baza të dhënash të strukturuar dhe të validuara, arkivim të përmirësuar të rasteve nga UNMIK-u dhe EULEX-i, dhe transparencë më të madhe në dokumentimin dhe arkivimin e proceseve gjyqësore që lidhen me krimet e luftës.<sup>572</sup> Raporti i BIRN sugjeron disa rekomandime në këtë drejtim, përkatësisht nevojën për të: (i) krijuar një bazë të dhënash të centralizuar dhe të validuar të viktimave të luftës për të siguruar dokumentacion gjithëpërfshirës; (ii) për të standardizuar praktikën e publikimit për të ruajtur qëndrueshmërinë dhe besueshmërinë në raportim; (iii) për rritur transparencën në proceset gjyqësore, duke përfshirë arkivimin e rasteve nga UNMIK dhe EULEX, për të nxitur besimin e publikut; (iv) për të adresuar dezinformimin duke ofruar dokumentacion të saktë dhe të plotë të krimeve të luftës dhe përpjekjeve për drejtësi tranzicionale; dhe (v) për të bashkëpunuar me organizatat e shoqërisë civile për të monitoruar dhe raportuar mbi progresin e nismave të drejtësisë tranzicionale.<sup>573</sup>

**414.** Regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë në Kosovë i vitit 2024 përfshinte pyetje që lidheshin me pasojat e konfliktit të viteve 1998–1999 në Kosovë, duke përfshirë dëmtimin e pronës dhe nëse ndonjë anëtar i familjes ishte vrarë, plagosur ose zhdukur. OJQ NSI vë në pah se pyetjet ishin të kufizuara në periudhën nga 28 shkurti 1998 deri më 12 qershor 1999. Ky afat i caktuar kohor kritikua nga përfaqësuesit e shoqërisë civile serbe për përjashtimin e periudhës pas konfliktit, kur thuhet se ndodhën shumë sulme kundër serbëve të Kosovës dhe komuniteteve të tjera jo-shumicë.<sup>574</sup>

#### **415. Rekomandimet**

- Ministria e Drejtësisë duhet të bëjë një dallim të qartë ligjor midis pensioneve dhe reparacioneve për viktimat e luftës, në mënyrë që të mbijetuarit dhe anëtarët e familjeve të tyre të mos detyrohen të zgjedhin midis përfitimeve sociale dhe kompensimit për shkeljet e të drejtave të njeriut. Ky dallim duhet të sanksionohet ligjërisht për të parandaluar përjashtimet diskriminuese;
- KGJK duhet të rrisë transparencën në procedurat e krimeve të luftës duke siguruar qasje të publikut në proceset gjyqësore jo të ndjeshme dhe duke përmirësuar raportimin publik. Redaktimet dhe seancat e mbyllura duhet të kufizohen në mbrojtjen e viktimave dhe dëshmitarëve në vend që të kufizojnë mbikëqyrjen publike;
- Instituti për Krime Lufte dhe Ministria e Drejtësisë duhet të forcojnë bashkëpunimin rajonal për t'i dokumentuar të gjitha krimet që lidhen me luftën dhe rastet e personave të zhdukur, duke siguruar bashkëpunim gjyqësor ndërshtetëror. Kosova dhe Serbia duhet të angazhohen në marrëveshje ligjore kuptimplote për të lehtësuar ndjekjet penale dhe ekstradimin e kriminelëve të luftës;
- Qeveria e Kosovës dhe institucionet përkatëse duhet ta rishikojnë afatin zyrtar kohor në lidhje me viktimat e luftës për të siguruar që proceset e drejtësisë tranzicionale t'i pasqyrojnë përvojat e të gjitha komuniteteve të prekura.

572 BIRN (2024), [Raporti i BIRN Kosova mbi Drejtësinë Tranzicionale thekson nevojën për krijimin e një baze të dhënash mbi krimet e luftës](#).

573 BIRN (2024), [Raporti i BIRN Kosova mbi Drejtësinë Tranzicionale thekson nevojën për krijimin e një baze të dhënash mbi krimet e luftës](#).

574 NSI (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

## 8.2. Korrupsioni dhe të drejtat e njeriut

**416.** Një ekzaminim i korrupsionit në kontekstin e të drejtave të njeriut ofron një përmbledhje të niveleve të theksuara të shoqërisë në të cilat ndodh korrupsioni dhe pengon arritjen e të drejtave kolektive. Veçanërisht në vendet në zhvillim, adresimi i lidhjes ndërmjet korrupsionit dhe shkeljeve të të drejtave të njeriut ka një rëndësi të veçantë për zhvillimin e shoqërisë sipas parimeve demokratike të barazisë, gjithëpërfshirjes dhe transparencës.

**417.** Kushtetuta e Kosovës nuk i referohet fjalës “korrupsion” në tekstin e saj, por u ofron autoriteteve qeverisëse kornizën kushtetuese për të rregulluar këtë çështje përmes ligjeve dhe themelimit të agjencive të pavarura, në përputhje me nenin 142 të Kushtetutës. Në përputhje me këtë nen, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit u krijua me mandatin për të mbikëqyrur zbatimin e disa ligjeve kryesore që lidhen me parandalimin e korrupsionit, siç janë: Ligji Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, Ligji Nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e një Funkcioni Publik, Ligji Nr. 08/L-108 për Deklarimin, Origjinën dhe Kontrollin e Pasurive Publike dhe Dhuratave dhe Ligji Nr. 06/L-085 për Mbrojtjen e Sinjalizuesve. Në vitin 2024, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin për Prokurorinë Speciale për të përmirësuar reagimin e drejtësisë penale ndaj rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë. Ky ligj synon të përmirësojë ndjekjen penale të krimeve të rënda, përfshirë krimet e luftës, duke forcuar kapacitetin dhe pavarësinë e Prokurorisë Speciale.<sup>575</sup> Strategjia e Sundimit të Ligjit e Kosovës (2021-2026) thekson luftën kundër korrupsionit përmes vetingut gjyqësor dhe reformave institucionale.<sup>576</sup>

**418.** Ndërkohë që Kosova ende nuk e ka nënshkruar Konventën e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit (UNCAC) për shkak të pamundësisë së saj për t’iu përmbajtur konventave të OKB-së, Koalicioni i Shoqërisë Civile UNCAC konsideron se Kosova ka demonstruar një angazhim të madh për të ndërtuar një infrastrukturë ligjore dhe institucionale për të luftuar korrupsionin përmes masave legjislative të cilat janë në përputhje me parimet e UNCAC.<sup>577</sup> Megjithatë, pavarësisht kornizës solide legjislative mbi ligjet dhe politikat kundër korrupsionit, Koalicioni UNCAC konsideron se “vazhdojnë të ekzistojnë sfida të rëndësishme në zbatimin e tyre efektiv”, me agjencitë e zbatimit të ligjit që nuk kanë arritur të japin rezultatet e dëshiruara.<sup>578</sup>

**419.** Raporti i Komisionit të BE-së i vitit 2024 thekson përparim të kufizuar në luftën e Kosovës kundër korrupsionit në vitin 2024. Pati disa përparime në gjykimin e rasteve të korrupsionit, të cilat rezultuan në një numër më të lartë vendimesh gjyqësore dhe dënimesh përfundimtare; megjithatë, rezultatet u ndikuan shumë nga mungesa e burimeve dhe mungesa e paanshmërisë dhe llogaridhënies brenda gjyqësorit dhe shërbimeve të prokurorisë. Ndërsa ka pasur përparim në shkallën e zgjidhjes së rasteve civile, efikasiteti i përgjithshëm, trajtimi në kohë dhe shkalla e zgjidhjes së rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë mbeten të kufizuara. Autoritetet e Kosovës

575 YIHR KS (2025), Kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë në vitin 2024.

576 Ministria e Drejtësisë (2025), [Strategjia për Sundimin e Ligjit](#).

577 Koalicioni i Shoqërisë Civile UNCAC (2024), [Raporti i ri i shoqërisë civile për Kosovën: Nevoja për llogaridhënie më të madhe, zbatim më të mirë dhe pavarësi gjyqësore](#).

578 Koalicioni i Shoqërisë Civile UNCAC (2024), [Raporti i ri i shoqërisë civile për Kosovën: Nevoja për llogaridhënie më të madhe, zbatim më të mirë dhe pavarësi gjyqësore](#).

inkurajohen dhe u kërkohet të tregojnë një angazhim më madh për të krijuar një bazë të fortë në luftimin e rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë, ndër të tjera, duke forcuar përdorimin e mjeteve antikorrupsion, siç janë planet e integritetit dhe deklaratat e pasurisë së institucioneve publike. Për të siguruar një trajtim më efikas të rasteve të korrupsionit të nivelit të lartë, duhet të forcohet bashkëpunimi midis policisë, shërbimeve të prokurorisë dhe gjyqësorit.<sup>579</sup>

**420.** Një raport i rëndësishëm i shoqërisë civile mbi zbatimin e Kapitujve II dhe V të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit në Kosovë u botua nga OJQ Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) në vitin 2024.<sup>580</sup> Ndër të tjera, Raporti analizoi performancën e institucioneve kryesore kundër korrupsionit dhe i renditi ato si më poshtë: (i) Organi Shqyrtues i Prokurimit, Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Prokurori i Shtetit, morën një rezultat “të dobët” performance; (ii) Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Këshilli Gjyqësor i Kosovës, Agjencia për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara ose të Konfiskuara, Njësia e Inteligjencës Financiare dhe Zyra Kombëtare e Auditimit morën një rezultat “mesatar” performancës; ndërsa (iii) Agjencia për Informim dhe Privatësi ishte i vetmi institucion që mori një rezultat “të mirë”.<sup>581</sup> Një analizë e thelluar e neneve specifike të UNCAC zbuloi se ekziston një mospërputhje e dukshme midis statusit të zbatimit në ligj kundrejt statusit të zbatimit në praktikë, me shumicën e dispozitave të UNCAC që zbatohen dobët në praktikë.<sup>582</sup> Raporti i IKD-së liston 26 rekomandime konkrete për veprime prioritare për të ndihmuar në përmirësimin e zbatimit të UNCAC në Kosovë dhe kështu të tregohet një vendosmëri më e fortë për të parandaluar dhe luftuar korrupsionin.<sup>583</sup>

**421.** Në vitin 2024, OSBE-ja publikoi *Raportin e Monitorimit të Rasteve Gjyqësore në Ballkanin Perëndimor: Nga Letra në Praktikë*, që mbulon periudhën korrik 2021 deri në mars 2024, me një kapitull të dedikuar për Kosovën. Raporti identifikon sfidat sistematike në trajtimin e rasteve të krimit të organizuar dhe korrupsionit, duke përfshirë zbatimin e dobët të Kodit të Procedurës Penale, praktikën gjyqësore jokonsistente, aktakuzat me cilësi të ulët, mungesën e transparencës, rigjykimet e përsëritura dhe qasjen e kufizuar në vendimet gjyqësore në të gjitha gjuhët zyrtare. Raporti paralajmëron se këto çështje përforcojnë perceptimet e pandëshkueshmërisë dhe zvogëlojnë besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Raporti i monitorimit i EULEX-it për vitin 2024 i pasqyron këto shqetësime, duke theksuar nevojën urgjente për t'i forcuar kapacitetet prokuroriale, gjyqësore dhe ligj-zbatuese për të adresuar në mënyrë efektive korrupsionin e nivelit të lartë dhe krimin e organizuar.<sup>584</sup>

579 Komisioni i BE-së (2021), Raporti për Kosovën 2024, f. 6.

580 IKD (2024), [Raporti i Shoqërisë Civile mbi zbatimin e Kapitullit II \(Parandalimi\) dhe Kapitullit V \(Rikuperimi i Aseteve\) të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit në Kosovë](#).

581 IKD (2024), [Raporti i Shoqërisë Civile mbi zbatimin e Kapitullit II \(Parandalimi\) dhe Kapitullit V \(Rikuperimi i Aseteve\) të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit në Kosovë](#), shih Tabelën 2: Performanca e institucioneve kryesore të përzgjedhura për më shumë komente mbi performancën e tyre dhe fushat ku ato duhet të përmirësohen për të përmbushur më mirë mandatin e tyre.

582 IKD (2024), [Raporti i Shoqërisë Civile mbi zbatimin e Kapitullit II \(Parandalimi\) dhe Kapitullit V \(Rikuperimi i Aseteve\) të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit në Kosovë](#), shih Tabelën 1: Përmbledhje e zbatimit për më shumë detaje mbi statusin e zbatimit të neneve të UNCAC në Kosovë.

583 IKD (2024), [Raporti i Shoqërisë Civile mbi zbatimin e Kapitullit II \(Parandalimi\) dhe Kapitullit V \(Rikuperimi i Aseteve\) të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit në Kosovë](#), shih Tabelën 1: Përmbledhje e zbatimit për më shumë detaje mbi statusin e zbatimit të neneve të UNCAC në Kosovë.

IKD (2024), [Raporti i Shoqërisë Civile mbi zbatimin e Kapitullit II \(Parandalimi\) dhe Kapitullit V \(Rikuperimi i Aseteve\) të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit në Kosovë](#), shih Tabelën 1: Përmbledhje e zbatimit për më shumë detaje mbi statusin e zbatimit të neneve të UNCAC në Kosovë.

IKD (2024), [Raporti i Shoqërisë Civile mbi zbatimin e Kapitullit II \(Parandalimi\) dhe Kapitullit V \(Rikuperimi i Aseteve\) të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit në Kosovë](#), shih faqet 90-91 për një listë të plotë të rekomandimeve.

584 OSBE (2024), [Raporti i Monitorimit të Rasteve Gjyqësore në Ballkanin Perëndimor: Nga letra në praktikë – Vlerësimi i Efektivitetit të Përgjigjeve Gjyqësore ndaj Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit të Rëndë](#). Duhet theksuar: Raporti ka kryer monitorim të procesit gjyqësor për rastet e krimit të organizuar dhe korrupsionit që rrjedhin nga Gjykata Supreme e Kosovës, Gjykata e Apelit e Kosovës dhe 7 gjykatat kryesore themelore në Kosovë.

**422.** Sipas Raportit Vendor për Kosovën 2024 të publikuar nga Indeksi i Transformimit BTI, pavarësisht premtimeve të larta të Qeverisë së Kosovës për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar, pak është arritur në këtë fushë.<sup>585</sup> Korrupsioni është konsideruar si një nga çështjet kryesore që ka nevojë urgjente për zgjidhje, me gjyqësorin që është i kompromentuar nga nivelet e larta të korrupsionit dhe mungesa e zbatimit të kornizës ligjore kundër korrupsionit. Në shumë raste të rëndësishme korrupsioni të nivelit të lartë që përfshinin politikanë kryesorë, ata që janë shpallur fajtorë shpesh janë dënua me librim me kusht. Ngjashëm me Raportin e OSBE-së të raportuar më sipër, Indeksi i Transformimit i BTI-së gjithashtu konsideron se konfiskimi i aseteve është veçanërisht i kufizuar në rastet e korrupsionit të nivelit të lartë. Gjetje të tjera të rëndësishme të këtij Raporti përfshijnë faktin se: (i) korrupsioni është i përhapur në administratën publike; (ii) agjencitë kundër korrupsionit nuk kanë stafin e nevojshëm; (iii) korrupsioni po pengon zhvillimin e sektorit privat, me praktikën e korrupsionit që veprojnë si pengesa për biznese të ndryshme private; (iv) korrupsioni gjendet kryesisht në shërbimet publike si energjia, farmaceutika, telekomunikacioni, shërbimet postare, hekurudhat, trafiku ajror dhe ndërtimi, etj.<sup>586</sup>

**423.** Sipas një ankete të opinionit të kryer nga UNDP, perceptimi i qytetarëve të Kosovës është se niveli më i lartë i korrupsionit ekziston brenda gjyqësorit, Doganave të Kosovës dhe KEDS, ndërsa Policia e Kosovës rezultoi si institucioni publik më pak i korruptuar në perceptimin e të anketuarve.<sup>587</sup>

**424.** Në vitin 2024, Kosova e përmirësoi pozitën e saj duke u renditur në vendin e 73-të nga 180 vende në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International, nga vendi i 83-të në vitin 2023. Gjersa kjo shënon një përparim modest në përpjekjet e perceptuara për të luftuar korrupsionin, përmirësimi mbetet i brishtë, veçanërisht në dritën e shqetësimeve të vazhdueshme për ndërhyrjen politike në gjyqësor, duke nënvizuar nevojën për reforma të vërteta dhe forcimin e pavarësisë institucionale.<sup>588</sup>

**425.** Lufta kundër korrupsionit është një sfidë e madhe për shoqëritë moderne, ku OSHC-të luajnë një rol jetësor. Njohuritë digjitale u mundësojnë OSHC-ve të monitorojnë, analizojnë dhe raportojnë korrupsionin në mënyrë më efektive, duke kontribuar në një shoqëri më transparente dhe të drejtë. Udhëzuesi «Korrupsioni Digjital - Sfidat e Epokës Moderne» u hartua nga Rrjeti i Aktivizmit Civil, me mbështetjen e OJQ AKTIV, për t'i ndihmuar OSHC-të që ta luftojnë korrupsionin digjital, veçanërisht në komunitetet jo-shumicë të Kosovës.<sup>589</sup>

**426.** Ndërsa digjitalizimi rrit transparencën dhe zvogëlon gabimet njerëzore, kjo gjithashtu paraqet sfida të reja. Keqpërdorimi i TI-së për korrupsion mund të ndodhë në qeveri, ndërmarrje publike ose në çdo nivel autoriteti, me mjete digjitale që lehtësojnë aktivitete korruptive të fshehura ose të pazbuluara. Korrupsioni digjital përfshin përdorimin e teknologjive digjitale (si platformat online, softuerët dhe bazat e të dhënave) për të manipuluar të dhënat, për të lehtësuar ryshfetet ose për

585 Indeksi i Transformimit i BTI-së, [Raporti Vendor për Kosovën 2024](#).

586 Indeksi i Transformimit i BTI-së, [Raporti Vendor për Kosovën 2024](#).

587 Kallxo (2024), [UNDP tregon se cili institucion e mendojnë si më të korruptuar në Kosovë](#).

588 Transparenca Ndërkombëtare (2024), [Indeksi i perceptimit të korrupsionit](#).

589 AKTIV (2025), Kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.



të fshehur transaksione të paligjshme. Ky lloj korrupsioni mbivendoset me korrupsionin kibernetik, i cili i referohet konkretisht korrupsionit përmes kanaleve kibernetike, duke përfshirë hakimin, phishing dhe ransomware. Korrupsioni kibernetik përfshin përdorimin e mjeteve dhe platformave kibernetike si kriptovalutat, dark web dhe hakimin për aktivitete korruptive si ryshfeti, zhvatja ose manipulimi i të dhënave. Kjo gjithashtu përfshin përdorimin e teknologjive si deepfakes për të mashtruar ose dëmtuar individët për qëllime korruptive. Shkurt, epoka digjitale paraqet si mundësi ashtu edhe rreziqe të reja për korrupsion, duke shfaqur kështu nevojën për njohuri dhe vigjilencë të madhe digjitale nga organizatat e shoqërisë civile.<sup>590</sup>

#### 427. Rekomandimet

- Qeveria e Republikës së Kosovës duhet ta rrisë pavarësinë dhe kapacitetin e institucioneve kundër korrupsionit. Kjo përfshin ndarjen e fondeve të mjaftueshme dhe zvogëlimin e ndërhyrjeve politike në proceset gjyqësore;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) duhet të sigurojnë qëndrueshmëri dhe transparencë në gjykimin e rasteve të korrupsionit duke adresuar numrin e lartë të lirimeve dhe rigjykimeve;
- Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit duhet ta përmirësojë zbatimin e ligjeve për deklarimin e pasurisë duke krijuar një mekanizëm të pavarur monitorimi dhe duke rritur dënimet për mosrespektimin e tyre;
- Ministria e Drejtësisë duhet t'i japë përparësi miratimit të Draft-strategjisë Shtetërore Kundër Korrupsionit 2024-2027 dhe Planit të Veprimit;
- Ministria e Punëve të Brendshme duhet të zhvillojë një strategji kombëtare për të luftuar korrupsionin digjital dhe ryshfetin kibernetik, duke siguruar që institucionet qeveritare, bizneset dhe organizatat e shoqërisë civile të jenë të pajisura me mjete digjitale për të gjurmuar dhe parandaluar transaksionet financiare të paligjshme.

### 8.3. Mjedi dhe të drejtat e njeriut

**428.** Të drejtat e njeriut dhe mjedi janë të lidhura ngushtë me njëra-tjetrën.<sup>591</sup> Të drejtat e njeriut nuk mund të gëzohen pa një mjedi të qëndrueshëm, të sigurt dhe të shëndetshëm. Efektet negative të ndryshimeve klimatike kërcënojnë gëzimin e plotë të të drejtave të njeriut, duke përfshirë të drejtat për një mjedi të qëndrueshëm, të sigurt dhe të shëndetshëm, të drejtën për jetë, ujë, kanalizim, ushqim, shëndet, strehim, vetëvendosje, kulturë dhe zhvillim.<sup>592</sup> Në korrik 2022, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi një rezolutë në të cilën deklarohet se "të gjithë në planet kanë të drejtë për një mjedi të shëndetshëm".<sup>593</sup> Rezoluta është një vendim historik që deklaron në mënyrë të qartë qasjen në një mjedi të pastër dhe të shëndetshëm si një të drejtë universale të njeriut.<sup>594</sup> Më pas, ajo u bën thirrje palëve të interesit të rrisin përpjekjet e

590 AKTIV (2025), Kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

591 Rrjeti i Mjedisit në Gjenevë [Geneva Environment Network](#) (2023).

592 OHCHR [OHCHR](#) (2022).

593 Rrjeti i Mjedisit në Gjenevë [Geneva Environment Network](#) (2023).

594 Kombet e Bashkuara (2022), [Asambleja e Përgjithshme e OKB-së shpall qasjen në një mjedi të pastër dhe të shëndetshëm si një të drejtë universale të njeriut](#).

tyre për të zbutur efektet e krizës klimatike, duke përfshirë shtetet, organizatat ndërkombëtare dhe bizneset.

**429.** Kushtetuta e Kosovës nuk e njeh të drejtën për një mjedis të shëndetshëm. Megjithatë, në nenin 52 thuhet se “Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi dhe trashëgimia kombëtare janë përgjegjësi e të gjithëve” dhe se “Çdokujt duhet t’i jepet mundësia të dëgjohet nga institucionet publike dhe të merren parasysh mendimet e tyre për çështje që ndikojnë në mjedisin në të cilin ata jetojnë”. Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit Mjedisor, Ligji Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, Ligji Nr. 08/L-250 për Ndryshimet Klimatike janë instrumente të rëndësishme ligjore për të mbrojtur mjedisin në Kosovë. KEDNJ nuk e njeh në mënyrë eksplicite të drejtën për një mjedis të shëndetshëm. Megjithatë, një numër standardesh ligjore ndërkombëtare të zhvilluara nga Këshilli i Evropës, përkatësisht KEDNJ, Karta Sociale Evropiane dhe Konventa e Bernit për ruajtjen e jetës së egër evropiane, janë përdorur me sukses për të bërë progres në çështjet mjedisore në të gjithë Evropën.<sup>595</sup>

**430.** Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ) ka gjykuar më shumë se 300 raste që lidhen me mjedisin, ku ka zbatuar koncepte të tilla si e drejta për jetë, jetë familjare, dhe liri të fjalës në një gamë të gjerë çështjesh mjedisore, duke përfshirë ndotjen, fatkeqësitë e shkaktuara nga njeriu ose fatkeqësitë natyrore, dhe qasjen në informacionin mjedisor.<sup>596</sup> Në prill të vitit 2024, GJEDNJ vendosi për tre raste të ndryshimeve klimatike, përkatësisht rastin nr. 1 *Verein KlimaSeniorinnen Schweiz dhe të tjerët kundër Zvicrës* (ku katër gra dhe një OJQ u ankuan për pasojat e ngrohjes globale në kushtet e tyre të jetesës dhe shëndetin e tyre); rastin nr. 2 *Carême kundër Francës* (ku një banor i një komune në Francë u ankua se Franca kishte ndërmarrë hapa të pamjaftueshëm për të parandaluar ngrohjen globale, gjë që po ndërhyr në të drejtën e tij për jetë dhe të drejtën për respektimin e jetës private dhe familjare); dhe rastin nr. 3 *Duarte Agostinho dhe të tjerët kundër Portugalisë dhe 32 shteteve të tjera* (ku disa fëmijë/të rinj u ankuan për efektet aktuale dhe të ardhshme të ndryshimeve klimatike dhe ndikimin e tyre në jetën, mirëqenien, shëndetin mendor dhe gëzimin paqësor të shtëpive të tyre).<sup>597</sup> Gjersa rastet nr. 2 dhe 3 u hodhën poshtë si të papranueshme, në rastin nr. 1, GJEDNJ-ja vendosi që Zvicra “nuk kishte përmbushur detyrimet e saj (“detyrimet pozitive”) sipas Konventës në lidhje me ndryshimet klimatike”.<sup>598</sup> Këto raste ia vlen të përmenden duke pasur parasysh se qytetarët e Kosovës që kanë shqetësime mjedisore dhe OSHC-të që punojnë në çështje mjedisore kanë të drejtë t’i referohen drejtpërdrejt këtyre rasteve në gjykatat e rregullta.

**431.** Në vitin 2024, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin e parë për Ndryshimet Klimatike në Kosovë.<sup>599</sup> Qëllimi i Ligjit është t’i përcaktojë përgjegjësitë dhe detyrat e autoriteteve shtetërore në marrjen e masave për zbutjen e efekteve të ndryshimeve klimatike. Ligji zbatohet për të gjithë operatorët dhe sektorët, aktiviteti i të cilëve ka ndikim në ndryshimet klimatike, përkatësisht industrinë e energjisë, prodhimin, ndërtimin, karburanteve, minierave, pylltarisë, biodiversitetit, zonave të mbro-

595 Këshilli i Evropës (2024), [Mbrojtja e mjedisit duke përdorur ligjin e të drejtave të njeriut](#).

596 Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (2024), [Mjedisi dhe Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut](#).

597 Dhoma e Madhe e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (2024), [Vendimet e Dhomës së Madhe në çështjet e ndryshimeve klimatike](#).

598 Dhoma e Madhe e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (2024), [Vendimet e Dhomës së Madhe në çështjet e ndryshimeve klimatike](#).

599 [Ligji nr. 08/L-250 për Ndryshimet Klimatike](#) (2024).

jtura, bujqësisë dhe blegtorisë, menaxhimit të mbeturinave dhe ujërave, shëndetësisë, transportit, rrugëve dhe hekurudhave, aeroporteve, digave, turizmit, etj. Ligji gjithashtu rendit objektivat, parimet e tij, masat e ndryshimeve klimatike, masat e monitorimit dhe raportimit, ndërsa ofron edhe bazën ligjore për krijimin e një Këshilli Kombëtar për Ndryshimet Klimatike. Në përgjithësi, Ligji ka qëllime shumë ambicioze dhe kërkon miratimin e të paktën pesë dokumenteve strategjike ose planeve kombëtare, siç janë miratimi i: (i) Strategjisë Afatgjatë për Dekarbonizimin; (ii) Strategjisë për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike; (iii) Planit të Veprimit për Përshtatjen ndaj Ndryshimeve Klimatike; (iv) Planit Kombëtar për Energjinë dhe Klimën; (v) Kontributit Kombëtar të Përcaktuar. Mbetet për t'u parë nëse Qeveria e Republikës së Kosovës dhe organet ndërminstrore përgjegjëse për zbatimin e këtij Ligji do të jenë në gjendje t'i përmbahen standardeve dhe objektivave të larta të përcaktuara prej tij. Komisioni i BE-së ka vënë në dukje tashmë se ka një numër dokumentesh që ende mbesin për tu hartuar dhe se kapaciteti i institucioneve publike, përfshirë inspektoratet, për të përmbushur përgjegjësitë e tyre në lidhje me ndryshimet klimatike duhet të "forcohet urgjentisht dhe ndjeshëm".<sup>600</sup>

**432.** Agjenda e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor synon të pasqyrojë Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane në një mënyrë proporcionale dhe të përshtatur për vendet përkatëse.<sup>601</sup> Objektivi është që sfidat rajonale mjedisore dhe klimatike të shndërrohen në mundësi dhe zgjidhje të ripërtëritshme. Duke pasur parasysh se burimet natyrore dhe ndryshimet klimatike nuk njohin kufij, Agjenda e Gjelbër parashikon veprim të përbashkët rajonal, i cili do të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik dhe rimëkëmbjen e gjelbër të të gjithë rajonit në periudhën pas pandemisë.

**433.** Monitorimi në kohë reale i cilësisë së ajrit tani është bërë i mundur nëpërmjet një rrjeti prej 12 stacionesh monitorimi të ajrit të pozicionuara në vende të shpërndara gjeografikisht në komunat e Kosovës. Kjo mundëson matjen e cilësisë së ajrit në Kosovë në kohë reale. Qasja nga këto 12 stacione është e arritshme nëpërmjet platformës së Indeksit Evropian të Cilësisë së Ajrit të Agjencisë Evropiane të Mjedisit (EEA).<sup>602</sup> Monitorimi i ajrit bëhet bazuar në Ligjin Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja dhe legjislacionin dytësor të nxjerrë posaçërisht për këtë qëllim, përkatësisht Udhëzimin Administrativ Nr. 09/2023 mbi metodën e monitorimit të cilësisë së ajrit, mbledhjen e të dhënave, kriteret dhe metodologjinë.<sup>603</sup> Pavarësisht disa përparimeve të vërejtura në përmirësimin e cilësisë së ajrit, kjo çështje vazhdon të jetë një rrezik i madh shëndetësor për shkak të vonësive në zbatimin e plotë të masave të duhura korrigjuese që do të ndihmonin në frenimin e ndotjes së ajrit.<sup>604</sup>

**434.** Cilësia e ajrit në Kosovë është një shqetësim i madh shëndetësor, me një përqendrim mesatar të PM2.5 2.4 herë më të lartë se vlera vjetore e udhëzimit të OBSH-së për cilësinë e ajrit.<sup>605</sup> Një faktor kyç që kontribuon në situatën aktuale është varësia nga energjia e qymyrit për të siguruar furnizimin me energji, si dhe praktika e djegies së lëndëve djegëse të ngurta, përfshirë dru zjarri, për ngrohje dhe gatim shtëpiak. Një analizë diakronike e trendit që mbulon vitet 2018-2024 tregon se cilësia e ajrit - e paraqitur këtu në mikrogramë për metër kub ajër - i tejkalon vazhdimisht udhëzimet e OBSH-së për cilësinë e ajrit prej 10 µg/m<sup>3</sup>, me vitin 2024 që shënon një rritje në in-

600 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 84.

601 Komisioni Evropian (2020), [Udhëzime për Zbatimin e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor](#).

602 IQ Air (2024), [Cilësia e ajrit në Kosovë](#).

603 Gazeta Zyrtare, [Legjislacioni primar dhe sekondar për parandalimin e ndotjes së ajrit](#).

604 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 82.

605 IQ Air (2024), [Sa është e ndotur Kosova?](#)

deksin mesatar të cilësisë së ajrit nga 19 në vitin 2023 në 24 në vitin 2024.<sup>606</sup> Prishtina vazhdimisht përbën cilësinë më të keqe të ajrit brenda Kosovës, ndërsa gjatë vitit 2024, Vitia ishte qyteti më i pastër në Kosovë. Ka momente, veçanërisht gjatë dimrit, kur përqendrimi mesatar i PM2.5 në kryeqytetin e Kosovës është 20.7 herë më i lartë se vlera vjetore e rekomanduar e PM2.5 (të dhënat e 2 janarit 2025). Kjo bën që Prishtina për fat të keq të konsiderohet si një qytet që rivalizon qytete të mëdha si Pekini, Mumbai dhe Nju Delhi kur bëhet fjalë për ndotjen e ajrit, sipas një studimi të Bankës Botërore.<sup>607</sup>

**Tabela 4. Cilësia e ajrit në mikrogramë për metër kub ajër në Kosovë nga viti 2018 deri në vitin 2024**

| Viti                                                            | 2018 | 2019 | 2020 | 2021 | 2022 | 2023 | 2024 | Udhëzimi i OBSH-së |
|-----------------------------------------------------------------|------|------|------|------|------|------|------|--------------------|
| Indeksi Mesatar i Cilësisë së Ajrit në $\mu\text{g}/\text{m}^3$ | 30.4 | 23.5 | 20.0 | 14.7 | 19.4 | 19.0 | 24   | 10                 |

**435.** Burimet kryesore të ndotjes së ajrit janë emetimet nga djegia e lëndëve djegëse të ngurta, përfshirë qymyrin dhe drurin, si në vend ashtu edhe në industrinë e energjisë, e cila përdor termocentrale me qymyr. Sipas Bankës Botërore, kjo përbën rreth gjysmën e emetimeve të grimcave 2.5 (PM2.5) në Kosovë (shih paragrafin vijues). Ndërsa rreth 20 përqind e ndotjes së ajrit në Kosovë vjen nga jashtë vendit, shumica është rezultat i burimeve që mund të kontrollohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës.<sup>608</sup>

**436.** Termocentralet me qymyr në Kosovë përbëjnë një burim të madh të ndotjes së ajrit. Dy termocentralet ekzistuese, Kosova A dhe Kosova B, ndodhen në qytetin e Obiliqit, i cili është fqinj me Prishtinën dhe për këtë arsye është përgjegjës për pjesën më të madhe të ndotjes së ajrit në qytet. Duhet theksuar se termocentralet renditen si termocentralet e para dhe të treta më të ndotura në Evropë. Së bashku, ato emetojnë katër herë më shumë PM2.5 sesa shumica e termocentraleve të tjera me qymyr në rajonin e Ballkanit.<sup>609</sup> Gjersa ato i sigurojnë Kosovës infrastrukturën e saj energjetike, ndotja e ajrit që rezulton është e dëmshme për mjedisin natyror dhe shëndetin e njeriut.

**437.** Përveç rreziqeve për shëndetin e njeriut, ndotja e ajrit e dëmton edhe mjedisin natyror. Komponimet kimike si oksidi i azotit dhe amoniaku i lëshuar në tokë dhe ujë rezultojnë në hapësira të çekuilibruara kimike me çrregullime të konsiderueshme në ekosistemet natyrore dhe biodiversitetin. Ndikime të tjera përfshijnë erozionin e ndërtesave dhe shiun acid që kontribuon në dëmtimin e bimëve, pyjeve dhe të korrave. Një burim veçanërisht i rëndësishëm për ngrohjen globale dhe ndryshimet klimatike ka të bëjë me emetimet e gazrave serrë.

606 Indeksi i Cilësisë së Ajrit (2024), [Indeksi i Cilësisë së Ajrit në Kosovë](#).

607 Banka Botërore (2019), <https://documents1.worldbank.org/curated/en/519991508764269649/pdf/ACS21442-WP-ALBANIAN-93p-KOSOVO-Jobs-Diagnostic-Final-for-printing-ALB.pdf>.

608 IQ Air (2024), [Cilat janë burimet kryesore të ndotjes së ajrit në Kosovë?](#)

609 IQ Air (2024), [Cilat janë burimet kryesore të ndotjes së ajrit në Kosovë?](#)

**438.** Tri projektet e hidrocentraleve në lumin e Deçant, Lumbardhi/Bistrica dhe Belaja/Belica, kanë qenë objekt i një mosmarrëveshjeje ligjore midis Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës së Kosovës dhe investitorit austriak të hidrocentraleve KelKos, për vite me radhë.<sup>610</sup> Në korrik 2024, Qendra për Raste Gjyqësore Strategjike në Kosovë, së bashku me OJQ-në “Pishtarët” dhe tre qytetarë nga Deçani, ngritën një padi në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës duke argumentuar, ndër të tjera, shkelje të Nenit 52 (Përgjegjësia për Mjedisin) të Kushtetutës.<sup>611</sup> Aplikantët konsiderojnë se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme e kanë interpretuar Ligjin Nr. 04/L-147 për Ujërat në mënyrë arbitrare dhe kanë neglizhuar dëmin e dukshëm mjedisor të krijuar nga këto tre hidrocentrale. Deri më tani, Gjykata Kushtetuese ka gjetur vetëm një herë shkelje të Nenit 52 të Kushtetutës në vitin 2010.<sup>612</sup> Mbetet për t’u parë se çfarë qëndrimi do të mbajë në lidhje me hidrocentralet e famshme të Deçanit.

**439.** Strategjia e re e Energjisë e Kosovës (2022-2031) shmang zhvillimin e mëtejshëm të hidrocentraleve për shkak të shqetësimeve mjedisore. Ky është një hap i rëndësishëm përpara që e bën Kosovën të parën në rajon që ndalon promovimin e hidrocentraleve të reja. Strategjia planifikon rritje ambicioze në energjinë e ripërtëritshme, duke synuar dekarbonizimin deri në vitin 2050.<sup>613</sup> Nënshkruesit e Agjendës së Gjellbër angazhohen për dekarbonizim deri në vitin 2050, duke i dhënë fund kështu përdorimit të të gjitha lëndëve djegëse fosile: naftës, gazit dhe qymyrit.

#### **440. Rekomandimet**

- Qeveria e Kosovës duhet t’i japë përparësi financimit dhe koordinimit ndërministror për të siguruar zbatimin efektiv të ligjeve dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me klimën në Kosovë;
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës duhet të forcojë mekanizmat zbatues për të frenuar ndotjen industriale, veçanërisht nga termocentralet me qymyr Koso-va A dhe Kosova B;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Gjykata Kushtetuese duhet të sigurojnë mbikëqyrje më të fortë gjyqësore mbi kontestet gjyqësore mjedisore duke i dhënë përparësi rasteve që kanë të bëjnë me degradimin mjedisor dhe të drejtën për një mjedis të shëndetshëm;

### **8.4. E drejta për barazi dhe mosdiskriminim**

**441.** Mosdiskriminimi është një e drejtë themelore e njeriut që është e sanksionuar në traktate të ndryshme ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, duke përfshirë DUDNJ, Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe Paktin Ndërkombëtar për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore. Në nivelin e KEDNJ-së, mbrojtja kundër diskriminimit sigurohet nëpërmjet dy dispozitave të ndryshme, përkatësisht Nenit 14 të KEDNJ-së i cili sanksionon mbrojtjen kundër diskriminimit në gëzimin e të drejtave të përcaktuara në Konventë; ndërsa Neni 1 i Protokollit Nr. 12 të KEDNJ-së zgjeron fushëveprimin e mbrojtjes kundër diskriminimit në “çdo të drejtë të përcaktuar me ligj” duke futur kështu një ndalim të përgjithshëm të diskriminimit që nuk është domosdoshmërisht

<sup>610</sup> Pishtarët (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

<sup>611</sup> Qendra për Raste Gjyqësore Strategjike (2024), [Dorëzohet kërkesa për vlerësimin e kushtetutshmërisë së aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës për hidrocentralet e Deçanit](#).

<sup>612</sup> Gjykata Kushtetuese e Kosovës, çështja nr. KI 56/09, [Fadil Hoxha dhe 59 të tjerë kundër Kuvendit Komunal të Prizrenit](#).

<sup>613</sup> YIHR KS (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.



i ngjashëm me të drejtat e KEDNJ-së.<sup>614</sup> Kosova ka detyrim ligjor për të siguruar që të gjithë individët brenda juridiksionit të saj të mbrohen nga diskriminimi në bazë të racës, përkatësisë etnike, gjinisë, moshës, fesë, orientimit seksual dhe karakteristikave të tjera të mbrojtura.

**442.** Kushtetuta e Kosovës i referohet barazisë në nenin 3 të Kushtetutës, ku parashikohet se ushtrimi i autoritetit publik në vend duhet të bazohet në parimin e barazisë para ligjit për të gjithë individët. Neni 24 i Kushtetutës më pas ndalon në mënyrë të qartë diskriminimin dhe garanton mbrojtje të barabartë sipas ligjit për të gjithë individët. Për më tepër, si barazia ashtu edhe mosdiskriminimi janë pjesë e vlerave kushtetuese të shpallura në nenin 6 të Kushtetutës, mbi bazën e të cilave do të funksionojë rendi kushtetues i Republikës.

**443.** Ligji Nr. 05/L-020 për Barazinë Gjinore, Ligji Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Kodi Penal Nr. 04/L-082 gjithashtu ofrojnë një kornizë ligjore për mbrojtje të individëve nga diskriminimi dhe për t'i mbajtur kryesit përgjegjës. Ligji Nr. 05/L-019 për Institucionin e Avokatit të Popullit e ka autorizuar Institucionin e Avokatit të Popullit për promovimin, monitorimin dhe mbështetjen e trajtimit të barabartë pa diskriminim bazuar në Ligjin për Barazinë Gjinore dhe Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Avokati i Popullit mund të paraqitet gjithashtu në cilësinë e mikut të gjykatës (*amicus curiae*) në proceset gjyqësore që merren me të drejtat e njeriut, barazinë dhe mbrojtjen nga diskriminimi, përfshirë edhe para Gjykatës Kushtetuese. Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, Nr. 2007/08 për Themelimin e Njësive për të Drejtat e Njeriut në Komuna, ka parashikuar themelimin e njësive të përbëra nga të paktën tre zyrtarë, përfshirë koordinatorin e Njësive për të Drejtat e Njeriut.<sup>615</sup> Zyra për Qeverisje të Mirë (ZQM), së bashku me Grupin Punues Ndërmënyës Qeveritare për të Drejtat e Njeriut, është një mekanizëm tjetër institucional që synon koordinimin e përpjekjeve kundër diskriminimit në të gjitha institucionet.

**444.** Një vlerësim ex-post i Ligjit Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi u krye në vitin 2023, nga një grup pune i përbërë nga anëtarë të OSHC-ve, ndër të tjerë.<sup>616</sup> Bazuar në këtë Raport, një ndryshim në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka filluar në vitin 2024 dhe po vazhdon me qëllim që kjo nismë e re ligjore të vihet në konsultime publike në vitin 2025. Për qëllimet e hartimit të këtyre ndryshimeve, grupi punues ka mbajtur disa takime në vitin 2024 dhe ato pritet të vazhdojnë në vitin 2025 deri në finalizimin e kësaj nisme shumë të rëndësishme.<sup>617</sup>

**445.** Megjithatë, siç thekson raporti vjetor i Komisionit Evropian për vitin 2024, legjislacioni për mbrojtjen nga diskriminimi është përgjithësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare, por zbatimi i tij është i dobët për shkak të kapacitetit të dobët institucional.<sup>618</sup> Në dhjetor 2024, Avokati i Popullit i dorëzoi Kuvendit të Kosovës Raportin e tij Vjetor mbi Zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ku ka identifikuar disa çështje kritike, duke përfshirë: (i) ndërgjegjësimin e ulët institucional në lidhje me rëndësinë e mbledhjes dhe regjistrimit të të dhënave mbi rastet e diskrimin-

614 Për më shumë detaje mbi kuptimin dhe zbatueshmërinë e Nenit 14 të KEDNJ-së dhe Nenit 1 të Protokollit Nr. 12 të KEDNJ-së, shih Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (2024), [Udhëzues mbi Nenin 14 të KEDNJ-së dhe mbi Nenin 1 të Protokollit Nr. 12 të Konventës](#).

615 RrDNj (2024), raporti i përbashkët i OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

616 Zyra e Kryeministrit (2023), [Raport mbi Vlerësimin Ex-Post të Ligjit Nr. 05/L-021 për Mbrojtjen nga Diskriminimi](#).

617 YIHR KS (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

618 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 35.

imit; (ii) mungesën e elementeve kyçe në sistemin e përgjithshëm për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi; (iii) dështimin për t'i zbatuar procedurat e kundërvajtjeve në rastet e diskriminimit; (iv) zbatimin joadekuat të kornizës legjislative mbi diskriminim nga gjyqësori; (v) mungesën e të dhënave institucionale mbi shkeljen e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.<sup>619</sup> Sipas Raportit të Komisionit të BE-së, shkalla e zbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit është veçanërisht e ulët kur bëhet fjalë për diskriminimin/barazinë.<sup>620</sup>

**446.** Diskriminimi në bazë të identitetit etnik vazhdon të jetë një problem i madh në Kosovë, ku dinjiteti, veçanërisht i anëtarëve të komuniteteve rome, egjiptiane dhe ashkali, është i cenuar. Në vitin 2022, avokati Tomë Gashi u gjobit me 2,500 euro pasi kishte shkëlmuar gjësendet e një personi që kërkonte lëmshë në Sheshin Nënë Tereza, gjë që çoi në ngritjen e një ankese kundër tij nga YIHR KS pranë Dhomës së Avokatëve të Kosovës.<sup>621</sup> Pas ankesave dhe padisë gjyqësore kundër Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK) nga Gashi, edhe ankesa në Gjykatën e Apelit dhe në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës përfundimisht u refuzuan, duke vërtetuar masat disiplinore ndaj tij.<sup>622</sup>

**447.** Sipas një Raporti mbi narrativat e mediave online të publikuar nga OJQ D4D në vitin 2024, mizogjinia dhe nxitja e urrejtjes ndaj grave në Kosovë vazhdojnë të jenë të pranishme në media. Shembuj konkretë të postimeve në media tregojnë tendencën për t'i portretizuar gratë si të dobëta (madje edhe ato që janë profesionalisht aktive si avokate ose në profesione të tjera), ndërsa komentet degraduese dhe poshtëruese në përgjigje të postimeve të tilla janë të shumta. I njëjti trend shihet edhe në publikimet mediatike në gjuhën shqipe dhe serbe.<sup>623</sup>

**448.** Diskriminimi prek kryesisht të drejtat që lidhen me arsimin, qasjen në shërbime sociale dhe kujdes shëndetësor, punësimin dhe të drejtën e përdorimit të gjuhës zyrtare.<sup>624</sup> Disa raporte të Avokatit të Popullit theksuan ekzistencën e diskriminimit në lidhje me të drejtat e komuniteteve dhe anëtarëve të tyre, diskriminimin për shkak të moshës së pensionistëve që paguajnë kontribute, të drejtat e personave paraplegjikë dhe tetraplegjikë, përfaqësimin e barabartë të grave dhe burrave në të gjitha nivelet e sektorit publik, kuotat gjinore etj.<sup>625</sup> Diskriminimi ndaj grave, veçanërisht në vendin e punës, mbetet gjithashtu një sfidë e rëndësishme. Gratë shpesh paguhen më pak se burrat për të njëjtën punë dhe janë të nënpërfaqësuara në pozita udhëheqëse. Përveç kësaj, gratë nga komunitetet jo-shumicë, veçanërisht ato nga komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian, vuajnë nga diskriminim i shumëfishtë në lidhje me punësimin dhe qasjen në shëndetësi. Fëmijët me aftësi të kufizuara përballen me diskriminim në qasjen në institucionet parashkollore, ndërsa personat e tjerë me aftësi të kufizuara përballen me diskriminim dhe pengesa në qasjen në shërbimet sociale, arsim, kujdes shëndetësor, pajisje ndihmëse dhe infrastrukturë fizike. Diskriminimi bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor është gjithashtu i përhapur, ku anëtarët e komuniteteve LGBTIQ+ përballen me stigmatizim, diskriminim dhe dhunë.<sup>626</sup>

619 Institucioni i Avokatit të Popullit në Kosovë (2024), [Komunikatë për shtyp – Avokati i Popullit i dorëzoi Kuvendit të Republikës së Kosovës Raportin Vjetor 2023 mbi Zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi](#).

620 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024, f. 31.

621 YIHR KS (2022), [Komunikatë për publikun](#).

622 YIHR KS (2023), [Epilogu i çështjes: Tomë Gashi u shpall përgjegjës për ndërmarrjen e veprimeve joetike, shkelje të detyrave dhe autoritetit të avokatit](#).

623 D4D (2024), [Narrativat në mediat online gjatë muajit prill-qershor 2024](#).

624 Komisioni i BE-së (2024), Raporti për Kosovën 2024.

625 Institucioni i Avokatit të Popullit (2024), [Raporti Vjetor 2023 mbi zbatimin e Ligjit për Mbrojtjen nga Diskriminimi në Republikën e Kosovës](#).

626 CEL (2025), kontribut për raportin e përbashkët të OSHC-ve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë 2024.

**449.** Në Ditën Ndërkombëtare për Zero Diskriminim, më 1 mars 2024, pesë OJQ (YIHR KS, CEL Kosova, CSGD, QKSGJ dhe Civil Rights Defenders) ngritën padi kundër Kuvendit të Kosovës dhe njëres prej deputeteve, Labinotë Demi Murtezi, duke pretenduar se gjuha e saj diskriminuese dhe shpifëse ndaj personave LGBTIQ+ shkelte të drejtat e tyre kushtetuese për ruajtjen e dinjitetit dhe mosdiskriminimin.<sup>627</sup>

**450.** Zbatimi i masave kundër diskriminimit në praktikë ndërlikohet më tej nga koordinimi i dobët në nivelin e komunave. Shumë komunitete të marginalizuara nuk kanë qasje në drejtësi dhe përballen me pengesa në kërkimin e dëmshpërblimit për diskriminim.

**451.** Në nëntor 2024, Samiti i Ballkanit Perëndimor Kundër Diskriminimit Racor u mbajt në Prishtinë nën moton: "Forcë në Diversitet: Një Shoqëri pa Diskriminim Racor".<sup>628</sup> Eventi bëri bashkë udhëheqës, ekspertë dhe aktivistë nga e gjithë Kosova dhe rajoni për të diskutuar dhe zhvilluar strategji që synojnë luftimin e diskriminimit racor kundër komuniteteve romë, ashkali dhe egjiptiane. Samiti u përqendrua në vlerësimin e ndikimit të samiteve të kaluara në politikën dhe praktikën për të luftuar diskriminimin racor, duke reflektuar mbi sfidat e mëparshme dhe mësimet e nxjerra përgjatë viteve.

**452.** Në dhjetor 2024, YIHR KS publikoi raportin e saj me titull: "Gjuha diskriminuese në tekstet shkollë: Një analizë e teksteve shkollë të nivelit të mesëm të lartë në Kosovë".<sup>629</sup> Raporti ofron një shqyrtim të hollësishëm të diskriminimit të manifestuar në tekstet shkollë që përdoren në arsimin e mesëm të lartë në Kosovë. Më konkretisht, në lidhje me diskriminimin, raporti nxjerr në pah gjetjet e mëposhtme: (i) trajtimi i roleve gjinore tenton të mbështetet në strukturat dhe normat patriarkale që i portretizojnë gratë në role të nënshtruara dhe shtëpiake; (ii) përfaqësimi i fëmijëve, adoleshentëve dhe të rriturve më në moshë është shpesh reduktiv dhe i mungon kompleksiteti, duke nxitur kështu një pamje të kufizuar mbi potencialin e individëve gjatë fazave të ndryshme të jetës, gjë që mund t'i dekurajojë nxënësit nga eksplorimi i nuancave të moshës dhe plakjes; (iii) ka lidhje të vazhdueshme të papërshtatshme midis bukurisë fizike dhe vlerës shoqërore; (iv) diskriminimi ndaj personave LGBTIQ+ është si eksplicit ashtu edhe implicit, me paragjykime të qarta dhe të nënkuptuara që pohojnë patologjizimin e vazhdueshëm të identiteteve jo-heteronormative.<sup>630</sup>

### 453. Rekomandimet

- Zyra Ligjore e Kryeministrit duhet të sigurojë që ndryshimet e ardhshme në Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi të jenë plotësisht në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke adresuar veçanërisht anti-gjipsizmin, diskriminimin me bazë gjinore dhe të drejtat e personave LGBTIQ+;

627 YIHR KS (2024), [Ngritet padi kundër Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe deputetes Labinotë Demi Murtezi](#).

628 Terre des hommes (2024), [Samiti i Ballkanit Perëndimor kundër Diskriminimit Racor](#).

629 YIHR KS (2024), [Gjuha Diskriminuese në Tekstet Shkollë: Një analizë e teksteve shkollë të nivelit të mesëm të lartë në Kosovë](#).

630 YIHR KS (2024), [Gjuha Diskriminuese në Tekstet Shkollë: Një analizë e teksteve shkollë të nivelit të mesëm të lartë në Kosovë](#).

- IAP duhet të rrisë monitorimin e rasteve të diskriminimit duke krijuar një bazë të dhënash të centralizuar mbi ankesat për diskriminim, zgjidhjet e tyre dhe përgjigjet institucionale;
- MASHTI duhet t'i rishikojë urgjentisht tekstet shkollore të arsimit të mesëm të lartë për të eliminuar gjuhën diskriminuese, veçanërisht në lidhje me rolet gjinore, përfaqësimin moshor dhe çështjet LGBTQ+. Ky proces rishikimi duhet të përfshijë ekspertë për barazinë dhe të drejtat e njeriut për të siguruar përmbajtje të balancuar dhe gjithëpërfshirëse;
- Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK) dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) duhet ta rrisin mbikëqyrjen gjyqësore të rasteve të diskriminimit duke siguruar që gjykatat t'i japin përparësi dhe t'i gjykojnë në mënyrë efektive rastet e diskriminimit.

